

BABAI HEROI IM





Shkolla 9 - Vjesare "Turgut Özal"

Babai Heroi im

Koncepti dhe Dizajni: Selman FETIAHOĞLU

Kopertina: Dorjan PITANI

Redaktorë: Imelda PRENÇE

Erjon SALIASI

Esmeralda DIBRA

Elda RRUSTEMI

Mësueset:

Merita OSMENAJ

Suela HOXHALLI

Irma DERIAJ

Fatbardha GJURA

Enkelejda VELO

Gidiola HËSA

Jora BANDA

Elona VELIA

Familja është baza e shoqërisë. Në fakt për të parë cilësinë dhe zhvillimin e një shoqërie mjafton të hedhësh sytë nga konstrukti i familjes. Uniteti i nënës me babanë i bazuar në dashuri, respekt, bashkëpunim dhe mbështetje të dyanshme, duke siguruar një atmosferë të shëndetshme familjare, është një nga nevojat më të mëdha të fëmijëve. Brezat që rriten në një atmosferë të tillë kanë për t'u kthyer në një shoqëri të shëndetshme.

Për mendimin tim, roli i babait në familje nuk duhet të jetë të ruajë autoritetin duke thënë "Unë jam babai dhe do të bëhet siç them unë!" Babai shfaq dashuri dhe respekt për të shqen dhe interesohet nga afër për fëmijët, i dëgjon pyetjet e tyre dhe përpiket t'u gjejë zgjidhje, duke patur një disiplinë të caktuar dhe duke ruajtur një ekuilibër mes të qenit hera herës shok dhe kryesisht duke treguar nga rruga e drejtë me dashuri atërore. Fëmija që e ndien të atin pranë zhvillon ndjenjën e të qenit i sigurt, me vlerë, zhvillon vetëbesimin dhe krijon konceptin që ka një vend, të cilit i përket.

Vite më parë, me rastin e festës së nënës, me kontributin e nxënësve u krijua një libër për nënën, në formën e një dhurate për nënat e nxënësve tanë. Këtë vit bashkë me mësuesit e gjuhës dhe nëndrejtorët menduam se do të ishte një gjë e bukur dhe me një mesazh të mirë të bënim diçka të ngjashme edhe për babanë. Projekti i dedikimeve për babanë, një prej dy personave më të rëndësishëm në jetën e çdokujt, nisi me vitin e ri dhe u kurorëzua me dy libra, një për nxënësit e fillores dhe tjetri për ata të arsimin të mesëm të ulët.

Të dy këta libra ruajnë ndjenjat e rreth 1300 nxënësve për baballarët e tyre. Disa e nisin duke thënë "Babushi im", të tjerë "Heroi im". Teksa disa fëmijë e shikojnë babanë si shok, të tjerë e shikojnë si dikë të paarritshëm. Të gjithë dedikimet e çojnë lexuesin larg, drejt kujtimeve të ngjashme, që edhe vetë i kanë përjetuar. Çdo lexues ka për të gjetur vetveten në rreshtat e këtyre librave, të rrethuar nga nostalgjia e atyre ditëve të shkuara. Mbase dikujt mund t'i shpëtojnë edhe lotë.

Teksa i uroj lexim të mbarë kujtdo që i merr këto dy vepra të mëdha në duar, dëshiroj të shpreh falenderimet e mia për punën e palodhur fillimisht për të zotët e projektit, mësuesve tanë dhe më pas nxënësve të dashur.

Drejtori
Selman Fettahoğlu

Babai

Heroi im

Nga prindër dhe mësues

Më vjen pranë, ngadalë dhe më buzëqesh, por vetëm në ëndrra.

U bënë tashmë shumë vite pa Të, pa praninë e Tij në jetë, pa fjalën e Tij. Pak nga pak mbushen 33 vite që është larguar. Kujtimi i tij është i paprekur, i freskët dhe me të njëjtën fuqi, si atëherë kur e kisha pranë, madje mendoj se tani shumëfishohet dashuria për Të, sepse ndërthuret me mallin...

Kam mall të pamatë për tim At..., e nuk e di se çfarë të rendis më parë në këto rreshta. Më duhet të përshkruaj çfarë përfaqësonte ai për mua dhe për njerëzit që e njihnin. Nuk dua ta bëj një figurë mbinjerëzore dhe aq më pak të anashkaloj vlerat e tij të mëdha njerëzore, vlera që prej kohësh nuk i shoh më tek njerëzit e shoqëria.

Një njeri i rrallë, i ushqyer me idealin e së mirës, njerëzores, të thjeshtës. I edukuar me ndjenjën e dashurisë për atdheun, e reflektuar kjo në punën e tij të përditshme, në përkushtimin ndaj profesionit të tij si inxhinier avionësh. I edukuar me dashurinë e madhe për familjen dhe katër fëmijët e tij.

Nuk e njihje gënjeshtren, hilen dhe të ligën. I zgjidhte problemet përherë me qetësi. Qetësi e butësi. Nuk e teproj kur them që ishte vërtet njeri i rrallë. Nuk mbaj mend të ngrinte zërin. E folura e Tij i shkonte për shtat fytyrës së qetë e të qeshur. Kam qenë një fëmijë i bekuar me dy prindër të mrekullueshëm, të cilët më rritën në një shtëpi të thjeshtë, por me vlera të mëdha, me shpirt të madh e human, aty ku kalova vitet më të lumtura të jetës sime: fëmijërinë time. Një fëmijëri e pasur, e mbushur tashmë me kujtimet më të bukura, që sot më bëjnë të buzëqesh dhe të emocionohem njëherazi. Kam shumë mall për babanë tim, për fjalën e tij. Më mungon dora e tij ledhatare, ajo dorë ku u mbështeta kur isha e vogël, ajo dorë që më përcolli kur isha e veshur me fustanin e bardhë të nusërisë.

Malli sa vjen e shtohet më shumë për tim At. Ky mall përzihet me krenarinë që kam qenë bija e një Ati të tillë. Unë mundohem të mbaj në kujtesë të gjallë gjithçka nga babai im: Kujdesin që tregoj për edukimin e fëmijëve të mi, ashtu siç bënte edhe im At në përkushtimin ndaj familjarëve të mi dhe në respektin ndaj shoqërisë.

Vështrimi i tij i ngrohtë, fjalët dhe zëri i tij i qetë nuk kanë se si të shuhen nga kujtesa ime. Babai im do të jetë me mua dhe pranë meje deri sa të më rrahë zemra, deri në frymën time të fundit.

Baba, mbetesh i rrallë, unikal dhe i shtrenjtë për mua.

Mësuese Merita Osmenaj

Akoma ndjej butësinë dhe ngrohtësinë e asaj dore të madhe e të fuqishme.

-Babi, -u lodha!

Dhe krahët e tij më mbështillnin në gjoksin e tij të ngrohtë, ku rehatohesha dhe shplohdesha, për të ecur përsëri pa u rrëzuar, e mbrojtur nga ajo dorë fisnike.

Gjithmonë tek korniza e portës, gjysma e fytyrës dhe syri im priste të shihte një pikë në horizont, që sa vinte e zmadhohej. Ishte silueta e babit tim, më të mirë e më të bukur në botë.

"Mami, mami, erdhi babi!"

Cepi i xhaketës së tij zgjatej nga dora ime e vogël dhe dora tjetër shtrihej për të marrë racionin e ditës (karamelet dhe çokollatat).

Çdo moment i jetës sime pranë tij ka qenë i lumtur.

Afërdita Riveni

Për Ty ... i shtrenjti im!

Po rri mendueshëm dhe syngulur në zbrazëtinë e kësaj letre, ... jo se nuk kam asgjë për të të thënë ..., por kam shumë për TY ... BABAI IM I SHTRENJTË..., SHOKU IM ..., IDHULLI IM ..., HEROI IM ...

Që në vogëli njerëzit më thoshin "Marta sa shumë i ngjan babait tënd kur qesh." Kjo më lumturonte pamasë, por sa shumë e dëshiroja të kisha gjysmën e mençurisë tënde. Më mbaje shumë afër vetes dhe inkurajimi yt ishte motivi im. Gjithmonë më thoshe "Mëso shumë dhe bëhu e zonja, ki respekt për veten dhe po kështu të kesh për të gjithë!" Nuk mërziteshe me mua, edhe tani nuk mërzitesh, madje jemi shokë shumë të mirë. Të kisha zili se lexoje shumë dhe dije çdo gjë, ndaj të kam modelin tim perfekt. Më dhe edukatë e kulturë, por dhurata më e bukur që më ke dhënë është që ti beson tek unë dhe më vlerëson për gjërat që arrij dhe shpesh më thua "...

Je e shtrenjta ime që s' më zhgënjeve kurrë!"

BA ... Të falenderoj dhe përulem përballë teje dhe fisnikërisë tënde me mirënjohje e respekt, për çdo gjë që ke bërë e bën për mua me aq urtësi e dashuri. Je busulla ime, mirëkuptimi im, i mençuri im, këshilluesi më i saktë, mbreti dhe heroi i botës sime!

Të dua në pafundësi, të dua pra shumë se kam gjakun tënd, je babai im ideal dhe i tillë do të jesh gjithmonë ... i shtrenjti im. Të shtrëngoje të puth fort.

Marta PJETËR Skënderi

Jam krenare që jam fëmija yt

Ai është një revolucion i vetvetes, i cili e ka shtyrë veten nga zeroja në numra shumë të mëdhenj, aq sa madhësia e tyre është e paimagjinueshme. Për gjithçka që ai ka arritur në jetë i detyrohet vetes dhe mundit të tij. Koha në të cilën ai duhet të bënte zgjedhjet e duhura ishte nga më të vështirat, por gjithsesi ai mori të gjitha kthesat e suksesshme. Rruga e tij nuk qe gjithmonë e shtruar, madje as në fëmijëri, që ta lejonte atë të ecte drejt pa u kërrusur nga lodhjet e punës, por megjithatë frytet e shpresës dhe mundit të tij, po jepen tani, duke e lejuar që t'i plotësojë sa më mirë ëndrrat që ruajti në zemër. Dhimbjet i ka fshehur me mjeshtëri, gjithnjë nën atë buzëqeshjen e tij të ngrohtë, për të mos i kaluar familjes së tij vuajtjet që dikur kish përjetuar. Pavarësisht çdo problemi e lodhjeje që nuk e lejon të vërë shpesh gjumë në sy, familja është gjithmonë në rradhë të parë. Asnjë nga mrekullitë e kësaj bote, nuk do të ishte fitore për të, nëse s'do të ndikonte në lumturinë tonë.

Prej tij kam kuptuar se çdo gjë mund të arrihet në këtë botë, pa pasur një karakter negativ, pa pasur smirë, zili, xhelozë në shpirt. Ato asnjëherë nuk të çojnë diku, por gjithmonë të ngecin në errësirë, të bëjnë të harrosh që ke një jetë që të është dhuruar, dhe të bëjnë të jetosh më shumë jetën e dikujt tjetër, sesa të gëzosh të mirat që të ka ofruar jeta jote. Megjithatë kjo s'do të thotë të ulësh veten para të tjerëve, por gjithmonë të ecësh me kokën lart, pasi askush nuk vlen aq shume sa të meritojë mërzitjen tënde, aq më pak të derdhësh lot, përveç familjes tënde. Është e vetmja që në mënyrën e saj unike, do të të dojë gjithmonë!

Ai kurrë nuk më imponoi idetë e tij, mendimet apo idealet që ai kishte krijuar, madje ai kurrë nuk më tha si duhet të jetoja, por ai jetoi dhe më dha mundësinë të merrja nga eksperiencat e tij më të mira. Ishte i vetmi, i cili më trajtoi si një zonjushë të vogël ende pa u rritur, dhe që më përkëdheli kur isha shndërruar në një zonjushë. Ishte po ai që buzëqeshte, kur unë buzëqeshja edhe pa e ditur shkakun. Ndërsa kur vija e pikëlluar, ai vuante edhe pse nuk e dinte përse. Tek ai isha e falur, para se të gaboja dhe e harronte gabimin tim, para se të pendohesha. Më arsyetonte para se të kërkoja falje, dhe më gjendej pranë, përpara se t'i kërkoja ndihmë.

Si një fëmijë, unë e kam parë gjithmonë babain tim si një hero. Për mua, ai ishte mjaft i fortë për të mbajtur me një dorë një mal, i gjatë mjaftueshëm për të arritur hënën dhe të ma jepte mua, dhe aq i mençur sa të dinte gjithçka për çdo gjë. Nuk kishte asgjë që babai im nuk mund të bënte. Ai harxhoi mjaft kohë për të më mësuar të lexoja, të shkruaja, ecja dhe flisja. Kur po mësoja të ecja, si çdo fëmijë, unë do të bija herë pas here. Babai im do të më ngrinte lart dhe do të më vinte përsëri në këmbët e mia. Ai gjithmonë më inkurajoi me fjalët që të ngrihesha dhe të provoja përsëri. Nuk ndjeva asnjë dyshim në sytë e tij. Ai më bëri të besoj, se unë mund të arrija çdo gjë që kam vendosur në qëllimet e mia. Ishte veç një fjali e thjeshtë që për mua ndalte kohën, kapërcente distanca, sfidonte jetën dhe që më bënte të kuptoja, që mbrojtja e tij kundrejt meje ishte imune ndaj çdo dështimi. Ai gjithmonë ka thënë: "Jam dhe do të mbetem shumë krenar për ty!"

Megi Këllezi (ish nxënëse)

Klasat e 6-ta

Do të jesh gjithmonë heroi im
Unë e dua shumë babain tim. Babai im është njeriu më zemërgjerë që njoh.
Ai është shumë i dashur me mua, vëllain dhe motrën time. Kur kam një
problem, ai është i pari që ma zgjidh atë. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë
për mua, vëllanë dhe motrën.
Të dua shumë babi im!

Alban Himallari 6A



Ti je babai im!
Të kam ajër,
pa të cilin nuk mund të jetoj.
Të kam mendim,
pa të cilin nuk mund të vazhdoj.
Ti je drita e syve të mi,
qartë më ndihmon të shikoj.
Ti je arsyeja,
që unë sot jetoj.
Ti je kuptimi i jetës sime,
Idhulli im je ti!
Vullneti im, je ti!
Urtësia jote,
është frymëzim për mua.
Je gjithçka për mua,
prandaj BABI IM shumë të dua!

Albin Hoxha 6A



Babai im e ka emrin Dejvi dhe është heroi im. Mua më ka mbështetur shumë
në çdo veprim dhe në çdo vendim që kam marrë. Ndonjëherë ai edhe më ka
bërtitur për gjërat e gabuara që kam bërë. Shumica e fëmijëve mendojnë se
babai na bërtet, sepse na ka inat, por e vërteta është se ai na bërtet, pasi na do
të mirën. Prandaj unë e dua shumë atë dhe i them të gjithë fëmijëve në botë,
që t'i duan të gjithë baballarët në tokë.

Arbi Çiftja 6A

Babai im është njeriu më i mirë në të gjithë botën, është i adhureshëm. Ai është me mua gjithmonë dhe në çdo moment. Babi im është një mrekulli për familjen tonë, është dhurata më e bukur që ne kemi. Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë, njeri me shpirt të pastër e të bukur, që në jetë ka hasur shumë vështirësi, që në fëmijërinë e tij. Në moshë shumë të vogël iu desh të punonte, duke i vështirësuar ndjekjen normale të studimeve. Ai e do shumë punën dhe përpiqet që në familjen tonë të mos mungojë asgjë. Ndiej shumë keqardhje, kur ai tregon për fëmijërinë e tij, ajo nuk krahasohet me jetën që ne bëjmë. I shtrenjti baba, me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti.

Je si një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si një busull drejtuese, për mua. Je këshilluesi më i saktë e që më bërë të mos gaboja kurrë në jetë.

Alvis Qëndro 6A



Heroi im je ti

Ti je njeriu më i shtrenjtë për mua
Babai im i dashur,
o sa shumë të dua,

Ti je njeriu më i shtrenjtë për mua,
dhe unë gjithmonë do të të dua.

Gjithmonë ti ke qenë aty për mua,
çdo dëshirë që kam pasur, ti ma ke plotësuar,
me mund ti, më ke edukuar,
e për të ecur në jetë, me nder më ke mësuar.

Deri më sot nuk e kam kuptuar,
se sa i rëndësishëm je ti për mua!
Pa ty asgjë nuk ka kuptim,
as udhëtime e as pasuri.

Tani e kuptoj më mirë,
se TI BABI je heroi im!

Kejsi Qato 6A

Babi, dashuria jote më rrit

Babi është heroi im. Ai kujdeset dhe më mbron gjithmonë. Nëse unë kam një problem ose një kërkesë, vjen dhe diskuton me mua dhe më jep këshilla ose më plotëson një dëshirë timen. Babi, ti je ai që punon dhe na siguron shkollimin dhe edukimin më të mirë. Babi, të jam mirënjohëse për gjërat që na jep, na siguron, na shkollon dhe më e rëndësishmja na do pa kushte dhe kjo dashuri ne na rrit! Babi, të dua!

Livia Murataj 6A



Babai ideal për mua

I shtrenjti baba, thellë nga shpirti më dalin këto fjalë. Je idhull për mua! Je heroi im! Je shembulli më i mirë për mua! Je shoku më i denjë që kam! Je ai që më mirëkupton më shumë. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar gjithmonë ke qenë aty për mua. Je ai që më ndihmon të zgjedh rrugën e drejtë. Je këshilluesi më i saktë që më bën të mos gaboj kurrë në jetë. Të dua shumë, sepse kam gjakun tënd, sepse jam djali yt që nuk të zhgënjën kurrë. Gjithmonë unë do të ndiehem krenar për ty! Je babai ideal për mua! I tillë do të mbetesh deri në fund!

Buen Hoxha 6A



10 arsye përse të dua

1. Ti je kujdesur gjithmonë për mua.
2. Asnjëherë s'je kursyer për ne.
3. Te ti gjithmonë mund të mbështetem.
4. Ti je personi më i rëndësishëm për mua.
5. Ti me mamin jeni të vetmit persona që s'më keni lënduar kurrë.
6. Unë nuk e kuptoj përse rri i mërzhitur dhe kjo është një arsye pse s'mund të të ndihmoj.
7. Unë do të jem gjithmonë aty për ty edhe kur mos të më kërkosh.
8. Pa ty jeta ime s'do kishte kuptim, sepse ti ia vlen në çdo kuptim.
9. Unë jam shumë krenare për çdo arritje tënden, sepse çdo arritje e jotja më ka bërë kjo që jam sot.
10. Ti më ke dhënë forcë të përballoj çdo gjë dhe për këtë të falenderoj. Të dua shumë babi!

Greis Koka 6A

Shembulli yt më frymëzon
 Babi, të dua!
 Ti je kujdesur shumë për mua.
 Shembulli yt më frymëzon,
 do të të ndjek nga pas gjithmonë.
 Je i dashur,
 je korrekt,
 më frymëzon në çdo aspekt.
 Punëtor e zemërgjerë,
 I qeshur ti je kurdoherë.

Rei Xhoga 6A



Ti je heroi im
 Babi, o babi, të dua shumë,
 që kujdesin për mua e ke në maksimum.
 Ti je heroi im,
 që çdo ditë timen e bën plot shkëlqim.

Çdo herë ti më shpëton,
 e çdo ditë për ne punon.
 O babi, unë të dua fort,
 më shumë se çdo gjë në botë!

Laura Çela 6A



Ti je idhulli im!

Babi ti je heroi im, më i madhi që kam pasur ndonjëherë. Ti më ke ndihmuar gjithmonë me detyrat dhe më ke blerë gjithçka kam dashur. Më ke çuar në çdo vend dhe kurrë nuk më ke mërëzitur. Ti ke pasur çdo herë kohë të luash me mua dhe kurrë nuk më ke thënë "jo"! Ti m'i ke plotësuar të gjitha dëshirat në kohën kur doja unë dhe kur kishte mundësi! Ti je idhulli im! Ti je gjithçka për mua! Pa Ty Unë Nuk Do Të Isha Asgjë!

Deivi Gani 6A



Babi ARBENI, je mbreti im. Më ke mësuar gjërat më të shtrenjta për jetën time. Nuk kam ku t'i gjej ato fjalë të urta që m'i thojë ti. Më pëlqen kur jam aty pranë teje. Respekti im për ty është shumë i lartë dhe të dy e dimë këtë. Dhe ndoshta notat e mia nuk të pëlqejnë, por ta dish se të kam në zemër dhe do të të kem gjithmonë. Nuk e përshkruaj dot lidhjen tonë të fortë. Nuk kam më fjalë të të përshkruaj, Mbreti Im.

Ajsel Mlika 6A

Ti je kryefjala e jetës
Fjala e parë në jetën e çdo fëmije,
Je ti, baba.
Dashuria e madhe e çdo fëmije,
Je ti, baba.
Heroi i djalit tënd gjithmonë,
Je ti, baba.
Jorgani i çdo gabimi gjithmonë,
Je ti, baba.
Ai që mërzitet për çdo lot që rrjedh,
Je ti, baba.
Ai që për lumturinë tonë bëhet lumë që rrjedh,
Je ti, baba.
Ai që më bën të guximshëm në çdo aspekt,
Je ti, baba.
Ai mashkull që çdo herë më flet me respekt,
Je ti, baba.

Adri Pjetërgjokaj 6A



Babi, Je Heroi Im
Babi im, babi im,
të kam pranë në çdo veprim,
ti je i gjatë, i fortë, i shpejtë,
dhe kokëfortë ndonjëherë.
Ti mua më mëson,
çdo ditë gjëra të reja,
pa ty këto gjëra,
kurrë s'do t'i bëja.
Kalojnë minuta e sekonda,
por me ty shpërthej si bomba.
Ti më ndihmon ta shikoj botën,
me një tjetër këndvështrim,
pa bërë asnjë gabim.
Babi, Je Heroi Im!

Erik Heidorn 6A

Për më të shtrenjtin tim

Babai im është njeriu më i mirë në botë. Për çdo gjë ai më gjendet gjithmonë pranë. Këtë ese unë po ia dedikoj më të shtrenjtit tim. Me raste ai dhe nxehet e më bërtet pak, por unë e kuptoj se ai e ka për të mirën time dhe kur i kërkoj falje ai e pranon faljen, sepse e di se unë e kam kuptuar gabimin. Babai im më kupton gjithmonë dhe më këshillon e më flet si të më ketë shokun e tij të ngushtë. Në çdo moment që jam vetëm me babanë tim kënaqem shumë, sepse ne flasim bashkë për çdo gjë. Një shprehje për babin tim: "I vetmi çelës për të më hapur zemrën dhe për të më ngritur humorin, është zëri i babit tim të mrekullueshëm."

Geldi Pepa 6A



Ti më je gjithmonë pranë

Babi, je më i miri në botë. Gjithmonë më je gjendur pranë kur kam pasur nevojë për ty dhe akoma vazhdon të më gjendesh pranë. Të falenderoj nga zemra për çdo gjë që ke bërë për mua deri më sot. Je babai më i mirë dhe ta dish që të kam shumë xhan. Përpiqesh që mua të mos më mungojë asgjë dhe të falenderoj nga zemra. Për mua je dhe do të mbetesh babai më i mirë..

Gledis Bajrami 6A



Personi më i fortë

Personi më i fortë para syve të mi,

Heroi më i mirë për fëmijën e tij.

Ndihma më e shpejtë për çdo njeri,

Lumturi të japin sytë e tij.

Është ai që ka qenë hero gjatë gjithë jetës së tij, Babai Im!

Greta Xhemo 6A



I dashur baba,

Për vite me radhë më kanë thënë se i ngjaj tim eti. Kjo nuk e di në të ka ardhur në mënyrë të afërt apo jo... Rëndësi ka se gjithmonë e kam pritur me shumë krenari. Megjithatë nuk kam arritur ta pranoj asnjëherë përpara syve të tu. Të kam lënduar e më ke lënduar po në të njëjtën mënyrë, prapë më do dhe të dua, edhe pse s'ta kam thënë. Edhe për këtë ty të ngjava. M'i mësove ti të tëra. Si t'i mbaj gjërat përbrenda, si t'i them në sy... Ashtu si ç'thotë populli, nganjëherë fjalët janë vërtet fukarallëk. Eci në bulevard i tretur dhe përjetësisht më torturon ideja që s'të kam thënë asnjëherë "të dua", ndërkaq që kanë qenë dy meshkuj të tjerë që u kam thënë të njëjtat fjalë, që ty s't'i thashë asnjëherë! Në qoftë se s'ta thashë dje, në qoftë se s'ta them sot, atëherë më humb shpresa se do të mund të ta them më vonë.

Alfred Gabili 6A

Krenaria ime je ti!

Babi heroi im, lumturia ime, shpresa ime. Personi më i rëndësishëm në këtë jetë. Krenaria ime në çdo aspekt. Më je gjendur pranë në çdo moment. Jam krenare që jam vajza jote. Nuk do të resht kurrë së menduari për ty. Prandaj shumë të dua. Faleminderit për çdo gjë që ke bërë për mua. Dashuria jote më ka ndjekur kudo. Ti do të jesh gjithmonë personi numër Një në jetën time. Dhe kjo kurrë nuk do të ndryshojë!



Mesila Hoxha 6A

Për një person, bota s'feston. Për një person festë nuk duhet që zemrën t'i tregosh. Një njeri në jetën time kurrë s'më lëndon. Historinë time veç kupton. Në momentin e keq ai më shpëton dhe si shpërblim veç një gjë kërkon, lumturinë dhe dashurinë. Të dish, të duash e të kuptosh se kurrë në jetë s'do fitosh, po të kopjosh. Mos t'i ikësh nga duart, të dish një gjë, i vetmi person, për ty, është ky hero. Mos harro kurrë, se kush je. Unë jam vajzë e babit në këtë atdhe e këtë gjë kurrë s'e harroj, se veten time kurrë s'e kuptoj, veç babi im më kupton dhe më gëzon. Lumturia ime, familja ime, zemra ime, varet nga një njeri. Ai është vetëm babi im. Unë e dua, ai më do dhe këtë gjë s'e ndalon kush!



Selvi Shamo 6A

Babi im është një hero i vërtetë. Gjithmonë m'i plotëson dëshirat që unë kam. Nuk lodhet asnjëherë nga ne. Edhe kur vjen nga puna i lodhur dhe vëllai im i vogël kërkon lodra të reja, nuk e kam dëgjuar ndonjëherë të thotë jo. Edhe nëse unë nuk shkoj mirë me mësimë babi më inkurajon dhe më thotë të mos dorëzohem asnjëherë. E dua shumë babin tim. Ai është si një engjell mbrojtës për mua. Dhe në verë për ditëlindjen time më çoi në Disney Land. Kjo ishte një surprizë shumë e bukur për mua. Edhe unë dua të bëj diçka për t'ia shpërblyer gjithë këto të mira që na ka bërë. Nuk mund t'i shkruaj dot të gjithë ndjenjat që kam për të. BABI im të dua shumë!

Shefrin Shtylla 6A



Baba, je heroi im
Ti për mua ke më shumë se një kuptim,
gjithmonë do të të kujtoj,
kurrë këshillat e tua nuk do t'i harroj!
Në mendjen time,
kemi shumë kujtime.
Për ty malli më ka marrë,
pavarësisht se të shoh çdo natë.

Albi Çela 6B

I shtrenjti Babi im

Babi im është i shtrenjtë siç është për çdo fëmijë babai. Ai na ka qëndruar pranë në çdo moment të jetës sonë. Edhe në ato momente që kanë qenë shumë të vështira, por edhe në ato të mirat. Ai ka sakrifikuar shumë për ne, çdo gjë e ka vetëm e vetëm për ne. Babi im ka bërë gjithçka për mua. Jam djalë që ka bërë shumë gabime, por ti më ke falur gjithmonë. Tani që jam rritur kam shumë nevoja, por ama kam edhe shumë përgjegjësi. Edhe ditët që ke munguar më ka marrë malli shumë për ty. Për ty jam shumë krenar. Shpresoj që edhe ti të jesh krenar për mua kur të rritem. Ti më ke dalë gjithnjë krah. Je shumë i shtrenjtë për mua. Nuk e di se çfarë mund të bëj pa ty. Tani nuk i kuptoj sakrificat e tua, por kur të rritem jam shumë i sigurt që do t'i kuptoj ato dhe punën e lodhshme tënden. E di që është e vështirë të rritësh tre fëmijë si ne. Ne kemi patur shumë teka, por ti me nënën time keni bërë shumë dhe na i keni plotësuar. Unë ju jam shumë mirënjohës, besoj dhe vëllezërit e mi.

Alden Malaj 6B



Babai ideal

I shtrenjti baba, je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë udhëheqësi më i mirë për mua. Je ai që më ka ndaluar të mos gaboj e të mos veproj pa menduar. Je këshilluesi më i saktë që më ndihmon të zgjidh çdo problem. Do përpiqem të mos gaboj kurrë në jetë duke ndjekur këshillat e tua. Të dua shumë, sepse kam gjakun tënd, sepse jam djali yt që nuk të zhgënjën kurrë. Gjithmonë unë do të ndihem krenar për ty. Je babai ideal për mua.

Arkadis Berberi 6B



Vendi i veçantë në zemrën time të takon Ty

Çfarë mund të them për të? Ai është njeriu më i mirë, më i dashur dhe ai që më plotëson të gjitha dëshirat e mia. Që kur kam qenë e vogël, me të kemi qenë shumë të lidhur me njëri-tjetrin, si një trup e një mendje të lidhur bashkë. Mbaj mend shumë mirë se mami më ka thënë se babi donte shumë të kishte një vajzë, por si përfundim në fillim pati një djalë, vëllanë tim të madh. Më pas ëndrra iu plotësua dhe pati një vajzë, mua. Nuk e di, nëse ai ka qarë kur më ka parë për herë të parë, po nuk dua t'ia di, sepse derisa di që ai më do e do të më dojë përgjithmonë, kjo nuk ka rëndësi. Me babin kam pasur shumë aventura, sepse ai është shoku im më i ngushtë. Ai nuk është vetëm një baba, ai për mua është një shok, një mbret e një thesar i çmuar. Dhe mbi të gjitha është heroi më i madh që do të më mbrojë e nuk zëvendësohet nga askush në jetën time. Sepse të gjithë kanë vende të ndryshme në jetën time, por ai zë vendin e tij të veçantë në zemrën e jetën time. Të Dua Babi, Më Shumë Nga Të Gjithë!

Dea Xhemalaj 6B

Me zemër ti më ledhatove
Që nga momenti që linda, ti më mbështete,
për të ardhmen tonë mendove,
Dhe me zemër ti më ledhatove.
U rrita, u poqa, prapë ti më mbështete,
gjithë këto kohë pranë teje kam qarë,
kam qeshur e jam trishtuar,
kam arritur qëllime të vështira.
Ti u gëzove dhe përsëri më ledhatove,
pikë loti ti nuk nxore,
se je burrë dhe burrat s'qajnë.

Ti ke arritur kryen,
nuk mendoj se do të të kap,
por gjithashtu betohem,
se do të kem besim në vete,
e përpara do të eci.
Ty krenar do të të bëj,
siç ke bërë ti prindërit e tu.
Sa herë më ke bërtitur,
ca herë mësim kam marrë,
ca herë veshin s'ua kam vënë.
Po tregohem i sinqertë, o ba
prandaj unë ty të dua!

Enis Allajbeu 6B



Heroi im

Babai im është personi që më ka ndenjur pranë gjithmonë, më ka mbrojtur e më ka mbështetur. Një nga personat më të rëndësishëm në jetën time, të cilit i përkushtoj shumë dashuri dhe më vjen inat që për të nuk ka asnjë festë. Por nuk ka problem, sepse për mua çdo ditë është një festë e bukur kur jam me babanë tim. Megjithëse unë jam shpesh herë i pabindur, ai përsëri nuk mërzitet dhe fillon të jetë po i njëjti person i dashur e punëtor i palodhur. Ai punon ditë e natë vetëm për të më shkolluar mua dhe që të më rritë mua. Është e vështirë ta shprehësh tërë këtë dashuri, siç është e vështirë ta shpërblesh tërë këtë mund dhe këto vuajtje që ka pasur dhe kaluar për mua Heroi Im.

Arbri Peka 6B

Njeriu që të mban në zemër gjithmonë
 Babai im, heroi im, njeriu më i veçantë dhe më i dashur. Njeriu që gjithmonë më ndihmon, më mëson, më bën të kuptoj kuptimin e jetës, të dashurisë. Ti je njeriu që lodhet natë e ditë për të më bërë mua dhe familjen të lumtur. Baba, je njeriu që gjithmonë të mban në zemrën e tij, dhe me vuajtje e me hidhërim. Njeriu që gjithmonë të beson, edhe në momente të këqija. E mbaj mend se sa shumë luanim bashkë e ziheshim gjithashtu. Akoma i kemi ato zënkat e vogla për gjithçka të vogël a të madhe. Sa shpejt kaluan vitet që nga koha kur isha fëmijë! Mbaj mend që gjithmonë më bëje të qeshja, madje edhe tani më bën. Më argëton në çdo mënyrë të mundshme. Ti gjithmonë je i zënë dhe jo ngaqë dëshiron ti, por sepse do të na bësh ne të lumtura. Je kurdoherë i stresuar dhe me dhimbje koke kur vjen në shtëpi. Ti vjen në orët më të vona, por prapë nuk ndikohesh nga lodhja, prapë më mëson kur ke mundësi, prapë del me mua, prapë më argëton, prapë më bën të lumtur. Ti je dhurata e Zotit, sepse nuk besoj që të gjithë fëmijët mund të kenë një baba kaq të mrekullueshëm, kaq zemërgjerë, kaq heroik. Je një dhuratë më e shtrenjtë se diamanti e më e shtrenjtë se çdo gjë tjetër. Je një dhuratë e pakrahasueshme, një dhuratë që të gjithë e nderrojnë. Unë e di që ti je dhe i rreptë, pasi gjithmonë mendon për të ardhmen time, për arsimimin tim, për jetën time para tëndes. Baba, është fjala që gjithmonë i jep zgjidhje problemeve, fjala që gjithmonë i jep kuptim jetës sime. Ai është mbrojtësi im nga çdo gjë që më ndodh. E di që fjalët nuk janë të mjaftueshme, por janë nga zemra. Janë fjalët më perfekte që një njeri mund të thotë. Dua të të them që je jeta ime, je gjithçka për mua, je babai më i mirë në botë. Gjithmonë do të të dua, edhe pse shumë gjëra mund të ndodhin. Faleminderit për gjithçka!

Dea Merkaaj 6B



Babi, je njeriu më perfekt

Nëse në jetën time ka një mashkull për të cilin do të jepja jetën, JE TI. Të dua aq shumë, aq marrëzisht sa që pa ty në jetën time, s'do dija ç'të bëja, s'do dija të ecja, s'do dija të jetoja. Për mua je njeriu më perfekt që ekziston, jo sepse je Babi im, por sepse je me të vërtetë një njeri që në këtë botë apo në tjetrën nuk ekziston një tjetër si ty. Ndihej mirë kur të shoh. Ndihej mirë kur më flet. Ndihej mirë kur më shikon, kur më përqafton. Ndihej mirë në çdo hap që bëj. Të shoh dhe e kuptoj që po plakesh dhe s'e ke idenë se sa e vuaj këtë gjë. Do bëja gjithçka që të të shikoja gjithmonë njësoj, me atë buzëqeshjen tënde që më bën njeriun më të lumtur në botë e më jep kurajo atëherë kur mendoj se jam keq, që më jep forcë të përballoj çdo gjë në këtë jetë që vetëm të përplas. Të dua shumë, BABI!

Sead Kafellari 6B

Babi je mbrojtja dhe forca ime

Babai! Ç'vlerë i kemi kushtuar ne atij? Është e vërtetë që nëna ka sakrifikuar shumë për të na dhënë një jetë, por nuk është e gjitha. Jeta ka nevojë për një mbrojtje siç ka nevojë truri për kafkën, veza për lëvozhgën dhe zemra për trupin. Por babai, përveçse mbrojtje, është edhe forcë, si luftëtari ka nevojë për mburojën, por edhe për shpatën. Farën e bën pema, por ne e rritim atë dhe e mbrojmë. Në jetën tonë mami është fara, ujitja, dielli dhe përkujdesja. Babi është trungu, që mban degët dhe gjethet. Pa trungun pema është një pirg gjethesh. Pa gjethet dhe degët, pema është një trung i thatë. Babi janë këmbët, mami janë duart. Pa këmbë ne nuk ecim dot, pa duar ne s'bëjmë dot asgjë. Babi është zemra, mami është mendja. Mendja është mendimi, zemra është vepra. Pa mendje, zemra s'di si të veprojë. Pa zemër, mendja s'di si të mendojë. Jeta pa mamin nuk di si të shërohet. Jeta pa babin nuk di si të lëndohet. Djemtë zakonisht kur rriten ndjekin shembullin e babait të tyre, sepse babai është heroi i tyre. Unë do të ndjek shembullin e babait tim, sepse ai është heroi im!!!

Boris Metaliaj 6B



Je heroi im

Babai im, të dua shumë. Je ti i vetmi mbreti im. Ti je mbreti që sundon në zemrën time. Engjëlli im që fal vetëm dashuri. Je jeta ime. Je heroi im. Je një nga gjërat më të çmuara të jetës sime. Je ti ai që më ka mbështetur në çdo sfidë të jetës sime. Më ke plotësuar çdo dëshirë që kam pasur. Dhurata ime më e çmuar në këtë jetë je ti dhe familja ime. Të dua, babai im!!!

Darius Çollaku 6B



Babai im është gjithçka për mua. Unë kaloj shumë kohë me tim atë. Ai më ndihmon për çdo nevojë që kam. Kur mërzitem për diçka, ai më bën që t'i kaloj gjërat sa më shpejt. Kur kam ndonjë problem, flas me të dhe ai më dëgjon me vëmendje e përpiket me fjalë të ngrohta e me një përqafim të më japë kurajo e të më qartësojë. Ne udhëtojmë shumë shpesh. Na pëlqejnë aventurat dhe argëtohemi pafund me njëri-tjetrin. Zakonisht ne të dy jemi më gazmorët në familje. Babi është një mik shumë i mirë, sepse kur i tregoj një sekret ai nuk e nxjerr. Në familje unë kam edhe një vëlla më të madh, por babi mua më llaston më shumë. Babi është një burrë i mençur e i shkathët, që vë familjen para gjithçkaje dhe gjithmonë përpiket që ne të jemi sa më të arsimuar dhe të rritemi të lumtur. Ai është heroi i ditëve të mia! Sa me fat ndihem që jam vajza e tij!

Ekaltra Sulçe 6B

Babai im është njeriu që unë dua më shumë. Ai më plotëson çdo dëshirë dhe asnjëherë nuk më bërret, por më lejon që të bëj çfarë të dua. Ne zakonisht e shpenzojmë kohën me njëri- tjetrin në lagje, duke bërë xhiro me biçikletë. Babai im më ka mësuar shumë gjëra dhe unë e falenderoj për këtë. Gjithmonë më ka thënë se çfarë është e saktë dhe çfarë është gabim. Babai më kupton më mirë se mami, prandaj unë gjithmonë bisedoj me atë të parin dhe pastaj me mamin. Ai është shoku im më i ngushtë dhe unë e dua shumë.



Enea Hoxha 6B

I dashur babi,

Ka shumë gjëra që unë dua të të them. Por unë nuk gjej dot fjalët ose nuk gjej dot kohën apo vendin e duhur. Por në këtë letër të veçantë, babi, do të gjesh të paktën pjesërisht, ndjenjat që këto vite kanë zënë vend në zemrën time. Unë mund të kujtoj ende ecjet tona, lojërat që luajtëm, ato bisedat tona. Kjo letër vjen për të falënderuar babin tim, për fjalët e nevojshme edhe këshillat dhe udhëzimet, që formuan ditët e mia të rritjes. Asnjë fjalë nga unë nuk mund të tregojë, babi, gjërat që me të vërtetë ndiej, por ti duhet ta dish se dashuria ime për ty është e madhe, e ngrohtë dhe e vërtetë.

Erkli Boka 6B



Shoku i ngushtë i jetës sime

Ai që më ka qortuar për gabimet. Ai që punon e lodhet për ne. Për këto sakrifica ne s'do të të harrojmë kurrë. Ka momente të vështira që ti i kalon pa u ankuar kurrë. S'ka nevojë për t'u mërzitur, sepse ti je burrë i rëndë. S'të pikon pika e lotit, sepse burrat nuk qajnë. Pranë teje kam qeshur e qarë. Me përqaftimin tënd të ngrohtë më ke marrë në krahë dhe jam krenar që të kam ty baba.



Ergi Tahiri 6B

Ti je gjithë bota ime
 Babai im i dashur,
 sa shumë më ke lumturuar.
 Gjithmonë më përqafton,
 e gjithmonë më përkëdhel.
 Ti ke qenë i pari,
 që kam dashur pafund.
 E kurrë s'të kam zhgënjyer,
 prandaj do të të dua përgjithmonë.
 Ti je Gjithçka për mua,
 Je Babai Im, Heroi Im!

Ines Balliu 6B

Babit tim
Babi, o babi im,
Ti je heroi im!
Që nga momenti që linda,
Ti ke qenë afër meje,
Ti më ke mbështetur në çdo hap të jetës sime.
Babi, o babi im,
Unë të dua shumë!

Eskobar Elezi 6B



Babit tim

I shtrenjti babai im. Jam unë djali yt i parë, ai djalë që ka bërë gabime në jetë dhe ka kuptuar shumë. Ai djalë që bën gjithçka që të ndihesh krenar për djalin që ke dhe ke rritur. Ai djalë që është krenar për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë. Punon për familjen tonë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na dhënë të gjitha të mirat që kemi nevojë, duke na plotësuar të gjitha kushtet. Babi, kur unë të dal të punoj, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, ç'është të rritësh fëmijë. Babi im, kam shumë fjalë për të thënë, fjalë që nuk mbarojnë. Të dua shumë dhe jam shumë i kënaqur e i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti. Ti dhe mami jeni pasuria ime. Për ju të dy fal dhe jetën. Ju dua shumë.

Joel Metaj 6B



Babai im, heroi im
Babai im, ai që më sjell gëzim,
Ai që për ne mendon,
Ai që jetën ma zbukuron,
Ai që për ne sakrifikon.
Ai që më jep hare,
pa ty jeta nuk do të kishte kuptim,
pa ty nuk do të jetoja unë tani.
Ti je ai që jetë më jep,
ja pse unë do të të dua përjetë!

Klara Muça 6B

I dashur ba
 Ti je kujdesur shumë për mua,
 Ti mua më ke si shokun tënd,
 Ti je heroi im, ndaj
 Unë të dua shumë!



Klei Shkupi 6B

Fjala më e bukur në botë

Babai im nuk është hero. Ai është Supermeni ose jo më mirë Batmani. Dikush mund të thotë që fjala baba nuk ka vlerë, por për mua është fjala më e bukur në botë. Pse nuk ka një festë për baballarët siç është për nënat? Kjo është e padrejtë. Baballarët punojnë tërë ditën dhe kur vijnë natën vonë përsëri nuk janë lodhur. Babi im është punëtor, por dhe ndonjëherë dembel gjithashtu. Sa herë babin kam afër, ndihem e sigurt. Atij mund t'i shpreh çdo gjë dhe të ndihem e lirë. Ai kujdeset për mua më bën të ndihem si princeshë. Ai është idhulli im, zemra ime, është mbreti im. Pa babanë tim, jeta s'do të kishte kuptim. Sa të dua babi! Ti je i veçantë. Si ti s'ka tjetër. Çdo dëshirë ma plotëson dhe gjithmonë e tepron. Je i palodhur dhe i mirë me të gjithë. Sa të dua ty, o baba, s'do të dua asnjë sa të jem gjallë. Je dhurata më e bukur që kur kam lindur. Të Dua Heroi Im!!!!



Klejsa Neza 6B

Babai im, një nga qeniet më të bukura njerëzore, një nga njerëzit më të çmuar për çdo fëmijë në botë. Babai është ai i cili nuk lodhet kurrë duke nxjerrë fjalë të bukura nga goja, ai i cili është më i plotfuqishmi dhe që asnjëherë nuk dorëzohet për fëmijën e tij. Të gjithë baballarët në botë kanë të njëjtin qëllim. Të jenë të dashur, të mirëkuptueshëm dhe të fuqishëm. por ai është më i veçantë sepse është babi im.

Klea Kaloshi 6B



Ti më bën KRENARE!

Babi im lodhet për ne, sakrifikon për ne, bën çdo gjë që është e mundur vetëm për të na bërë të lumtur mua dhe vëllanë tim dhe unë i jam shumë borxhlie. Gjëja më e vogël që mund të bëj, është të dal mirë me mësim, duke i dhënë atij lumturi. Ti më ke dhënë besim në vetvete dhe unë jam shumë krenare për veten time. Ndonjëherë më ke qortuar, por ka qenë e vlefshme. Na ke bërë të kalojmë momentet më të bukura të jetës ose pushimet më të bukura. Më ke mësuar shumë gjëra që nuk do i kisha të lehta për t'i mësuar pa ty. Edhe pse ndonjëherë kemi kaluar ditë të këqija, unë nuk mërzitem, sepse ka pranverë, por ka dhe dimër. Unë e di që ti kalon shumë vështirësi në punë dhe je shumë i lodhur, por kur je me ne përpiqesh mos t'i vësh në dukje duke mos na shqetësuar. Unë një ditë do të gjej princin tim, por babi, ti do të mbetesh mbreti im! Jam shumë krenare që të kam baba ty dhe do të jem gjithmonë!

Tania Shoraj 6B

Babi, një nga fjalët më të magjishme. Një fjalë që veshi kurrë nuk lodhet së dëgjuari. Një fjalë që të nxjerr edhe nga skutat më të thella të errësirës. Babi, ai që nuk lodhet kurrë së thëni fjalë të mira, ai që kurrë nuk heziton të të japë një përqafim. Ai gjithmonë të mbështet, pavarësisht se e gjithë bota mund të të ketë dalë kundër. Babi im, je heroi im që zemrën ma mbush plot gëzim!

Luisa Spahiu 6B



Kur përmend emrin tënd
Më vijnë ndërmend shumë mendime
Pa ty jeta është më e vështirë
Pa ty jetën nuk e mendoj dot
Kur jam me ty ndihem plotësisht i mbrojtur
Babi, të dua shumë

Ardian Marinaj 6C



Thellë brenda zemrës sime

Nëse fjala ime e parë ka qenë Nënë, e dyta pa diskutim ka qenë Baba. Ti je krijesa më e fortë që kam parë në këtë botë, që mund të përballosh çdo gjë. Çdo ditë vjen i lodhur nga puna, por megjithatë gjithmonë arrin të na japësh buzëqeshjen tënde të ngrohtë. Ti në çdo moment je i hapur me mua dhe kërkon të marrësh mendimin tim, edhe nëse ai nuk është i vlefshëm. Këshillat e tua janë fjalët më të çmuara për mua dhe që duhet t'i kujtoj në çdo çast. Nëse nuk t'i kam thënë kurrë këto fjalë, ky është momenti dhe vendi i duhur për ta bërë. E di, sakrificat e tua janë të panumërta për ne, që të mos na mungojë asgjë. E di, me këto fjali nuk mund të ta shpërblej, por e di që me këto fjalë do ta kuptosh se sa shumë të dua dhe se të kam gjithmonë në mendje. Çdo moment me ty është një eksperiencë e paharrueshme, ose një aventurë përrallore. Nëse mendja jote është e mbushur me çështje pune që futen dhe dalin nga ty, jam e sigurt që vetëm ne nuk të dalim nga mendja asnjëherë, nga mendja jote e mbushur me dije. Nëse nuk t'i kam thënë të gjitha gjërat, dua që ta dish që ato janë thellë brenda zemrës sime.

Amisa Lesha 6C



Babi im është njeriu më i mirë në të gjithë botën, është i adhurueshëm. Ka qenë aty gjithmonë. Babi im është mrekulli, madje është dhurata më e bukur që mund të bëhej. Është perfekt, është burri që i qëndron më së miri roli i prindit, është i pabesueshëm. Unë dhe vëllai im jemi me fat që e kemi. Ka qenë aty për të gjitha gjërat, kur thamë fjalën e parë, kur bëmë lëvizjen e parë, në ditën e parë të shkollës, në festën e abetares, sa herë që jemi sëmurë dhe sa herë që kemi festuar. Babit duhet t'i them faleminderit, për shkollën që po më jep, për dëshirat që m'i ka plotësuar dhe mbi të gjitha për jetën që më ka ndërtuar, një jetë me të gjitha të mirat. Duhet t'i kërkoj falje jo vetëm babit, por edhe mamit për shumë gabime, por mund t'u premtoj që do t'ua shpërblej sa më parë.

Brajan Nesim 6C

Heroi im je ti, je ai që më mbron. Je gjithçka në trupin tim. Kur ty të dhemb diçka, mua më dhemb i gjithë trupi. Prandaj po të shkruaj se e meriton, je gjithçka që ka kjo botë. Ti edhe kur unë bëj ndonjë gabim më qorton dhe më këshillon ashtu si vetëm ti di. Sa të dua, o baba!



Brian Duriçi 6C

Babin tim unë e dua shumë. Ai më ndihmon sa herë që kam vështirësi në mësim dhe për ndonjë gjë të përditshme që unë nuk e bëj dot. Ai më vjen e më ndihmon sa herë që unë e thërras. Më qorton ndonjëherë, por e ka për të mirën time dhe do më të mirën për mua. Ne luajmë së bashku lojëra të ndryshme dhe kënaqemi shumë. Më mëson të luaj sporte të ndryshme dhe ndonjëherë më flet për fëmijërinë e tij. Unë e duaaaaa shumë babin tim!



David Shundi 6C

Babi, fjala më e shtrenjtë në këtë botë,
Ti je ai që më qëndron pranë gjithmonë.
Ti je shoku im më i mirë
Që më qëndron pranë në një moment të vështirë.
Të dua shumë i shtrenjti im!

Hilda Marinaj 6 C



Thonë se babai është ai që e ndihmon fëmijën të arrijë ëndrrat. Është e vërtetë. Ai gjithnjë më ka bërë të besoj më shumë në vete. Shumë herë më ka thënë se nuk do të shohë lotë në sytë e mi. E di mirë sa lëndohet kur unë lëndohem. E di që ai është gjithmonë aty për mua.

Thonë se babai është ai që e drejton fëmijën te sukseset. Është e vërtetë. Ai gjithnjë përpigjet të më inkurajojë dhe bën gjithçka për mua. Sa herë kthehet i lodhur në shtëpi, më buzëqesh sikur të mos ishte i lodhur, por unë e di mirë sa sakrifica janë bërë për mua. Aq shumë sa unë nuk i mbaj dot mbi supe. Mbase nuk kam pasur shumë raste ta shpreh, por shumë herë kam dashur të kërkoj falje për të gjitha shqetësimet që i kam shaktuar.

Thonë se babai do më shumë fëmijën më të vogël të familjes. Është e vërtetë. E di shumë mirë këtë. Sa herë e kam bërë të ndihet i lodhur nga gjithë ato biseda fëmijënore. Mbase i kam kujtuar momente të harruara, të zhytura thellë në memorie. Ndoshta sakrificat e bëra dhe të gjitha momentet e lodhjes së babit më kanë treguar se babai im është hero i vërtetë. Sepse më ka thënë që dëshiron të njihet si babai im, më ka bërë të kuptoj se ai dëshiron lumturinë time më shumë se të tijën. Se vlerëson më shumë ndjenjat e mia se të tijat. Fjalët e këshillat e tij më buçasin në mendje. Janë kolonat zanore të jetës sime. Janë fjalët e babit, e atij që nuk do ta harroj kurrë!

Keti Bardhoshi 6C

Babai për gjithkënd është i shtrenjtë. Të jep një dorë të ngrihesh lart në jetë. Është një ndihmë që kurrë nuk të lë në baltë. Babai im më ndihmon, më këshillon, por kjo nuk është asgjë në krahasim me dashurinë që ka dhe më jep. Është i shtrenjtë, i pazëvendësueshëm. Kush ka baba, ka gjithë botën në dorë. Sa e sa herë ai më ka këshilluar dhe gjithmonë për të më ndihmuar. Një baba kam, prandaj gjithmonë do ta dua dhe do ta vlerësoj si idhullin dhe shembullin tim. Ai ma bën qejfin sa herë ndihem i mërzhitur dhe më ngre lart sa herë që bie. E kam thënë gjithmonë dhe do ta them se si një baba që të do dhe të ndihmon kur ke nevojë, nuk ka në botë. Gëzohem pafund që kam një baba të tillë që më rri pranë gjithmonë. Mërzitem pa masë kur mësoj se disa njerëz nuk kanë babanë që t'i ndihmojë. Shpesh them se kam idhuj të ndryshëm në fusha të ndryshme të jetës, por e kam pasur gabim, sepse idhulli që kam dhe do të kem do të jetë babai im i dashur. Këta janë baballarët tanë dhe ata që nuk kanë për të na lënë vetëm në botë. Një baba i mirë, një jetë e mirë!

Ersi Uruçi 6C



Pa ty bota nuk vijon,
pa ty rruga nuk ndalon,
jam këtu për ty ,
dhe nuk do të iki pa ty.
Për mamin më thonë të shkruaj,
Por për ty dua të shkruaj,
Se shumë unë ty të dua.

Marson Aga 6C



Baba,
fjala më e fortë në zemër,
fjala, e cila më mbron kurdoherë.
Te ti kam besimin më të madh në botë,
Ti je i vetmi, që më kupton shumë mirë në jetë,
Çdo dëshirë që kam, ti ma bën realitet.
Je heroi im,
e kam me të vërtetë!
Ti je ai, që me një përqafim,
largon çdo frikë që kam në çdo mendim.

Kevin Kotarja 6C



Ai nuk krahasohet me asnjë gjë
Të flasësh për babain nuk është e lehtë. Ai është gjithçka për mua. Ai nuk krahasohet me asnjë gjë. Ai lodhet çdo herë që të më bëjë mua të qesh. Ai më ka regjistruar mua në një nga shkollat më të mira, në kurset më të mira etj. Ai është njeriu që më mban ngrohtë. Me të, diskutoj gjithçka. Pa të, jeta do të ishte e mërzhitshme e pa kuptim, pasi ai është një shok përjetë. Ai është babai im!

Deni Xhaferri 6C

Babi im HERO
 Babi im është hero,
 është njeri që shumë më do.
 Kurdoherë më ka qëndruar pranë,
 kur kam qeshur e kur kam qarë.

Kur isha i vogël, shpesh më ledhatonte,
 por ndonjëherë edhe më qortonte,
 sot që po rritem, kohët kanë ndryshuar,
 nuk jam më si i vogël që t'i qëndroj nëpër duar.

Sa herë më thotë: Shko dhe mëso!
 dhe unë i kam thënë: Mos u shqetëso!
 Sa herë me detyrat, ai më ndihmon,
 por më shumë me sportet ai më zhvillon.

Ndonjëherë në fundjavë, dalim për drekë,
 bashkë me vëllanë sportet praktikojmë,
 dua që më pas, rrugën e tij të ndjek,
 që një të ardhme të ndritur ne të vazhdojmë.

Noel Sulejmani 6C



Unë Ty të dua pafund!

Është e thjeshtë t'i thuash një babai hero, por për mua je më shumë se aq. Nuk ka fjalë në botë që të të përshkruajë ty, baba. Një hero si ti, nuk harrohet kurrë e mbetet në mendjen e të gjithëve. Ti je shtylla e familjes e pa ty ajo bie. Gjithmonë të shtrëngoј dorën fort, se e di që kam mbështetje. Shkallët e jetës me ty i kalova, pa menduar se ç'më pret më vonë, se e di që po u rrëzoja, do t'më kapësh ti. E di, nuk ka shumë festa për ty, por unë prapë nuk të harroj se je personi që më ndihmon. Edhe pse këtë letër e shkruaj me fjalë që kanë fund, dije se unë të dua pafund ty. Sa shumë kartolina të dhuroja e prapë fletët nuk më dolën. Ja edhe sot këtë gjë po bëj, veç për të shtrenjtin tim. Po të kthehem mbrapa e di, ke hasur shumë vështirësi por ja sot, nesër, pasnesër..... je një hero për mua e për të gjithë. Çdo gjë që bëre e ke bërë për mua e motrën, çdo natë pa gjumë bashkë me mamin e bëtë për ne. Sa herë mendoj për të ardhmen, por nuk shqetësohem se ju kam ju të dyve. E di që këtë letër po ta shkruaj veç ty, por ti bashkë me mamin do të mbeten i dy heronjtë e mi!

Xhoi Beja 6C

Dashuri që s'ka kufi!

Unë nuk e di ç'të shkruaj për babanë tim. Çfarëdo të shkruaj për të, ngelet e pakët krahasuar me dashurinë, të cilën kam unë për babin tim. Një zë i brendshëm më thotë të pyes tërë universin dhe të di se ç'mendojnë të tjerët për babanë e tyre dhe unë ta shkruaj këtë letër me mendimet më të thella që shprehin dashuri, por jo, s'ka fjalë ta përshkruaj këtë dashuri!!! Nuk ndiej vetëm dashuri, por edhe krenari për sukseset e tij dhe jam e lumtur që kam një baba si ai. Ai i ka të gjitha vetitë që një baba duhet të ketë. Ai mbi gjithçka ka dashurinë për ne dhe na do fort. Dua të them se e dua aq shumë atë, sa edhe t'i them të dua sa i tërë universi, duket sikur i kam përcaktuar kufi dashurisë dhe ngelet e pakët për këtë dashuri që s'ka kufi!!!

Melis Albayrak 6C



Shoku im më i ngushtë

Të flasësh për ty nuk është e lehtë. Je gjithçka për mua. Je njeriu më i shtrenjtë që unë kam. Je shoku im më i ngushtë. Ti punon e lodhesh për familjen tonë. Me mua tregohesh bujar e i dashur. Më ke ndihmuar dhe më ke përkrahur në çdo ditë të jetës sime. Më ke rritur me dashuri e më ke plotësuar të gjitha kushtet që kam nevojë. I kemi ndarë të gjitha sekretet bashkë. Gjithmonë më ke trajtuar si shok e si mik. Të gjitha këto gjëra, baba, ti m'i ke plotësuar. Të kam thënë shumë gjëra në jetë baba, por një gjë që kam në mendje dhe do të më shoqërojë gjithë jetën është se unë jam krenar e i lumtur që jam biri yt. Të dua baba!



Genti Sinanaj 6C

Thonë se heronjtë nuk vdesin, ata jetojnë përjetësisht në zemrat tona.

Asnjëherë nuk e kisha menduar se vdekja do të merrte njeriun tim më të shtrenjtë, babin tim. Nuk arrij ta kuptoj se si ajo u tregua e pamëshirshme dhe na tregoi fundin e rrahjeve të zemrës së tij... Për një gjë jam e sigurt: "Zoti merr pranë personat, për të cilët ai ka nevojë..."

Nuk kam urrejtje, por as falenderime. Zoti më dha mundësinë të shoh botën përtej çdo gjëje... zhgënjimin, hidhërimin, ama dhe dashurinë në sytë e njerëzve. Nuk është e lehtë për mua, të shkruaj për atë që më mungon në çdo hap të jetës, në çdo gëzim apo zhgënjim timin. Tek ai gjeja frymëzimin për të ecur përpara, për t'u rritur. Ai ishte busulla ime, për të cilin kam shumë nevojë. Ai ishte heroi i jetës sime. Për një gjë jam e sigurt, heroi im është engjëlli im mbrojtës që më ndjek kudo dhe që unë kurrë nuk do ta zhgënjëj... Sot kuptova që jeta më dha një mundësi e ajo është e nesërmja, do ta jetoj atë si të jetë dita e fundit me mallin për babanë tim, heroin e ëndrrave të mia! Të dua HEROI IM!

Perla Malo 6C

Shoku im më i mirë

Babain e dua fort. Ai është një nga njerëzit që dua më shumë. Unë me tim atë flasim si shokë. Ai më plotëson çdo dëshirë. Gjithashtu më pëlqen kur kaloj kohë me babain tim, pavarësisht se ai lodhet gjatë gjithë javës. Prej babait ne jemi në këtë shkollë. Babai im do që unë të marr nota të mira. Kjo është e vetmja gjë që ai kërkon prej meje. Babai im punon ditë për ditë dhe unë mërzitem që nuk kaloj kohë me të. Unë e dua shumë atë.

Endi Rexhepi 6C



Babai është ai person që të inkurajon çdo ditë të jetës dhe të fal çdo gabim që mund të bësh, sepse ai të do dhe do të të dojë përgjithmonë. Babai është ai që punon deri në orët e vona të natës, sepse ai dëshiron t'i sigurojë kushte sa më të mira fëmijës së tij, që ai të rritet i lumtur dhe i shëndetshëm. Dashuria e babait për fëmijën e vet, është aq e madhe dhe e zjarrtë, sa nuk krahasohet as me madhësinë e universit dhe as me nxehtësinë e Diellit. Babai e krenon çdo ditë fëmijën e vet prandaj dhe ne fëmijët duhet ta krenojmë babanë tonë, të paktën duke bërë mirë edhe gjërat më elementare që një fëmijë mund të bëjë. Prandaj dashuria dhe respekti nga fëmija për babanë duhet të jetë e pafundme. Kështu që duajeni babanë, heroin tuaj!

Bergi Avdulaj 6C



Babi im, heroi im
Unë të dua,
sa ti s'e di,
se gjithmonë më ndihmove,
edhe kurrë nuk u ankove.
Babi të dua shumë,
porsi rrjedhë që s'ka fund.
Babi, të dua shumë,
pasi gjithmonë je kujdesur për mua.
Të dua më shumë se gjithçka
dhe do vazhdoj të të dua,
sepse Ti je heroi im.

Arnis Llazari 6C

Babai im është heroi im, njeriu që e respektoj më së shumti në botë dhe që më bën të mendoj që në jetë, meshkujt nuk janë të gjithë njësoj. Ai më bën të ngrihem nga divani kur vjen nga puna, jo nga frika, por nga respekti dhe nga dëshira që kam. Jam i gatshëm që t'i përgatis mëngjesin, drekën e darkën kur ai të dojë dhe çfarë të dojë. Shpesh mund të kthehet i lodhur nga puna dhe nuk i pëlqen të flasë shumë, por unë mundohem që ta qetësoj, edhe pse e di që është e vështirë të kujdesesh për gjashtë veta në familje. Mua dhe vëllait tim nuk na ka munguar asgjë, mbi të gjitha dashuria. Besoj që njerëzit për këtë kanë më shumë nevojë në jetë. Babai që kam unë, nuk do të më lërë asnjëherë në baltë dhe kurrë nuk do të na bëjë të ndihemi keq. Unë e dua babin tim.

Brendon Nesim 6C



I vetmi njeri që dua më shumë në botë është babai im. Ai më jep siguri, më jep vetëbesim dhe trimëri. Ai më mëson shumë gjëra për bimët, tokën, njerëzit, Gjithçka. Im atë është i fortë dhe më mban si djalë dhe si vëlla. Ai gjithmonë përpiqet të më mirëkuptojë. Gjithmonë më jep këshilla të vlefshme për shoqërinë dhe jetën. Babanë tim e dua më shumë se çdo gjë tjetër në botë. Ndaj jam krenar që e quaj BABA!!!

Deivis Bejleri 6C



Babai im është shumë i dashur me mua. Ai nuk krahasohet me asnjë gjë. Ai më ndihmon kur kam nevojë për detyrat, për në futboll etj. Babi është heroi im. Unë për herë të parë, atë kam parë. Ai punon deri vonë për të na plotësuar dëshirat. Unë e dua shumë babanë tim. Ai është heroi im, më i miri në botë!

Leandro Hyseni 6C



Gjithkush ka një model shumë të mirë në jetë që do t'i ngjajë dhe ky është babai. Babai im, është heroi i familjes sime. Ai është një njeri shumë i dashur dhe kur kam qenë i vogël gjithmonë rrija pranë tij. Babai im punon gjithë ditën dhe vjen në shtëpi shumë vonë. Ai punon për të mbajtur familjen tonë sa më mirë. Babai im më ka treguar gjithçka që ka kaluar në fëmijëri. Fëmijëria e tij ka qenë shumë ndryshe nga e jona. Kur jam pranë tij ndihem shumë i fortë dhe i mbrojtur nga çdo gjë. Kur dëgjoj atë teksa flet për gjërat që ka realizuar, më shtohet besimi ndaj tij. Unë mendoj se do të më realizohen gjërat që babai im ka realizur kur ka qenë i vogël. Tani që jam rritur, unë flas me babanë tim sikur ta kisha shok. Babai im ka shumë shokë dhe unë dua t'i ngjaj atij në të gjitha gjërat. Ky është babai im, heroi im, më i miri në botë!

Tedi Hajdëri 6C

Babai im, ti je si unë, emrin të kam vënë "shoku im". Unë dashurinë më të madhe për ty e kam. Kur ty pranë të kam, çdo vështirësi mbaron. Ti si shok më ke mbajtur. Në çdo vend në të cilin ke qenë, pranë më ke marrë. Çdo gjë që kam pasur me ty e kam zgjidhur. Ti më ke mësuar çdo gjë që dhe vetë ke ditur. Shoku im, ti për mua je zgjidhja e çdo problemi. Të dua, Shoku im!



Amir Teqja 6D

Babai im për mua është më shumë se prind. Ai është vëllai im, shoku im dhe krahu im i djathtë sa herë kam nevojë. Ne të dy kalojmë shumë momente të bukura së bashku. Ai më trajton si të rritur dhe më mëson si të bëhem një burrë i zoti dhe një baba me karakter kur të rritem. Babai im më mbështet në çdo hap të rëndësishëm që bëj në jetë. Ai gjendet gjithmonë aty për të më dhënë një dorë dhe për të më ngritur sa herë që rrëzohem. Une jo që e dua pa fund, por e adhuroj atë më shumë se çdo gjë. Ai nuk është thjesht babai im, ai është inspirimi im. Babai është heroi im.



Bjorni Prrini 6D

Babai im i shtrenjtë!

Ti je gjithmonë me mua. Kur ndihem keq, ti më gjendesh pranë bashkë me mamin. Asnjëherë nuk më ke thënë jo, për gjërat që më nevojiten. Ti je bota për mua. Bashkë me mamin dhe motrën, të duam më shumë se çdo gjë në këtë botë. Ti përherë ke menduar se dua më shumë mamin, por do ta provoj sot, se çdo gjë që ke menduar ka qenë gënjeshtër. Unë kam vetëm një baba, një hero e në çdo herë që ndihem vetëm e di se ti je pranë meje. Dije, se ashtu siç je ti pranë meje, do të jem dhe unë pranë teje. Ti je mbreti im e unë princi yt. Të dua përgjithmonë! Djali yt Enio!



Enio Kazazi 6D

Si çdo fëmijë tjetër mua babai im më duket më i miri në botë. Ai më ka ndihmuar të kaloj vështirësi të mëdha, madje më ka ndihmuar të kuptoj kuptimin e vërtetë të jetës. Ndonëse ndonjëherë unë e mërzit atë me sjelljen time jo të mirë, ai më ka treguar se nuk do të arrij asnjë gjë në jetë nëse vazhdoj të sillem keq. Babai më ka dhënë fuqinë, ndërsa nëna më ka dhënë dashurinë. Babai më ka bërë të fortë edhe shumë të zgjuar. Si çdo fëmijë tjetër unë e dua shumë babain tim.

Eldi Pashaj 6D



Babai im është gjithçka që kam. Ai është heroi im dhe do të jetë gjithmonë i tillë. Këtë letër po e shkruaj që të tregoj se sa shumë të dua. Të falenderoj shumë që je babai im, që më ke falur dashuri gjithmonë, që ke qenë gjithmonë aty kur kam pasur nevojë, që më ke mundësuar një jetë të mrekullueshme. Gjithashtu të falenderoj për edukatën që me ke dhënë, që më ke mësuar si të sillem. Zemra ime është e madhe dhe atje ka shumë vend për ty dhe kjo zemër mund të të ketë lënduar, por ajo nuk do ta bëjë më dhe do të vazhdojë të të dojë aq shumë sa të do edhe tani.

Adela Shahini 6D

Babai im, je njeriu më i suksesshëm që kam parë ndonjëherë. Ti je shumë i shtrenjtë për mua. Ti je i pazëvendësueshëm. Dy si ty nuk i gjen dot. Ti ke arritur shumë gjëra të mëdha për shumë pak kohë. Prandaj unë ty të quaj njeriun më të suksesshëm. Me shumë mundime ti ia arrite qëllimit tënd, që të bëheshim një nga të parët në biznesin e hotelerisë. Ti më ke bërë moral për shumë gabime që unë kam shkaktuar. Më ke ndihmuar shumë herë për shumë nevoja që kam pasur. Ty më shumë të konsideroj si shok, si vëlla të madh. Fjalët për ty janë të pafundme, dhe nuk gjej dot më shumë fjalë për një njeri të madh si ti. Të gjithë pjesëtarët e familjes janë krenarë për ty dhe për punën tënde. Unë po vazhdoj të rritem dhe dashuria për ty nuk shuhet asnjëherë. Unë po e mbyll këtë letër me tri fjalë: Të Dua Shumë!

Henri Çerenishti 6D



I shtrenjti ba, jam unë, vajza jote e parë, ajo vajzë që ka bërë gabime në jetë dhe ka kuptuar shumë, ajo vajzë që bën gjithçka që të ndihesh krenar për vajzën që ke dhe po rrit, ajo vajzë që është krenare për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë. Ti çdo ditë punon për familjen, pa pushuar asnjë moment, duke na plotësuar çdo dëshirë e të gjitha nevojat që kemi, duke na plotësuar të gjitha kushtet. Babi, kur të dal të punoj, kur të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind e të rritësh fëmijë. Babi im, ka shumë fjalë për të thënë të dua shumë, dhe jam shumë e kënaqur, e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti. I shtrenjti baba, ti je gjithçka për mua. Unë për ty jap gjithçka. Edhe pse s'ta kam thënë ndonjëherë se sa të dua, sot do të ta them...

Megi Jata 6D



Babanë tim unë e kam si shokun tim të ngushtë. Ai më ndihmon me detyrat kur nuk i kuptoj. Ai më jep këshilla për gjëra të reja që provoj. Më kujtohet kur provova biçikletën për herë të parë. U pengova e rashë, por kisha babanë pranë. Atij i pëlqen shumë të bëjë udhëtime, ndaj shkojmë jashtë shtetit si familje. Fundjavave unë dua të qetësohem për vete, por ai i mbush ato plot me aktivitete. Herë do të shkojë në mal, e herë do të shkojë në det, gjithsesi ne kënaqemi me të vërtetë. Kur nuk udhëtojmë me makinë, rrimë në shtëpi duke parë ndonjë emision. Edhe pse ne shkojmë mirë, kemi ndryshime në preferenca. Atij i pëlqen futbolli, por gjëra të tilla nuk janë pengesa. Në krahasim me mua ai është më i duruar, sepse ai bën çdo plan në mënyrë të perfeksionuar. Për këto arsye unë e shoh babanë si shokun tim ose ndryshe: ai është heroi im.

Noel Sharka 6D

O babai im i dashur,
 sa mall kam për ty,
 nuk di si t'ia nis,
 për dashurinë që kam për ty.
 Jeta ime pa ty,
 nuk do kishte kuptim,
 sepse ti je pjesë e shpirtit tim.
 I mirë apo i keq,
 nuk më intereson,
 sepse ti je babai im,
 më i miri në botë!
 Baba, ti je ai që dëshirat m'i plotëson,
 dhe çdo gjë e realizon.
 Më ndihmon me detyrat,
 më tregon gjëra që s'i di,
 dhe më ndihmon me gjërat e mia.

Redi Hoxha 6D



O baba, ti je thesari më i çmuar,
 që nuk mund ta përshkruaj dot me fjalë.
 Ti je si universi që nuk ka fund,
 Ti je heroi im.
 Faleminderit për gjithë gjërat,
 që ke bërë për mua.
 Që më ke qëndruar pranë,
 në çdo moment të vështirë.
 Edhe faleminderit për të gjitha sakrificat e tua për mua dhe Rein.
 Po të them faleminderit përsëri, sepse nuk ka fjalë
 që ta përshkruajë se sa shumë ke bërë ti për mua.

Kelsey Bushi 6D



Si çdo person tjetër edhe unë e kam një hero dhe ai është babai im. Babai është një ndër personat më të shtrenjtë për çdo njeri. Babai është personi, i cili di të jetë gjithmonë aty për ty dhe do të mundohet për më të mirën. Babai është personi, i cili do të linte gjithçka për ty. Babai është personi, i cili do të të dojë pa kushte dhe do të sakrifikojë gjithçka për ty, prandaj kam vetëm tri fjalë të vogla për çdo baba: "Faleminderit për gjithçka, për çdo gjë që na keni dhënë, për çdo buzëqeshje! Ju duam shumë!"

Anisa Haldeda 6D

Babi, ti je personi më i shtrenjtë për mua. Gjithmonë kur kam nevojë për diçka ti je pranë meje për të më ndihmuar. Dhe kur bëj gabime ti gjithmonë më korrigjon në mënyrë të drejtë. Ti kujdesesh shumë për mua. Unë nuk di si të ta shpërblej, por detyra ime tani është vetëm të mësoj e të sillem mirë. Unë s'kam fjalë për ta përshkruar dashurinë që kam për ty. Të dua, babi!

Elgi Bami 6D



Nuk di nga t'ia filloj dashurisë që kam për ty. Janë aq shumë momente të bukura që kam kaluar me ty, sa nuk mund të numërohen kurrë. Je thesari më i madh në të gjithë universin. Në çdo moment ke qenë gati për të më ndihmuar për çdo problem që më ka ndodhur. Më ke plotësuar të gjitha gjërat që të kam kërkuar. Më ke falur për shumë gabime. Ndonjëherë edhe më ke qortuar. Me pak fjalë, mos ta zgjas më, të dua shumë, babi më i mirë në botë!

Ajakid Demiraj 6D



Shumë punëtor,
Shtatëlartë e i pashëm,
që rrezaton fuqi dhe moral.
Me vullnet rrallë të thyeshëm,
fjalët domethënëse si kushtetutë,
ecja që tregon energji.
Jeta kalon në punë dhe sakrifica,
Për ty, o burrë i pamposhtur!
Shoku im, Babi im!

Glen Qesku 6D



Babi ti je heroi im. Me mamin rri më shumë, por ti je gjithmonë aty për mua. E di që ndonjëherë ti bëhesh xheloz që unë kaloj më shumë kohë me mamin prandaj sot një dedikim për ty kam.

B si bota ime,
A si arka e thesarit, të zemrës sime
B si bukuritë e botës,
I si instrument melodioz.

Babi fjala trimërore e kësaj bote! Ti je heroi im dhe unë ty kurrë s'do të të braktisja. Do të jem gjithmonë aty me ty, siç ke qenë gjithmonë ti për mua. Ti je babai im i shtrenjtë si diamanti. Ti je mbreti im dhe unë princesha jote.

Nikol Kolaveri 6D

Dy Fjalë, Pesë Shkronja: "Të Dua!"

Djali i parë që një vajzë mund të dashurojë. Djali i parë dhe i vetmi në zemrën e tyre. Shoku më i mirë që ato kanë. Ditari i tyre ku rrëfejnë çdo sekret. Për mua je ari më i kushtueshëm! Rëndësia e jetës time! Dashuria e parë! I vetmi! Arma më e fortë! Ngrohtësia e shpirtit tim!

Emili Leka 6D



Bota ka miliarda fëmijë dhe të gjithë e kanë një hero. Ai është babai i tyre si është për mua dhe babai im. Babai im ka bërë çmos për të më rritur të shëndetshëm dhe me një jetë sa më të mirë. Ai më do pafund dhe dëshiron që unë të bëhem dikushi në jetë. Ke sakrifikuar aq shumë për mua sa që nuk e di se si të ta shpërblej. Shpesh mendoj për dashurinë e madhe që kam për ty. Të dua pafund dhe do të të dua gjithmonë!

Ersi Lika 6D



Çfarë do të thotë të jesh hero? Kur e mendoj këtë, më vjen ndërmend babai im dhe menjëherë rrjedhin kujtimet kur kemi qeshur e gëzuar së bashku ose jemi mërzhitur apo kemi qarë. Unë mendoj që hero është dikush që sakrifikon jetën për ty, dikush që ka dëshirë që ti të ecësh përpara në jetë dhe është dikush që do, që ti të jesh i lumtur. Ka disa arsye pse unë e konsideroj babnë si heroin tim. Arsyeja e parë është që më ka mësuar se puna është një nga virtytet e mëdha të njeriut dhe se puna më me vlerë është puna me sakrificë. Arsyeja e dytë është që babi më ka mësuar mirësinë e dashamirësinë që duhet të kem ndaj familjes e njerëzve që njoh. Më ka mësuar të jem e sjellshme, e mirëkuptueshme dhe të mendoj para se të veproj. Gjithashtu unë e konsideroj babin si hero, pasi babi më ndihmon dhe më frymëzon të përmirësohem edhe nëse bëj gabime. Babai është shembulli më i mirë i një heroi që do të bënte çdo gjë që ti të jesh e sigurt, të edukohesh dhe kur të dalësh në jetën e botën e vërtetë, të mos kesh nevojë për të, pra të jesh dikush i pavarur dhe i sigurt në vetvete.

Ky është babai im, që do të bënte çdo gjë për mua. Edhe pse unë nuk e shpreh me fjalë, babi e kupton se është një hero e idhull për mua.

Fiona Gjoça 6D



Çdo njeri do të donte t'i ngjante heroit të tij, po ashtu edhe unë. Heroi im është babai im. Babai im, pavarësisht punëve të shumta që ka, e gjen gjithmonë kohën për të më argëtuar mua me sporte të ndryshme si futboll, tenis etj. Një gjë tjetër që më pëlqen tek ai, është se ai i ndihmon shumë njerëzit në nevojë, dhe unë do të përpiqem të bëj të njëjtën gjë. Babai im quhet Elvis Naçi dhe për mua do të jetë heroi dhe shembulli im përgjithmonë.

Firdeus Naçi 6D

Babai im është njeiu më i shtrenjtë për mua. Babai luan vërtet rolin e një heroji në jetën e një vajze. Babai im më ka qëndruar gjithmonë pranë. Unë dhe ai kemi shkuar gjithmonë mirë bashkë. Mbaj mend kohët kur isha e vogël dhe babi më mësonte se si t'i jepja biçikletës, dhe si gjithmonë më ndihmonte të ngrihesha kur rrëzohesha, ashtu siç ka bërë dhe këto 12 vite. Ka qenë aty për mua që të më ngrinte kur rrëzohesha, sepse ai është babai për një vajzë, është njeriu që të qëndron gjithmonë pranë në çdo moment. Është njeriu që të udhëzon në rrugën e një jete më të mirë, është ai që të mëson si të përballesh me jetën, si t'i dalësh zot vetes. Është ai që nuk heq kurrë dorë së bëri fëmijën e tij të lumtur. Babai për vajzën është si engjëll i ardhur nga qielli për ta ndihmuar në çdo moment. Unë shikoj babanë tim dhe mendoj se sa shumë ka hequr ai vetëm që unë të jem kjo që jam sot. Gjeta rastin për të shprehur dashurinë time ndaj teje, baba. Ti je ai që ke qenë gjithmonë në krahun tim. Je ai që përpiqesh të më kuptosh për çdo problem që kam dhe përpiqesh ta zgjidhësh bashkë me mua. E kuptoj që edhe të kam zhgënjyer, dhe të kërkoj falje nga thellësia e zemrës, por siç e di dhe ti, unë jam akoma duke u rritur dhe mësoj nga çdo gabim që bëj. Shpresoj që ta kuptosh se sa shumë rëndësi ke për mua. Kjo letër nuk është mjaftueshëm. Por të premtoj, të premtoj, baba, se nuk do të zhgënjehesh më nga unë. Të dua shumë!



Helia Çalliku 6D

Një njeri, një hero, një baba... babai im. Kudo që të shkoj, nuk ka vend ku unë të mos e ndiej mungesën e tij pranë meje. S'ka moment që unë të mos mendoj për ty dhe prandaj dua të të dedikoj këtë poezi.

Babi im s'është si të tjerët,
ai është më i miri i të gjithëve.
Të tjerët mund ta mohojnë,
por për mua është numri një.
Gjithmonë do ta dua,
edhe sikur të më lëndojë.
Prapë se prapë unë do ta dua,
se ai prapë do të më dojë.
Dhe e di shumë mirë,
se kjo poezi ndoshta nuk ka fare rimë.
Por tani s'ka më rëndësi,
sepse ajo që dua të them është,
se unë e dua atë në pafundësi!

Babi, unë të dua pafund e nuk ka fjalë për ta përshkruar pafundësinë. Ato që ke bërë për mua unë nuk mund të t'i kthej, sepse janë të pafundme, por unë mund të të them se ti je numri një! Kurrë mos e harro këtë! TË DUA!!

Tesia Thereska 6D

Babai im është një biznesmen i suksesshëm. Ai ka disa parce lojërash dhe dy lokale. Ai punon shumë dhe është menaxhues shumë i mirë i kohës. Babai im e vlerëson shumë paranë, por që të zgjerojë biznesin duhet të hedhë para në qarkullim për të fituar edhe më shumë. Ai nuk rrezikon, por mendohet shumë para se të shpenzojë. Unë e vlerësoj shumë babanë tim për zgjuarsinë dhe mençurinë e tij. Në të ardhmen unë do të ndjek gjurmët e tij.

Ergi Lamaj 6D



Babi im i dashur,
unë të dua shumë,
Dashuria ime për ty,
rrjedh si një lumë.
Do të të dua në çdo çast të jetës,
gjithmonë do të të kem pranë vetes.
Ti je babi më i mirë në botë,
ndaj dhe unë të dua fort.
Ti mendjen e ke gjithmonë te unë,
edhe nëse unë jam në gjumë.
Të uroj gjithë të mirat e kësaj bote, babai im,
Ti do jesh gjithmonë, pjesë e trupit tim!

Uejsi Çaça 6D



BABA!
Një fjalë e ëmbël,
Një krijesë po aq e rëndësishme sa nëna,
Po aq i dashur, Po aq i mirë.
BABA!
Personi që më ka mbështetur gjithmonë,
Ai që më ka shpëtuar, kur kam qenë në telashe,
Një hero që ka ardhur nga ëndrrat e mia,
Një person aq i dashur për mua po aq sa nëna,
Shpresoj që të jetosh i lumtur përjetë.

Uendi Baço 6D



I dashur babi, ti për mua je hero. M'i plotëson të gjitha dëshirat. Babi, ti për mua je gjithçka. Je idhulli im. Ke bërë shumë sakrifica për mua. Je munduar shumë që të më mësosh dhe ia arrite qëllimit. Ke qenë gjithmonë pranë meje, në momente trishtimi e gëzimi. Momentet që kemi kaluar bashkë, nuk do t'i harroj kurrë. Të dua dhe do të të dua gjithmonë!

Amir Pazari 6E

Babi, shoku im,
Babi, heroi im!
Ti ke bërë shumë gjëra për mua,
prandaj, ty unë shumë të dua.
Ti më ndihmove në çdo vend,
dhe s'u lodhe kurrë.
Unë çdo gjë e mbaj mend,
dashurinë tënde s'e harroj kurrë!
Ti i njëjti ngelesh për mua,
në zemrën time gjendesh ti.
O baba, hero për mua,
je ti, o heroi im!
Koha kalon dalëngadalë,
tani po kuptoj më shumë,
Baba, gjithmonë m'u gjende pranë.
Këto s'do t'i harroj kurrë!
Babi, idhulli im,
nga ty kam shumë kujtime,
nga më të ndryshmet, me gëzime,
Sa lumturi ka shpirti im.
Babi, shumë të dua,
je si Skënderbe për mua!
Një fjali po të them unë:
Dashuria për ty s'do të shuhet kurrë!

Andrea Bylykbashi 6E



Baba, në këtë tekst do të të tregoj dashurinë time për ty.
Ti edhe pse vije i lodhur dhe ndonjëherë i stresuar nga puna, më mbaje në krahë dhe më puthje. Unë gjumin e kisha të vështirë, edhe sot e kam. Ti më mbaje në krahë dhe më vije në gjumë. Kur ti më çoje në shtrat, unë hapja sytë dhe ndieja mungesën tënde. Çohesha dhe me vrap vija tek dhoma juaj. Ti ma bëje me shenjë që të flija me ju në krevat. Në çdo moment kur kam qenë i mërzhitur, ti ke qëndruar pranë meje. Më thoshe që nuk kisha pse të mërzhitesha, sepse të kisha ty, mamin dhe motrën. Kur shkoja në ekskursione më shkruaje: "Më thuaj për çdo gjë. Mos harro, unë udhëtoj tërë botën për ty." Këto fjalë i kujtoj gjithmonë në ekskursione. Më ke mbështetur kur ishim në Barcelonë. Unë qava, sepse kishte humbur skuadra e zemrës. Ti duroje lotët e mi. Më mbështesje dhe më gëzoje. Siç e shikon ba, kam shumë gjëra për të thënë. Kjo thjesht është një pjesë e tyre. Djali yt.

Colin Orlando Balla 6E

Babai im është njeriu më i dashur. Ai gjithmonë bën çdo gjë për mua. Ai më ndihmon gjithmonë dhe gjithashtu kujdeset për mua. Prandaj kudo që të jesh unë do të të dua ty, babai im!

Brendis Kasharaj 6E



Tema më trazon shumë, sepse të shkruash për babin më duket edhe e lehtë, edhe e vështirë. E lehtë, sepse është njeriu që njoh më mirë, por e vështirë se më duket sikur nuk do arrij të shkruaj gjithçka që kam në zemër për të. Unë e kam të vështirë të shprehem, por do të shkruaj gjërat më të rëndësishme. Babi im është njeriu që unë kam model ose ndryshe është modeli apo idhulli im. Me babin komunikoj për gjithçka. Ai ma ka fshirë ndrojtjen, flet me mua si shok, ndaj e quaj si "oazin" e shqetësimeve të mia. Ai nuk më bërtet, por më dëgjon dhe këshillon ose miraton. Ai ka komunikim të mirë me të gjithë ne, mamin, motrat e me mua. Babi di ta mbajë fjalën, pasi kur të premtan për diçka ai e bën. Edhe ne, kur kërkojmë diçka, jemi të kujdesshëm që të mos abuzojmë, sepse ai punon e lodhet shumë. Kur shkojmë me pushime, ai na kënaq me humorin e tij, por edhe me surprizat që na bën. Shpesh surprizat e ditëlindjeve na befasojnë dhe themi "Sa shpirt të gjerë ka babi!" Po babi im është i komunikueshëm edhe me punëtorët, u gjendet pranë, kur kanë nevojë. Kjo na bën edhe më krenarë për të. Jam i lumtur që kam një baba të tillë, ndaj dua t'i premtoj se edhe unë do të ndjek rrugën e tij. Të dua shumë babi im!

Klejti Bici 6E



E dua fort tim atë! Çdo ditë që kalon e njoh më mirë dhe kuptoj se sa shumë përpiqet ai për mua. Çfarë më pëlqen tek babai më shumë, është kur bisedojmë si shokë të vërtetë dhe ai më kërkon mendim për ngjarjet apo gjërat që duhet të bëjmë së bashku. Gjithashtu më pëlqen kur kalojmë kohën e lirë së bashku, gjatë kohës kur më shoqëron me makinë nëpër kurse të ndryshme dhe bisedojmë apo kur bëjmë shëtitje të gjata në breg të detit apo pranë liqenit artificial. Pavarësisht se babai im lodhet gjatë ditëve të javës, ai përpiqet që në fundjavë të organizojë me familjen shëtitje në natyrë apo vizita në qytete të tjera të Shqipërisë, për t'u njohur më nga afër me natyrën dhe historinë e vendit tonë. Babai im ndihmon njerëzit në nevojë e të sëmurët. Sa krenar ndihem, kur më drejtohen njerëz të panjohur për të më treguar se sa mirënjohës janë për mirësitë e ndihmën që im atë u ka dhënë. Do të doja që në jetë t'i ngjaj babait tim për mirësitë ndaj njerëzve dhe lumturinë që i jep familjes sonë me dashurinë e përkujdesjet e tij.

Kujtim Alimehmeti 6E

Gjithkush në jetë udhëhiqet nga modeli i njeriut, të cilit dëshiron t'i ngjajë dhe si i cili ëndërron të bëhet. Për mua, ky model është babai im. Ai është njeriu më i dashur për mua dhe që kur kam qenë i vogël kam krijuar një lidhje të veçantë me të. Babai im punon shumë dhe koha që i mbetet për të qenë pranë nesh në familje është e kufizuar. Unë e kuptoj sa shumë përpiqet që të mos humbasë asnjë ditë pa ndenjur sadopak me mua. Ndihehem shumë i lumtur në fundjavë ose kur kemi pushime dhe kemi mundësi të rrimë më shumë së bashku. Kur jam pranë tij, ndihem i fortë dhe çdo problem më duket më i lehtë për t'u zgjidhur. Ai më tregon shpesh për veten, vështirësitë që ka kaluar që kur ishte fëmijë dhe si ka arritur të realizojë ëndrrat që ka pasur. Ndërsa e dëgjoj, unë krijoj ëndrrat e mia dhe më rritet më shumë besimi se ato do të mund t'i realizoj, duke mos pasur frikë të përballem me çdo vështirësi dhe pa u ndier i vetëkënaqur me atë që kam arritur. Babai im ka shumë miq e shokë që e duan dhe e respektojnë dhe unë ndihem shumë mirë për këtë. Përpiqem t'i ngjaj atij duke qenë i dashur me shokët, i gatshëm për t'i ndihmuar dhe të mos lëndoj askënd. Tani që po rritem, e ndiej veten gjithnjë e më të afërt me babanë tim, kuptohemi lehtë dhe jemi shokë të mirë. Kënaqem kur më thonë se i ngjaj atij. Do të vazhdoj t'i ngjaj atij, sepse gjithmonë do të mbetet modeli im, heroi im!

Erik Noka 6E



Baba! Një fjalë e shenjtë ke qenë për mua! Për mua ke qenë hero, luftëtar dhe qindra gjëra të tjera. Kur rrëzohesha, ti ishe i pari që më ngrije përsëri në këmbë dhe më thoje: "Do të bëhesh shumë mirë, mos u shqetëso!" Ti ke qenë ai, i cili më thoshte të bëhesh më i fortë dhe i shkathët, por sigurisht që të fokusohesha tek mësimet në fillim. Kur unë me vëllanë ziheshim, ti ishe ai që na ndante dhe na qortojte bashkë me mamin. Babi, më mungon... Nuk ndodhesh këtu personalisht, por gjithsesi do jesh ne zemrën time përgjithmonë. Të dua, heroi im! Do të jesh gjithmonë në zemrën time!

Bjorn Prifti 6E



Babi, heroi im! Vërtet ti je heroi im! Jetën ma ke bërë një million herë më të bukur. Më ke plotësuar çdo dëshirë që unë kam dashur. Më ke çuar në vendet më të bukura në botë. Sa herë që unë kam bërë ndonjë gabim, ti gjithmonë më ke folur dhe unë e kam kuptuar gabimin. Kur unë jam lënduar pak, ti gjithmonë ke qenë aty, që mua të më ndihmoje. Unë jam shumë krenar për ty babi! Ti ke hapur një kompani bashkë me vëllanë tënd dhe ajo kompani është një nga kompanitë më të suksesshme në Shqipëri, dhe unë të premtoj që nuk do ta lë mbrapa atë. Pra, kjo të bën ty babi heroin tim. Por jo vetëm heroin tim. Ti je heroi i gjithë familjes sonë, mamin, motrës edhe mua. Babi, ti je heroi ynë!

Erik Bici 6E

Tani që jam i vogël, unë s' e kuptoj,
 por babi vazhdon, të më këshillojë.
 Unë do të vazhdoj të mësoj,
 Ëndrrën babit t'ia plotësoj.
 Shkollën do të mbaroj,
 larg me studime unë do të shkoj.
 Unë ndoshta larg, shumë vite do të qëndroj,
 por familjen time, nuk do ta harroj.
 Një jetë timen unë do të filloj,
 por babin s' do e harroj.
 Nga ty mësova si të shkëlqej në jetë,
 Babi, heroi im do të jesh përjetë.

Daniel Lavdari 6E



Ti je njeriu më i rëndësishëm në familje. Ti punon deri në darkë dhe kur vjen nga puna ti je shumë i lodhur, por prapë e gjen kohën për ne! Ti gjithmonë je aty për të më ndihmuar. Asnjëherë nuk mërzitesh kur unë të bëj shumë pyetje. Për mua dhe motrën ti je si një arush i madh. Sa herë që vritem ti je i pari që më ndihmon. Babi të kujtohet udhëtimi në Romë që bëmë bashkë? Ai ishte udhëtimi më i bukur i jetës sime! Po kur provova Roller coasterin e parë? Ti më dhe kurajo ta bëja. Po hera e parë kur hipa në avion? Ti ma hoqe frikën, ti më ndihmon për gjithçka. Ti më mësove biçikletën, ti më thojë gjithmonë: "Mund të vritesh kur e mëson, por në fund do më falenderosh!" Asnjëherë s' më ke lënë vetëm. Ti ke qenë në çdo festë që kam bërë! Faleminderit Babi!!!

Matteo Mavriqi 6E



Babi, më ke mbështetur gjithë këtë kohë, më rrite dhe më dhe kurajo të vazhdoja përpara me jetën time. Nuk të quaj Baba, por miku im i pandashëm, dhe nuk ka gjë në botë të ndajë miqësinë tonë. Nuk ka gjë me të cilën mund të të falenderoj mjaftueshëm që ekziston. Ahhhhhhhh, do të doja që jeta të ishte e pafundme që ta shijoja familjen time përgjithmonë. Si mbyllje për këtë shkrim do të doja të të shkruaja këtë poezi të shkurtër:

Babi,
 Je heroi im,
 Je miku im,
 Je prindi im,
 Je i fortë, siç është një hero për një fëmijë.
 Sikundër një shishe uji; Ti je shishja edhe ne jemi uji.
 Fjalët e mia nuk rreshtin, por vetëm mund të them se Ti je heroi im!
 Me dashuri, yt bir.

Etien Dhima 6E

Babai im i dashur,
në punë të kam parë,
herë-herë të lodhur,
por gjithmonë fitimtar.
Shokë unë kam shumë,
plot më kanë zili,
që nuk mund të kenë,
një baba si ti.
Dashuria ime,
s'përshkruhet dot me fjalë,
ti në jetën time,
je diçka e rrallë.
Babai im i dashur,
unë të dua shumë,
se sakrificat e tua,
për mua nuk kanë fund.
Babai im i shtrenjtë,
për mua je hero,
mësimet e tua,
kurrë nuk do t'i harroj.



Edi Koka 6E

Babi, ti ke qenë gjithmonë një hero për mua. Edhe pse kemi bërë shumë zënka bashkë, unë të dua shumë. Sakrificat që ke bërë për mua, mamën dhe vëllezërit e mi, janë të pabesueshme. Ti ishe ai që më mësove për rreziqet e kësaj bote. Ti ishe ai, që më mësove të mirën dhe të keqen. Ti ishe ai që më bëje të lumtur edhe në momentet e trishta. Momentet që kemi kaluar bashkë i mbaj në kujtesën time. Edhe kur ti të ikësh, do të mbetesh në kujtesën time. Të Dua Shumë Babi!

Heily Haxhiymeri 6E



Babai im, është personi më i dashur për mua. Është dikush i pazëvendësueshëm në jetën tonë dhe do të ishte pak ta quanim hero. Ai është njeriu që na mbështet kur ne nuk kemi besim te vetja, na zgjat dorën kur rrëzohemi, dhe është gjithmonë aty për ne deri sa të vijë fundi. Babai është ai që të vlerëson si askush tjetër dhe ti për të nuk do të rritesh kurrë pavarësisht kohës. Babai im nuk zëvendësohet as me njëqind persona të tjerë. Që nga dita kur linda, ti ke qenë aty për mua. Edhe tani po mendoj për ty, teksa shkruaj këto fjalë. Por jo, këto nuk janë thjesht fjalë, nuk janë thjesht shkronja që kanë lindur për t'u përdorur nga njerëz të zakonshëm. Jo, këto janë fjalë që burojnë nga dashuria, mirësia dhe mirënjohja ime për ty. Sot, ndërsa po shkruaj të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe unë nuk do të mundem të ta shpërblej këtë kurrë. Ky shkrim të dedikohet vetëm ty, i dashur baba, për të të thënë faleminderit!

Iris Aliaj 6E

Babai është me të vërtetë heroi im. Ai më ka mbështetur dhe është kujdesur për mua dhe vëllanë tim tërë jetën. Babai im është shumë i dashur, por ndonjëherë kur unë ngacmoj vëllain e vogël më bërtet, por nuk e ka me të keqe. Atij i pëlqen shumë futbollli dhe ka qenë presidenti i skuadrës së futbollit "Skënderbeu". Nuk kam shkruar shumë për të, sepse nuk do ta mbaroja kurrë këtë letër. Me dashuri, vajza jote Kendra!

Kendra Zeqo 6E



Babai im është një hero. Ai më ndihmon gjithmonë me çdo gjë. Unë i jam shumë mirënjohës atij. Ai më ndihmon gjithmonë kur jam në rrezik, ndonjëherë ai më bërtet, por ai e bën vetëm për mua. Heroi im jep gjithçka për mua. Faleminderit heroi im!

Endi Çorja 6E



Babai, heroi im, me ndjenjën dhe dashurinë më të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti. Je një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë që unë ndjek. Je shoku më i mirë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, ti ke qenë si një busull drejtuese për mua. Je personi që më kritikon dhe më frenon pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i drejtë që kam. Të dua shumë shumë, gjithashtu jam krenare për ty, sepse je babi ideal dhe më i miri për mua!

Klea Muçeku 6E



Babi, dikush që asnjëherë nuk të harron, dikush që të mbron gjithmonë, dikush që të plotëson çdo dëshirë dhe që të qëndron gjithmonë pranë. BABI, ti je si një yll, që je me ne gjithmonë dhe na ndjek në çdo hap. Ti je ai që gjithmonë ke bërë çdo gjë për mua dhe motrën. MAMI është vërtet gjëja më e çmuar dhe më e rëndësishme në jetë, por asnjë vajzë nuk do të ndihej PRINCESHË pa babanë e saj. Ti je shoku im, je vëllai im, por mbi të gjitha, ti je BABAI im, që gjithmonë je aty për mua duke më mbrojtur nga çdo e keqe. Në zemrën time dhe të motrës, nuk qëndron njeri para teje dhe mamit. Tani ne po rritemi nga pak, por kemi diçka që na zien përbrenda. Patjetër, janë dhimbjet që na pushtojnë zemrën, teksa shohim që vitet po kalojnë dhe nuk kthehen më. Janë 137 vitet e fëmijërisë që edhe pse dëshirën e kemi të madhe që të kthehen, nuk kthehen dot. Jam e sigurt që do të na marrë malli për gjithë kohën e kaluar bashkë. Dëshira më e madhe e jotja dhe e mamit është që ne të bëhemi dikush në jetë. Ti na ke premtuar diçka: Do Të Qëndrosh Gjithmonë Me Ne, Derisa Të Bëhemi Dikushi Në Jetë. Babi, ti je gjithçka për mua dhe dije që unë Të DUA SHUMË!!!

Megi Musta 6E

Babai im për mua është si një superhero, por pa superfuqi. Ai mund të mos ketë superfuqi, por ai është babai im dhe unë kurrë nuk do e ndërroja për askënd. Ai ka karakterin më të mirë. Ai është i dashur, zemërgjerë, i guximshëm, i fortë dhe arsyeton kur ne e kemi gabim. Ky karakter e bën atë një nga herojtë më të mirë për mua. Kur ne bëjmë ndonjëherë gabime, ai arsyeton me ne, e pastaj na ndihmon. Një gjë tjetër që e bën atë superhero është që ai ndihmon shumë veta si shokët e tij, familjen, etj. Kur unë s'kuptoj ndonjë mësim, gjithmonë unë i drejtohem atij e pastaj mamit për ndihmë. Disa herë, kur unë dhe motra ime zihemi ai na ndan nga zënka e pastaj na pyet pse ne u zumë me njëri-tjetrin. Unë kur të rritem, dua të bëhem si ai një superhero për fëmijët e mi.



Ridion Karçini 6E

Babi për mua do të mbetet gjithmonë heroi im. Nuk besoj se ekzistojnë fjalë për ta përshkruar. Ti je aty gjithmonë kur jam në vështirësi, je shpatulla ku mbështetem. Jam krenare që kam një baba si ti dhe jam njeriu më me fat në botë që të kam baba. Kurrë nuk më ke thënë jo, gjithmonë m'i ke plotësuar dëshirat. Të falenderoj për çdo gjë që ke bërë për mua. Por gjëja më e shtrenjtë që më ke dhënë janë mësimet e tua dhe të premtoj që nuk do t'i harroj gjatë gjithë jetës sime.



Sara Pajtoni 6E

Je gjithçka për mua, je heroi im. Të dua shumë shumë... Je i shtrenjtë për mua! Gjithmonë do të jem krenare për ty! Dashuria e ëmbël që kam për ty, më bën të gëzohem shumë! Ti punon për familjen tënde! Kur ndihem në vështirësi të kërkoj vetëm ty, nuk dua që të më ndihmosh, vetëm të kem një përqafim nga ti. Ti më ndihmon dhe më mbështet kur kam nevojë për ty! Të dua shumë heroi im!!



Sindi Nikolli 6E

Babi ti ke qenë për mua një hero dhe gjithmonë do të mbetesh i tillë. Momentet e bukura dhe sakrificat që ke bërë ti për mua s'm'i ka dhënë askush tjetër përveç teje. Nuk do t'i harroj kurrë momentet që kemi kaluar bashkë. Më mungon jashtë mase, më mungon buzëqeshja jote, puthjet e tua, zëri yt, zënkat tona, më mungon ti..... Më mbahet mend ditën e fundit që dolëm bashkë dhe ti që më bëje moral, duke thënë po sikur mos të ishe në jetë. Dhe ajo gjë që lutesha gjithmonë mos të të ndodhte ty, të ndodhi. Do e kujtoj gjithmonë heroin tim, ty babi! Shpresoj tani të jesh duke më dëgjuar teksa e lexoj këtë letër për ty BABI!

Sofia Burimi 6E

Personi që admiroj më shumë në këtë botë është babai im. Ai ishte i pari që më pa kur erdha në këtë botë, i vetmi me të cilin kam përjetuar çastet më të bukura të jetës, ai që ma bëri fëmijërinë më të bukur. I mbaj mend të gjitha kujtimet e fëmijërisë, çdo këshillë që më ke dhënë, çdo dhuratë ditëlindjeje, çdo shaka që kemi bërë bashkë. Ndihem me fat që kam një baba të tillë. Më ke qëndruar pranë në rastet më të vështira, më ke respektuar, më ke dashur. Shumë herë mendoja se unë kisha gjithmonë të drejtë, nuk e dëgjoja fjalën tënde. Ty këto të bëheshin plagë, por që kuroheshin, kur unë e kuptoja gabimin dhe reflektoja. Edhe pse vjen vonë nga puna, ti gjithmonë e gjen kohën për të na argëtuar, mua, vëllanë dhe motrën time, për të dalë me biçikleta, për të shkuar në kinema etj. Më ke plotësuar të gjitha dëshirat. Ke qenë hero i luftës time më të madhe, jetën. Do të doja të të falenderoja për gjithçka që ke bërë, por nuk mundem, pasi dashuria nuk shprehet dot me fjalë.

Stivi Peleshi 6E



Sa shumë kam për t'i thënë atij që më dha jetën, atij që në çdo moment më mbush me dashuri, atij hero i që sa të kem frymë do e dua dhe do jetoj me imazhin e tij si gjënë më të shtrenjtë në jetën time... Babait! Babai gjithmonë më ka ruajtur dhe mbështetur në çfarëdo që bëj. Pa atë, nuk do të kisha arritur deri këtu ku jam tani. Duhet të di, se pas meje fshihet një baba që më ka gdhendur me durim dhe dashuri copëzat e karakterit tim, një baba që kurrë nuk është lodhur të më vijë rrotull. Dhe unë nuk jam asnjëherë vetëm, ai është gjithmonë me mua, për mua, sa herë që unë të ndiej se kam nevojë për të. Hidhen hapat lehtë gjatë viteve, gjithmonë drejt një fluturimi me krahë më të fortë, gjithmonë drejt rrugëve të reja, gjithmonë me një qëllim në mendje, me shumë dashuri në zemër, me një buzëqeshje në buzë dhe me sytë e kthyer herë pas here pas, për të riparë, përqaftuar dhe shuar mallin me atë që më solli deri këtu. Dhe unë po eci rrugës sime, por shikimin e kam përherë aty, tek Familja Ime...

Albana Bami 6F



Babai im i dashur, unë ty të dua shumë. Unë e di që ti do bëje gjithçka për mua. Ti mua gjithmonë më ndihmon kur kam nevojë për ty. Ti je babai më i mirë në botë. Ti gjithmonë mendon për më të mirën time. Mua më ndihmon, sa herë unë kam nevojë për ty. Ti kurrë s'më lë në baltë. Unë jam i sigurt se ti kurrë s'do më lësh vetëm, gjithmonë do më gjendesh pranë. Kur unë isha i vogël, e dija që ti do ishe gjithmonë me mua. Ti dëshirat gjithmonë m'i plotëson. Ti je babai më i mirë në botë. Të dua sa e gjithë bota! Me dashuri Amari!

Amar Kruja 6F

Babai heroi im,
Ai është shumë trim.
Kur për ndihmë kam nevojë,
Atë kërkoj.
Kur në vështirësi jam,
Atë pranë që të më ndihmojë e kam.
Atë shumë e dua,
Ai është shumë i veçantë për mua.

Amir Gjana 6F



Të gjithë e shikojnë babanë e tyre si hero. Babai ka punë tepër të rëndësishme. Ai, së bashku me nënën, duhet të punojë për kontributin në familje, duhet të ndihmojë me punët e shtëpisë, të më ndihmojë mua me detyrat dhe shumë gjëra të tjera. Babai im bën shumë sakrifica për mua. Ai ka hequr dorë së ndjekuri dëshirat e tij për të realizuar dëshirat e mia. Unë asnjëherë nuk kam frikë sepse e di që ai është gjithmonë aty për mua. Kur jam në vështirësi babi im nuk më le të shqetësohem dhe problemet i zgjidhim së bashku. Kur unë jam e sëmurë, e ndiej merakun e tij, derisa unë të shërohem. Jam e bekuar që e kam në jetën time. Jeta është gjithmonë më e bukur dhe e lehtë kur ke në të heroin tënd, babanë. Të dua shumë babi!

Altea Ali 6F



Një person i dashur. Njeriu më i guximshëm. Personi që nuk e pengon asgjë për ta arritur atë që do. Shakatë e tij, të cilat të bëjnë gjithmonë për të qeshur. Në qoftë se akoma nuk e keni kuptuar për cilin person po flas, atëherë ja ku po jua them, babai im, pra babai më i mirë në botë. Nëse nuk e njihni atë, atëherë ja ku po jua përshkruaj. Ai është personi që punon më shumë nga të gjithë që unë dhe motrat e mia, të kemi një të ardhme të ndritur. Edhe pse kemi pasur disa probleme kohët e fundit, babai im vazhdon të jetë i fortë dhe të na i plotësojë dëshirat mua dhe motrave të mia. Ai është një njeri me shumë shije në rroba, në modelime, në dekorime dhe shumë gjëra të tjera që kanë lidhje me modën apo me designing. Tani të flasim pak për babanë tim si fëmijë. Babai im ka qenë i shkëlqyer me mësimet prandaj ai më inkurajon mua që të dal sa më mirë. Shumë njerëz thonë që ai ka qenë një djalë shembullor, nuk bënte zhurmë apo rrëmujë dhe mua më thonë që i kam ngjarë atij. Unë ndihem shumë krenare që kam një baba të tillë!

Ami Gjoça 6F

Një familje pa baba,
 le ta dijë që s' do të ketë shumë të ardhura.
 Pa baba, është sikur të mungon një vëlla,
 se aq shumë e dua.
 Baba, të të humbas ty,
 Ndihem i ndarë për dy.
 Heroi im, je ti baba!
 Kush më mësoi teksa rritesha,
 Ti baba!
 Kush më këshillonte më së shumti,
 Ti baba!
 Kush më hapi sytë për të parë botën,
 Ti baba!
 Të kam borxh gjithë jetën për sakrificat që ke bërë për mua personalisht.
 E di sa je përpjekur për të më bërë këtë që jam sot, e them veçanërisht,
 Se pa ty do ndihesha i mbyllur në vetvete,
 përfundimisht!
 Ti je ai që më kupton faktikisht,
 ndaj teknikisht, vetëm me ty mundem të flas hapur,
 (edhe me mamën po është ndryshe kur flet burri me "burrin")
 Jam shkolluar (deri më tani)
 E, kam mësuar,
 ngaqë ti më ke këshilluar.

Andrea Çela 6F



Për më të mirin tim!

Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtimit tim, babait tim! Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë, njeri me shpirt të pastër e të bukur. Nuk gjej dot mënyrën si ta tregoj dashurinë për babin tim. Fjalët ngatërrohen dhe nuk ka për të përshkruar të shtrenjtin tim. Kur dëgjoj "babi" imazhi i të adhureshmit tim më shfaqet. Ai është babi pa të meta, pa gabime, është shembulli i babait ideal. Ai është forca që s'më lë të ndalem para asnjë pengesë. Babai im, është njeiu më i mirë në të gjithë botën, është i adhureshëm. Ai ka qenë me mua në çdo çast të bukur, të lumtur, të trishtuar të jetës sime. Babai im, është mrekulli, ai është perfekt. Unë dhe vëllai im jemi me fat që e kemi. Ka qenë aty për çdo gjë, kur thashë fjalën e parë, kur kam bërë lëvizjen e parë. Babait tim dua t'i them faleminderit për çdo gjë, për çdo dëshirë të plotësuar, për shkollën time, kur kam qenë sëmure, për faktin që është një baba i tillë, dhe mbi të gjitha për jetën që më ka ndërtuar, një jetë me të gjitha të mirat e mundshme.

Beola Kodra 6F

Babai im, shoku im më i mirë, idhulli im. Unë e adhuroj babanë tim. Nuk më duhet një hero me shpatë për të krahasuar dhe treguar se kush është babai im. Ai lufton çdo ditë me vështirësitë e me problemet e përditshme, punon shumë, që unë të rritem një fëmijë i lumtur, i shkolluar, i kompletuar me të gjitha gjërat. Por përveç këtyre, ai është një baba dhe një shok që më kupton shumë mirë. Ne përshtatemi shumë me njëri tjetrin. Flasin si dy moshatarë, luajmë së bashku. Ai më fal shumë dashuri. Do doja shumë që kur të rritesha, të bëhesha dhe unë një njeri i mirë dhe i përkushtuar si babai im. Nuk është e nevojshme të bësh heroizma për t'u dukur një hero. Heroizmi më i madh është të duash dhe të respektosh familjen, ashtu siç bën dhe babai, hero i im.

Klejvist Demaj 6F



Babai im është njeriu që mund t'i flasë gjithmonë gjërat hapur. Ai punon shumë për të më rritur mua dhe vëllanë tim dhe të na shkollojë sa më mirë e të na bëjë ne të ditur. Gjithmonë do që çdo gjë të shkojë sa më mirë, si çdo prind për familjen dhe fëmijët e vet. Për mendimin tim, babai është shtylla e familjes, sepse të gjitha gjërat ai i menaxhon. Është gjithmonë interesante të dalësh me babanë tënd, sepse çdo gjë mund të ndodhë (ndoshta të blen një PlayStation 4, por çdo gjë mund të ndodhë). Falenderoj Zotin që më ka bërë me një baba si ti!

Kristi Lipivani 6F



Baba, unë e di që nuk shpenzojmë shumë kohë së bashku, por unë të dua shumë ty dhe mendoj se ti je hero i im. Dhe kur kam qenë i vogël, mendoja se ti mund të më ndihmoje dhe të më shpëtoje nga çdo gjë. Unë nuk kam frikë, sepse e di që ti do të jesh gjithmonë aty për mua dhe nuk do të më lësh të rrëzohem, por do të jesh gjithmonë aty siç ke qenë gjithë këto vite. Gjithë këto vite, unë të kam parë që ti je munduar dhe ia ke dalë qëllimit që ne të ndihemi sa më mirë e komodë. Ti nuk je vetëm baba për mua, por ti je dhe si një shok i ngushtë për mua. Baba, nuk kam ndonjë kujtim që të kam kërkuar për ndihmë dhe nuk ma ke dhënë, dhe për këtë të falenderoj. E di që ti lodhesh duke punuar ditë e natë, vetëm që unë dhe motrat të kemi një jetë sa më të bukur. Por për ne, një jetë e bukur është duke pasur përkrah një baba si ty. Me dashuri, djali yt Arbi!

Arbi Tërshana 6F



Babi është shumë i rëndësishëm për mua. Ai më çon ku të dua unë. Më blen çdo gjë që kam nevojë. Më pëlqen shumë të dal me babin tim. Edhe pse ka shumë punë, ai gjithmonë e gjen kohën e lirë për mua. Babi im është shumë i mirë. Ai shpesh më merr te puna e tij. E kam shumë me dëshirë profesionin e tij. Unë do të bëhem si babi im kur të rritem.

Klei Kollçinaku 6F

Babi, heroi im!
 Babi, të dua!
 Je gjithçka për mua.
 Shembulli im je ti!
 Në vështirësi më ndihmon,
 më inkurajon,
 kur kam nevojë.
 Heroi im,
 miku im më i mirë,
 je ti!
 Babi im!

Noel Demo 6F



Baba ti je gjithçka për mua. Dua të të falenderoj për gjithçka që ke bërë për mua. Prandaj këtë tekst po ta shkruaj që ta dish se sa të dua. Ti gjithmonë vjen dhe më përqafton dhe dashurinë ti ma shton. Unë një ditë do të të falenderoj për gjithçka që ke bërë për mua. Babi, dua që ta dish se sa shumë të dua.

Rei Çuko 6F



Babai im! Sa e sa fjalë mund të them për ty, për heroin tim. Ti më je gjendur pranë gjithmonë dhe mërzinë time e ke kthyer në të qeshura, ditët më të këqija i ke kthyer në ditët më të lumtura. Ti je një njeri i ndershëm, i zgjuar dhe i palodhur që gjen kohë për gjithçka. Ti më ke motivuar në të gjithë hapat e jetës sime dhe në praninë tënde asgjë nuk është e pamundur. Në praninë tënde, ëndrrat marrin krahë dhe fluturojnë. Nuk e di se si do t'ia dilja pa ty. Prandaj ti je heroi im dhe gjithmonë do të jesh!

Denat Çitozi 6F



Është njeriu më i shtrenjtë për mua në këtë botë, është me shpirt të pastër dhe të bukur. Ai ka pasur shumë vështirësi që kur kam lindur. Punonte që të mbante familjen, ndonëse të ardhurat nuk mjaftonin. Babait iu desh të qëndronte larg nga ne që të na sillte të ardhura. Ai është një njeri, të cilit nuk do t'ia harrojmë kurrë mundin që ka bërë për ne. Babanë do ta dua më shumë se çdo njeri tjetër. Atë që ka bërë për mua nuk do ta harroj kurrë. Kur dikush është i vuajtur dhe e sheh familjen e tij pa të ardhura, në varfëri, gjen guxim për gjithçka, ia del mbanë dhe atëherë kur nuk mundesh më, i jep më shumë forcë vetes, sepse bëhet fjalë për familjen. Dhe kur dikush është i drejtë, siç është ai, ka gjithmonë Zotin më vete. Ai më ka plotësuar çdo gjë që kam kërkuar, si për shembull biçikletë, telefon etj. Këtë që ai ka bërë për mua, nuk do ta harroj kurrë dhe do t'ia shpërblej gjithmonë dashurinë e tij me punë, suksese e dashuri.

Endrit Çenga 6F

Babai është heroi im dhe më ndihmon sa herë që jam në momente të vështira. Ai mundohet të më plotësojë çdo dëshirë që kam. Madje ai edhe gatuan makarona shumë të mira. Ai asnjëherë s'më ka lënë në baltë, por më ka ndihmuar. Dhe gjithmonë kur kam pasur ndonjë problem, ai më ka ndihmuar ose është munduar t'i zgjidhë ato. Ja përse unë e quaj babin tim hero.

Jonas Heidorn 6F



Babai im është shumë i rëndësishëm për mua. Babai im është shembulli i parë më i mirë. Ëndrra ime në jetë është të bëhem si ai. Një njeri serioz, i pari për profesionin e tij dhe shumë familjar. Babai im është një ndihmë dhe një motivim shumë i madh për mua, për gjithçka në jetë. Babai im gjithë kohën e lirë e kalon me mua. Ai më ndihmon shumë në mësim, në sport, pra në çdo aspekt të jetës. Babai im është heroi im, sepse ai gjithmonë qëndron pranë meje si një hero mbrojtës, që asnjëherë nuk largohet dhe nuk dorëzohet për të më mbrojtur. Babai im më nxit gjithmonë për një të ardhme të mirë. Ai preokupohet në maksimum për mua dhe vëllainë tim. Por, ai nuk është i mirë për mua vetëm në aspektet mësimore. Ai gjithmonë zbavitet shumë me mua dhe tregon shakatë më zbavitëse në botë. Ai gjithmonë thotë që për të: "Nuk mund të ketë vajzë më të mirë se mua!"

Kiara Olldashi 6F



Babai im i dashur,
s'ka fjalë për të të përshkruar,
më i rëndësishmi je ti për mua.
Të dua shumë me të vertetë,
sepse ti gjithmonë me krahë të hapur më pret.
Le të bëjmë qejf, le të lundrojmë,
Ti je me të vërtetë më i miri,
pra, bashkë të ngazëllojmë!

Marina Peshtani 6F



Ai gjithmonë më ngre, kur unë bie. E dua më shumë se çdo gjë në botë. Ndonjëherë e bezdis kur vjen nga puna. Shpesh ne dalim shëtitje dhe kalojmë momente të bukura bashkë. Unë dua të bëhem si babi im.

Marko Ismaili 6F

I Veçanti Im Baba,
 personi më i çmuar,
 që përjetë më frymëzoi,
 më dha vullnet të jetoj,
 ashtu siç unë dëshiroj.
 Më ofroi gjithçka në jetë,
 më ofroi diçka me vlerë,
 dashurinë e një prindi,
 atë dashurinë e vërtetë.
 Ai është arsyeja,
 pse tek unë buzëqeshje ka,
 e për mua gjithmonë,
 Ai do mbetet kuptimi i jetës.
 Prezenca e tij,
 jetën ma bën të çmuar,
 Baba, ti je personi
 më i veçantë për mua.
 Jeta ime pa të,
 nuk do kishte kuptim,
 ngaqë ai është,
 pjesë e shpirtit tim.

Matteo Esposito 6F



Shumë njerëz thonë që vajzat rrinë më shumë me baballarët. Epo këto fjalë janë shumë të vërteta. Babi im rri shumë me mua edhe kur dalim flasim bashkë. Ai është gazmor dhe i zgjuar. Ka karakter shumë të fortë. Babai im është një hero i vërtetë për të gjithë, pasi ai ka shpëtuar jetë njerëzish. Ai është një mjek shumë i zoti. Babai im mund të jetë hero për shumë njerëz, si edhe për mua. Ai më hapi derën e dijes, kur më regjistroi në një nga shkollat më të mira në Tiranë. Prandaj unë dua ta falenderoj babanë tim për çdo gjë që ka bërë për mua. Çdo baba është një hero për fëmijën e vet. Asnjë fëmijë s'e meriton të jetë pa një figurë atërore.

Ajla Rroji 6G



Babai është heroi im, sepse është i gatshëm të bëjë çdo gjë për mua. Ai çdo herë më mbron dhe unë e dua pafundësisht atë. Kur kam qenë e vogël, para se të më zinte gjumi, babi më lexonte tregime të ndryshme, por tani jam rritur dhe nuk me tregon më. Ndonjëherë do doja ta bënte përsëri këtë gjë. Të më lexonte përsëri si atëherë fëmijë. Ai është i shtrenjti im, është i mrekullueshëm.

Alba Bylyku 6G

Personi që më ka ndenjur pranë që kur isha foshnjë. Ai më ka drejtuar drejt së ardhmes, më ka udhëzuar dhe më udhëzon gjithmonë. Është përkushtuar e përkushtohet për mua dhe kur kam ndonjë problem, ai gjithmonë më ndihmon, nuk më lë kurrë vetëm. Sado e lodhshme të jetë puna e tij, ai asnjëherë nuk dorëzohet dhe kur unë jam e mërzitur, ai është personi që më bën të qesh. Ai është heroi im, ai është Babai Im!

Blerta Kryemadhi 6G



Babi im gjithmonë mundohet të më kënaqë. Gjithmonë na çon me pushime në vende të ndryshme për t'u kënaqur dhe për t'u njohur me botën. Ndonjëherë më qorton, por ai e ka vetëm për të mirën time. Ne jemi shumë shokë bashkë. Babi im ka profesionin e doktorit, ai shpëton jetë, prandaj ai është me të vërtetë Hero! Je gjithmonë i kënkur në shtëpi, edhe kur je i mërzitur, ti nuk e tregon, pasi do që të jemi të gjithë të gëzuar. Të dua shumë!

Armin Vargu 6G



Sa lind dielli
e hapet qielli,
sytë e babit,
më kujtohen.

Shikoj qiellin
anembanë,
babi im
retë shpërndan.

Ai është liqeni im,
lotët e tij sjellin
gëzim,
ai është babai im.

Kur unë qaj,
më jep përqaftim.
Kur unë qesh,
më sjell më shumë
gëzim.
Çdo gjë e bëj,
për babin tim.

Stejsi Çupi 6G

Babai im është një hero për mua. Ai më ka mbështetur mua në situata të vështira. Ai është personi, i cili më ka treguar dhe më ka inspiruar për të luajtur futboll. Kur kam qenë i vogël, babi dhe unë kemi pas luajtur me pasa. Gjithashtu babi im më ka mësuar biçikletën. Madje, ai ka qenë aty, kur unë kam luajtur ndeshjen time të parë. Ai gjithmonë e ruan qetësinë në çdo situatë dhe gjithashtu unë e kam pasur atë, idhullin tim të fëmijërisë në futboll.

Denis Faqolli 6G



Babi, ti je heroi im. Ti je gjithmonë aty për mua sa herë që unë kam nevojë për ty. Babi, ti je heroi im dhe unë kurrë s'do të të braktisja. Ti je i pari që më vjen mua në ndihmë kur kam nevojë. Duhet të ta shpërblej gjithë këtë që ti ke bërë për mua. Do të kem gjithmonë nevojë për ndihmën tënde, por do të ketë raste që duhet t'ia dal vetë në jetë. Nuk do të harroj kurrë ty dhe se çfarë ke bërë ti për mua.

Endri Kola 6G



Babi im është vërtet një hero. Ai lodhet shumë për ta mbajtur familjen tonë të lumtur dhe që mua dhe vëllait tim mos të na mungojë asgjë. Gjithashtu punon fort për të më çuar mua në një shkollë private. Edhe pse e ka ditën shumë të ngarkuar dhe i duhet të vendosë gjithçka në një orar të caktuar, ai gjithmonë gjen pak kohë për mua dhe tim vëlla. Por babi nuk e ndihmon familjen vetëm nga ana ekonomike, por ndonjëherë edhe me punë shtëpie. Kur babi sheh se mami është e lodhur, ai lan disa pjata ose bën darkën. Që në vogëli, babi im ka qenë shumë i mirë në matematikë dhe ka fituar olimpiada të matematikës. Ai donte që edhe unë të isha po aq i mirë sa ai në matematikë, ndaj babi ka qenë një ndihmë e madhe për mua. Nuk është rasti i matematikës i vetmi, kur babi më ka ndihmuar. Në të vërtetë ai ka qenë gjithmonë aty për mua kur unë kam pasur më shumë nevojë për ndihmë. Gjithmonë më ka mbështetur e ka besuar te unë dhe më ka dashur e vazhdon të më dojë shumë. Ndoshta ndonjëherë nxehet shpejt, por në fund të fundit askush s'është perfekt. Unë gjithnjë e kam konsideruar babin si shokun tim. Babi është idhulli im. Unë dua të jem si ai kur të rritem. Si një person që e do shumë familjen e pjesëtarët e saj, që jep nga lumturia e vet për ta, që le mënjanojë gjithçka vetëm për të gjetur sadopak kohë për ta shpenzuar atë me njerëzit e dashur. Babi im është babai më i mirë në botë!

Joel Merkaj 6G

Babi im është heroi im sepse ai më gjendet gjithmonë pranë. Ai më zgjidh problemet që kam, më jep këshilla, është si shok për mua, ai është engjëlli im mbrojtës. Babi më jep forcën që më nevojitet. Ai mund të jetë i rreptë për ne, por ai e bën për të mirën tonë, që ne të kuptojmë. Babi ka një rol shumë të vështirë, babi të mundëson më të mirën, babi dhe në pozitë të vështirë të realizon dëshirën. Ne pa babin nuk do jetonim në shtëpi, pa atë nuk do kishim ushqim. Nuk kam fjalë për ta përshkruar. Faleminderit babi që më mundësove gjithçka, unë nuk do të di si ta shpërblej atë që ke bërë për mua deri më sot! Faleminderit babi, që më rrite dhe u bërë mësues për mua! Faleminderit për çdo gjë që ke bërë për mua...



Aron Smakaj 6G

Bota ka miliarda fëmijë dhe të gjithë këta fëmijë kanë një hero. Ai është babai i tyre, siç është për mua babai im. Babai im ka bërë çmos për të më rritur të shëndetshëm dhe me një jetë sa më të mirë. Ai më do pafund dhe dëshiron që unë të bëhem dikushi në jetë. Ke sakrifikuar aq shumë për mua saqë nuk e di, se si të ta shpërblej të gjithën. Disa herë mendoj për dashurinë e madhe që kam për ty. Të dua pafund dhe do të dua gjithmonë. Babi im, ti je jeta për mua dhe unë të dua e do të të dua edhe në pikën e fundit të jetës. Me ke rritur me dhembshuri e me dashuri!



Elsi Dino 6G

Thuajse të gjithë fëmijët kudo ku janë rriten duke parë filma vizatimorë. Edhe unë nuk bëj përjashtime. Sa fillova të kuptoj pak, në orare të veçanta gjatë ditës kam parë filmat e mi të preferuar. Shumë prej tyre kishin në qendër heroin. Mbaj mend që më pëlqente shumë Spiderman-i dhe Batman-i. Të dy luftonin kundra së keqes, për ta bërë botën një vend më të mirë. Vitet kaluan dhe unë u rrita, por vendin e heroit, Spiderman apo Batman e zuri babi im. Po po, mos u çuditni! Ai vërtet nuk ka superfuqi, po për mua është një hero. Po ç'është heroi? Është ai që na gjendet pranë gjithmonë, veçanërisht atëherë kur ne kemi më shumë nevojë. Edhe babi im është gjithmonë aty për mua. Sa shumë e bezdis me kërkesat e mia, por ai nuk lodhet kurrë. "Babi, më duhet të printoj diçka," dhe babi nxiton, megjithëse kujtohem vonë në darkë për t'i bërë. "Babi, ka dalë një film i ri," dhe ai nuk thotë kurrë, "Por jam i lodhur, moj Ema..." Nxiton të bëhet gati që unë mos të shkoj vonë. Babi im punon shumë, që mua të mos më mungojë asgjë. Ai nuk mungon kurrë kur unë kam nevojë për të. Ai sillet mirë me të gjithë dhe përpaket gjithmonë të ndihmojë njerëzit në vështirësi. Është edhe një qytetar model, pasi gjithmonë zbaton rregullat që janë vendosur dhe më mëson që edhe unë kështu të veproj kur të rritem. Unë jam shumë me fat që kam një baba si ai. Ai është heroi im !!!

Ema Çaushaj 6G

Babi, faleminderit për gjithçka që më ke dhënë Që më ke rritur,
 që më ke mbështetur, që më ke qëndruar gjithmonë përkrah.
 Ndihamat e tua s'kanë të numëruar, as me fjalë s'mund t'i shpreh.
 Gjithmonë më ke dhënë atë që dua dhe dëshirat m'i ke plotësuar.
 Faleminderit për gjithçka!

Kesli Sejdarasi 6G



Në gjithë jetën, disa nga kujtimet e mia më të bukura kanë babanë pjesë të tyre. Babai ka qenë gjithmonë atje për mua, gjithmonë duke u munduar të më ndihmojë. Ai mundohet të më sigurojë një të ardhme të sigurt dhe sa më të lumtur. Ai bën gjithçka për lumturinë time, ai kthen gjithë botën përmbys për mua. Babai më plotëson çdo dëshirë dhe shumë rrallë ma prish. Kur jam e mërzitur, ai më bën të qesh, kur jam e lodhur ai më mbush plot me energji dhe kur jam e lumtur, ai sigurohet që asgjë mos ta prishë atë moment. Ai që më ka mësuar gjysmën e gjërave që di tani. Ai gjithmonë mundohet të fusë të qeshurën në mes të çdo gjëje, edhe pse mua më duket sikur ai nuk po e merr seriozisht. Ai është i qetë, më dëgjon, ai më tregon për gabimet e tij, sepse shpreson se kështu ai ka për të më shpëtuar nga disa telashe. Ai gjithmonë beson tek unë dhe më e rëndësishmja është që ai më do fort. Unë duhet ta falenderoj me mijëra herë për ato që ka bërë për mua. E dua shumë babanë tim!

Amina Haxhialushi 6G



I Dashur Baba!
 Babi, ti je gjithçka për mua,
 unë ty shumë të dua.
 Ti je jeta ime, që më rrite.
 Ti je njeriu më i mirë i jetës sime.

Unë kur të takova, shumë u lumturova,
 dhe jetën me ty e gëzova.
 Tani që u rrita, ti më ke mësuar të jem i fortë,
 që të tjerët mos të më ngacmojnë dot.

Frenci Valteri 6G

Çfarë është për mua një hero? Unë mund ta përkufizoj me një emër tjetër, emrin e babait. Më mbajti në krahët e tij, që kur u bëra pjesë e kësaj bote, më mësoi hapat e parë dhe që atëherë nuk më ka lënë të rrëzohem. Nëse do të më duhej të zgjidhja dhe një herë, unë do të zgjidhja gjithmonë atë, babanë tim. Po do të thoni ju se çfarë heroizimi ka bërë ai? Ai është aty me mua kur qaj dhe më qetëson, ai është aty me mua kur qesh dhe qesh me mua, ai është aty kur jam sëmurë dhe më shëron. Ai e zbukuron jetën time dhe më bën të jetoj. Ai ka fuqinë të zbutë shpirtin tim dhe me një shikim të ëmbël të tij çdo gjë bëhet më e bukur. Ja ky është heroi im, babai im!

Kristel Serra 6G



Babi im është njeriu më i mirë në botë, është heroi im dhe i familjes sime. Shumëkush do të thoshte po të njëjtën frazë, madje me shumë krenari dhe dashuri. Ama, unë sinqerisht kam disa arsye të forta që e bëjnë figurën e babait tim të jetë e pashoqe, e jashtëzakonshme dhe e ndjerë. Ai është personi që mbi të gjitha më fal një dashuri të papërshkrueshme çdo sekondë, ndonëse e takoj dhe qëndroj me të vetëm kur mbërrin mbasditja. Do doja t'i thoja faleminderit për çdo gjë që më ka mundësuar, për çdo sekondë që më ka falur dashuri, për çdo moment që më ka bërë të ndihem me fat që po jetoj. Po mendoj se është më i përshtatshëm një çast i dytë, kur unë të jem rritur e të jem pjekur, kur unë ta kem kuptuar plotësisht babin tim. E atëherë unë do ta falenderoj nga zemra dhe do t'ia shpërblej çdo sakrificë dhe ledhatim. Ndonjëherë më vjen t'i kërkoj falje kur është i mërzhitur, i lodhur, i dhemb koka dhe rri i menduar, ndonëse gabim nuk kam bërë. Po ai kurrë nuk thotë që lodhet për mua. Tani a më kuptoni se sa i vyer është prindi im? Për të gjithë fëmijët, që nuk kanë arritur të gëzojnë dashurinë e babit, shpresoj që dikur të arrijnë të bëhen vetë të tillë dhe ta falin ata vetë, dashurinë që nuk e morën dot asnjëherë.

Kapllan Sheno 6G



I dashur baba,

E di që kohët e fundit nuk të kam kënaqur shumë me notat që kam marrë, por unë të kam bërë një premtim, i cili është se unë do të bëj maksimumin për të marrë notat më të mira. Do përpiqem të lexoj çdo mësim nga e para, që të mos kem asnjë problem, në asnjë pyetje. Baba, ti përherë m'i ke plotësuar dëshirat e mia, por me një kusht ama, që të merrja nota të mira. Unë kam reflektuar në gabimet që kam bërë dhe premtoj që do ta mbaj premtimin tim. Jam krenar që kam një baba si ti dhe do bëj çmos që ti të jesh krenar për mua, djalin tënd. Të dua shumë, djali yt ILIRI!

Ilir Ndoja 6G

Babi, ti je hero për mua... Ti je një nga ata persona, të cilët pavarësisht gjithçkaje, me shumë dashuri i edukojnë fëmijët e tyre. Ti më ke falur gjithmonë dashuri dhe mbrojtje në çdo kohë. Unë e di se nëse një ditë do të gjendesha në vështirësi, ti do të ishe aty për të më ndihmuar. Edhe pse ne kemi bërë gabime, ti na ke treguar rrugën e duhur. Ti na ke mësuar se për të arritur suksesin, duhet të punosh shumë. Prandaj edhe unë do të mësoj sa më shumë, për të arritur rezultate sa më të larta dhe për të bërë ty dhe mamin krenarë. Babi, ti gjithmonë ke qenë aty kur unë kam pasur nevojë për ty, prandaj edhe unë do të mësoj shumë për t'i plotësuar të gjitha ëndrrat që keni për mua dhe do t'i bëj realitet, ashtu siç keni bërë ju të miat...

Sibora Hysenaj 6G



Kur hapa syt' për her' të par',
Isha vetëm, në një spital të madh,
S'kishte kush të më mbante në krah,
Madje as mami, të më ushqente me qumështin e saj.

Por babi erdhi në spital,
Dhe më përqafoi me mall,
Un' ndjeva dashurinë e tij,
Të zjarrt' e të pakufi.

U ndjeva më e mbrojtur,
Edhe pse isha në spital,
Se afër meje kisha,
Mbrojtësin tim të veçant'!

Babi është heroi im më i madh,
Më ka ndihmuar në çdo çast,
Për mua është njeriu më i shtrenjtë
Dhe do ta dua shumë gjithmonë!

Meliora Veliaj 6G



Shumë fjalë nënës i kushtohen, por unë sot i kam disa fjalë për ty babai im, heroi im. Nënës i kam dhuruar buzëqeshjen e parë, ndërsa babait i kam dhuruar adhurimin tim. Ai është idhulli im. Babai është një person që të mbështet e të përkrah. Të them se je babai më i mirë në botë nuk është mjaftueshëm, pasi për të gjithë fëmijët, prindërit e tyre janë më të mirët, por ti me të vërtetë je i veçantë për mua dhe unë të dua shumë babi im!

Sibora Likaj 6G

Në qoftë se do të shkruaja një histori,
Do të ishte historia më e bukur që kam shkruar ndonjëherë...
Për një baba të dashur dhe të kujdesur,
Që kishte një zemër prej ari.
Do mund të shkruaja një milion faqe,
Por nuk do mundja të përshkruaja dashurinë për të.
Shumë herë të kam zhgënjyer,
Dhe dhimbje të kam sjellë,
Por do të të bëj krenar,
Dhe buzëqeshja jote kurrë nuk do të mbarojë.
Sepse ti je heroi im,
Që më ke mbështetur kudo dhe kurdo,
Dhe kurrë nuk më ke lënë vetëm,
Në çdo moment të vështirë.
Të Dua Shumë ,Babai Im i Dashur!
Me dashuri, vajza jote!

Sara Çollaku 6G



Babi është heroi im. Babi është një nga fjalët e para që kam thënë. Babi është një nga njerëzit më të dashur për mua. Kur jam me të, ndihem e sigurt. Është ai që mundohet të mos më prishë asnjë nga dëshirat e mia. Edhe pse mund ta kem mërzitur, ai më ka mbështetur në çdo hap të jetës sime. Ai është gjithçka për mua. Babi është një nga njerëzit që më do pa interes. Babi është ai që më ka shpëtuar gjithmonë. Është ai që çdo ditë do ta shohë vajzën e tij të lumtur. Babi është një yll, i cili shndrit çdo ditë dhe ma ndriçon rrugën drejt së ardhmes. Babi, të dua shumë, pa interes. Unë kam marrë shumë nga virtytet e tij, qetësinë, dashurinë etj. Gjithashtu unë kam marrë edhe një nga tiparet e tij më të bukura, sytë. Babi dhe mami, ju jeni njerëzit e parë që më keni marrë në dorë kur linda. Babi im i dashur, të dua shumë dhe të falenderoj për gjithçka që ke bërë për mua! Të uth fort vajza jote e madhe, Vesa Çeliku.

Vesa Çeliku 6G

Klasat e 7-ta

Sa herë mendoj për babain tim, mendoj për heroin tim. I kujtoj shpesh ato momente që ai më ka bërë të qesh dhe ndonjëherë dhe të qaj duke menduar e pyetur veten time: "Vallë a do t'i përjetoj gjithmonë këto çaste?" Babai im punon fort e sakrifikon gjithçka për mua dhe për gjithë familjen time. Jo rrallëherë mendoj me vete në do të jem i aftë t'ia shlyej gjithë këtë dashuri me dashuri dhe gjithë këto sakrifica me arritje. Edhe pse mendimet e mia sot lëkunden, thellë në shpirt e di që do të të bëj krenar, sepse të kam gjithmonë pranë. Babi, me këtë shkrim dua të të them disa fjalë: "Të Dua Babai Im!"

Elgis Zeneli 7A



"Ai është babai im..."

Çfarë mund të them për të? Një njeri që më ka mbështetur e ndihmuar për të dalë nga shumë situata të vështira. Ka qenë me mua në çdo kohë, në të mirë e të keqe. Më ka ndihmuar gjithmonë kur kam pasur vështirësi në mësim. Më ka këshilluar çdo herë kur bëja një gabim, që mos e përsërisja prapë. Sa herë që ndodhte e kundërta, edhe pse mërzitej, ai do të më ndihmonte që të mos e bëja sërish. Shpeshherë ai m'i rikujton gjërat e lezetshme që kam bërë kur isha i vogël. Edhe pse s'më pëlqen, unë gjithmonë do të jem djali i tij i vogël. E pra, ky është babai dhe modeli im. Kur të rritem dua të bëhem si ai. Sado larg që të jem e sado të vështira që të jenë situatat, e di që ai do të jetë gjithmonë pranë meje për të më ndihmuar.

Rubin Muja 7A



Ti që më rrite,
ti që më edukove,
ti që më qëndron pranë
dhe në kohë të vështira.
Ne të dy kemi qeshur,
por dhe jemi mërzitur.
Me ty kam ndarë sekrete,
ti je më i mirë miku im.
Ty të dedikoj këtë poezi.
Ty baba...
Ty, heroi im!

Sardi Molla 7A

"Babai im"

Ç'të them për të, veçse është njeriu më i dashur për mua. Babai, ai që punon gjithë kohën për një familje të shëndetshme. Babai, ai që investon për mua që një ditë të më shikojë të rritur e të shkolluar. Është ai që më udhëzon se si t'i mbijetoj intrigave të kësaj bote. Është ai që nuk do të kursente asgjë për familjen duke më mësuar që vetëm me punë dhe sinqeritet arrihet suksesi. Është ai që unë e dua më gjithë shpirt, që e dua pa kufi. Me pak fjalë, babai është heroi im.

Taulant Arizaj 7A



Ti ditës sime i sjell gëzim.
Më jep krahë, fshin çdo trishtim.
Ke punuar që unë të kem një të ardhme të mirë,
ke sakrifikuar... për mua,
dhe dua ta dish që shumë të dua!
Më ke qëndruar pranë
e mësimet e jetës m'i ke mësuar,
ndaj të falenderoj,
kurrë s'kam për t'i harruar!

Mirgen Xhunga 7A



Kohët e vështira në jetë shpeshherë na vënë në provë, ndërsa ju prindër jeni gjithmonë të kudogjendur dhe na ndihmoni të mos gabojmë. Një shembull i pakrahasuar, përkujdesje e pafund, nbështetje pa kushte, të gjitha i marr vetëm nga ti baba. Dhembshuria, situatat gazmore mënyra se si e transmeton çdo gjë të bën të veçantë, baba. Ndoshta një ditë unë do gjej princin tim, por ti do të mbetesh gjithmonë mbreti im! Jam me fat që rritem në një familje me prindër që kultivojnë dashuri, mirësi, kulturë dhe shpresoj shumë që të ndjek hapat tuaj. Jam me fat që kam një baba si ti dhe uroj që vetëm buzëqeshje të shoh në fytyrën e shpirtin tënd! Të admiroj dhe të dua pafund BABA!

Patris Haxhiu 7A



Babai im është hero për mua. Ai është gjithmonë aty kur unë kam nevojë. Ai më ndihmon me mësimet, por edhe me gjëra të tjera. Kur më ndërruan klasën, babi e pa që isha i mërzhitur, prandaj më linte të luaja me shokët gjatë gjithë ditës. Babi më plotëson çdo dëshirë. Por si çdo prind tjetër, ai mërzhitet kur unë bëj ndonjë gabim në shkollë. Megjithatë unë e di që ai më do të mirën. Unë e dua shumë babanë tim dhe jam i sigurt që edhe ai më do mua.

Ernan Nuri 7A

Babai im është kujdesur për mua që kur isha shumë i vogël.

Më ndihmonte kur rrëzohesha dhe vritesha në kohën që isha ende i vogël. Babai im më ndihmonte të ngrihesha në këmbë, më shoqëronte për në shtëpi pa shprehur asnjëherë lodhje. Kur përsëritja mësimet, sa herë që kisha test e bëja gabime, babai im më ndihmonte dhe më udhëzonte t'i zgjidhja ushtrimet kur gjendesha në vështirësi. Unë dilja me nota jo të mira në teste, por ai nuk mërzoj, më këshillonte që të bëja kujdes kur i lexoja pyetjet dhe të mësoja më shumë. Kur isha fëmijë i vogël bëja prapësira, bëja rrëmuje gjithë shtëpinë, por ai prapë më toleronte dhe më donte shumë. Babi je pasuria më e çmuar për mua dhe fjalët nuk mjaftojnë për të të falenderuar, për të të shprehur dashurinë time për ty.

Majk Prusha 7A



Baba, fjala që një fëmijë belbëzon që në lindjen e tij. Babai është personi që më gjendet gjithmonë pranë, që më ndihmon në çdo pengesë, që më del krah në jetë. Është ai person që punon pa pushim që familja të jetojë në kushte sa më të mira, që ka sakrifikuar çdo gjë dhe është lodhur aq shumë për familjen e tij dhe akoma vazhdon dhe do të vazhdojë ta bëjë. Babai është një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Është ai që më kritikon dhe kjo është pjesa që më pëlqen më shumë, kritika, sepse unë pas çdo gabimi marr një mësim. Nuk kam fjalë për të të përshkruar, mjafton që të përmend gjërat që ai ka bërë dhe do ta kuptosh se ç' do të thotë fjala baba për mua. Babi, të dua!

Uendi Duriçi 7A



Babi, eh, sa herë jam përpjekur të shkruaj për ty, por nuk kam mundur... Gjithmonë kam shkruar për mamën dhe ti asnjëherë nuk je bërë xheloz. Babi, të dua më shumë se gjithçka dhe ti po ashtu. Unë jam gjëja më e shtrenjtë për ty. Ti do më mbrosh gjatë gjithë jetës sime. Ju punoni e lodheni për të ardhmen tonë. Unë të kam dashur, të dua dhe do të të dua shumë. Je çdo gjë për mua. Unë nuk dua që ti të më puthësh me ato mustaqet e tua që i kam aq inat. Të kujtohet kur unë isha në klasë të dytë dhe ti kishe ditëlindjen, por unë gjatë gjithë kohës rrija në dhomë dhe ju menduat se çfarë kisha. Në fakt nuk kisha asgjë, unë vetëm po të përgatisja ty një vizatim dhuratë. Por nuk pata guxim të ta jepja sepse kisha turp. Nuk e di në e ke marrë, por unë nuk pata guxim të ta jepja. Njerëzit, kur isha e vogël, gjithmonë më pyesnin atë që unë e kam shumë inat: "Cilin do më shumë? Mamin apo babin?" dhe unë që thoja gjithmonë "Babin", por sigurisht isha fëmijë, sepse tani ju dua të dyve shumë. Thoja ashtu sepse mami më bërtiste për gabimet që bëja, kurse ti jo. Babi, tani po e mbyll këtë shkrim këtu, gjithsesi ti e di sa shumë të dua.

Fiona Gilani 7A

I shtrenjti babai im,

Jam unë, vajza jote e dytë. E di që kam bërë e bëj gabime, por falë teje kam kuptuar shumë dhe mundohem të bëj gjithçka që ti të ndihesh krenar. Ndihem krenare për ty, për ekzistencën tënde, për edukatën dhe kulturën që na ke dhënë dhe vazhdon të na japësh. Gjithë jetën tënde po e sakrifikon për familjen duke punuar pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na dhënë të gjitha gjërat që kemi nevojë për 13 vite radhazi, duke u munduar për rrugën më të mirë që unë duhet të ndjek. Gjithmonë nga goja jote kanë dalë dhe vazhdojnë të dalin fjalë të ëmbla si mjalti! Edhe kur më këshillon, mënyra që ti zgjedh është shumë e qartë dhe e ëmbël. Ti ke një sjellje të veçantë jo vetëm me mua, por me të gjithë, e cila është e pakopjueshme. Je unik! Babi, kur unë të dal të punoj, kur të bëhem me familje do ta kuptoj ç'do të thotë të jesh prind, ç'do të thotë të rritësh tre fëmijë, ç'do të thotë të jap dhe të marr nga jeta dhe çfarë do të thotë familje. Gjithmonë më ke emëruar si "Goca e babit", ose kur isha edhe më e vogël "Floriri i babit". Babi im, kam shumë fjalë për të thënë, që nuk mbarojnë. Është shumë e vështirë për mua të zhvilloj një temë të tillë, sepse për të të përshkruar ty, mua nuk më mjaftojnë një e dy fletë, por as një libër dhe as një roman. Nuk di se me çfarë fjalësh mund ta përshkruaj dashurinë time për ty. Je idhulli im. Si do të ta shpërblej gjithë këtë mirësi, dashuri dhe sakrificë që bën për mua? Nuk do mund të ta shpërblej kurrë, qoftë duke mësuar, qoftë me vlerë monetare apo me dashurinë që të kam falur dhe do të të fal gjatë gjithë jetës sime. Babai im është për mua një krijesë qiellore, dashuri përrallore që vetëm siguri e besim më dhuron. Babi, jam përherë e sigurt nën kujdesin tënd. Je idhulli im...

Esjena Hidri 7A



Babi, ti je gjithçka për mua. Ti je ai që më ka qëndruar gjithmonë pranë kur kam pasur nevojë. Ti je ai që ka qarë për mua. Jam vajza më e lumtur në botë që të kam ty baba. Je njeriu më i shtrenjtë në jetën time. Je ai që kur kam qenë e mërzitur, më ke bërë të lumtur. Je ai që gjithë ditën ma kthen në gëzim. Jam krenare për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë. Gjithë jetën tënde po punon për familjen pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë. I shtrejti baba, ti dhe mami jeni pasuria ime, për ju të dy fal dhe jetën. Ju dua shumë. Nuk kam fjalë për ta përshkruar dashurinë time për ty. Je babai më i mirë në botë. Edhe pse nuk kanë të sosur fjalët e mia për ty, ti ke qenë, je, dhe do të mbetesh babai më i mirë. Dua që ti të jesh gjithmonë i lumtur sepse edhe unë do të jem gjithmonë e lumtur. Të dua shumë, shumë!

Elsona Kupa 7A

Babai im është heroi im i vërtetë, është personi më i veçantë në jetën time. Ai është një atlet dhe artist shumë i mirë dhe noter me profesion. Në fundjavë atij i pëlqen të luajë me mua gjatë tërë ditës. Gjatë ditëve të javës ne punojmë shumë dhe harxhojmë kohën maksimale duke punuar në zyrën e tij. Ai përpiqet më së miri për ta mbajtur familjen tonë të lumtur. Ai punon shumë për të siguruar të ardhura ekonomike për familjen. Gjithmonë përpiqet të më mbushë me gëzim sa herë që nuk jam në humor. Babi më ka edukuar të çmoj vlerat mbi çdo gjë e tek të gjithë. Në të njëjtën kohë ai më ka dhuruar shumë gjëra që unë gjithmonë kam dëshiruar t'i kem. Babai im gjithmonë ka bërë më të mirën për mua. Sa herë që kam nevojë për të, ai është gjithmonë i gatshëm për të më ndihmuar. Ai është hero për mua, ka humor, është inteligjent dhe i pëlqejnë aventurat. Atij i pëlqen të udhëtojë dhe kjo është arsyeja pse ne të dy gjithmonë shkojmë në vende të largëta (nganjëherë jashtë vendit) gjatë pushimeve. Deri më sot kemi udhëtuar në: Monte Carlo, Nice, Zvicër, Tailandë, Kualalumpur, Itali, Turqi, Greqi etj. Të dy i pëlqejmë shumë udhëtimet dhe kjo është arsyeja pse pushimet janë gjithmonë të mirëpritura për mua e babanë tim. Babi, je shembull për mua...

Sara Zhelegu 7A



Babai është personi që më do shumë, më rri pranë dhe më frymëzon, më mbron kur e gjithë bota është kundër meje dhe është i gatshëm të bëjë gjithçka për mua. Ai mundohet të m'i plotësojë të gjitha kërkesat dhe dëshirat që shpreh. Për të gjithë fëmijët babai është hero. Edhe unë dua të bëhem si babai im e të eci në gjurmët e tij. Ai gjithmonë mundohet të m'i shpjegojë të gjitha gjërat pa e tejkaluar, që kur të rritem, të bëhem dikush në jetë. Këshillat dhe qortimet më kanë ndihmuar të kuptoj gabimet edhe pse nuk ndihem mirë kur e shqetësoj dhe i marr kohë nga koha e tij. Ai është kritiku që i ka frenuar fëmijët të mos hedhin hapin e gabuar, është këshilluesi më i saktë që mundohet t'i bëjë fëmijët të maten para se të hedhin një hap në jetë. Babai jo vetëm të këshillon, të kritikon, të mbron, të do, por edhe sakrifikon çdo gjë për ty. Mendoje pak sa ditë pa gjumë ka qëndruar orëve të vona të natës për t'u siguruar që je mirë. A e ke menduar ndonjëherë se çfarë kanë shkaktuar tekat e tua dhe me sa mund janë plotësuar? Po ta mendosh, a ka ndonjë rast kur ai nuk të është gjendur ose nuk të ka ndihmuar për ndonjë gjë? Jo. Babai nuk më ka thënë kurrë jo. Për mua babai ka qenë dhe do të jetë gjithmonë heroi im. E kam thënë dhe po e them prapë që babai im është një njeri i mrekullueshëm. Babai mua më ka trajtuar gjithmonë si shoqe dhe unë e vlerësoj shumë. Edhe kur bëja gabime nuk më bërtiste. Kur merrja ndonjë notë të keqe gjithmonë më inkurajonte që unë të përmirësohesha dhe të kuptoja gabimet e mia. Gjithë këto shembuj e mendime më bëjnë që ta dua më shumë babanë tim kaq të veçantë.

Sara Huqi 7A

I shtrenjti babai im,

Me kënaqësinë më të madhe po shkruaj këto fjalë për ty . Babi, hapat e parë me ty i hodha, fjalën e parë "babi" shqiptova. Kur isha e vogël, a e mban mend që thoja: "Do flesh nani me mua se kam frikë nga arushi?" Dhe ti më thojë: "Përderisa babi është këtu, arushi nuk të merr kurrë!" Kur shkonim në plazh e kisha frikë ujin e ftohtë dhe ti më merrje në krahë dhe më mësove të mos kisha frikë detin dhe pishinën që kishim tek vila në plazh. Ti dhe mami më keni edukuar dhe drejtuar gjithmonë me butësi dhe dashuri. Ju jam mirënjohëse për gjithë jetën. Me ardhjen në jetë të Elgisit, vëmendja jote tek unë ishte sërish edhe pse për ty ishim njësoj, ti e kuptoje që më pëlqente të isha në qendër të vëmendjes. Mbas katër vitesh erdhi në jetë vëllai vogël, Orgito. Sërish ti ishe i fokusuar tek unë dhe falë teje unë nuk ndjeva xhelozin ndaj vëllezërve. Edhe mbas 10 vitesh, kur familja jonë u shtua me vëllanë më të ëmbël në botë, Noar, ti vëmendjen e ke te unë edhe pse jam më e madhe! Gjithmonë do të ndihem krenare për ty. Ke qenë dhe je babai ideal për mua. I tillë do mbetesh deri në fund të jetës sime. Jam krenare që kam një baba si ty. Të dua shumë! Elisa jote e vogël.

Elisa Zeneli 7A



Babai më ka ndihmuar dhe do më ndihmojë gjithë jetën. Që kur linda, ai u kujdes për mua. Kur unë fillova të rritesha, ai më mësoi të eci, më mësoi t'i jap biçikletës dhe shumë gjëra të tjera që askush tjetër s'do m'i bënte në këtë botë. Do bëj më të mirën që t'ia shpërblej me rezultatet në mësim. Tani që e ndiej veten të rritur, kam filluar ta ndihmoj në punët e tij dhe pavarësisht kohës së kufizuar që më ngel për ta ndihmuar, ai gjithmonë më shpërblen. Çdo gjë që bën është edukuese, nxitëse dhe e drejtë. Ai vërtet është heroi im!

Noel Kraja 7A



Babi im, njeriu më i dashur, njeriu që më shoqëron edhe në largësi, njeriu që më mbështet në gjërat e drejta dhe di si t'më këshillojë kur bëj ndonjë gjë të gabuar. Ai për mua është një hero i pazëvendësueshëm dhe kështu do të jetë gjithmonë. Është një numër shumë i madh arsyes, sa më mungon aftësia për t'i shprehur të gjitha, por mbi të gjitha unë e dua shumë babin tim. Edhe në ditë me diell, yllin e tij e shoh më ndritshëm.

Një ndër gjërat që gjithmonë kujtoj është fakti se jam në gjendje t'i jap biçikletës . Por për mua shprehja : "Jam në gjendje t'i jap biçikletës" nuk është në kuptimin e parë . Për mua biçikleta është shumë më tepër se aq. Më ka mësuar dhe nuk lodhet duke më orientuar se si të jem një udhëheqës i mirë i jetës sime. Babi të falenderoj! Të falenderoj si fëmijë, si shok dhe si nxënës! Je heroi im.

Fergi Sukaj 7A

I shtrenjti babai im... Jam unë vajza jote e vetme që të dua fort, edhe pse shpesh bëj gabime. E di që te ti do të gjej njeriun e palodhur që m'i shpjegon gjërat për t'i kuptuar dhe më kupton bashkë me nazet e moshës. E di që duhet të bëj gjithçka që të ndihesh krenar për mua, edhe pse e meriton që të mos mërzhitesh asnjëherë. Jam krenare për ty, për dashurinë që më ke dhënë. Gjithë jetën tënde ke punuar e punon për familjen, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na plotësuar të gjitha kushtet, të gjitha nevojat që kemi. Babi, kur të dal të punoj, kur të bëhem me familje do ta kuptoj më mirë ç'do të thotë të jesh prind, ç'do të thotë të rritësh dy fëmijë, ç'do të thotë të japësh dhe të marrësh nga jeta, çfarë do të thotë familje. Babi im, kam shumë fjalë për të të thënë... Të dua shumë dhe jam shumë e kënaqur, e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti. I shtrejtji baba, ti dhe mami jeni pasuria ime. Për ju të dy fal dhe jetën. Ju dua shumë! Je si një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar gjithmonë ke qenë përkrahësi më i mirë për mua.

Arba Strataj 7A



I shtrenjti baba,

Me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti. Je idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si busull drejtuese për mua. Je këshilluesi më i saktë e që më ke bërë të mos gaboj në jetë. Të kam lënduar e më ke lënduar, po në të njëjtën mënyrë, prapë më do dhe të dua, edhe pse asnjëherë s'ta kam thënë. Dhe për këtë ty të ngjava, m'i mësove ti të tëra. Jetoj me kujtime të mrekullueshme... Pranë krevatit kam në kornizë fotografina tënde që e shoh çdo natë para se të fle... Ëndërroj për të ardhmen time siç e deshe dhe ëndërrove dhe ti. Të falenderoj për dashurinë e përkujdesjen pa kufi që kam marrë vazhdimisht nga ti. Të falenderoj që më ke qenë pranë në çdo gjë. Je aleat dhe shok, baba dhe mik.



Mateo Qemolli 7A

Babai im është heroi im. Gjithmonë i pranishëm dhe i përkushtuar shumë aty ku ishte e nevojshme. Ai ka punuar orë shtesë që të më ushqejë mua. Në moshë shumë të vogël iu desh të punonte e të mbante nënën, babanë, motrat dhe vëllezërit e tij, sepse ishte fëmija i madh në atë familje me 15 persona. Bëhet fjalë për 32-33 vjet më parë, kur dhe mundësitë ekonomike ishin pothuajse zero. Im atë ka pasur një fëmijëri të vështirë, ose më saktë nuk ka pasur fëmijëri fare, sepse pavarësisht moshës duhet të punonte dhe të mbante familjen. Iu desh të linte edhe shkollën, herë shkonte e herë jo, derisa e ndërpreu, sepse nuk kishte çfarë të vishte, madje edhe në ato herë që shkonte, më shumë ishte zbathur. Punonte ku të mundte për të mbajtur familjen, ndonëse të ardhurat nuk mjaftonin, me gjithë ndihmën që jepnin edhe prindërit e tim eti. Vuajtjet nuk e gjunjëzuan, përkundrazi e bënë më të fortë, ndaj them që baba im është heroi im.

Joel Gjidia 7A

Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtë tim, babait tim. Ai ka qenë dhe është një person shumë i drejtë, njeri me shpirt të pastër e të bukur, që në jetë ka hasur shumë vështirësi. Heroi im është babai im, sepse ai është i veçantë për mua, është një artist dhe atlet shumë i shpejtë. Ndonjëherë i pëlqen të shtrihet në shtrat gjithë ditën e të mos bëjë asgjë! Gjatë javës kalon shumë kohë me vëllanë tim dhe mua duke bërë gjithçka për ne. Ai më jep kurajo dhe më ndryshon gjendjen emocionale kur jam e trishtuar. E dua shumë babin tim!

Marla Kazani 7A



Sot jam ulur dhe po mendoj. Po mendoj për fëmijërinë time, për kohën që kemi kaluar bashkë. Me lot në sy dhe njëkohësisht me një kënaqësi në zemër po ta shkruaj këtë letër, babë. Sa me fat jam që i kam prindërit e tillë. Sa me fat jam që e kam një babë si ti! Që kur isha i vogël më ke mësuar ç'është e mira dhe e keqja. Kur bëja sherre, ishe ti ai që më ke mbrojtur e këshilluar. Nuk është se më ke llastuar, përkundrazi je mundur të sillesh shumë serioz dhe i drejtë me mua. E di që ndonjëherë të kam mërzitur, por të jap fjalën që do t'i ndjek këshillat e tua për ty dhe për veten time që të bëhem si ti.

Marko Malaj 7A



Nuk e gjej dot mënyrën për të treguar dashurinë për personin më të shtrenjtë për mua. Fjalët më ngatërrohen dhe nuk di se si ta përshkruaj. Je një person i mrekullueshëm! Më ke mësuar të jem e dashur, e edukuar dhe e respektuar. Përherë më ke dhënë këshilla me vlerë, më udhëzon në rrugë të drejtë dhe bën më të mirën për mua. Ti baba, ke qenë me mua në çdo rast të bukur, të lumtur, të gëzuar e të trishtë. Duhet të të falenderoj për çdo gjë, duke filluar nga çdo tekë që më ke plotësuar, duke qenë aty kur hodha hapin e parë, kur kisha "Festën e Abetares" etj. Duhet të të them faleminderit për gjithçka dhe se unë nuk do mund të ta shpërblej dot kurrë. Ti je unik dhe perfekt. Gjithnjë e kam adhuruar imazhin tënd, angazhimin tënd në çdo gjë që bën, dëshirën tënde për të qenë pjesë në aktivitete të reja dhe dëshirën për t'ia dalë mbanë. I shtrenjti baba, me mirënjohje të thellë t'i drejtoj këto fjalë shpirti. Je idhull, je hero i im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si busull drejtuese për mua. Je kritiku, këshilluesi im, që më frenon para se të hedh hapin e gabuar e të gjykoj mbi atë që bëj.

Romina Gjana 7A

I shtrenjti Baba,

Je si një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Ti mua më dhe jetën. Ti je mbreti im, drita e syve të mi. Ty baba gjithmonë do të dua. Ti për mua je një në një milion. Ti je engjëll që ka zbritur në tokë. Ti për mua je parajsa e vetme në tokë. Në ditë të vështira ti më rri pranë. Që në fëmijëri ti më ke qëndruar afër atëherë kur unë ta kisha nevojën ty. Ti je personi që unë dua të bëhem në jetë. Kur më vjen ti në mendje mendoj për fjalët i dashur, zemërmirë dhe i fuqishëm. Që në fëmijëri ti më ke qëndruar pranë atëherë kur unë kam pasur nevojë. Njerëzit ikin e vijnë, por ti do të qëndrosh përgjithmonë në zemrën time. Nuk do ta imagjinoja kurrë jetën pa ty. Unë kam dhe do të kem gjithmonë nevojë për ty...

Alenis Ivanaj 7B



"Babai, heroi im"

Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtit tim, babait tim. Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë për mua. Ai quhet "Hero" për mua sepse ka bërë gjithçka unë doja. "Baba" është fjala më e dashur për një vajzë, e cila dëshiron gjithmonë të ketë një shok të ngushtë, të flasë me të, të luajë me të, por është e thjeshtë të gjendet sepse është aty pranë teje gjithmonë, sepse është BABAI yt, "Heroi yt". Baba quhet një "Hero" i cili ka sakrifikuar shumë për gjithçka ka bërë, le të themi përkujdesjen për familjen e tij të shtrenjtë dhe çdo mundim për fëmijët e tij, që të shkollohen sa më mirë të jetë e mundur. Je kritiku që më ka frenuar pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë që më bëre të mos gaboj kurrë në jetë. Gjithmonë do ndihem krenare për ty. Ke qenë babai ideal për mua dhe akoma je. Baba, po t'i them këto fjalë sot për të shprehur dashurinë e madhe që kam për ty, sepse ti je ai që më ke treguar shumë gjëra që sot ia kanë vlejtur dhe të them faleminderit sot për gjithçka ke bërë, jo vetëm për mua, por për të gjithë të dashurit e tu!

Emilia Uka 7B



Babai është shtylla e familjes sonë, ai që na mban në këmbë. Ai që sakrifikon nevojat e tij për të na kënaqur ne. Çdo kërkesë që ne kemi, ai nuk e mënjanon, por përpiqet që me çfarë mundësie të ketë, ta realizojë. Babai është ai që na këshillon për gjëra të cilat duhen e s'duhen bërë.

Është ai që pavarësisht se kthehet i lodhur, të pyet për ditën tënde dhe të ndihmon për çdo gjë që ku ke hasur vështirësi. Edhe pse nuk e tregon, është një nga të vetmit që të do dhe do të të dojë pavarësisht çdo gjëje. Babai është modeli më i mirë që mund të ndjekim. Babai është një hero i vërtetë, të cilit duhet t'i jemi mirënjohës përjetë.

Tedi Xhiani 7B

"Babai, heroi im"

Babai im është idhulli im. Dhe unë atë e quaj me gjithë shpirt, heroin tim. Ai është një person punëtor, i cili për familjen e tij bën gjithçka. Ai na siguron neve çdo gjë që duam. Kjo nuk është një gjë e thjeshtë dhe jo shumë njerëz mund ta bëjnë. Kur ne themi "baba", nuk ka lidhje me emërtimin e kësaj fjale, por me gjithçka që na vjen ndërmend kur e themi këtë fjalë. Ka lidhje me ndjenjën që ne përjetojmë. Prandaj duhet që kushdo ta kuptojë fjalën "Baba" sipas mënyrës së tij. Babai është heroi ynë më i madh. Ai është gjithmonë aty për të na ndihmuar. Ai na mbështet gjithmonë dhe është një njeri i dashur i cili na dhuron shumë gjëra. Ti je personi që unë në jetë dua të bëhem. Por unë jam me fat, kam një baba i cili më do pafund. Ai është personi që kam për model në jetë. Gjithashtu, heroi im më i fuqishëm dhe më real.

Enes Lleshi 7B



Babai im më do shumë,
për të mirë e jo të keq.
Për të më dhënë dashuri,
më mëson si bën ai.

Ai bashkë do të jetë me mua,
dhe gjithmonë do të jem me të.
Sytë e tij janë mbështjellë me dashuri,
për të më sjellë kënaqësi!

Aleks Muça 7B



"Babai im"

Ç'të them për të, veçse është njeriu më i dashur për mua! Fjalët ngatërrohen dhe nuk ka më për të përshkruar të shtrenjtin tim. Ai është babai pa të meta, pa gabime, është shembulli i babit ideal. Babai është ai që punon gjithë kohën për mua, por jo vetëm për mua, për të gjithë familjen. Është ai që unë e dua me gjithë shpirt. Ai që e dua pa kufij. Babai është ai që po investon për mua. Është ai që një ditë dëshiron të më shohë të rritur e të shkolluar. Është ai që nuk do të kursente asnjë qindarkë për familjen. Babai im është ai person që thotë që vetëm me punë dhe sinqeritet arrihet suksesi. Është ai që më mëson se si t'i mbijetoj intrigave të kësaj bote e të këtyre njerëzve. Fundja çdo baba është mbret për vajzën e tij dhe sado të flasim për të, fjalët kurrë s' do të mjaftonin. Me pak fjalë, babai është heroi im!

Vikena Mera 7B

Babi është heroi im. Mendoj që ai është dhe do të jetë shembulli im në jetë. Ai është një nga personat më të dashur për mua, një nga më të rëndësishmit. Ai është aty për çdo nevojë që unë kam. Ai më ndihmon gjithmonë, sidomos me problemat e matematikës. Më pëlqen mënyra se si ai është gati gjithmonë të më qëndrojë përkrah. Ai ka një mënyrë të veçantë të zgjidhjes së problemeve (jo vetëm të matematikës). Ai është shumë i përkushtuar ndaj familjes së tij, sidomos për mua dhe për motrën. Megjithëse dëshirat tona mund të jenë të shumta dhe ndonjëherë të paarsyeshme, ai është përpjekur për të bërë më të mirën e mundshme. Në familjen tonë, me ndikimin dhe prezencën e tij nuk ka munguar asnjëherë argëtimi, të qeshurat e suprizat pafund. Unë e shoh që ai ka punuar, vazhdon të punojë shumë dhe me mund ka arritur çdo gjë në jetë. Për babin tim, mendoj se dhe për çdo prind tjetër për fëmijën e tij, shkollimi im është gjëja më e rëndësishme, pasi sipas tij vetëm një shkollim i mirë të hap dyert e jetës dhe të bën të jesh dikush në shoqëri. Për këtë arsye dhe sakrificat që bëjnë prindërit e mi për shkollimin tim dhe të motrës, mendoj që një ditë, me punën tonë të përditshme do të shpërblehen.

Babi im është çdo gjë për mua, për motrën dhe mendoj që është shtylla e familjes sonë. Jam krenare për babin tim dhe dëshira ime më e madhe është të eci në hapat e tij.

Ema Sadiku 7B



Babai im, shumë të dua,
je e gjithë bota për mua.
Je si një zog që fluturon
e ngado që shkon,
veç lumturi dhuron.

Je i zgjuar e punëtor,
je shembull perfekt si mentor.
Duke ndihmuar të tjerët,
shpesh të shoh,
e më dukesh porsi një hero.

Një hero super i mirë,
me një shpirt të dëlirë.
Lutem që të gjatë jetën ta kesh,
që pranë gjithmonë të jesh.
Të më rrethosh me dashuri,
ashtu siç ke bërë që në vegjëli.

Esli Qefalia 7B

"Ti për mua je një hero"

Babi, sot është hera e parë që po shkruaj për ty, për një krijesë kaq të çmuar, që sakrifikon çdo ditë për mua. Tani që po e mendoj, jam me fat që m'u dha mundësia për të shkruar për ty. S'e di si do të ishte jeta ime pa ty. Ndoshta si një tunel i errët pa rrugëdalje në fund. Je një ndër të vetmit persona që më do me gjithë shpirt e pa kushte në këtë botë. Me ty zihem pothuajse çdo ditë, se ndonjëherë bezdisem prej merakut tënd të tepërt, por në fund zbutem kur mendoj se gjithçka ti e thua për mirën time. Ndoshta ti shpeshherë tregohesh më i rreptë se ç'duhet me mua, por nuk ka aspak problem, pasi e di që gjithçka që ti thua, buron nga thellësia e zemrës. Ti për mua, je një hero, një hero që punon për mua çdo ditë, mendon, sakrifikon, lodhesh e shqetësohesh gjithmonë. Mundin tënd nuk e di se si do të ta shpërblej ndonjëherë, heroi im. Për mua ti je shpatulla ku unë mbështetem sa herë që kam nevojë, je dera më e sigurt ku unë mund të trokas. Je shoku im më i mirë, më i vërteti që unë kam. Shumicën e kohës mërzitem me ty, zemërohem prej zakoneve të tua duke mos më lejuar të dal, apo duke më marrë telefonin. Por sa herë të tjerët më shkaktojnë probleme, ti je gati të djegësh botën kur dikush më lëndon mua. Fjalët për ty janë të tepërta e s'di ç'të them. Faleminderit që je gjithmonë aty për mua sa herë që kam nevojë! Të dua pafundësisht heroi im, heroi i çdo vajze!

Frenki Stojku 7B



"Të dua, baba"

Ti, o baba,

ti, o heroi im,

me ty s'ndërrohet gjë,

ke për të ngelur gjithmonë në shpirtin tim!

Ti je një zemër e artë,

një shpirt i bardhë.

Të dua, baba!

Heroi im!

Gentjan Çifliku 7B



"Ti do të mbetesh gjithmonë në zemrën time, heroi im"

Babi im, ti që më rrite me dashuri dhe përkushtim të madh ndaj meje, ti që më gjendeshe pranë sa herë që unë kisha nevojë dhe që më thoje që asnjëherë mos të ngurroja së treguari ty për çdo gjë, ti që gjithmonë më ke konsideruar si shokun tënd dhe unë ty si heroin tim. Të dua shumë, pavarësisht mërzitjeve që ndonjëherë na pengojnë të shprehim dashurinë që kemi. Sado që të rritem unë do të mbetem djali yt i vogël përgjithmonë!

Ti do të mbetesh gjithmonë në zemrën time, heroi im!

Korin Harizaj 7B

"Për ty o ba, fjalët nuk mbarojnë"

Fjala e parë që kam thënë ishte babi. Babi është një qenie shumë e dashur për mua. Gjithmonë, edhe në momente të vështira më është gjendur pranë. Edhe kur unë kam bërë gabim ai ka qenë personi që më ka mbështetur dhe më ka këshilluar. Dhe pse unë nuk kam një vëlla, nuk ia kam ndjerë ndonjëherë mungesën, pasi ti e ke zëvendësuar gjithmonë atë.

A të kujtohet? Kur unë linda, ti për herë të parë qave nga gëzimi. Unë edhe pse e vogël dhe nuk kuptoja, arrita ta ndiej ngrohtësinë dhe dashurinë tënde kur më more në krahë.

Babi im i dashur, ti më ke shoqëruar në çdo hap të jetës dhe je kujdesur shumë mirë për mua. Pavarësisht se tani jam pak më e madhe dhe nuk kalojmë më aq shumë kohë bashkë, mua prapë më kujtohet se si më ke mësuar të eci, si ke luajtur me mua si dhe çdo natë që uleshe dhe më lexoje libra, gjithashtu dhe dashuria që më ke falur gjatë këtyre viteve.

Ti quhesh një hero për mua pasi ti je një nga personat të cilët janë kujdesur për mua, për shkollimin tim dhe për dëshirat e mia. Ndonjëherë ne kemi pasur dhe mosmarrëveshje, por prapë ti ke pasur të drejtë pasi çdo gjë që ke bërë, e ke bërë për mua. Fjalët e mia sigurisht që nuk krahasohen me dashurinë që më ke falur gjatë këtyre viteve, por prapë dua ta dish se ti je idhulli dhe heroi im në këtë jetë. Unë gjithmonë do të të dua, pasi ti për mua je një mrekulli dhe një fat shumë i madh në këtë jetë. Për ty o ba, fjalët nuk mbarojnë, pasi ti je një gjallëri që më fal mua gëzim në jetë. Ta dish që ti ke një vend shumë të madh në zemrën time dhe unë kurrë nuk do t'i harroj sakrificat që ke bërë për mua.

Noemi Hoti 7B



"Ti je gjithçka për mua..."

Të kam ajër,
pa të cilin nuk mund të jetoj.

Të kam ujë,
pa të cilin nuk mund të lundroj.

Ti je drita e syve të mi,
pa të cilët nuk mund të shikoj.

Ti je arsyeja,
që unë sot jetoj.

Ti je ëndrra ime,
që çdo natë e ëndërroj.
Ti je kuptimi i jetës sime,
pa të cilin unë nuk mund të vazhdoj.

Idhulli im je ti!
Optimizmi yt, më bën krenar!

Erbilin Basha 7B

"Kur jam me ty, e gjithë bota është e imja"
 Babi im i dashur,
 mund të rri e të shkruaj këtu për orë të tëra,
 por një gjë është e sigurt,
 këto që shkruaj,
 nuk mund të jenë të mjaftueshme
 për dashurinë që më fal ti mua.

Do të doja të të falenderoja,
 se ti më ke mësuar mua gjithçka,
 më ke mësuar që të mos heq dorë kurrë nga ëndrrat e mia,
 më ke mësuar të jem ajo që jam,
 jam shumë me fat që kam një hero si ti.
 Kur jam me ty,
 e gjithë bota është e imja.

Mos kujto se kur të rritem do të të harroj.
 Heroi im, babi im,
 në zemrën time ke qenë, je dhe do të ketë
 gjithmonë një vend për ty!
 Të Dua Shumë!

Sonia Lika 7B



Babai është pa dyshim hero i ynë. Ai është një figurë që gjithmonë shprehet si serioz, por po të gërmosh thellë, babai bëhet një krah i djathtë, bëhet një shok i ngushtë, dhe gjithashtu merr kuptimin e plotë të fjalës "Baba". Kur ne themi "baba" ka lidhje me gjithçka që na vjen në mend kur themi këtë fjalë. Ka lidhje me ndjenjën që ne përjetojmë, prandaj duhet që kushdo ta kuptojë fjalën "baba" sipas mënyrës së tij. Babai është hero i ynë më i madh. Ai është gjithmonë aty për të na ndihmuar. Ai na mbështet përherë dhe është një njeri i dashur, i cili na dhuron shumë gjëra. Babai bën shumë gjëra për ne. Ai është një prind që përkushtohet shumë ndaj nesh. Për mua babai është si ai ortak i punës me të cilin ti je gjithmonë në kontakt, je i lidhur dhe e di që mund të mbështetesh dhe që ke siguri dhe të jep ndihmë në gjithçka që ne bëjmë. Babai vazhdon të na bëhet si një strehë që na mbron nga gjithçka e rrezikshme dhe e dëmshme. Babai është një punëtor i palodhur që kurrë nuk ankohet. Kur themi fjalën "baba", ka lidhje me ndjenjën që ne përjetojmë, prandaj duhet që kushdo ta kuptojë këtë fjalë sipas mënyrës së tij.

Klajdi Murataj 7B

"Unë krenohem me ty"

Këtë krijim sot dua t'ia dedikoj babait. Sa herë takoj njerëz, shokë e të afërm, më thonë që i ngjaj shumë babait nga paraqitja. Një ditë po shikoja një foto timen kur isha i vogël dhe një foto të babait, në atë moshë ngjanim si dy pika uji.

Unë dua më shumë që t'i ngjaj atij në vetitë shumë të mira që ka. Dua të bëhem një djalë punëtor dhe i papërtuar si ai.

I dashur babai im, ti çdo punë e bën me dëshirë.

Këtë veti kaq të mrekullueshme tënden dua t'ia edukoj vetes. Ne të dy kemi të njëjtin pasion për pikturën dhe kjo gjë më bën krenar, sepse ti je heroi im. Kur isha i vogël, ishe shoku im në çdo lojë. Ne vazhdojmë të luajmë bashkë futboll si shokë të një skuadre që është familja jonë. Ti gjithmonë më këshillon, që të mos e përdor shpesh fjalën "jo". Unë të kundërshtoj, por thellë në shpirt e di që ke të drejtë. Gjithmonë më mban afër vetes e më ndihmon në çdo vështirësi. Unë shpeshherë edhe të kam mërzhitur, por kurrë nuk e kam bërë me dashje, sepse unë të dua shumë! Shprehja jote: "I duruari, i fituari!", më është bërë moto në ditët e mia. Unë krenohem me ty, sepse ti je njeriu me virtyte dhe cilësi të jashtëzakonshme. Dua të të ngjaj ty e të bëhem vazhdimësia jote, o heroi im!

Noel Papajani 7B



"Babi, të dua shumë"

Babai është njeriu më i shtrenjtë në botë. Edhe pse duket sikur ai nuk të vëzhgon shumë, ai është personi, i cili shqetësohet më shumë për ty dhe të vëzhgon nga larg.

Fjalët për të përshkruar dashurinë për babain, janë të shumta. Ne kemi shkruar shumë për mamin, por tani mund të shprehim dashurinë për babain. Babi të dua shumë!

Aron Demiraj 7B



Hera e parë që i dhashë biçikletës, ti m'u gjende pranë,
rrëzohesha dhe ti vije me vrap të më ndihmoje.

Fjalët e mia të para ti i dëgjove,
hapat e mia të parë i pe dhe u lumturove.

Kur luanim me top së bashku,
si shok më trajtoje.

Eh, ato ditë akoma më kujtohen...

Pra, po flasim për një hero,
që dhe Supermeni nuk e shkatërron dot.

Ai hero është babai që për djalin e tij,
s'ka gjë në botë që e ndalon!

Klajdi Shamo 7B

Të shtunën pasdite u ula mbi tryezë.
 Me laps në dorë fillova të shkruaj një vjershë.
 Një vjershë të vogël e të thjeshtë.
 Mendova e mendova deri në mëngjes,
 por nuk kisha as edhe një shpresë.

Pasi u dorëzova,
 me vrap shkova,
 futa kokën nën jastëk e fillova të qaj nën të.

Babai më përqafoi duke më treguar
 se nuk qe nevoja për t'u shqetësuar.
 Duke e përqaftuar edhe unë, i thashë:
 -Gjithnjë kam ëndërruar për një hero,
 duke mos e kuptuar që e kam pasur këtu gjithë këtë kohë!

Martina Gjoni 7B



"Ti je ai..."
 Ai që më dha guxim për herë të parë,
 ishe ti babi im.
 Ai që më ndihmoi të hidhja hapin e parë,
 ishe ti përsëri.

Babi,
 Ti je busulla që gjithmonë më drejton në rrugën e saktë.
 Ti je gëzimi në sytë e mi.
 Ti je ai që botën ma mbush me gëzim.
 Je ai që jetës sime i jep kuptim.

Unë mund ta gjej princin tim,
 por babi, ti do të mbetesh gjithmonë mbreti im.
 Ti nuk je hero i njohur nga bota,
 por je një hero për vajzën tënde të vogël.
 Ti je heroi im!

Klara Elezaj 7B

"Unë jam krenar për ty biri im... "

"Çfarë mund të bëni ju për të promovuar paqen në botë? Shkoni në shtëpi dhe falini dashuri familjes suaj." Kjo shprehje e së madhes Nënë Tereza më bën të mendoj që familja është gjëja më e rëndësishme në jetë.

Të flas për familjen nuk është e lehtë, sepse të gjithë duhen njësoj. Ajo nuk është thjesht një grup njerëzish që kanë lidhje gjaku me njëri-tjetrin, por një ngrohtësi dhe një paqe që vetëm familja ta fal. Kur mendoj për një nga pjesëtarët e saj, vërtet prekem dhe mendoj se a do të vijë koha që dhe unë t'i ngjaj atij? Guximi, vendosmëria, kurajoja dhe të gjitha karakteristikat që e karakterizojnë këtë njeri që unë e kam për nder që e kam baba, më bëjnë çdo ditë të mendoj se ai është një nga motivet që unë eci përpara. Babi është ai që natën e bën ditë dhe ditën natë, duke punuar për ne dhe duke ia bërë familjes jetën dhe me të lumtur.

Dita nis duke pritur me orë të gjata kur do të vish ti dhe koha duket sikur ngrin dhe e gjithë bota ime vërtitet rreth një momenti. Më duken sekondat vite derisa të trokasë sërish dera dhe babi im të jetë në shtëpinë e tij. Dita, kur fytyrat janë të padallueshme dhe asgjë nuk duket se përbën interes për fëmijët, përveç minutave që kalojnë së bashku me shokun më të mirë që kanë. Kur e imagjinoj fytyrën e tij të guximshme më vjen ta mbaj kokën lart, ashtu siç ti më ke mësuar. Hero nuk ka vetëm nëpër filma, hero me shpata nuk ka vetëm në histori, me kalorës që shikojmë ne të dy në netët e gjata të dimrit, edhe pse mamaja na thërret disa herë që është bërë vonë, por ti sërish me buzëqeshjen, që është emblema jote e fortë e kalon dhe atë moment. Babi nuk është vetëm ai personi që të mëson dhe ti mund ta kopjosh sikur po kopjon një figurë nga libri në fletore, por është një person që ty të mëson të kuptosh që jeta ka vështirësi dhe vetëm burri i shtëpisë, mund t'i përballojë me pozitivitet dhe të luftojë për të sjellë harmoninë dhe dashurinë në familjen e tij. Në ditët e sotme është ai që ti mund t'i besosh verbërisht dhe të diskutosh me të si një shok që të kupton dhe të kritikon në momentet që duhen. Dy zanore dhe dy bashkëtingëllore vërtet formojnë këtë fjalë të vogël, por me një kuptim të madh. Forca, duart që të përkrahin dhe përqafimet që jepen pa kushte më bëjnë mua si njeri edhe pse i vogël, të mendoj sa me fat jam, që jam pjesë e kësaj familjeje dhe kam këtë baba. Të të falenderoja për ekzistencën tënde është pak... Të të thoja që je idhulli im, është shumë pak. Të qenët prind është e vështirë, por më e vështirë është të mendosh që a do vijë koha kur mund të jesh për mua kaq krenar sa jam unë sot për ty? Ashtu siç sot ti më hap rrugën për çdo aventurë, dhe unë do të bëj të pamundurën që aventurat e mia të më çojnë në të ardhmen në majat më të larta dhe të të bëj ty krenar, ashtu siç më ke bërë ti mua të ndihem gjithmonë. Fjala "baba" për mua është tepër e veçantë dhe gjithmonë mendoj se ai do të jetë motivimi dhe përkrahja ime dhe mezi pres të vij momenti që ai të më thotë : "Unë jam krenar për ty, biri im... "

Alen Rakipi 7B

"Për ty, babai im"

Babai është ai që më ka ndihmuar, ai që më ka mbajtur kur unë kam rënë.

Ai që më korrigjonte gabimet që unë bëja. Për mua ti je çadra ime që më mbron nga dielli përcëllues. Ti je ai që më ndihmon mua në kohë të vështira, ai që më qortoje mua kur bëja ndonjë gabim, edhe pse unë mërzhitesha, e dija që e kishe për të mirën time. I shtrenjti babai im, edhe unë do ta kuptoj se ç'do të thotë të kesh tre fëmijë ose më shumë. Sa je lodhur për të më mësuar mua dhe për të m'i hequr ato vese që më janë pakësuar tanimë. Më je gjendur pranë çdo ditë kur unë isha i mërzhitur. Ti je ai që gjithmonë na bën për të qeshur dhe kur jemi në kulmin e mërzhisë. Kur luajmë futboll bashkë... Kur dalim bashkë në ditët e acarta që janë mbuluar me një batanije bore të bardhë. Ti je babai im që më bën krenar përditë. Jam krenar të flas për babain tim, por jo vetëm ti do të më bësh krenar... Një ditë do të të bëj edhe unë krenar ty. Për ty babai im!

Amel Sula 7C



E dua nënën dhe babanë,
se për mua gjithmonë mendojnë.
Kur unë gjendem në vështirësi,
ata përherë janë aty.
Më kujtohet si më rritën,
me sakrificë, mund e lodhje.
Vuajnë, vuajnë ditë dhe natë,
që unë të kem gjithçka.

Arlind Pashaj 7C



Roli i babait në familje është shumë i rëndësishëm. Kjo, pasi vetë babai është shtylla e familjes ose siç quhet në gjuhën popullore "Burri i Shtëpisë". Në këtë ese, dua të trajtoj rolin e babait në familje, por edhe tek vetë fëmijët.

Siç e thashë më lart, babai është shtylla e familjes, pasi ai i jep zgjidhje shumë problemeve apo zënkave që ndodhin brenda në familje, si për shembull duke qetësuar një zënkë, apo duke ndihmuar një pjesëtar të familjes në një problem madhor. Gjithashtu, babai ka një rol shumë të rëndësishëm në familje edhe për vetë faktin se ai mbështet çdokënd në çfarëdolloj vështirësie që kemi, për shembull ai po më ndihmon mua në një projekt shkollor ku unë synoj për medaljen e artë. Babai është edhe ai që na shpjegon shumë cikle që ndodhin në jetën tonë, por edhe sse i funksionojnë gjërat në botë. Por edhe në shumë familje të tjera, në rast se pyet ndonjë prej fëmijëve se kë do më shumë, probabiliteti do të ishte shumë i madh për ndonjë nga opsionet: ose mami, ose babi.

Pra, siç e shohim, babai ka një rol shumë të rëndësishëm në familje, pasi pa të familja do të ishte shumë e çorganizuar.

Aleks Ndreu 7C

Ku mund ta nis për të përshkruar këtë njeri kaq të rëndësishëm për mua. Babai është gjysma e një fëmije. Është ai që e motivon fëmijën edhe në rastet më të vështira e të pamundura. Është babai ai që të ndihmon të ngrihesh kur ti je në tokë. Babai është shoku i ngushtë i një djali. Por mbi të gjitha babai është shtylla e një familjeje dhe pa të asgjë s'do ishte e mundur. Asnjëherë nuk do të harroj se çfarë ka bërë babai im për mua. Unë jam një djalë shumë me fat që kam një baba të tillë.

Arsel Demaj 7C



"Babai është kuptimi i vetë jetës"

Sa fort të dua,
se më mësove.
Fjalën e parë
e thashë nënë,
të dytën e thashë baba.

Këtë poezi po shkruaj,
ndaj dashurisë tënde
baba!

Më plotësove çdo dëshirë
që e desha,
por tani kam dëshirën të
them se fort të dua...

Babi, tani jam rritur,
kam mbushur 13 vjet.
Tani mua më ka ardhur
radha të të plotësoj ty dëshira.
Babi im, je i vlefshëm për mua...

Tomas Asllani 7C



"Heroi im, është ai... im atë"

Qenia e një heroi në jetën time sot më është dukur diçka e largët, gati-gati element përralle. Një hero në ditët e mia?! E kush mund të jetë aq i lartë në cilësi?! I qetë, me dorën në supin tim, këshillues e zëëmbël, përherë i gatshëm të më mbështesë, edhe në ditët e mia më të këqija. Sytë e tij janë vendi ku gjej dashuri, vështrimi i tij më mban ngrohtë. Prania e tij më bën të pamposhtur. Heroi im?! Është ai... im atë!

Joni Pashako 7C

Babai për të gjithë është i dashur. Mund të thuash që është mburojë për secilin prej nesh. Që kur lind ai të gjendet pranë dhe të jep gjërat që të nevojiten si: dashuria, ngrohtësia, përkushtimi. Baba nuk quhet personi që të lind, por ai që të rrit me përkushtimin dhe dashurinë e tij. Babai është një njeri që të kushton shumë kohë, që punon shumë për ty dhe lodhet. Nëse një moment je larg tij, ai mendon për ty. Që në vogëli babi më ka blerë gjërat që më nevojiten: ushqimet, karficat, rrobat, lodrat, librat dhe më ka bërë të mundur arsimin në një shkollë të mirë. Nuk mund ta kërkoj asnjëherë një baba ideal sepse unë e kam tashmë. Ai baba që çdo ditë më këshillon për jetën, ai baba që më ka rritur me vlera, ai baba që lodhet, që është krenar për mua dhe që më jep aq shumë dashuri. Nuk mund ta përshkruaj dot dashurinë për babain tim, sepse ajo është e pafundme. Babai im sigurisht është heroi im. Kur mërzitem ai më mbështet. Ai më tregon rrugën e drejtë dhe pasojat e rrugës së gabuar. Ai është i rreptë për disa gjëra dhe na ndalon gjërat e shumta që moshatarët tanë i bëjnë, sepse ai i ka përjetuar situata të ndryshme si këto dhe e di që janë të gabuara. Babi dëshiron që të mësoj shumë dhe të bëhem dikush në jetë. Ai më mbështet në zgjedhjet e mia. Unë nuk rri dot pa babain tim, sepse e dua shumë. Çdo sekond që kaloj pa të më duket si një shekull. Të gjithë duhet ta duam ashtu si është, sepse askush nuk mund ta zgjedhë babain e vet.

Ketlin Marku 7C



Babai është prindi yt. Babai është një nga njerëzit e parë që ti sheh, një nga njerëzit e parë që ti do, njeriu për të cilin shqetësohesh dhe një nga fjalët e para që ti thua dhe mendon. Ai është njeriu me të cilin ti qëndron dhe ndihesh e sigurt. Për shumë të tjerë ai është një nga personat me të cilin ndihesh më e lirë, psh. mund të shihni filma bashkë, por edhe t'i tregosh për disa nga eksperiencat e tua deri tani dhe t'i krahasosh me ato të tijat. Mund të flasësh e të bësh aq shumë gjëra me të. Baba për mua do të thotë shumë gjëra. Ai më kupton se si unë ndihem, është një burim mbështetjeje dhe force, që nga fillimi i jetës sime. Ai më ndihmon dhe më fal gabimet. Nuk ka rëndësi se ç'mund të më dalë rrugës, ai më inkurajon që të vazhdoj ç'kam nisur. Më ndihmon e më këshillon, në një mënyrë të veçantë e të menduar mirë.

Prandaj babai është një hero për mua dhe unë e dua shuuuumë!

Sepse siç thotë edhe shprehja popullore shqiptare: "Vajza lë edhe kokën për babain."

Altea Bollano 7C

"Babi..."

Ç'mund të them për babin tim? Babi është idhulli im, heroi im, pika ime e dobët, dashuria ime e parë, personi që ka qenë gjithmonë aty për mua dhe më ka mbështetur në çdo vendim timin. Askush s'mund ta përshkruajë dashurinë e madhe që kam për ty. E mban mend kur isha e vogël? Unë isha princesha jote, kurse ti mbreti im, apo kur dilyn bashkë, më trajtoje si të isha e rritur. Më kujtohet shumë mirë se sa shumë më ke duruar e sa shumë të kam acaruar. Mbaj mend se si s'të lija të dilje pasi filloja të qaja ose kur ikje jashtë shtetit e unë gjithmonë sëmuresha. Ti ke qenë aty për mua kur hodha hapat e parë, kur ika në klasën e parë e s'ta lëshoja dorën se kisha frikë, kur këndova për herë të parë në një skenë etj. Unë mund të vazhdoj të shkruaj, por s'do mjaftonte as një libër i tërë për të treguar se çfarë ne të dy kemi kaluar. Dua thjesht ta dish se sado larg që të jemi, do jesh gjithmonë në zemrën time.

Alesia Pulti 7C



"Të dua, babi"

I dashur baba,

Nuk di çfarë fjalësh të them për ty.

Ti je ai, i cili më ke ndenjur gjithmonë pranë.

Ti je ai, që sa herë jam rrëzuar më ke ngritur.

E di sa shumë ke sakrifikuar për mua vetëm që unë të jem e lumtur.

Çdo dëshirë që unë nuk shprehja, ti e shihje në sytë e mi dhe përherë e plotësoje.

Unë jam kjo vajzë e rritur kaq mirë vetëm prej teje.

Prej teje i cili më ke dhënë pasurinë e gjithë botës.

Të dua babi dhe kurrë nuk do të të ndërroj me askënd tjetër!

Vendin tënd askush nuk e zëvendëson dot!

Ersja Hoxha 7C



"Babi, kjo fjalë kaq e dashur..."

Babi... Çfarë kuptimi ka kjo fjalë! Njeriu që si një mburojë më mbron nga të gjitha të këqijat. Ai është personi që nuk të do me interes. Baba nuk mund të bëhet dot një prind kur lind një fëmijë, por bëhet kur ai sakrifikon për të. E pra, edhe babi im e meriton këtë fjalë kaq të dashur, që nuk të mërzhitet kurrë. Babi është një nga njerëzit më të dashur për mua. Është normale që një fëmijë të dojë babanë e tij, ashtu siç e dua unë babin tim. I jam shumë mirënjohëse, pasi babi ka qenë gjithmonë pranë meje, në çdo hap që kam hedhur. Më ka mësuar që në fund të një tuneli gjithmonë ka një dritë. Gjithashtu më ka mësuar të dalloj të mirën nga e keqja, që gjithmonë të kem durim, pasi do të mbarojë me një fitore të madhe. Kam shumë për të mësuar dhe për të kuptuar dhe e di që babi do të jetë pranë meje për të m'i shpjeguar.

Ema Koka 7C

"Jam krenare që kam një baba të tillë"

E kam shumë të vështirë të shkruaj një letër për personin që më ka mësuar aq shumë. Babai im, ashtu si edhe mami, ka qenë aty në hapat e mi të parë, duke u përkujdesur dhe ndihmuar gjithmonë për çdo gjë që unë kam pasur nevojë. Ai më mbështet kur jam e mërzhitur, e lodhur apo e ngarkuar me shumë mësimë dhe më jep kurajo për të vazhduar dhe kaluar vështirësitë me besim.

Ai është njeri i mrekullueshëm dhe gjithmonë më ka mësuar të jem e dashur, e duruar, e respektuar dhe e sinqertë. Unë shumë herë kam gabuar ose e kam mërzhitur me fjalët apo veprimet e mia, por ai gjithmonë me durim, më ka treguar rrugën e duhur për të mos i përsëritur ato në të ardhmen.

Babi gjithmonë më ndihmon me mësimet kur unë kam nevojë, duke u përpjekur të ma shpjegojë disa herë derisa unë ta kuptoj. Shpeshherë ai më tregon histori të ndryshme interesante, të cilat ngelen gjatë në kujtesën time. Gjithashtu, ai luan së bashku me mua lojëra të ndryshme, jo vetëm kur jemi në shtëpi, por dhe kur shkojmë me pushime. Të gjitha këto më bëjnë të mësoj më shumë, të argëtohem më tepër, t'i shoh gjërat me optimizëm e mbi të gjitha të jem më e përgatitur për të ardhmen. Jam krenare që kam një baba të tillë!

Unë mund të vazhdoj të shkruaj pafundësisht, por s'do të mbaroja kurrë, sepse kemi kaluar kaq shumë momente të bukura dhe nuk do të dilte një libër i tërë për të treguar dashurinë që unë kam për babin tim.

Jona Nuredinaj 7C



"Nëse kam babin afër, kam gjithë botën"

Unë mendoj se për mua, babi im, nuk është vetëm një prind, për mua ai është një nga personat më të shtrenjtë që kam. Dashuria ime për babin tim nuk ka të krahassuar, nuk ka as fjalë të cilat mund të përshkruajnë dashurinë që kam për babin tim. Ai është heroi im, është shoku im, është gjithçka. Ai më rriti me mund, u përkushtua shumë tek unë, dhe unë e falenderoj shumë. Arriti të plotësojë çdo gjë që unë doja, çdo dëshirë, çdo tekë, dhe e falenderoj përsëri! Nëse kam babin afër, kam gjithë botën, sepse prej atij kam mësuar shumë gjëra në jetën time, dhe jam i sigurt që ato këshilla të babit tim do të më shërbejnë shumë në jetë. Shpresoj që unë të bëhem ai djalë që babi im ka dashur gjithmonë. Babi të dua shumë!!!

Gledi Spahiu 7C



"Të dua shumë babush"

Babi është heroi im. Në çdo hap të fëmijërisë sime ai ishte aty duke më mbajtur dorën fort... Fjalët e tij të zgjuara zënë vend në mendimet e mia. Sytë e tij janë si pasqyrë për shpirtin tim... Ai është mbreti im dhe unë princesha e tij e vogël. Ne të dy dalim shpesh bashkë, vetëm ne të dy, babi dhe unë. Duke folur për shkollën, udhëtimet dhe të ardhmen mendoj se sa me fat jam që ai është babai im. Jam e sigurt që ai do të jetë kudo në jetën time, duke më shtrënguar dorën fort si dikur kur isha e vogël... Të dua shumë babush!

Livia Çaushaj 7C

Babai im i dashur,
mos mendo që të harrova
që nuk shkruaj për ty.
Të dua shumë o babi,
kam gjithmonë nevojë të të kem pranë.
Në prehrin tënd
ku kokën kam mbështetur,
kam ndier përherë
dashuri dhe siguri.
Ai zë i yti më ndihmon,
këshillat që i dëgjoj çdo ditë:
"Bir bëhu i fortë,- më thua,-
mos u dorëzo, mos u mërzit!"

Noel Huti 7C



"Babai, heroi im"
Ti më përqafton me dashuri mua,
edhe kur unë jam gabim,
ti më inkurajon plot besim,
edhe kur unë ndonjëherë dështoj.
Ti buzëqesh dhimbshëm me mua,
edhe kur unë gënjej.
Ti më fal plot shpresë,
edhe kur unë gaboj.
Nëse është një gjë në jetë,
që nuk dua ta ndryshoj kurrë,
je ti, babai im i shtrenjtë,
je ti, që kaq shumë më do mua!

Uerd Ndreu 7C



"Babi im ..."

Përveç përrallave edhe në jetën time... ka një hero. Përveç princeshave edhe une kam një hero... babi im. Babi je më i miri! Ishe ti ai që më ndihmoi të ngrihesha. Ishe ti ai që kur shkelje në dhomën time e shndërroje në lëndinë të rritur me trëndafila, të rritur me dashurinë tënde, dhe njëra nga ato gonxhe isha unë, e cila u rrit me vlerat dhe dashurinë tënde! Për Ty, babi, jam po ajo bebja e sapolindur, që e ke mbajtur në krah, e ke përkundur e përkëdhelur, i ke dhënë dashuri, e ke këshilluar në rritje, ke derdhur lot për të...

Kaltra Sulaj 7C

Babi im është një hero. Ai ka sakrifikuar shumë për ne. Të dy prindërit duhen falenderuar, por më shpesh ne falenderojmë nënën dhe harrojmë baballarët. Ata kanë një rol të rëndësishëm në jetën tonë dhe janë disa nga njerëzit që meritojnë më shumë falenderime. Babi im ka qenë gjithmonë pranë meje dhe më ka ndihmuar dhe këshilluar, prandaj ai është një nga njerëzit më të rëndësishëm në jetën time.



Sidrit Pashako 7C

Për mua ishte i pari që më preku në krevatin ku kisha lindur. Dhe sot është i pari që më motivon për gjithçka. Trungu i familjes, i cili na mbështet në çdo vendim që ne marrim, që nuk mërzitet kurrë me ne, që na bën të qeshim edhe në çastet më të vështira. Për mua ti je motivimi i ëndrrave të mia. Çdo ditë që kalon unë shpresoj akoma më shumë që të bëhem si ti. Unë e di që ti ke kaluar shumë çaste të vështira dhe përsëri më dilje përpara me një buzëqeshje në fytyrë. Ti je ai që çdo çast të jetës mundohesh ta shijosh dhe ta bësh të paharrueshëm për ne. Ti je ai që punon me qetësi dhe pa u lodhur me mua, sa herë që unë kam nevojë. Më pëlqen shumë fundjava kur ti vjen dhe më përkëdhel sa herë kur unë zgjohem. Më pëlqen zëri yt, gjithmonë i qetë dhe plot dashuri. Kam gjithmonë një admirim sa herë që të shoh duke punuar pa lodhje dhe me maturi, kur kthehesh në shtëpi vonë i lodhur nga ndonjë mbledhje, por gjithsesi i qeshur dhe na shikon me dashuri. Nëse do të më duhej të shkruaja më shumë për ty, do të mbushja faqe të tëra me fjalë dashurie dhe admirimi. Por ama një fjalë të fundit do ta them: "Jam shumë krenare që kam një baba si ti!"

Vanesa Aliko 7C



"Babai, heroi im"

Ti doje një familje dhe e realizove,

Kur erdha në jetë më urove,

Më more në krahë,

Më puthe, më përkëdhele,

Më dhe dorën e në rrugët e jetës më drejtove.

Më ke ndihmuar të hedh hapat e mi të parë. Më ke qëndruar pranë në të gjitha aktivitetet dhe në të gjitha gjërat që kam ndier nevojën tënde. Kur hyj në shtëpi, e kam të nevojshme një përqafim tëndin sepse më jep fuqi, më mbush me shpresë.

Të adhuroj për çdo gjë dhe të falenderoj për gjithë ç'bën për mua. Shkollohem në një institucion që të gjithë e ëndërrojnë, më edukon, mbështet, më nxit dhe më plotëson çdo dëshirë që unë kam. Ç'mund të kërkoj më shumë? Ti je njeriu më i dashur për mua. Mbjat mend kohët kur kemi shkuar në Romë, Firence, Amsterdam e sa shumë jemi kënaqur të gjithë bashkë. Nuk e shpreh dot sesa shumë të vlerësoj. Përkrah teje të tjera ditë të gëzuara, përkrah teje i sigurt. I dashur babi, ky shkrim të dedikohet Ty.

Alvin Sejdiaj 7D

"Babai im, një hero, i cili kurrë nuk lodhet"

Baba, një fjalë e cila dëgjohet kudo. Thua "babi" kur të vritet këmba. Thua "babi" kur rrëzohesh. Babi më ka ndihmuar të bëhem e fortë, më ka ndihmuar të ngrihem lart, më ka ndihmuar të eci përpara. Babi më ka ndihmuar të mësoj biçikletën. Ai ka qenë gjithmonë pranë në çdo moment. "Babi" thashë kur linda dhe babi do të them deri në frymën e fundit. Ai më ka mbështetur gjithmonë, edhe kur kam pasur gabim. Babai më ka mësuar sporte, më ka ndihmuar në matematikë dhe kudo ku unë kam pasur vështirësi. Ai më ka ndihmuar të futem në rrugën e duhur dhe të sillem mirë me njerëzit, edhe në qoftë se e kanë gabim. Gjithmonë kur jam mërzitur për ndonjë notë të keqe, ka qenë ai i pari që më ka ngritur humorin. Babi më ka filmuar në momentet e veçanta kur kam qenë e vogël, momente të cilat më bëjnë të qesh sot. E falenderoj për çdo kujtim që ka ruajtur, për çdo fjalë të ëmbël, për çdo përkëdhelje e mbështetje të pakursyer. E falenderoj shumë që ka qenë gjithmonë aty për mua dhe nuk është dorëzuar kurrë, pavarësisht gjithçkaje. Çdo ditë vere kur babi ka qenë në punë, mezi prisja të vinte në shtëpi dhe t'i ngrija humorin. Nuk është njësoj një verë pa babain ose një dimër pa babin. Të dy prindërit janë të rëndësishëm në çdo moment të jetës dhe jeta është më e bukur kur të gjithë pjesëtarët ndihen të lumtur. Sa herë shkoj në shtëpi pyes: "Ba, në shtëpi je?" Babi gjithmonë më ndihmon të marr nota të mira, sidomos në matematikë. Babi më zgjon çdo ditë në mëngjes. Edhe në fundjavë babi vjen dhe më thotë ëmbëlsisht: "Shkoi ora 11:00." Kur mërzitem me vëllezërit, babi është i pari që më mbështet edhe pse ndonjëherë nuk kam shumë të drejtë. Babai im, një hero, i cili kurrë nuk lodhet. Ai më ndihmon të forcoj një pjesë të karakterit tim. Nuk e di ku do të isha ose si do të isha pa babin dhe ndihmën e tij. Unë i ngjaj shumë atij nga personaliteti dhe pamja fizike. Pa babin nuk do të isha kjo që jam sot. Pa të, jeta nuk do të ishte e sigurt për mua. Babi të falenderoj për gjithçka. Të falenderoj aq shumë sa nuk mund të gjej fjalë për ta përshkruar. Të dua babi!

Amabel Kola 7D



Babai im është heroi im, sepse ai më ka mbrojtur gjithmonë kur nuk jam ndier mirë. Babai im më ka qëndruar pranë edhe kur unë jam vrarë ose nuk mundesha të kaloja një pengesë në jetën time. Ai ishte nje hero i vërtetë në rrugën time të gjatë e të vështirë të jetës. Pa atë, unë nuk do të mund të isha në këtë vend që jam tani, pa atë, unë nuk do të mund të kaloja vështirësitë që sjell jeta. Kjo do të thotë se prania e prindërve është e pazëvendësueshme. Edhe pse na qortojnë dashuria ime për prindërit forcohet më shumë, sepse e kuptoj që më duan.

Arsildo Veliu 7D

"Je babai më i mirë në botë"

Babai është heroi im, sepse ai më mbron dhe me zgjuarsi na çon në rrugën e duhur. Unë kam dëgjuar shumë heronj në këtë botë. Nga këta, asnjë nuk kam parë real, vetëm nëpër filma. Por edhe heronjtë nëpër filma nuk lodhen dhe japin gjithçka për ty. Ata janë për të mbrojtur njerëzit në rrezik. Ndërsa këtij heroi real nuk i hyn asnjëri në sy përveç teje. Ai dhe zemrën e jep për ty. Për ty ai ka sakrifikuar dhe ka lodhur mendjen se si ti të jetosh më këto të mira që ke sot. Ai ka sakrifikuar dhe do të sakrifikojë për ty deri në frymën e fundit. A nuk ishte ai që ty të dha kurajë kur ti ishe në gjendjen më të keqe të mundshme? A nuk ishte ai që thotë: "Provoje, jepi, forca, edhe po nuk ia dole do të jem unë pranë teje!" A nuk ishte ai që diçka që për ty ishte e pamundur, ai e bën të mundur? Unë edhe pse mundohem të të çmojë, nuk gjej dot lehtë fjalët për të të karakterizuar. Jam i sigurt se çdo njeri në këtë botë mund të më hedhë tutje e mund të më zhgënjëjë, por ti jo! Edhe sikur unë të kem faj edhe gjithë bota të më ngrihet kundër, ti prapë do të thuash se ato kanë faj përsëri. Ti bashkë me kohën keni treguar se jeni më të veçantë dhe nuk gaboni. Nuk kam më fjalë ta përshkruaj këtë njeri kaq të mirë e që është babi im. Fjalët më ngatërrohen me njëra-tjetrën dhe luajnë me trurin tim. Do të doja të të falenderoja një mijë herë që më rrite dhe më solle deri këtu me përpjekjet e tua. Do të doja të bëhesha sa gjysma jote kur të rritem. Të falenderoj për çdo minutë dhe sekondë që më ke kushtuar në këtë botë! Je babai më i mirë në botë!!

Arlis Arapi 7D



Që kur kam qenë i vogël s'më ka munguar asnjëherë dashuria, ndihma dhe mbështetja jote. Kur unë rrëzohesha, ti më ngrije prapë. Sa herë që kam pasur vështirësi, ti më ke qëndruar pranë. Sa herë që shikoja ëndërr të keqe, më merrje në krevatin tënd. Jam i lumtur dhe krenar që të kam baba! Për çdo gabim ti më këshillon, më fal dhe më mbështet...Të falenderoj pafund!!

Harelson Demiraj 7D



Babai , heroi im

Babai është njeriu më i çmuar në jetën time. Në çdo moment që kam kaluar, ai ka qenë pranë meje. Shpeshherë, kur gjërat nuk shkojnë mirë e unë dekurajohem, një bisedë me babanë më bën të vetëdijshme se jeta vazhdon dhe unë duhet të kthehem në realitet. Kur jam e pavendosur, gjithmonë marr këshillën e tij. Marrëdhënia jonë nuk është si prind-fëmijë , por më shumë si shokë. Por ne së bashku kemi kaluar dhe shumë momente argëtuese, të cilat do të mbeten gjithmonë në kujtesën time. Sa herë që ndihem e mërzitur , babi më sjell në humor duke më kujtuar shakatë që ne bëjmë gjithmonë. Ky është babai im , heroi im, njeriu për të cilin unë do të jepja gjithçka për ta bërë të lumtur e krenar.

Amelia Duxha 7D

Babai im është mbështetja ime më e madhe, sepse ai më ndihmon në çdo vështirësi të jetës sime. Që kur linda ndjeva ndjesinë e ngrohtë të krahëve të tij. Ai më merrte në krahë, më vendoste në gjumë, më ushqente etj. Kur unë qaja më fshinte lotët dhe i vinte shumë keq për mua. Është munduar gjatë gjithë kësaj kohe që unë të rritesha me gjithë të mirat e kësaj bote. Kur them fjalën "BABI" ndiej një siguri te vetja. Kur kthehet nga puna më takon direkt mua, pastaj mamin. Ai më ndihmon dhe për mësimet, që unë të dal mirë në shkollë. Le të themi se ai më ka plotësuar çdo dëshirë që unë i kam kërkuar. Di të më këshillojë pa më bërë të ndihem keq. Jam shumë e lumtur dhe shumë me fat që kam një baba si ai. Babai është heroi, frymëzimi im!

Mei Aliko 7D



"Forca që s'më lë të ndalem nga asnjë pengesë"

Nuk gjej dot mënyrën si ta tregoj dashurinë për babin tim. Fjalët ngatërrohen kur kam për të përshkruar të shtrenjtin tim. Ai është baba pa të meta, pa gabime, është shembulli i babit ideal. Është ai për të cilin nuk lodhem duke i thënë se e dua shumë, por dashuria e tij e kalon timen. Është ai që kur qaja më fshinte lotët. Është ai që gjithmonë më jep këshilla dhe se si duhet të sillem me shokët, me të afërmit, me mësuesit etj. Është forca që s'më lë të ndalem nga asnjë pengesë.

Është ai që nuk lodhet nga gabimet e mia, është ai që më bën të qaj dhe të qesh. Është i kudogjendur për mua kurdo e kudo, sa herë që jam në vështirësi. Babi, ti je krenaria jonë, je ai që dua më shumë në të gjithë botën!

Të dua shumë!

Sindi Shutina 7D



"Ba, të dua pafund"

Babi është gjëja më e shtrenjtë që kam. Ai është heroi im, mbështetja ime dhe një nga dashuritë më të shtrenjta që kam dhe do të kem ndonjëherë në jetë. Për mua fjala "baba" do të thotë shumë. Sa herë them këtë emër, më kujtohen të gjitha mundimet që ka bërë për mua. Të flasësh për ty nuk është diçka e lehtë, për të vetmen arsye se nuk ka fjalë apo gjest që mund të tregojë dashurinë e madhe që kam për ty. Kur mendoj momentet e fëmijërisë më kujtohesht Ti, gjithmonë pranë meje duke më falur dashuri siç di vetëm ti ta dhurosh.

Ba, nuk kam ç'të them tjetër, veçse të dua pafund dhe jam vajza më me fat që kam një baba si ti!

Ergina Veliu 7D

Babai për çdo fëmijë është një mbështetje e madhe gjatë gjithë udhëtimit të tyre, ndërsa për ne vajzat është dhurata më e çmuar, heroi ynë, ai tek i cili gjejmë gjithmonë mbështetje. Por, pse pikërisht ti dhe jo dikush tjetër është heroi im?! Ti ke qenë heroi im që fëmijë dhe ende vazhdon të jesh... Ke qenë aty kur kam gabuar. Ke qenë po aty kur kam pasur ngarkesë me shkollën. Të kam pasur mbështetje sa herë ndihesha keq dhe më dukej sikur bota më shembej para syve. Je sërish pranë dhe tani që po kaloj një nga fazat më të vështira të jetës, adoleshencën. Babi, do të jesh heroi im edhe kur të largohem prej teje për të filluar një kapitull tjetër. Babi, për mua je si ajo copëza pa të cilën nuk mund të plotësohet figura. Sado që të përpiqem të të ngre në pedestal për çdo gjë që ke bërë për mua, mendimet më ngatërrohen dhe e kuptoj që për një njeri të tillë nuk ka fjalë për ta përshkruar. Nuk e mendoj dot jetën pa Ty, babi. Je një shpatull ku e di se mund të mbështetem, pa u stepur me mendimin se mund të më gjykos. Babi, dije se dhe sikur 10000 vite të kalojnë, ti ke për të qenë gjithmonë heroi im dhe njeriu i pazëvendësueshëm në jetën time!

Amy Gaxha 7D



Babi është një fjalë shumë e rëndësishme në jetën time.

Ai më ka ndihmuar mua në hapat e mi të parë, ai më ka përkrahur gjatë gjithë jetës sime dhe për këtë e falenderoj jashtë mase. Ti ke qenë pranë meje në ditë të bukura e të këqija dhe ti je një nga pjesët më të rëndësishme në jetën time. Herë-herë pyes veten si do të ishte jeta ime pa një figurë të rëndësishme si ti, babai im. Këto rreshta që po t'i shkruaj tani, nuk e përshkruajnë dot dashurinë dhe dhembshurinë tënde. Të falenderoj jashtë mase që ke sakrifikuar çdo gjë për mua në këtë botë! Ti ke punuar me orë të gjata në punë, ti zgjohesh herët dhe kthehesh vonë vetëm që unë të kem një jetë sa më të mirë. E falenderoj Zotin që mua më ka dhënë mundësi të kem një figurë kaq të mirë në jetën time. Ti je një hero më i veçantë nga heronjtë e tjerë, sepse ti sakrifikon dhe jetën për familjen tënde. Të jesh një baba, ndoshta ndonjëherë është një pozicion i vështirë, por i veçantë për çdo fëmijë në këtë botë. Më kujtohet kur isha e vogël dhe thoja që kisha frikë, ti asnjëherë nuk thoje jo, por gjithmonë më rrije pranë derisa mua të më zinte gjumi. Sa herë që ti më thua që më ke shumë xhan, ta dish që ato fjalë janë të rëndësishme për mua dhe që kurrë nuk do t'i harroj. Ti gjithmonë më ke mësuar dhe më ke treguar se çfarë është e drejtë dhe çfarë jo, dhe ato fjalë më kanë motivuar që unë te eci përpara.

Era Shpofi 7D

"Babi për mua është mbreti im dhe unë jam princesha e tij"

Babi për mua ka qenë gjithmonë pranë, që kur kam qenë e vogël e deri më tani. Ka qenë ai që më ka marrë në krahë e më ka ledhatuar. Ishte ai që më fshinte lotët kur vritesha. Babi për mua ka qenë heroi im në çdo vështirësi. Ka bërë çdo sakrificë për mua e më ka sjellë këtu ku jam sot. Ka qenë ai që është kujdesur për mua në çdo moment. Ka qenë ai që më ka ndihmuar të ngrihesha sa herë që rrëzohesha.

Në çdo moment ndiej ngrohtësinë e dorës tënde kur më ledhaton. Babi ti ke bërë çdo sakrificë për mua e më ke sjellë këtu ku jam sot. Ba, ke qenë gjithmonë mbështetja ime e kështu do të mbetesh përgjithmonë. Babi mua në këtë botë nuk më mungon asgjë, ngaqë ti je gjithçka e imja në botë. Faleminderit, mbreti im që ke bërë çdo gjë për mua! Por babi të premtoj që edhe unë kështu do të bëj për ty. Jam me fat që Zoti më ka dhuruar një baba e mbret si ti. Faleminderit babi që më bën të ndihem e lumtur në çast. Fjalët për ty nuk kanë kurrë të mbaruar e kurrë nuk do të kenë heroi im. Këtë dedikim ta drejtoj ty, babi im!

Xhejvisa Qafalija 7D



Që i vogël, fjala "Baba" më mbushte me kujtime të paharrueshme. E mbaj mend kur ai më çonte ndërsa unë rrëzohesha, kur më ndihmonte të mësoja, kur më merrte në krahët e tij të sigurt për të më fshirë lotët. Gjithashtu, dashuria, siguria ime varej nga ai. Babai, një gardian i jetës sime, që sakrifikon gjithçka vetëm që unë të jem mirë. Unë nuk po veçoj babanë nga mamaja ime, se dhe ajo ka sakrifikuar për mua, por ai më mbështet gjithmonë kur unë jam gati të dorëzohem. Ai më thotë se gjithçka mund të arrihet me besim dhe punë. Edhe pse disa herë jam mërzitur me të kur kam qenë i vogël, tani e kam kuptuar se babai im ka pasur të drejtë. "Ne duhet të shfrytëzojmë diçka për një gjë që do të duhet dhe jo për gjëra kot." -më thoshte ai. Kjo fjali më ka mbetur në mendje dhe nuk do e harroj kurrë. Disa njerëz nuk besojnë në superheronj, por unë e kam një të tillë. Dhe ai është babai im. Kur unë të kem fëmijë, nuk do t'i lë ata pa dëgjuar këshillat e tua. Të dua, babi im i dashur!

Ralf Alla 7D



Që kur isha i vogël babai im më ka mbështetur shumë, është kujdesur për ushqimin, rrobat, shkollimin dhe për të më siguruar një jetë të shëndetshme e të lumtur. Më ndihmon për mësimet dhe zakonisht në teste të rëndësishme. Të kam pasur gjithmonë krah dhe në problem të mëdha. Ti do të më vije afër, të më përqafoje dhe do të më thojë se do ta zgjidhim pa asnjë problem. Ti më ke mësuar shumë gjëra: si të notoja, si të luaja futboll ose sporte të ndryshme. Ti nuk bërtet, je një njeri i dashur. Në shumë raste ti më ke plotësuar më shumë dëshira se mami, por ka dhe raste që ti ma ke mbushur mendjen që mos ta merrja atë që kërkoja. Prandaj unë të quaj ty, heroin, idhullin tim!

Marin Stratorbërdha 7D

Që kur kam lindur, babanë e kam pasur afër. Ai më ka shoqëruar mua dhe vëllanë tim gjatë jetës sonë të përditshme e deri tani. Me babain unë luaja e mësoja çdo ditë e më shumë. Me mamin kam kaluar më shumë kohë sepse babi ka qenë në punë, por kjo s' do të thotë asgjë. E mbaj mend kur më ka marrë në dorë për herë të parë. Ai ka qenë aq i lumtur, edhe vëllai gjithashtu. Me Babin tim kam luajtur shumë kur kam qenë i vogël. Pothuajse çdo ditë pasi ai vinte nga puna, luante me mua. Kohët kur kam qenë më i vogël se tani i kaloja më së shumti me babin, mamin ose vëllanë, duke luajtur. Unë kam qenë më i vogli i familjes, kështu që ata duhet të kujdeseshin më shumë për mua sesa për vëllanë. Në çdo kompeticion, babi im ka qenë atje për të më dhënë besim dhe prej atij kam fituar. Por tani që jam rritur nuk do të thotë që nuk luaj me babanë. Ndonjë ditë ne dalim dhe luajmë basketboll tek fushat aty afër, ditën tjetër dalim me biçikleta së bashku. Kur kam bërë diçka gabim, babi ka qenë i pari që më ka treguar se e kisha gabim. Kur nuk isha mirë, babi ka qenë ai që më ka mbështetur i pari. Disa nga momentet më të bukura të jetës i kam kaluar me babin tim, kur kam fituar në gara noti, dhe kur kam marrë 10 në një test. Babi im ka qenë gjithmonë pranë meje dhe prandaj e dua dhe aq shumë. Ai dhe gjithë familja ime do të jetojnë në zemrën time deri në fund. Kur kam zhgënjyer ndonjëherë familjen, babi ka qenë ai që më ka thënë se çfarë bëra gabim. Babi ka qenë pranë meje gjatë gjithë momenteve të gëzuara dhe të hidhura në jetën time. Ai do të vazhdojë të më mbështesë gjatë gjithë jetës dhe unë do ta bëj atë gjithashtu. Ai më ka mësuar të ngas një biçikletë dhe si të gjuaj topin. Kam mësuar aq shumë gjëra nga ai, sa mund të shkruaja një libër të tërë me to. Dhe të gjitha ato që kam shkruar i janë dedikuar babait tim të dashur. Babi ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë një pjesë e rëndësishme e jetës sime, prandaj dhe e dua atë aq shumë. Me dashuri, nga djali yt!

Brendon Janku 7D



Kur përmendin babin tim,
plot krenari e respekt,
them me vete: "O sa mirë!"
Ndihem krenare dhe vetë,
se babi im më bën krenare.
Flet mirë dhe gjykon drejt.
E di se pranë teje,
që kur isha e vogël fare rrija,
rrija ditë e netë.
Gjithmonë ndihmon këdo,
pa përtesë, pa ngurrim,
siç më je gjendur çdo herë pranë.
Baba, heroi im!

Hera Haderi 7D

Babai, një nga figurat më të rëndësishme që na ka sjellë në jetë. Na ka rritur e na ka mbështetur gjatë gjithë jetës. Për të gjithë ne, është një figurë e rëndësishme dhe e dashur që na ka mbrojtur, na ka mbajtur në krahë e na ka fshirë lotët kur vriteshim e kur frikësoheshim.

Më kujtohen netët kur zgjohesha nga një ëndërr e frikshme dhe i thërrisja emrin e përplotur. Ai vinte me vrap për mua dhe rrinte më dëgjonte derisa të më kishte zënë gjumi përsëri. Më kujtohen edhe ditët kur vrapoja nëpër oborr dhe rrëzohesha. Shkoja në shtëpi e frikësuar dhe i thërrisja emrin që të më ndihmonte. Vinte me vrap, me qetësonte dhe më merrte një akulllore. E gëzuar i kapja dorën dhe ecja me të, dhimbja komplet e harruar. Më kujtohen ditët kur vinte nga puna i lodhur e i rraskapitur, unë i afrohesha, i hidhesha në krahë dhe e puthja në faqe. Më merrte në krahë, uleshim në kolltuk dhe rrinim ashtu në qetësi të lumtur me prezencën e njëri-tjetrit. Më pas më puthte në faqe dhe me një pamje të ëmbël në fytyrë më thoshte: "Ti je ilaçi im." E lumtur e përqafoja sërish pa ua kuptuar peshën atyre fjalëve. Çdo ditë më zgjonte me një buzëqeshje në fytyrë dhe më merrte në krahë që të shkonim bashkë të hanim mëngjes. Kur kishte punë më merrte me vete në zyrë dhe më dëgjonte gjithë durim, kur unë i tregoja historitë e fantazitë e mia. Kalonte kohë, vinte dreka dhe hanim të dy së bashku. Kur provoja një ushqim tjetër dhe bëja fytyra të ndryshme qeshte me gëzim dhe më jepte ujë. Dilnim jashtë pastaj dhe ecnim deri në shtëpi, unë duke folur dhe ai duke dëgjuar.

Shumë kohë ka kaluar që atëherë, por roli i babait tek unë nuk ka ndryshuar. Akoma më afrohet e më përqafon kur frikësohem e kur mërzhitem. Më mbështet e rri pranë meje në çdo zgjedhje që bëj. Më bën për të qeshur e më heq lotët nga sytë. Mendimi im për këtë baba të mrekullueshëm s'ka për të ndryshuar. Ka qenë një njeri që do e kujtoj përherë.

Babai me të vërtetë është një figurë e rëndësishme në jetën time dhe jam e sigurt që ashtu është te gjithkush. Dhe me këtë e mbyll këtë letër, këtë mesazh.

E fundit gjë që do them është që: "Çmoje këtë kohë me këtë engjell mbrojtës dhe tregoja dashurinë që ke për të."

Fiona Semini 7D



Babai është heroi im, sepse ai më ka ndihmuar më mësimet, më ka mësuar si të notoja, si të ecja dhe shumë gjëra të tjera. Ai më çonte më pushime, më blinte lodra kur unë ia kërkoja, por mbi të gjitha ai ka qenë gjithmonë pranë meje në ditët e vështira dhe në ato të mira. Kur unë bëja gjilpërat ai më thoshte që të mos frikësohesha, sepse ajo dhimbje do të kalonte sa të hapja e të mbyllja sytë. Unë jam i lumtur që e kam babanë tim, sepse disa fëmijë nuk i kanë baballarët e tyre dhe nuk e ndiejnë atë ndjesi që ka çdo fëmijë. Nuk do e imagjinoja dot jetën time pa babin tim, pa atë unë nuk do dija asgjë rreth Lojërave Olimpikë ose futbollit, basketbollit, volejbollit, madje do të isha dhe fëmijë i llastuar, sepse mua do të m'i plotësonin të gjitha dëshirat. Pa atë unë nuk mund të bëja asgjë, madje nuk do të isha dhe në këtë shkollë, mund të isha duke lypur në rrugë si shumë fëmijë të tjerë.

Rei Bushati 7D

"Baba, ti je heroi im"

Ti më ke rritur dhe më ke edukuar plot dashuri. Dashuria që kam për ty nuk mund të përshkruhet me fjalë, sado të mëdha të jenë. Pa ty nuk do mund të shkollohesha dhe të bëhesha ky njeri që jam sot. Edhe kur kam bërë gabime ti m'i ke falur gjithmonë. Ti je përkushtuar dhe më ke ndihmuar për të bërë detyrat, të gjitha dëshirat m'i ke plotësuar gjithmonë dhe nuk më ke kundërshtuar asnjëherë. Ti më ke përkrahur edhe në momentet e mia të vështira. Unë jam djali më i lumtur në botë që kam një baba si ti. Ti je i pazëvendësueshëm. Je babai më i mirë në botë!

Rei Mile 7D



"Atij që më do pa kushte..."

Këtë shkrim dua t'ia dedikoj një personi tepër të rëndësishëm për mua... Njeriut më të mirë në botë... Njeriut që ka punuar ditë e natë për mua... Atij që nuk e ka njohur kurrë fjalën lodhje... Njeriut që ka punuar me mish e me shpirt për të plotësuar të gjitha dëshirat e mia... Njeriut që për një lot timin do të digjte gjithë botën... Atij që më do pa kushte... Heroit tim, të cilin çdo vajzë ëndërron ta ketë.

I shtrenjti im babi, je një idhull për mua, je shembulli më i mirë në rrugën që unë do ndjek. Je shoku im më besnik, ai që më mirëkupton më mirë se kushdo tjetër. Në çdo çast gëzimi apo hidhërimi më ke ndenjtur pranë. Kam qeshur pranë teje, por edhe kam qarë, jam mërzhitur me ty, por ti ke qenë edhe arsyeja e buzëqeshjes sime. Je si një busull për mua, që më drejton në rrugën e drejtë të jetës. Je kritikuesi që më ka ndaluar për të hedhur hapin e gabuar. Je këshilluesi i denjë që kujdeset për çdo hap që hedh në jetë. Je lavdëruesi që më ka bërë të ndihem krenare për atë që jam.

Dëshiroj që në një të ardhme të ndjek rrugën tënde e të të ngjaj ty. Dua të veproj duke gabuar rrallë, ose më saktë të veproj në mënyrën e drejtë, ashtu siç më ke mësuar. Dua të mësoj nga gabimet e mia dhe të nesërmen t'i ndreq ato. Dua që të bëhem "dikush", të arrij në grada të larta, të kem profesionin dhe reputacionin tim, t'i bëj ballë çdo problemi që mund të has gjatë jetës sime, por më e rëndësishmja është të të bëj të ndihesh KRENAR për VAJZËN tënde.

Edhe pse ndonjëherë të kam shqetësuar apo të kam mërzhitur me veprimet e mia, ti e di që unë e bëj pa qëllim. Unë dua që të jem gjithmonë arsyeja e buzëqeshjes tënde, edhe në ditët e tua më të vështira. Më beso, ne do jemi krahuri i djathtë i njëri-tjetrit. Jam me fat që babai më i mirë në botë më përket mua.

Babi, më ke dhënë gjërat më të rëndësishme në jetë: kohën tënde, besimin tënd, kujdesin tënd dhe mbi të gjitha, dashurinë tënde. Singërisht, jam mirënjohëse që je pjesë e jetës sime. Je i pazëvendësueshëm për mua. Të kërkoj ndjesë për çdo rast që të kam mërzhitur! Të Dua Pafund!

Angela Ricco 7E

Babi, fjala e dytë
që themi mbas mamit.
Mbrotjtja jonë që në fëmijëri.
Zemra jonë në pafundësi.

Shok i ngushtë e i pandarë,
për ty mendoj me mall.
Në çdo moment ti je aty,
të ulur, të lumtur të dy.

Kur ti larg shkoje,
ditët si shekuj ishin.
Dhe vije më përqafoje,
jetën ma gëzoje.

Si tani , si atëherë,
ti je i njëjtë.
Heroi im dje dhe sot,
për mua je i vetmi në botë.

Në çdo ditë, në çdo natë,
unë ndihem me fat,
që vajza jote jam
dhe hero i vetëm për mua je!

Enxhi Lamçe 7E



Babai, hero i im! Njeriu më i dashur për mua!

Babai, njeriu më i dashur në botë. Ti je një njeri shumë i mirë në shpirt. Kushedi sa shumë gabime kam bërë gjatë jetës sime, por ti gjithmonë më ke çuar në drejtimin e duhur për më të mirën time. Sa herë që ti ikën jashtë shtetit për punë, unë e ndiej shumë mungesën tënde.

Baba, ti me të vërtetë je një hero dhe një shembull i mirë për mua. Të gjitha veprimet që ti shfaq gjatë kohës që ne kalojmë bashkë tregojnë se ti je një njeri shumë i mirë në karakter dhe me vlerë. Kur të bëhem një njeri më i madh dhe të kujdesem për veten, dua të të ngjaj ty dhe ti të më shikosh mua me krenari. Ti ke qenë një baba shumë i mirë dhe do të jesh gjithmonë një baba shumë i mirë. Të falenderoj për përkushtimin dhe përkujdesjen që ke dhënë tek unë!

Luis Plava 7E

Baba sen benim kahramanımsın. Sen beni hep cesaretlendirdin, yardım ettin, doğruyu yanlışı gösterdin. Ben hastayken benim hep yanımda durdun. Bunu senin için yazıyom çūnki seni çok seviyom. Senle çok macera yaşadık. Senle birsürü yer gezdik yeni yerler gördük. Bize hep sen baktın. Seni çok seviyorum!

Babi, ti je heroi im! Ti gjithnjë më ke inkurajuar, më ke ndihmuar, më ke treguar të vërtetën. Ti ke qenë gjithmonë me mua kur unë isha i sëmurë. Unë i shkruaj këto rreshta për ty, sepse të dua shumë! Kemi pasur shumë aventura bashkë. Të dy së bashku, kemi parë disa vende të reja. Ti ke treguar gjithmonë kujdes për familjen tonë. Të dua shumë!

Yusuf Resul 7E



1.Cili është roli i babait në shtëpi?

2.Si e menaxhon ai familjen?

3.Çfarë përshtypjesh lë figura e tij tek fëmijët?

1- Babai duke qenë se është figura më e rëndësishme në shtëpi dhe duke qenë se ai është mbështetja kryesore, ka të drejtë të plotë të quhet: "Shtylla mbajtëse e shtëpisë". Çdo ditë e shoh të djersitet, të lodhet e të nxitojë, ndërkohë që unë me shumë delikatesë kreh flokët apo bashkoj lidhëset e atleteve të kushtueshme që mbaj veshur.

2-Babai në shtëpi ka punën më të vështirë. Për shkak të zanatit që rrallë e zgjedhin sot, babai im drejton veterinarinë për gjithë Qarkun e Jugut. Kjo punë kërkon përkushtim të madh.

Për të qenë më afër me punonjësit e tij si menaxhues, duhet t'i vizitojë shpesh ata, edhe kur bëhet fjalë për zona të largëta. Meqënëse ne jemi familje e madhe, babait i lind nevoja të kryejë një punë të dytë si avokat, gjë që e detyron atë të punojë natën vonë para kompjuterit.

Mënyra se si ai e ka organizuar jetën më bën ta adhuroj, por njëkohësisht edhe të pyes veten: -A do të bëj edhe unë një ditë si babai im?

3-Pavarësisht se babai im është shumë i zënë me punë, ai asnjëherë nuk ka marrë nga koha jonë për të përmbushur detyrimet e tij. Prania e tij në shtëpi është kënaqësia jonë. Çdo ditë kur dal për në shkollë e qetë se poshtë pallatit më pret një furgon, dhe fakti që unë s'do të lagem apo bëj këpucët pis, më bën të kujtoj tim atë.

Kur dyert e shkollës hapen dhe pranë tyre është dikush që interesohet për hyrje-daljet në shkollë, përpara më shfaqet fytyra e babait të kujdesshëm.

Kur ulem në bankë dhe një dorë e ngrohtë më tregon se është aty për të më ndihmuar, kujtoj dashurinë e madhe të babait për arsimim.

Sa shumë arsye kam për ty!

Çdo hap i imi është i orkestruar nga ty!

Çdo ditë e imja është një merak më shumë për ty!

Ti je heroi im!

Qenia ime mori vlerë që në momentin kur atësia ime je ti!

Emma Kojdheli 7E

"Për babain më të mirë në botë"

Babai, njeriu më i shtrenjtë në botë. Ti je arsyeja pse unë jetoj. Edhe pse ndonjëherë bëj gabime, prapë ti më fal dhe më tregon rrugën më të mirë. Jeta pa ty do të ishte shumë e trishtueshme. Sa herë që ndodhesh larg meje, ndiej mungesën tënde. Do të doja shumë që dhe ti të kishe pranë teje babain tënd. Për mua ti je një njeri që më do të mirën.

Ti je ndër personat më të bukur në shpirt që unë kam takuar deri tani. Je i dashur me të gjithë, je i sjellshëm, ndihmon ata që kanë nevojë pa kushte dhe punon fort çdo ditë që neve të mos na mungojë asgjë. Ti nuk je thjesht babai im, por je shoku im më i mirë, heroi im, modeli që më frymëzon çdo ditë. Kur të rritem dua të të ngjaj ty në çdo aspekt. Dua që në të ardhmen, ti të më shohësh në sy, të ndiesh kënaqësi kur të shohësh sukseset e mia, por mbi të gjitha dua që të ndihesh krenar për njeriun që jam bërë.

Të premtoj se çdo ditë të jetës sime do të kujdesem dhe do të punoj shumë që të bëhem djaloshi që ti dëshiron!

Arbër Elezaj 7E



"Faleminderit babi"

Një nga njerëzit më të rëndësishëm të jetës sime, ai i cili gjithmonë më fal siguri. Heroi im, që kur isha i vogël e deri më tani. Gjithmonë ke qenë aty për mua kur unë kam pasur nevojë. Je njeriu pranë të cilit ndiej më shumë siguri. Ka pasur shumë gjëra që unë nuk i dija para se t'i mësoja nga ti. E ka shumë gjëra që unë akoma do t'i mësoj nga ti. Çdo gjë që kam mësuar prej teje deri më tani, më ka vlejtur shumë në jetë. Edhe pse jemi grindur ndonjëherë, unë gjithmonë do të të vlerësoj si heroin tim. Je si superheronjtë nëpër filma, ti je afër meje sa herë që unë kam nevojë për ty.

Më ke ndihmuar sa e sa herë e unë pothuajse asnjëherë nuk ta kam kthyer ndihmën. Për momentin jam i vogël, por në të ardhmen do të t'i shlyej shumë nga gjërat që ke bërë për mua. Ke pasur besim te unë, kur të tjerët nuk kanë pasur. Të falenderoj jashtëzakonisht shumë për këtë gjë!

Gjithmonë kam bërë poezi e shkrime për nënën, gjyshen, motrën, por kurrë për ty. Epo ja që edhe ty nuk të kam lënë pas dore. Thjesht kam pritur momentin e duhur.

Biorni Rabeta 7E

Babai im, një krijesë hyjnore që më ka ndihmuar në çdo çast të jetës sime. Më ka mësuar shumë gjëra që unë nuk i kam ditur. Njeriu që unë mund të ndaj problemet, është ai. Mbaj mend të gjitha momentet e bukura që kemi pasur, mësimet, argëtimet. Madje para ca kohësh më the se ç'kishte ndodhur kur unë eca për herë të parë.

Babai im s'ka kërkuar nga unë asnjë gjë tjetër, përveçse të marr nota të mira në shkollë dhe më ka dhënë dije që unë nuk i dija para se të shkoja në shkollë. Ai më ka mësuar gjërat që do më duhen në jetë.

Ai më ka mësuar të eci, të lahem vetë, të vishem dhe të ha vetë. Ai gjithmonë ka dashur të mirën time dhe kurrë nuk më ka lënë pas dore. Por nga të gjitha, vlerësoj që ai më ka dashur shumë, pavarësisht sjelljes sime, notave të mia apo prapësive që bëja unë.

Ai më ka ndihmuar në çaste të vështira. Ky njeri ka qenë pranë meje në zënka, grindje dhe më ka këshilluar si të jem një njeri më i mirë në jetë. Ky është babai im dhe unë do ta vlerësoj si heroin tim përjetë.

David Dervishaj 7E



Babai im është heroi im. Në çdo moment të vështirë të jetës sime, ai gjendet gjithmonë pranë meje. Ai më ndihmon të kaloj çdo pengesë në jetën time. Jo më larg se dy ditë më parë, bashkë me familjen vendosëm të shkonim për të bërë ski në Brod, Prizren. Unë kisha shumë dëshirë të zbrisja malin e lartë dhe bashkë me kushëririn tim vendosëm që të rrëshqisnim mbi dëborën bardhoshe. Papritmas ne të dy u rrëzuam nga pista e skive dhe përfunduam në fund të malit, ku asnjë njeri nuk na shikonte dot. U përpoqëm ta ngjisnim malin, por ishte e kotë pasi nuk mundeshim nga dëborat e shumtë si dhe nga këpucët e skive të cilat ishin shumë të rënda. Bërtitnim pareshtur me sa fuqi që kishim, por vendi ishte si një shkretëtirë pa jetë. Qetësia mbizotëronte dhe frika filloi të na shtohet. Kisha besim se babai im do të na gjente dhe do të na ndihmonte, ashtu siç kishte bërë gjithmonë sa herë që kam pasur nevojë. E kështu ndodhi. Zëri i babit po më bëhej gjithmonë e më i afërt derisa sytë e mi arritën ta shikonin për së largu. Ai rrëshqiti si një skiator i vërtetë drejt nesh për të na ndihmuar që të ngjiteshim. Kur u ngjitëm, ne ishim të lagur dhe të lodhur, ndërsa babit ende nuk i kishte ikur nga sytë shqetësimi që kishte për mua. E përqafova fort dhe nuk mund të mos i thoja:

- Baba, ti je heroi im!

Unë e di se gjithmonë do ta kem pranë babain tim, me këshillat dhe ndihmën e tij. Edhe pse këshillën e tij që të mos largohesha unë nuk e zbatova, babai im, heroi im më ndihmoi. Ai është shembulli që unë dua të ndjek kur të rritem.

Donald Zekaj 7E

Idhulli im, heroi im, nuk është as një aktor i filmave aksion, por as një futbollist i skuadrës sime të preferuar, është thjesht i dashuri babai im. Babi e kupton menjëherë kur jam i mërzitur, por jo vetëm e kupton, por edhe e di arsyen. Dua t'i ngaj atij, sepse më jep energji pozitive, mundohem të flas me fjalorin e tij, por ndonjëherë imitoj edhe mimikën, sytë e tij shprehës dhe gazplotë, por edhe picërrimin e tyre enigmatik kur më qorton. Babi im është njeriu me të cilën ndihem krenar. Bashkëbisedimi na bën shokë, ndeshjet e futbollit tifozë, mësimet kërkues dhe lojërat kuriozë. Zakonet tona të përbashkëta nuk do t'i ndërroja me asgjë në jetë! Shembulli tipik i njeriut të rregullt, ka hedhur rrënjë në personalitetin tim dhe dëshiroj të bëhem ai njeriu që në rrjedhën e jetës është pasqyra ku shihem përditë dhe ku më duket vetja më i mirë. Ai është heroi im, i shtrenjti im, me të cilin natyra nuk më ka dhënë shumë ngjashmëri fizike, por natyrisht shumë, shumë shpirtërore.

Uroj që ta kem në krah në të gjitha etapat e jetës sime!



Ditmar Drenofci 7E

Për të gjithë ne është shumë e rëndësishme të kemi një familje. "Familje" do të thotë lumturi, plotësimi dhe sigurimi i nevojave jetësore. Në këtë kontekst dëshiroj të theksoj se figura e babit për mua zë një vend të veçantë.

Babai është ai që në fëmijëri ishte "princi i kaltër", që në ëndrrat e mia plotësonte çdo gjë. Me kalimin e viteve fillova të kuptoj se kjo nuk ishte një ëndërr, por realiteti. Babi gjithmonë më ka qëndruar pranë në çdo moment, gjithashtu edhe mami. Ai gjithmonë m'i ka plotësuar dëshirat dhe çdo gjë që unë kam kërkuar, pa asnjë përjashtim. Besoj se shumë nga ne kanë arsye të ndryshme lidhur me dashurinë ndaj prindërve, por babai im ka diçka të veçantë: ai ka qenë gjithnjë tolerant ndaj meje dhe nuk më ka thënë kurrë "jo", prandaj dhe unë jam vajza e llastuar e babit. Me siguri shumë fëmijë mund të përfitojnë nga toleranca e prindërve, unë kam ditur të mos përfitoj nga kjo gjë. Mendoj se edhe në të ardhmen çdo gjë do të shkojë po kështu. E ardhmja vërtet mund të na sjellë te papritura, por unë e di që babi im do të ngelet ashtu siç është dhe do të jetë pranë meje. Prania e tij në të gjitha gëzimet, por edhe zhgënjimet do të më japë forcë për t'i përballuar të gjitha vështirësitë.



Emili Doçi 7E

Këto gjëra që do të të them, nuk kanë aspak mbarim ose vlerë. Gjithnjë kam adhuruar imazhin tënd prej "heroi". Unë besoj tek ti, besoj se ti, atje larg në Gjermani, kujdesesh jo vetëm për mua, por për të gjithë familjen. Unë gjithnjë kam besuar se ti, po ti, ke qenë "engjëlli im mbrojtës". Jam djali i parë, po ai djalë që ka bërë gabime në jetë dhe kam kuptuar nga ato. Ai djalë që është krenar për ty.

Gjithë jetën tënde ke punuar për familjen pa pushuar, ditë e ditë, javë e javë duke më plotësuar dëshirat e mia. Disa ditë të lumtura, disa ditë të mërzitura, ti je gjithmonë në mendjen time.

Unë nuk jam aq i zoti për të thurur fjalë për ty, por këto janë fjalë që vijnë nga thellësia e zemrës sime. Të dua!

Klevis Sina 7E

Shumica e vajzave janë të fiksuara pas baballarëve. Unë jam një prej këtyre vajzave. Babi im quhet Klodi dhe është personi më i mirë në botë dhe këtë nuk e them sepse është babi im, por se është e vërtetë. Ai është i dashur, i qetë, i kujdesshëm, i sjellshëm, nuk është aspak i rrëmbyer, s'gënjen kurrë, nuk është aspak egoist dhe është shumë, po shumë i zgjuar. Ai më bën shumë krenare sa herë që e shikoj, pasi më do shumë dhe unë e dua akoma më shumë. Ai bën çdo gjë për mua dhe vëllanë tim të vogël, majde shumicën e kohës ai bën më shumë sesa ne meritojmë.

Kur mësuesja na dha temën e esesë, u kënaqa shumë, pasi ne jemi fokusuar vetëm tek nënat dhe nuk u kemi kushtuar aq shumë vëmendje baballarëve. "Babai, heroi im", nuk mund të kishte temë më të vërtetë dhe më të lehtë për t'u shprehur. Të gjithë ne kemi heronj të ndryshëm nga të cilët motivohemi dhe të cilët duam t'i kalojmë. Unë jam me fat, sepse heroi im jeton me mua, në shtëpinë tonë. Ai më mahnit gjithmonë me aftësitë e tij dhe se si ai gjen kohë për mua dhe për vëllanë tim, edhe pse oraret i ka aq të ngjeshura. Ai vjen vonë në shtëpi dhe është gjithmonë shumë i lodhur, por nuk e shfaq kurrë këtë. Babi vetëm rri e të shikon me ata sytë e kaltër që i shkëlqejnë nga dashuria dhe me atë buzëqeshjen, e cila nuk mund të kopjohet, pasi është pasqyrimi i ndjenjave të tij. Vetëm një shikim mjafton për të të ngrohur zemrën, për të të lumturuar e për të të ndihmuar të harrosh çdo gjë që po ndodh, të ndalosh kohën e të ulësh pranë tij dhe thjesht të qëndrosh aty pa folur, pasi fjalët janë komplet të parëndësishme në këto momente. Një kënaqësi tjetër është kur unë bëj diçka për të. Sado e vogël dhe e parëndësishme të jetë, unë kënaqem që po bëj diçka për njeriun që sakrifikoi jetën e tij që unë nesër të jem e suksesshme dhe të kem një jetë me kushte më të mira se jeta e tij. Vetëm kur mendon se çfarë sakrificash ai ka bërë për ty, ti je gati të ngjitësh malin më të lartë, të durosh stuhinë më të fortë, të kalosh detin më të madh e më të egër vetëm që ai të jetë i lumtur.

Ba, nëse po e lexon këtë, thjesht doja të të thoja që ti je heroi im dhe je personi që nuk do e ndërroja me asnjë në gjithë botën! Të dua shumë, o ba, edhe të falenderoj që më mësove të jem kjo që jam!

Faleminderit që besove tek unë!

Faleminderit që sakrifikove për mua!

Faleminderit që më frymëzon çdo ditë me përkushtimin tënd!

Faleminderit që kujdesesh çdo ditë për mua!

Faleminderit që më mbajte dorën e më tregove rrugën që do ndjek!

Faleminderit që u bërë ura në të cilën unë sot po kaloj!

Faleminderit që më dhe krahë të fluturoj!

Faleminderit që je gjithmonë këtu për mua kur kam nevojë!

Faleminderit o ba, për gjithçka që ke bërë për mua, dhe pse ti e di që nuk do të ta shpërblej dot kurrë!

E kujt i duhet Batmeni e Supermeni kur unë kam "babun" time?!?!?

Të dua shumë o ba dhe do të të dua shumë gjithmonë, ty, heroin tim!

Helga Gradeci 7E

Këtë shkrim ia dedikoj heroit tim të vërtetë. Ai është shumë i shtrenjtë dhe i veçantë për mua.

Ai kujdeset jashtëzakonisht për mua, këmbëngul që unë të ushqhem shëndetshëm dhe mundohet të më plotësojë dëshirat. Ai më ka mësuar vlerat e jetës si: mirësinë, mirësjelljen, zemërgjerësinë e sinqeritetin. Ai përpaket që jo vetëm mua, por të gjithë në familje t'i bëjë të lumtur. Nëse unë di të notoj, nëse unë di të luaj futboll, nëse unë arrij t'i zgjidh problemet me shokët e mi, nëse jam ky që jam, gjithë kjo falë babait tim. Ai më ka mësuar ç'është e mirë dhe e keqe, më ka mësuar që gjithçka ta diskutoj me të pa hezituar. Ai është një baba i dashur dhe është dhurata më e çmuar që më është bërë. Sot që jam trembëdhjetë vjeç akoma më kumbojnë në vesh fjalët e babait për dy gjërat kryesore: disiplina dhe puna. Ai më ka treguar rrugën drejt suksesit, mundësitë që unë kisha, por në të njëjtën kohë zgjedhjen ma ka lënë mua në dorë.

Këtë besim që ai ka te unë, do t'ia shpërblej me rezultate në mësim. E falenderoj Zotin çdo ditë që më ka dhënë një baba të dashur dhe të kujdesshëm! Gjithashtu i uroj vetëm shëndet!



Keis Saker 7E

"Babai, një nga njerëzit më të rëndësishëm në jetë"

Çdo vajzë e ka babain e saj si një shpëtimtar për çdo problem të saj. Gjithmonë ka sakrifikuar për ne dhe ka punuar për më të mirën tonë. Ai është një ndër personat më të veçantë në të gjithë jetën time. Nuk do ta imagjinoja kurrë jetën time pa të. Gjithmonë e kam konsideruar si një idhull dhe ashtu do të jetë përherë. Më ka ndihmuar në kohët më të këqija, më ka bërë që të jap më të mirën dhe më ka treguar se jo çdo gjë është e thjeshtë. Çdo vajzë ka nevojë për të dy prindërit, por idhulli i vajzës është dhe do jetë babai gjithmonë.

Babai është dobësia e çdo vajze. Asgjë nuk do ta përshkruante babanë tim. Për mua është si një hero dhe një shembull për rrugën që unë do të ndjek. Është si një këshillues që më drejton tek më e mira. E gjithë dëshira ime është që të bëhem ajo që babai im është sot dhe të bëj gjithçka që ai bën. Babi im është një njeri i mprehtë, i zgjuar dhe shumë i dashur me mua. Është ai, që më bën të ndihem e guximshme për çdo gjë dhe e falenderoj për gjithçka. E dua shumë dhe jam e sigurt që dhe ai mundohet për të gjitha dhe më do shumë.

Nuk ka shumë fjalë për të thënë, sepse është njeri i mrekullueshëm dhe një ditë do ia shpërblej të gjitha këto, sepse ai e meriton. Mbase ai meriton një vajzë më të mirë se unë, sepse unë kam bërë gabime shumë të mëdha dhe ai nuk e meriton këtë. Është një baba shumë i përkushtuar tek unë dhe më ka mësuar shumë gjëra që unë nuk do t'i dija kurrë. Babai im është një baba ideal, jo se është babi im, por është shumë i afërt me mua, i mirëkuptueshëm dhe shumë i ndershëm. Jam e sigurt që për atë do të jem gjithmonë ajo vajza e vogël, e cila rri me të dhe e përqafohet gjatë gjithë kohës. Jam kaq krenare që jam vajza jote. Dua që ai ta dijë se është babi më i mirë në të gjithë botën. Të dua shumë babi!

Klea Murati 7E

Nëse është dikush tek i cili marr shembull, tek i cili mund të mbështetem në çfarëdolloj momenti, ai je ti. Krenohem me ty se si në ato kushte në ato kohë, ke bërë ato sakrifica e sot je këtu në të tilla pozicione të larta.

Je personi më pozitiv që njoh e kjo jo sepse je babi im, por çdo baba meriton të tilla fjalë. Shumë herë jam mahnitur se si ke bërë shumë gjëra në të njëjtën kohë dhe secilën prej tyre në perfeksion. Je njeriu më i palodhur që më kanë zënë sytë, je gati të bësh çdo gjë për familjen tënde. Edhe pse bëj gabime që ndonjëherë janë dhe të pafalshme, ti më tregon rrugën e drejtë, edhe pse vazhdoj të bëj gabime, ti asnjëherë nuk je lodhur duke më folur e duke më treguar rrugën e drejtë të jetës. Ke shumë besim tek unë dhe kurrë nuk e ke shuar këtë besim. Nuk je vetëm babi im, por je shoku im më i mirë, je heroi im, je diamanti im. E di që dëshira jote është që unë dhe Adri (vëllai) të jemi dikush në jetë. Je dhe do të jesh i vetmi për mua ...

Xhesika Begaj 7E



Babai është një nga pjesët më të rëndësishme të jetës. Po pse ne u kushtojmë më shumë rëndësi nënave? Kjo ese i dedikohet njeriut më të mirë në botë që e dua shumë.

Babai im është një njeri autoritar, i vendosur dhe shumë këmbëngulës, por mbi të gjitha një njeri me zemër dhe shpirt të pastër. Në çdo bisedë ai më këshillon dhe një nga mesazhet që nuk do ta harroj kurrë është: "Ki gjithnjë besim në vetvete dhe kurrë mos u dorëzo!" Në çdo situatë që më përball jeta, mendoj se si do vepronte ai, sepse e di që do të ishte zgjedhja e duhur. Gjithnjë mundohem të eci në hapat dhe në gjurmët e atij njeriu që më frymëzon dhe më jep forcë të eci përpara. Jam dhe do të jem gjithnjë krenare që jam vajza e atij babai.

Edhe pse ne kalojmë pak kohë bashkë, ti je gjithnjë në mendimet e mia, sepse vlerat që më ke dhënë ti do të jenë gjithnjë pjesë e rëndësishme e imja. Të gjitha këshillat e tua do të jenë drejtimi im në jetë. Falenderoj Zotin që je pjesë e jetës sime! Ti je idhulli im për jetën.

Faleminderit që je babai im!

Faleminderit që më do gjithmonë!

Faleminderit që me veprimet e tua më tregon rrugën e së drejtës!

Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua!

Faleminderit që...

Falenderimet nuk do të kenë kurrë fund për ty, por dua ta dish që... të dua shumë!

Melisa Malaj 7E

Babi është ai person që më kupton. Ai e di se si unë ndihem. Ai është si një shok për mua. Kur unë mërzitem, ai më ngre humorin. Është ai që bën të pamundurën që unë të kënaqem gjithmonë. Ai punon shumë për të më siguruar mua atë që duhet. Në këmbim të gjithë këtyre gjërave ai nuk kërkon asgjë prej meje. E vetmja gjë që babi im kërkon prej meje, është që të mësoj shumë për t'u bërë dikush në jetë.

Babi im është si një hero për mua. Ai më jep mundësinë të studioj në një shkollë shumë të mirë dhe prandaj duhet ta bëj krenar. Babi më ka mësuar se si të mos i gënjej kurrë njerëzit. Më ka treguar se kjo është një gjë e gabuar. Më ka thënë se çdokush duhet respektuar. Ai më ka thënë se duhet t'i ndihmosh gjithmonë njerëzit në nevojë.

Një gjë e keqe e tij është se është pak nevrrik. Ndonjëherë më qorton kur bëj ndonjë gabim të vogël. Kur e kupton se nuk duhej të më kishte bërë titur, ai më kërkon të falur. Ky është babi dhe heroi im, të cilin unë e dua shumë!

Niki Osmani 7E



Babi është personi që unë nuk mund ta përshkruaj në mënyrë të plotë. Dashuria ime e madhe për të, mund të përshkruhet vetëm me fjalë, por edhe duke e bërë atë krenar për mua, duke ndjekur hapat e tij në të ardhmen. Për çdo gabim që kam bërë dhe për çdo gjë që më ka ndodhur, ti babai im hero, ke qenë aty të më këshillosh e të më tregosh rrugën e duhur.

Ti babi ke qenë gjithmonë "shtylla e shtëpisë". Ti babi shqetësohesh për mua si asnjë tjetër, natën më mbron dhe ditën më përgëzon. Lufton gjithmonë fort në betejat e mia dhe më rri pranë sikur të jem një medaljon i çmuar. Ti babi më ke ndihmuar të ndreq gabimet e mia dhe të metat e mia. Vetëm ju, prindi im baba, i dini sekretet e mia, më keni ndihmuar t'i zgjidh ato. Që në vogëli më keni mësuar që duhet të jem vetvetja dhe nuk duhet të gënjej. Kështu që babi im i dashur do të vazhdoj të ndjek këtë rrugë deri në pafundësi!

Babi, besoj se me kalimin e kohës është treguar që ti je më i veçanti, je më i miri, mbi të gjitha je heroi im! Sepse ti je Zot pranë meje. Dhe natën vonë je jastëku më i ëmbël e i butë për mua. Të dua, babi!

Denada Roçi 7E



"Babai, njeriu që pothuajse të ka mësuar gjithçka"

Ai është njeriu i cili të mbështet kudo, edhe në momentet më të vështira. Ti baba më ke mësuar se si të jem një njeri i drejtë dhe i dashur. Ti baba më ke mësuar që edhe të ndihmoj njerëzit dhe mos t'i gënjej kurrë ata. Ti baba je idhulli im dhe asnjë njeri tjetër.

Ti baba më ke mësuar se si të notoj, t'i jap biçikletës, edhe diçka shumë të rëndësishme, që të mos dorëzohem kurrë në çfarëdolloj situatë. Ti baba je ai që më ke blerë çfarëdolloj gjëje që unë doja për ditëlindjen time.

Baba ty dhe familjen ju dua shumë! Ju jeni gjëja më e shtrenjtë për mua në këtë botë! Babi të dua shuuuuuuuumë!

Roalt Doka 7E

Babi, bashkë kemi kaluar shumë momente të bukura. Ne të dy jemi si shokë dhe i themi çdo gjë njëri-tjetrit.

Të kujtohet kur isha në kopsht dhe ishte 8 Marsi, Dita e Nënës? Edukatorja po na thoshte: "Sot është Dita e Nënës, këtë ditë duhet ta bëni sa më të bukur për mamatë tuaja, duhet t'i bëni mamatë tuaja sa më të lumtura, duhet t'i doni shumë..." Unë nuk e lashë të mbaronte dhe i thashë: "Po për baballarët çfarë do të bëjmë?" Edukatorja tha: "Sot është dita e mamave, baballarët e kanë në një ditë tjetër." Në atë moment u mërzita pak. Kur erdha në shtëpi dhe të tregova ty se si ndodhi, ti më the që edukatorja kishte të drejtë.

Babi unë dua të të ngjaj ty, e të eci nën hapat e tu. Dua të të përqafoj dhe të të them faleminderit, sepse më ke bërë kjo që jam sot, më ke plotësuar dëshirat e mia të shumta edhe pse të kota, më ke besuar për çdo gjë, ke qenë aty kur kam pasur nevojë për ty, ke qenë aty kur kam qenë e mërzitur, më ke ndihmuar në problemet që kam pasur, ke qenë aty kur nuk kam qenë mirë me mësim dhe më ke ndihmuar. E di që shumë persona në jetë mund të më hedhin poshtë, mund të më zhgënjëjnë, por ti asnjëherë. Ti ke qenë modeli im, prej teje dhe mamit jam kjo që jam sot. Nuk e di si mund t'jua kthej të gjitha këto gjëra që keni bërë për mua.

Babi, kur mora vesh temën e esesë nuk dija ç'të shkruaja në fillim, pasi kisha shumë gjëra për të thënë për ty. Më dukej shumë gjë e lehtë, por tani që po e shkruaj, është më e vështirë, nuk di se çfarë të shkruaj për ty më përpara, nuk dija se cilat momente që kemi kaluar së bashku të shkruaj më parë.

Vetëm kur them emrin BABI, më vijnë në mend shumë gjëra, më kujtohen momentet që kemi kaluar bashkë. Kur kam qenë e vogël, të kam dashur shumë, dhe tani të dua shumë dhe do të të dua më shumë. Ti je zemra, shpirti, vëllai dhe shoku im më i mirë. Faleminderit që ekziston! Çfarëdolloj gjëje që të ndodhë, mos harro se ti dhe mami do të jeni zemrat e mia! Të dua shumë!



Selma Mehmetaj 7E

Po të pyesni moshatarët e mi për idhullin e tyre, ata do të thonë që është një futbollist, aktor, model apo këngëtar. Por për mua është gjithçka ndryshe, idhulli im është babai im. Ai është personi që urren të më shikojë të mërzitur dhe bën gjithçka që unë të qesh. Ai është personi ku kam shkuar gjithmonë, kur kam pasur një problem. Është babai im ai që më kupton nga sytë, jo vetëm kur kam një problem, por edhe kur jam e lumtur. "Baba, ti je personi i vetëm që me atë shikimin tënd plot dashuri e me atë buzëqeshjen tënde, më fal një energji pozitive duke zhdurur çdo problem." Babai im është ai që ka zemrën më të madhe, është ai për të cilin unë çdo ditë e më shumë ndihem krenare. Është ai që më mëson si të sillem dhe të jem e dashur me të tjerët. Unë rrallë ia shpreh rëndësinë që ka ai në jetën time, por ai e di dhe e ndien që unë e dua shumë dhe frika ime më e madhe është ta humbas, pikërisht atë, atë që deri tani është protagonistin në ditarin e jetës sime. Ai është pika ime e fortë dhe e dobët. Tek ai unë shoh vullnetin tim. Optimizmi i tij, më bën krenare. Është ai që i jep kuptim jetës sime. Të dua shumë, babai im i dashur!

Lorna Lufi 7E

I dashur baba,

As nuk mund t'i imagjinoj sakrificat që ke bërë ti për të na rritur mua me vëllezërit e motrat e mia. Çdo ditë ke punuar fort, me shumë mundim dhe pa menduar për rreziqet. Nuk besoj se mund të ketë fjalë për të përshkruar dashurinë që ndiej unë për ty, kështu që thjesht po të them: "Të dua, heroi im!"

Aurel Domi 7F



Të gjithë heronjë që unë njoh, janë të fortë, të mëdhenj, madhështorë, por i vetmi hero që unë pëlqej më shumë, është babi im. Po pse babi im? Sepse ai më ka rritur, më ka ndihmuar në çdo gjë, më ka edukuar, më ka qortuar për çdo gabim që kam bërë. Ai më ka mbështetur në çdo aktivitet që unë bëj dhe më thotë që të mos heq dorë nga ajo që bëj. Por ndonjëherë dhe ai lodhet, mërzhitet, zemërohet, por kur unë dhe familja ime rrimë me të, ai bëhet më i lumtur dhe më i aftë në gjërat e tij.

Anesa Hoti 7F



Babi, ti më ke ndihmuar për shumë gjëra. Më ke ndihmuar për të bërë zgjedhjen e duhur. Babi ti më ke mësuar të bëj gjërat më bazike deri tek ato më të vështira. Ti më ke dhënë të drejtën e dijes duke menduar për shkollimin tim dhe duke zgjedhur shkollën më të mirë. Ti ke qenë gjithmonë aty pranë meje, ke qenë gati për të më ndihmuar dhe për të më përgëzuar. Babi, ti më ke treguar aspektin më të bukur të jetës duke më çuar në vendet ku natyra është e mrekullueshme. Babi ti më ke ngritur kur jam rrëzuar fizikisht dhe moralisht. Babi, ti je heroi im! Ti ke bërë shumë sakrifica për mua. Je për mua gjëja më e shtrenjtë! Ndonëse unë kam bërë gabime, ti prapë ke qenë aty, për të më qortuar dhe për të më mësuar të vërtetën.

Angelo Duçkollari 7F



Kur flasim për dashurinë, sigurinë dhe guximin, fjala e parë që na vjen në mendje është babai. Një figurë e dashur që duhet të gjendet gjithmonë në familje për të krijuar sigurinë dhe për të dhënë dashuri në çdo moment. Nëse ty do të të ndodhte ndonjë gjë, do të isha e gatshme të të ndihmoja, sepse jam më shumë se e lumtur që të kam. Ti meriton gjithë lumturinë e botës dhe të jem pranë teje, të të shoh të lumtur më bën të ndihem njeriu më i gëzuar në botë. Ti lodhesh shumë dhe unë këtë nuk e di se si të ta shpërblej, por do të vijë një ditë që do ta gjej me çdo kusht dhe ashtu si më je gjendur ti pranë do të bëj dhe unë të njëjtën gjë për ty, sepse të dua pafundësisht sa as këto fjalë nuk e përshkruajnë dot! Edhe pse është pothuajse hera e parë që shkruaj një letër për ty dhe e kam pak të vështirë që të shkruaj disa vargje të gjata, mbase nuk do mundem t'i them dot të gjitha çfarë ndiej për ty, por dua thjesht të dish se për ty, dua çdo të mirë dhe asnjë gjë nuk do mundet të më ndajë mua nga dashuria që kam për ty babi, heroi im!

Altea Xhemo 7F

Të gjithë fëmijët rriten me një model hero i në mendje. Ndonjëherë ky hero është një personazh filmash, një aktor i famshëm, një këngëtar ose një i afërm. Heroi im është im atë, një hero më i fortë e më i zoti se të gjithë heronjtë e tjerë, se çdo Herkul, çdo Batman e çdo version Supermen-i që mund të krijohet ndonjëherë. Babai im është në dukje një burrë i thjeshtë, punëtor dhe i përkushtuar ndaj fëmijëve të tij. Por, kush mund ta njohë një baba më mirë se djali i tij i vetëm? Që në moshë të vogël, ai më mësoi si të gjuaja topin e futbollit, si të ngjisa mjetin atëherë për mua të çuditshëm, të quajtur biçikletë, si të notoja, si të bëja mundje e çdo gjë tjetër që mëson një djalë i vogël, e shumë më shumë.

Në çdo hap të jetës sime, më ka treguar se si një njeri mund të jetë i zoti në çdo aspekt, të ketë njohuri mbi gati gjithçka e mbi të gjitha me këmbëngulje më ka mësuar se edhe unë mund të bëhem një ditë hero për dikë. Ai më ka bërë të besoj te vetja, te aftësitë e mia, te lufta e vazhdueshme për t'u bërë gjithnjë e më i mirë. Një ditë unë, si ai, do të jem një burrë i suksesshëm, një njeri i mirë e kur të kthej kokën pas do mendoj për heroin që më solli deri në atë pikë!

Arbër Rama 7F



I dashur babi,
Ti je njeriu më i shtrenjtë për mua,
pa ty kjo botë do të ishte e kotë.
Ti je ai që rrugën me ndriçon,
dhe dashuri më dhuron.
Ti je ai që më gjendesh pranë kur unë kam nevojë.
Ti je ai që më jep kurajë për të ecur përpara.
Babi, do të jesh gjithmonë në zemrën time!

Elta Beqja 7F



I shtrenjti baba,
Me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti.
Je si një idhull për mua, je hero i im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si një busull drejtuese për mua. Je kritiku që më ka frenuar për të mos hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë që më bërë të mos gaboj kurrë në jetë. Çdo fjalë e jotja tingëllon si fjalët e të madhit Zot.

Të dua shumë, shumë sepse kam gjakun tënd, sepse jam biri yt që nuk të zhgënjeu kurrë! Gjithmonë do ndihem krenar për ty. Ke qenë babai ideal për mua. I tillë do mbetesh deri në fund... edhe në kujtimet e mia.

Rigers Zypçe 7F

Asnjëherë nuk më është kërkuar të shkruaj një ese për babain tim, ndaj kam plot gjëra për të thënë për të. Babai në pamje të parë mund të duket tepër i vrazhdë, dhe me raste është, por gjithmonë rrezaton pozitivitet. Kur jam e trishtuar apo thjesht me humor të keq, ai vjen direkt nga puna në shtëpi dhe më merr të dalim bashkë për të më ngritur humorin. Asnjëherë nuk më ka presionuar për mësimet, madje është ai që më thotë tërë kohën se ato nuk janë asgjë para lumturisë sime. Në raste kur mamaja mund të jetë jashtë shtetit, ai porosit gjëra të shijshme për të ngrënë dhe që të tre, unë, ai dhe motra e vogël shohim filma sipas preferencave të secilit, derisa të na kaplojë gjumi. Babai gjithonë më ka mbështetur mua në jetë, ishte ai që më mbështeti kur kisha dëshirë të filloja kursin e pianos ose të frëngjishtes. Ai, por edhe mamaja më kanë nxitur të lexoja libra kur isha e vogël dhe tani nuk i heq dot nga dora. Kur mund të kem ndonjë shqetësim ai është i pari që përpiqet të gjejë një zgjidhje. Po vazhdova nuk do të mbaroj kurrë me të mirat që ka. Megjithëse ndonjëherë ai nxehet shpejt apo vepron pa menduar mirë, unë gjithmonë do ta dua. Çdo njeri, sado të mira që ka, sigurisht, ka edhe të këqija, por prapsëprapë do ta dua përjetë, pasi dashuria midis babait e bijës nuk ka kufi!

Enia Xhaferraj 7F



Që kur hodha hapat e mi të parë ti ishe aty për të më mbajtur nëse rrëzohesha. Ti ishe një gjigant në sytë e mi. Ti më mbroje nga rreziku. Ti ishe dhe je ende heroi im. Nuk ka fjalë të mjaftueshme për të treguar se sa të dua. Por unë do të përpiqem çdo ditë për të të bërë krenar për mua, sepse ti çdo ditë përpiqesh të më bësh të lumtur, të më blesh lodrat më të reja, më të bukura, të na çosh me pushime në vendet më të bukura, më ekskluzive. Ti i bën ato gjëra për ne, që të jemi të lumtur, kështu që unë nuk do t'i ndaloj kurrë përpjekjet e mia që të jesh krenar për mua. Ti je babai im i vetëm dhe i preferuari dhe unë kurrë nuk do të ndaloj së dashuri ty!



Eren Akif Bruçaj 7F

Fjala e parë në jetë, je ti baba.
Dashuria e madhe e çdo fëmije, je ti baba.
Heroi i djalit tënd gjithmonë, je ti baba.
Mburoja e çdo gabimi, je ti baba.

Ai që mërzhitet për çdo lot, je ti baba.
Ai që për lumturinë tonë bëhet lumë që rrjedh, je ti baba.
Ai që më bën të guximshëm në çdo aspekt të jetës, je ti baba.
Ai mashkull që çdo herë më flet me respekt, je ti baba!

Glejd Shahu 7F

Babi, një person mjaft i çmuar për mua. Ai është personi që kurrë nuk do dorëzohej për të na edukuar, për të na veshur, për të na ushqyer, për të na arsimuar etj. Pas çdo lloj vështirësie që mund të kalojmë ne, ai prapë nuk do dorëzohej asnjëherë. Dashuria e tij për familjen dhe sakrificat janë të pafundme.

Lodhja e tij është shumë e madhe, por atij nuk i intereson kur bëhet fjalë për familjen. Atë e dua dhe gjithmonë do ta dua! Prej tij nuk do heq dorë asnjëherë. Nga ai mësova një gjë mjaft të rëndësishme, që prej gjithçkaje mund të heqësh dorë, por prej familjes jo.

Ndihem shumë krenar dhe mjaft me fat që kam këtë baba të mrekullueshëm. Përkushtimi i tij ndaj familjes është i jashtëzakonshëm, kjo është një nga arsytet pse jam kaq krenar për të. Atij mund t'i besoj verbërisht dhe pa hezituar aspak. Prej tij kam mësuar edhe një gjë tjetër, që me mundim dhe pa u dorëzuar mund të arrihet gjithçka. E falenderoj shumë që më ka mbështetur dhe që kërkon vetëm të mirën për mua!

Me pak fjalë, ai është një model perfekt i një njeriu dhe do mundohem të bëhem si ai, sadopak. Babin do ta dua gjithmonë! Je heroi im!

Unejs Kondi 7F



Babai është heroi im dhe do të mbetet gjithmonë i tillë. Si çdo baba tjetër, edhe babai im ka cilësitë e mira të tij. Ai është shumë i dashur dhe i sinqertë. Është i edukuar dhe kurrë nuk përton së më bëri të gëzuar.

Heroi ka gjithmonë superfuqi dhe këto i ka edhe babai im. Edhe pse vjen i lodhur nga puna, ai gjithnjë gjen kohën për të ndenjur me mua, më pyet si ia kam kaluar në shkollë dhe ndonjëherë më ndihmon për projektet që kam. Babai im na fal shumë dashuri dhe vazhdimisht na jep këshilla se si duhet të sillemi me të afërmit, shokët, mësueset etj. Ai thotë gjithnjë të vërtetën dhe këtë virtutet e ka rrënjësor edhe tek unë. Unë e di se kujt dua t'i ngaj kur të rritem. Dua të jem i shkathët dhe punëtor, siç është dhe babai im. Dua të jem i qeshur dhe bujar, të kem shumë shokë dhe t'i ndihmoj të tjerët, si babai im. Heronjtë janë gjithmonë shembull në jetë, prandaj them që babai im është heroi im!



Sidrit Rrustemi 7F

Që e vogël, kujtimet më të bukura kanë filluar gjithmonë me fjalën "Prind".

Babi, e them këtë emër dhe mendoj për mijëra kujtime që kemi bashkë. Ndonjëherë mendoj ato kohë kur prisja të vije në shtëpi natën vonë, ose kur më ngrije humorin sa herë ndihesha e mërzitur.

Babi, mundohesh, përkushtohesh, jep. Mundohesh të më bësh sadopak të lumtur, përkushtohesh të më japësh atë që duhet, jep botën për të më vënë një buzëqeshje në fytyrë. E di o ba, shpesh mendohem, a do të kishte një si unë, pa një si ti?

A do të kishte sukses për mua po të mos ishte dora jote që më mbante shpatullat?

Janë shumë pyetje dhe të gjitha e kanë një përgjigje: -Jo!

Pse? Sepse s' do isha kjo që jam sot, pa ty afër.

Gjithmonë njerëzit nuk kanë besuar në superheronj, por ata s'kanë parë babin tim...

Të dua ba, të dua shumë!

Klea Karaxhaj 7F

Nëse ju nuk keni takuar kurrë një hero, kjo mund të jetë e vërtetë, pasi ju nuk keni takuar babain tim. Babai im është personi më i mirë në botë, jo vetëm se është babai im, por të gjithë baballarët nëpër botë janë të tillë. Ka shumë fjalë që të përshkruajnë ty, që unë nuk di që të përdor në fillim. Ti mua më këshillon në shtëpi për të bërë gjëra të mira jashtë, por kur ti je me shokët e tu, mburresh me mua, edhe pse disa herë jo me të drejtë. Ti je një nga personat që mua më ndihmon më shumë nga të gjithë dhe ai që unë e di që do mbështetem gjatë gjithë jetës sime. Ti për mua je edhe shoku im i ngushtë më i mirë në botë. Ti je gjithmonë aty, edhe kur ke shumë punë, ti je aty i gatshëm për çdo gjë dhe kurrë për të mos më lënë në baltë.

E di shumë mirë për gjërat që të mërzis dhe përsëri ti gjen mënyrën e duhur se si unë ta kuptoj gabimin tim. Këshillat e tua nuk kanë kurrë fund dhe të gjitha janë shumë të vlefshme për mua. Nuk kam fjalë të përshkruaj sesa shumë të lodh unë ty, por ti e di shumë mirë që të gjitha do të të shpërblehen një ditë. Nuk di se çfarë të them më shumë për ty, edhe po të vazhdoj, fjalët nuk do mbarojnë kurrë, por unë di të them vetëm se të dua dhe ti je vërtetë heroi im!

Dejvi Rakipi 7F



Tani jam rritur e nuk më pëlqen të fshihem pas dere kur ti vjen.

Me krahët e fuqishëm, hop më kapje e si një supermen
në lartësitë më ngrije.

Krahëhapur fluturimin filloja,
në qiellin kaltërosh me shqiponjën garoja.

Qeshja pafund e frika largohet,
sa herë zëri i babait dëgjohej:

-E vogla ime mbahu se të dy, askush s'na mund dot!

Vite kaluan e në heshtje lojën vazhduam,
Pa kërcime e premtime.

Dorën fort më shtrëngon kur frika papritur më sundon.

Hensara Muça 7F



Fjala e parë e çdo fëmije, je ti baba.

Ti je heroi im.

Ti më ke ndihmuar në ditët e mia më të vështira.

Ti më ke mësuar, ti më ke edukuar.

Ti je personi më i dashur për mua,
se ti je shembulli më i mirë për mua.

Ti je arsyeja e gjithçkaje.

Ti je babai im që më ke fshirë lotët në çdo trishtim.

Ti je më i forti, më i miri, më punëtori.

Ti je idhulli im.

Unë të dua pa masë.

Dea Fjora 7F

Babi është miku im më i mirë dhe e kam si vëlla të madh. Pse e dua kaq shumë babin tim?

Ai më korrigjon gabimet që bëj dhe më motivon për të bërë vetëm mirë dhe jo keq. Më ka ndihmuar kur kam pasur nevojë për ndihmë. Ai është personi më i fortë dhe më energjik që kam njohur ndonjëherë.

Më ka ndihmuar të zvogëloj frikën që kam për gjëra të shumta. Ai punon shumë vetëm e vetëm që kur të rritem të jetoj sa më mirë e të punoj në vende sa më të mira. Më këshillon çdo ditë dhe më gjen dobësitë që të më forcojë e të më përgatitë për të nesërmen.

Në mendimin tim, babi im po sakrifikon shumë për mua dhe një ditë unë e di që duhet ta shlyej borxhin që i kam babin tim, por për tani duhet të mësoj dhe ta lumturoj me nota të mira në shkollë. Faleminderit babi!

Kevin Gurakuqi 7F



Babai është heroi im sepse ai lodhet që unë të jem e lumtur sepse ai më do pavarësisht çdo gjëje. Babai im është zemërgjerë, atij i intereson për të tjerët. Ai më tregon kur jam gabim ose kur jam saktë, kur jam e mërzhitur ai më bën për të qeshur. Ai do që unë të mësoj dhe që të dal mirë me nota. Atë gjithmonë e merr malli për mua. Ai më ka mësuar që kurrë të mos heq dorë nga gjërat që dua, dhe të punoj shumë që t'i arrij ato. Ai është i zgjuar, i dashur dhe shqetësohet shumë për mua dhe motrën time. Ti je heroi im sepse ti lufton për mua!

Ti lufton që unë të kem një jetë më të lehtë, që unë të jem e lumtur dhe e gëzuar! Ti lufton sepse më do mua!

Ami Hoxha 7F



Babai im ti je një nga personat që të kam mërzhitur më shumë herë pas here, por ti prapë më ke falur. Të falenderoj për biznesin që ke ngritur për ne fëmijët! Ke pasur problemet e punës dhe ndonjëherë ke qenë dhe i stresuar, pastaj të vinin probleme prej meje në shkollë dhe ti mërzhiteshe shumë me mua. Por ta dish që je personi që unë dua më shumë nga çdo njeri në botë dhe je gjëja më e shtrenjtë që unë kam! Të kërkoj pafund të falur për gabimet dhe të premtoj që nuk do i përsëris më!

Të dua shumë!

Për gabimet që do bëj më vonë ta dish që unë do mundohem sa më shumë që mos t'i përsëris ato dhe të të bëj babanë më të lumtur në botë!

Tomi Llanaj 7F

Babi im, sa shumë të dua,
e vetmja dashuri e sinqertë je ti!
Dhe kur jam në vështirësi,
unë të thërras vetëm ty!
Nuk kërkoj asnjë gjë,
vetëm të më prekë dora jote.
Përqaqimi yt nuk ndërrohet,
me asnjë gjë të kësaj bote!

Për ty,
mbeta fëmija i llastuar.
Me dëshira dhe ëndrra
për jetën në vazhdimësi.
Ndaj shprehimisht,
shumë të dua pa kufi!
Se ti je heroi im!

Ti je engjëlli mbrojtës i jetës sime!
Uroj që çdo moment i jetës tënde
të jetë i mbushur me gëzim!
Se ti je një dhuratë, për mua.
Fort, shumë fort Të Dua!

Faleminderit Zotit
që më dha këtë baba!
Është i mrekullueshëm!
Si babi im në botë nuk ka!

Ira Serjani 7F



Babi, një nga njerëzit më të dashur për mua. Ti ishe heroi im i parë në këtë jetë. E gjithë dëshira ime është të eci nën hapat e tu, të gaboja aq bukur sa gabon ti. Dua të të përqafoj e të të them "Faleminderit!". Në këtë botë jam i sigurt që çdokush mund të më hedhë tutje, çdokush mund të më zhgënjëjë, çdokush mund të më tradhtojë, por ti, ti kurrë! Je vendi ku unë gjej të vërtetën, je babai im! E di që ka ndodhur e s'ta kam dëgjuar fjalën... Ti më kërkoje korrektësi, por unë kurrë nuk e zbatova. Ti më ke ndenjur te koka derisa më vinte gjumë. Gjithmonë më fale, pavarësisht gabimeve që bëj. Gjërat kaluan ngadalë dhe unë u rrita, fillova t'i kuptoja gjërat vetë, pa shpjegimin tënd! Po kuptova që ti ishe mbreti dhe heroi i botës sime. Mos më lër vetëm se pa ty në këtë botë jam askushi.

Samed Kokiçi 7F

"Për më të mirin"

E vërteta është që unë kurrë nuk mund të të ngre ty në piedestalin që ti meriton. Unë nuk jam aq e zonja sa të t'i shpërblej të gjithë gjërat që ti ke bërë për mua. Nuk mjafton një përqafim për të të treguar sa shumë vlen ti për mua. E gjithë dëshira ime është që të të ngjaj ty, e të eci nën hapat e tua, të gaboja aq bukur sa gabon ti. Dua të të përqafoj fort e të të them "FALEMINDERIT!". Eh ta dish ti sa të ëmbla më duken sot ato goditjet që më bëje në pëllëmbët e duarve sa herë që gaboja...

Në këtë botë jam e sigurt që çdokush mund të më hedhë tutje, çdokush mund të më zhgënjejë, çdokush mund të më tradhëtojë, por ti, ti kurrë! Ti bashkë me kohën, keni treguar që nuk jeni si gjithë të tjerët. Ti je më i veçanti, je ai njeriu besnik që qëndronte çdo natë te koka ime derisa mua të më zinte gjumi... Sepse ti je Zoti pranë meje! Prehëri yt është jastëku më i ëmbël e më i sigurt ku unë mund të fle e qetë. Je vendi ku unë gjej të vërtetën, je babi im! E di që ka ndodhur që dhe s'ta kam dëgjuar fjalën... Ti më kërkoje më shumë korrektësi, por unë kurrë nuk e zbatova. Gjithmonë më mban afër vetes tënde, pavarësisht gabimeve dhe zhgënjimeve që merr nga unë. Ti kurrë nuk më largon nga vetja, por më shtrëngon fort si të jem medaljon i artë. Ti lufton pafund në betejat e mia, ti more përsipër çdo gjë, vetëm që unë të mos prekesha nga asgjë e keqe. U rrita në mes të të mirave, me ty në krah mësova t'i ndaj gjërat nga njëra-tjetra. Por mësimi më i vlefshëm për mua është që duhet të kem respekt për veten, e në këtë mënyrë do të kem për të gjithë... Më quan "çuni im". Kur ndodhesh në vështirësi, ti thua se unë ia dal vetë, por aftësitë e mia vijnë gjithmonë si pasojë e mësimave të njëpasnjëshme që ti më jep. Ti më tregove për sekretet e tua, më tregove dhe për hilet, madje më tregove edhe për të metat e tua... Të metat i ndryshuam me forcën e njëritjetrit, u munduam dhe luftuam të kuptonim gabimet tona tek vetja jonë, e më pas t'i hiqnim ato... Gjërat kaluan ngadalë dhe unë u rrita, fillova t'i kuptoja gjërat vetë, pa shpjegimin tënd! Por kuptova që ti ishe mbret dhe hero i botës sime. Ti dije çdo detaj timin, ti dije çdo shprehje të mimikës së fytyrës sime, ti ishe pasqyra ime e vetme... I shtrenjti im, ti je i aftë të bësh çdo gjë me botën time, mund ta dërgosh ku të duash, por unë nuk kam frikë nga ti. Je drita e syve të mi, je heroi i çdo lufte e çdo beteje që unë kam kaluar, ti je në krye të të gjithë botës sime, je gjysma ime më e plotë dhe e saktë! Do të të përulëm gjithmonë, me dashurinë dhe respektin dhe do të të lutem: "Mos më lër vetëm, sepse pa ty në këtë botë unë jam askushi, të dua!"

Keisi Pengili 7F

Baba, ti je heroi im. Ti je një nga personat që respektoj më shumë. Ti më mëson se si të jem i përgjegjshëm për fjalët që them dhe detyrat që ndërmarr mbi shpatullat e mia. Në qoftë se nëna më mësoi fjalët e para në gjuhën amtare shqipe, ti më mësove fjalët e para në gjuhën e bukur angleze. Ti më mësove të notoj, të patinoj, të luaj tenis, ping-pong, të ngas biçikletën e parë dhe më përfshive në aventurat e tua, nga majat e larta të maleve, deri në thellësitë e oqeanëve dhe deteve. Duke qenë se praktikon profesionin e doktorit, ti tregon bujari dhe mirësi çdo ditë të jetës tënde, duke shpëtuar jetët e mijëra njerëzve që kanë nevojë për ndihmë. Kështu, ti fiton para për bukën e gojës dhe shkollimin e fëmijëve të tu, duke formuar rrënjët e familjes sonë dhe brezave që do të vijnë pas saj. Të gjitha ëndrrat të cilat nuk mund t'i bëje realitet në fëmijëri, po i përbush bashkë me ne, ditët e sotme. Unë dua të të ngjaj ty, në mënyrë që t'i jap edhe unë një të ardhme të sigurt familjes që do të krijohet, siç po ma jep ti mua. Ti ke pasur, ke dhe do të kesh gjithmonë një impakt të madh në jetën time, sepse je një baba shembullor për mua dhe motrën e një bashkëshort shembullor për nënën time. Për këto arsye, unë të dua shumë!



Sidrit Kokiçi 7F

I shtrenjti babai im... Jam unë vajza jote e parë, ajo vajzë që bën gabime në jetë dhe kupton shumë. Ajo vajzë që ke dhe ke rritur. Babai im, jam krenare për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë dhe për dashurinë. Gjithë jetën po punon për familjen duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na dhënë të gjitha kushtet. Babi im, ti gjithmonë kur kam qenë e mërzitur, je përpjekur të më lumturosh. Ti më ke mësuar rrugën e jetës, vlerën e së mirës dhe të së vërtetës. Heroi im, që supet kurrë s't'u lodhën kur mbi ta më mbaje për të më gëzuar. Oh, sa jam kënaqur kur luanim bashkë kur isha e vogël dhe bënim gjëra që përherë do t'i kujtojmë. Ti më ke mësuar se njeriu duhet të falë dashuri dhe mirësi ashtu siç fal edhe ti. E di që kur në ditë të vështira të jem, pranë do të të kem. Të kërkoj të falur për çdo herë që s'të kam dëgjuar, ndoshta edhe ndonjëherë të kam pikëlluar dhe me ndonjë fjalë të kam lënduar. Dashurinë për ty me fjalë s'e them dot. Ka shumë fjalë që për ty nuk mbarojnë. Të dua shumë dhe jam e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti. Të dua shumë!



Serena Malaj 7F

Të gjithë e dimë shumë mirë që të dy prindërit duhet t'i duam njësoj. Por ndonjëherë ndodh që ne ia shprehim këtë mamit dhe jo babit. Shkruajmë poezi, proza dhe vargje për mamin. Po për babin kush i shkruan? Asnjë. Prandaj dhe ky libër u dedikohet vetëm atyre. Në këto rreshta ne do të shkruajmë, por në të njëjtën kohë do t'u kërkojmë falje për gjithë këtë kohë që nuk kemi shkruar asgjë për ta. Në familje secili ka detyrat e veta. Mami është ajo që kujdeset dhe na edukon ne, kurse babi është ai që sakrifikon më shumë për familjen dhe jep gjithçka për të. Pavarësisht se ne, më të shumtën e kohës e kalojmë me mamin, të dy prindërit i duam në mënyrë të barabartë. Babai është heroi ynë, i cili na mbron nga të gjitha gjërat e këqija dhe që do të jepte jetën e tij për ne. Nga ai ne marrim mësim dhe këshilla, të cilat do të na vlejnjë gjatë gjithë jetës sonë. Ai është si ata superheronjtë që shihnim kur ishim të vegjël në filma vizatimorë. Por ka diçka më tepër, është më i mirë!

Alfrida Alimema 7G

"Babai im..."

Personi, i cili më përkrah dhe më ka përkrahur gjatë gjithë kohës, ai që më ka ndihmuar sa herë që kisha nevojë, njeriu që më ka bërë të arrij deri këtu ku jam tani. Babi është ai që asnjëherë nuk më ka lënë me lot në sy. Gjithmonë më mbro. Më jep këshilla që më ndihmojnë shumë në jetë. Gjithmonë më thotë të mos i marr për bazë fjalët e të tjerëve, më thotë se nëse unë ndihem mirë me veten time atëherë asnjë fjalë tjetër nuk ka rëndësi.

Po pra, këto të gjitha mund t'i them për personin më të dashur në botë. Nuk kam fjalë të mjaftueshme për të përshkruar sa shumë e dua atë. Babai ka sakrifikuar që të bëjë familjen e tij të lumtur. Dhe nuk e jep veten kur është i lodhur e kur është i sëmurë. Nuk e tregon veten kur ka dhimbje. Përkundrazi, e jep veten sikur të jetë shumë i lumtur. Babin tim e dua shumë! Nuk e di se sa herë do ta përsëris këtë fjalë në këtë shkrim sepse asnjëherë nuk do të lodhem duke e thënë.

Është e vërtetë që ndonjëherë mërzitet, por jo pa qëllim. E ka sepse do që ne fëmijët e tij të jemi dikushi në jetë. Të mësojmë edhe ne ashtu si ai, që të mund të arrijmë të kemi jetën që duam. Këshillat e babait mund të jenë këshillat më të rëndësishme për jetën. Babai rri ditë të tëra pa e parë familjen e tij, që të punojë dhe të na bëjë ne të lumtur.

Po nëse njëri nga fëmijët ikën larg? Atëherë ai fillon të punojë akoma edhe më fort. Babi është idhulli im! Asnjë nuk krahasohet më të. Ai është një hero! Jo vetëm për mua, por për të gjithë ai është një hero. Të gjithë besoj se e duan babain e tyre ashtu siç e dua unë. Nëse është larg apo afër, ai të do njësoj. Babi... kam disa fjalë për ty: "Të falenderoj për çdo këshillë, çdo mundim, çdo fjalë, çdo qortim..."

Të gjitha fjalët e tua vlejné më shumë se çdo gjë, çdo pikë dhe presje që ti nxjerr nga goja jote. Të gjitha bëjnë një pjesë shumë të madhe në jetën time. Po të mos ishte për ty, unë nuk do të isha këtu tani. Nuk kam fjalë të mjaftueshme për të të falenderuar, ndaj këtë shkrim ta dedikoj ty. Dua që gjithmonë të të shoh të jesh krenar për mua, ndaj këto fjalë të perkasin ty: "Të Dua Pafundësisht Shumë!"

Anjeza Brahimi 7G



Tani do ju flas për heronjtë, por jo për heronjtë që luftojnë po për ata që të rrinë gjithmonë afër. Këta heronj i kemi të gjithë ne, por thjesht nuk e mendojmë thellë që janë të tillë. Ky është babai. E quaj hero, sepse ai ka qenë aty për mua në çdo moment. Më ka dhënë çdo këshillë që më është dashur. Që në moshë të vogël ai rrinte me mua dhe kalonim shumë kohë bashkë. Kam kaluar momentet më të bukura me të. Me të jam shumë e lidhur dhe ne e ndajmë çdo gjë bashkë. Gjithashtu ne ngajmë dhe shumë në karakter dhe për këtë arsye merremi vesh shumë mirë me njëri-tjetrin. Kemi pasur dhe keqkuptime, por kanë qenë punë sekondash. Ai është personi që më bën më shumë për të qeshur dhe në çdo moment më bën të ndihem mirë. Ai më ka mësuar shumë gjëra, më ka ndihmuar shumë dhe më ka bërë këtë që jam sot. Më ka mësuar gjëra që askush tjetër nuk do të m'i mësonte aq mirë sa ai. Është dhe i rreptë, por nga qortimet dhe ndëshkimet kam mësuar shumë. Faleminderit që ke qenë gjithmonë pranë meje dhe më ke ndihmuar në çdo moment të vështirë!

Mishel Karafilaj 7G

Babain tim unë e dua shumë, si çdo njeri. Më ndihmon të kuptoj çdo gjë. Që në vegjëli, babi më përgjigjej për pyetjet që kisha. Edhe sot, babi im vazhdon të më ndihmojë për shumë pyetje që kam. Si çdo fëmijë, edhe unë kam pasur dhe kam dëshira dhe pasione. Babi është ai që m' i ka plotësuar këto dëshira. Madje, edhe pasionet për teknologjinë e informacionit dhe avionët (dy nga pasionet më të mëdha të miat), babi është njeriu që m' i ka ushqyer ëndrrat për to.

Pa babin tim, sot nuk do të isha ky që jam dhe nuk do të kisha këto që sot kam. Babai im është një person me cilësi të mrekullueshme. Ai është i zgjuar dhe shumë i duruar, cilësi këto fantastike. Babi im ka lindur në Vietnam, sepse gjyshi ka qenë ambasador atje, në kohën kur Vietnami ka qenë në luftë me Amerikën. Fëmijërinë e ka kaluar atje dhe ne flasim shpesh për këtë periudhë të vegjëlisë, moshë në të cilën ai ka zhvilluar edhe pasionet më të mëdha të tij: pikturën dhe kompjuterin. Ai ka fituar në Paris vend të parë në konkursin e UNESCO-s për pikturë dhe unë shoh me admirim të madh dosjen e pikturave të tij, të cilën ma ka dhënë gjyshi.

E ruaj me shumë kujdes këtë dosje dhe të gjitha punimet që ndodhen në të. Ajo më ndihmon të kuptoj botën e brendshme të babit në fëmijëri.

Në kohën e lirë që ne kalojmë bashkë, flasim dhe ndajmë mendime për shumë gjëra, sepse unë kam trashëguar të njëjtat interesa me të. Dhe, për këtë jam i lumtur! E kush nuk do të donte t' i ngjasonte babait të tij!

Në shëtitjet tona, zakonisht në fundjavë, ne takojmë miq e shokë të babit. Jam i lumtur dhe krenar për respektin dhe mirësinë, me të cilën ata përshëndeten me babin tim. Sa do të doja që kur të rritem t' i ngjaj atij, t' u fal mirësi dhe dashuri shokëve e miqve, t' i ndihmoj ata në nevojë, ashtu sikundër babai im!

Babi im është njeri pozitiv, shpresëdhënës, edhe në momente të vështira. Ai me fjalët e tij të ëmbla më ndihmon të kaloj çdo vështirësi, çdo moment delikat. Gjikimi i tij i drejtë dhe i mprehtë janë armët më të forta, të cilat kur të rritem dua t' i zotëroj edhe unë.

Babi im quhet Dritan. Ashtu siç ka emrin, dritë rrezaton në çdo çast të jetës sonë familjare. E qeshura e tij është prelud i momenteve që ne kalojmë së bashku, është melodia e ditëve tona, është motivi që frymëzon jetën tonë familjare.

Për babin nuk do të mjaftonin orët dhe kjo ese për të shkruar. Kam shumë gjëra që dua të shpreh. Por, një gjë është e sigurt e që do të ishte pjesë e pandarë e mendimeve të mia për të: "Babi, ti je modeli që unë dua të ndjek në jetë! Ti je frymëzimi im në çdo hap që hedh! Ti je udhërrëfyesi im në këtë rrugëtim të gjatë në rrugën e dijes! Dua të jem si ti edhe kur të dal në jetë!"

Babai im më ka dhënë dhuratën më të bukur që dikush mund t' i japë dikujt: Ai beson tek unë!

Babi, ti ke qenë, je dhe do të jesh gjithmonë shoku im më i ngushtë, heroi im!

Dardi Peka 7G

Babai im, prindi im i dashur, nuk do të mjaftojnë asnjëherë fjalët për ta përshkruar. Nuk di se çfarë të thuash për dikë që e do shumë, për dikë që është aty gjithmonë.

Është e vështirë të kuptosh sakrificat që bëjnë prindërit për fëmijën, për mua. Nuk e kupton se sa shumë të duhen dhe të duan prindërit, babai. Sa shumë kujdesen për ty. Çdo herë që jam sëmurë, babi më rri te koka, një milion herë pyet "Si je, si je?". Ai sjell mirëqenien e familjes. Pa të nuk do të ishte lumturia e plotë. Pa të nuk do të ishte familja e plotë.

Ndoshta jo hero i vërtetë, por ai kryen një akt heroik çdo javë. Çdo javë vjen i stërlodhur nga Korça. Ai kujdeset për mamanë e tij, gjyshen time, e cila tani është e sëmurë. Jeta i ka sjell këtë vështirësi, të cilën, ai përpiket ta kalojë sa më lehtë, por prapë është shumë e vështirë. Një mundim i madh, por një akt superheroik. Jo çdokush do ta bënte, duhet vërtet një vullnet i madh dhe një karakter i fortë, të cilët babai im i ka.

Babai, personi që të shoqëron përditë. Ai, që të bën të qeshësh çdo ditë. Ndoshta nuk mund të jetë hero i vërtetë, jo një superhero si ata nëpër filma, por ai gjithmonë do të jetë heroi im!

Rea Manoku 7G



Babi është krenaria ime. Këtë gjë mund ta them me plot kuptimin e fjalës. Nuk ka mjaftueshëm fjalë për të shprehur se sa mirënjohëse jam që në jetën time kam një njeri aq të vyer dhe të përkushtuar ndaj meje. Ai është idhulli im! Babi është një fjalë kaq e vogël, por me një kuptim aq të madh në jetën e çdokujt prej nesh. Ai është shoku më i denjë i çdo fëmije. Në çdo çast të vështirë, babi është busulla ime drejtuese.

Gjithmonë ai më jep këshillat më të mira. Babi më ndihmon në çdo situatë. Ja pra, këto e shumë gjëra të tjera e bëjnë atë heroin tim. Babi është ai, i cili më bën t'i mendoj gjërat dy herë. Ai përherë më gjendet pranë. Një dëshirë e imja është t'i ngjaj babait tim, të eci në hapat e tij si dhe të gaboja aq bukur sa gabon ai.

Një fjalë e vetme që kam për të është: "Faleminderit!" Asnjëherë nuk më ka zhgënjyer, pavarësisht çdo gabimi, më ka qëndruar pranë dhe nuk më ka larguar kurrë nga vetja. Ai është baba pa të meta, ai është shembulli i çdo babai ideal. Është ai i cili nuk lodhet kurrë nga gabimet e mia.

Unë jam princesha e tij dhe ai heroi im. Babi është njeriu të cilin e respektoj më shumë se çdo njeri tjetër në botë. Ai është njeriu më optimist dhe entuziast që njoh. Gjithmonë jam ndier si fëmija më me fat në botë, pasi kam një familje të mrekullueshme. Një familje ku babi im luan një rol shumë të rëndësishëm. Ja pse babai im është heroi im!

Anda Bushi 7G

Babai ...

Personi i vetëm, i cili nuk do të më mërziste për asnjë arsye në këtë botë. Thjesht fjala është kaq e dashur për mua. Dashuria e tij nuk më mjafton asnjëherë. Dashuria e tij është aq e madhe sa vetë mali më i lartë në botë. Babai është heroi im. Është personi më i dashur për mua.

E vërteta është që unë kurrë nuk mund të të ngre ty në fronin më të lartë të botës që ti meriton me fjalët e mia. Është thjesht e pamundur t'i thurësh ato fjalë me kujdes që të të tregojnë ty personin më të lavdishëm e të mrekullueshëm të botës. Ti, je mbreti i kështjellës sime të vogël. Babi, je gjithçka për mua. Je një nga personat më të rëndësishëm të jetës sime. Nuk ka lumturi më të madhe në botë sesa të jem pranë teje.

Ka pasur raste kur edhe të kam mërzitur apo zhgënjyer, por prapë nuk je mërzitur asnjëherë me mua. Bashkë me ty, unë lundroj deri në detin e pafundësisë sepse në krahët e tu do të isha gjithmonë e sigurt. Copëza mendimesh, gjysma frazash apo fjalësh, bishta ngjarjesh të parëndësishme ndërpresin njëra-tjetrën, shtyhen, kapen me njëra-tjetrën me një gjallëri që shtohet bashkë me shpejtësinë e kujtimeve të mia. Mendimet më trazohen shumë, por kujtimet që kemi së bashku më kalojnë si një film që s'ka mbarim para syve të mi. Një shikim plot dashuri i yti më mjafton për të më dhënë mua kurajën e gjithë botës.

Kujtimet gjendeshin aty, në një libër shumë të trashë në mendjen time. Prisja që këto kujtime të më merrnin me vete e të më çonin në një rrugë, e cila përfundonte vetëm tek Ti. Gjithmonë do të kem një derë ku mund të futem dhe gjithmonë do të jesh Ti. Gjithmonë do të kem një njeri ku të mbështetem dhe do të jesh Ti. Gjithmonë do të kem një vend të veçantë në zemrën tënde, ashtu siç ke edhe ti një vend të pazëvendësueshëm në zemrën time. Kujtimet që kemi kaluar së bashku nuk do t'i harroj kurrë. Me kujtimet tona të paharrueshme unë mund të shkruaj një libër të tërë. Ato kujtime gjenden gjithmonë në mendjen dhe në zemrën time, në një vend mjaft të veçantë...

Babai im, heroi im jo vetëm i përrallave, por edhe i problemeve në jetën time reale. Babi, të dua pafundësisht shumë dhe asnjë fjalë e imja nuk do të mjaftonte për të të shprehur dashurinë time që kam për ty! Të dua shumë!

Onejda Sheshori 7G

Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtit tim, babait tim. Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë, njeri me shpirt të pastër e të bukur, që në jetë ka hasur shumë vështirësi që në fëmijëri. Në moshë shumë të vogël iu desh të punonte e të mbante nënën, babanë, motrat dhe vëllezërit e tij, sepse ishte fëmija i madh në atë familje me 8 persona. Bëhet fjalë për 32-33 vjet më parë, kur edhe mundësitë ekonomike ishin pothuajse zero. Im atë ka pasur një fëmijëri të vështirë, ose më saktë nuk ka pasur fëmijëri fare, sepse pavarësisht moshës duhet të punonte dhe të mbante familjen. Në shkollë, herë shkonte e herë jo. Punonte ku të mundte për të mbajtur familjen, ndonëse të ardhurat nuk mjaftonin me gjithë ndihmën që i jepnin edhe prindërit e tij. Më vonë iu desh të merrte rrugët e Greqisë krejt i vetëm dhe të bënte edhe atje ç'punë të gjente. Gjendja në shtëpi në atë kohë ishte e vështirë, ndaj iu desh të bënte çdo lloj sakrifice. Babi im është një njeri tepër i fortë me shumë guxim dhe ambicie të madhe. Si ia doli i vetëm pas gjithë këtyre sakrificave? Kur dikush është i vuajtur e sheh familjen e tij pa të ardhura, në varfëri, gjen guxim për gjithçka, ia del mbanë dhe atëherë kur nuk mundesh më, i jep më shumë forcë vetes, sepse bëhet fjalë për familjen. Dhe kur dikush është i drejtë, siç është ai, ka gjithmonë Zotin me vete. Babit tim iu deshën shumë vite të qëndronte larg në emigrim, larg motrave, nënës, babait vëllezërve, dhe pas shumë kohësh edhe mamit, por për të mirën e tyre gjithmonë. Në atë kohë dërgoheshin vetëm letra dhe babi dërgonte gjithmonë të tilla ku i shkruante se ishte mirë. E kam quajtur këtë histori "Fëmijëri e bukur, por më shumë e trishtuar", e bukur se iu desh të punonte që të mbante familjen e tij. Dhe unë personalisht, ashtu si shumë të tjerë, besoj se të punosh për të ardhmen e familjes është një gjë e bukur, por më shumë e trishtuar, sepse nuk pati fëmijëri, atij iu desh t'u blinte motrave dhe vëllezërve kur ishte në Greqi, lodra dhe rroba. Ua dërgonte, por atij nuk i bleu askush lodra, nuk e jetoj fëmijërinë e tij si duhej. Por falë Zotit, falë kurajës së babit tim për të shkuar më përpara dhe për të jetuar si gjithë të tjerët mirë, ia doli. Besoj që çdokush do ndihej krenar për një baba të tillë, edhe pse shpesh trishtohem për fëmijërinë e tij. Por ai sot është bashkë me familjen e tij dhe ne jemi të lumtur si kurrë më parë dhe me një hero si babi im. Faleminderit Babi!

Ballëm Gega 7G

Babi im për mua është heroi im, ai është më i miri në botë dhe jam i sigurt që kështu është çdo baba edhe për fëmijët e tjerë. Unë kam një lidhje shumë të fortë dhe të veçantë me babin.

Babi mua më ka ndihmuar dhe përkrahur gjithmonë. Lidhja jonë si baba e bir është e pathyeshme dhe jam i sigurt se kështu do të jetë gjithmonë. Babi mua më ka ndihmuar e mbështetur gjithmonë, sa herë unë kam pasur nevojë për të. Dhe unë do ta ndihmoj sa herë ai të ketë nevojë për mua.

Babi mua më ka falur shumë dashuri dhe përkrahje dhe unë nuk do të isha sot ky pa ndihmën dhe përkushtimin e tij.

Unë babin tim e dua shumë si dhe ai mua. Do ta përkrahim njëri-tjetrin dhe do të jemi baba e bir, shokë përgjithmonë. Çdo problem do ta kalojmë bashkë dhe çdo sukses do ta arrijmë bashkë. Të dua shumë babi!

Klest Gadeshi 7G



Çdokush ka për hero një Spidermen, një Batman, por unë jo. Heroi im është babi. Mbase ai nuk ka superfuqi, por ama, për mua ai ka gjithë botën.

Ai është i pari njeri që shoh çdo mëngjes. Ai më çon dhe më merr në shkollë. Thjesht nga sytë e mi ai e shikon se si ia kam kaluar. Do të dijë çdo detaj: A jam mërzhitur, kush më ka mërzhitur, nga çfarë jam mërzhitur etj.

Babi më do perfekte, ndaj, më bën dhe vërejtje. Shpeshherë vërejtjet e tij më mërzhisin, më nervozojnë, por përfundimi është i njëjtë: Të jem më e mira!

Babi përpiket të më bëjë të lumtur dhe të m'i plotësojë dëshirat, sigurisht pa e tepruar. Kjo dashuri është reciproke. Ashtu si babi e kupton me një vështtrim që jam e mërzhitur, ashtu e kuptoj dhe unë kur kam bërë diçka gabim dhe kam tejkaluar kufirin. Në vetvete nuk dua ta mërzhis babin, por fjalët dhe veprimet dalin vetvetiu, pa e menduar se çfarë pasojash do të ketë pastaj. Por, kur e rimendoj pendohem dhe dëshiroj ta kthej kohën mbrapa dhe t'i ndryshoj ato fjalë që shkaktuan aq shumë dhimbje në disa fjalë të lumtura që do të jepnin vetëm fytyra të qeshura.

Shumica e fëmijëve janë më të afruar me mamatë. Kjo gjë është krejtësisht normale, pasi mami është ajo që të ka mbajtur 9 muaj në bark, por babai është ai që të bën të qeshësh.

Për mua, edhe babai, edhe mami janë të rëndësishëm dhe nuk duhet të krahasohen asnjëherë me njëri-tjetrin, sepse të dy kanë rolin e vet në zemrat tona. Me pak fjalë, janë heronjtë, udhërrëfyesit, idhujt tanë!

Daris Naska 7G

Që ditën e parë kur kam ardhur në këtë botë, ti ba më ke ndenjur pranë. Fjalët për ty nuk do mbarojnë kurrë sepse për njerëzit unikë ato nuk kanë fund. Ba, e di sesa shumë lodhesh, e di sesa shumë fjalët e pahijshme që njerëzit të thonë të lëndojnë, sepse më lëndojnë dhe mua. E di sesa shumë ti dhe mami keni sakrifikuar për mua, Borën dhe Besin. Ba, faleminderit që ke besuar gjithmonë tek unë dhe që më ke inkurajuar! Ndoshta ndonjëherë mund të të kem mërzitur, por prapë ti më ke qëndruar pranë. Je një nga personat të cilët njoh, që ka më shumë durim, gjithashtu dhe nga më të qetët. Mbaj mend kur isha 3 vjeç dhe ishim me pushime, ti po më mbaje në krahë dhe po lexoje një libër. Ti e di sesa mistreca kam qenë. Syzeve që kishe në kokë atë ditë u the "mirupafshim", sepse unë i rrëzova dhe ti u mërзите, por prapë durove dhe s'the një fjalë. Faleminderit babi që më ke dhuruar dashuri pa limite! Të dua shumë, e vogla jote!

Era Metaj 7G



Sa herë të shikoj ty duke punuar e duke u stresuar pas punës mendoj: "A do të arrij dot unë vallë të jem kaq punëtore e kaq dhënë pas punës sa ti?" Më beso, se nëse do të jem të paktën sa gjysma do të jetë një arritje e madhe.

E di, se tani për tani nuk mund të bëj ndonjë gjë shumë të madhe për të barazuar mundimin tënd për mua, por shpresoj që kur të rritem, ta realizoj sadopak këtë qëllim! Gjithashtu e di se kudo që të jem, çfarëdo që të jem duke bërë, do të gjej gjithmonë mbështetje në shpatullat e tua. Jeta të jep shumë sprova e të bën shumë pyetje, e kur ti përpiqesh të gjeshe përgjigjen, ajo ndryshon pyetjen, por unë jam e gatshme të përballem me çdo sprovë e t'i përgjigjem çdo pyetjeje sepse e di që do të të kem ty përkrah. Nuk të premtoj dot se nuk do bëj gabime sepse ato janë njerëzore, edhe pse unë do jap maksimumin për të mos i bërë, por të premtoj se nuk do i përsërit dy herë të njëjtat dhe se do i ndreq.

Unë gjithmonë synoj të ngrihem sa më lart, e ti me mamin jeni krahët që ma mundësoni këtë gjë. E di se nuk do të këputeni asnjëherë e se unë do të vazhdoj fluturimin për në rrugën e drejtë të jetës shumë e qetë.

Ka shumë filma për fëmijë me superheronj, por ka disa që nuk e kuptojnë se të jesh superhero nuk është nevoja të fluturosh, të ngresh pallate etj. Superhero mund të jesh edhe duke u munduar shumë që njerëzit që ti do, të jenë të lumtur. Dhe shembulli më perfekt i këtij njeriu je ti!

Çfarë ndiej për ty është mirënjohje, mirënjohje dhe vetëm mirënjohje. Kjo letër nuk është kurrsesi e mjaftueshme për ty! Madje dhe një mijë libra dedikuar ty, nuk do të mjaftonin! Gjithsesi unë këtu po e mbyll e po të them: Faleminderit për çdo gjë! Të dua, ba!

Emi Baloshi 7G

Për të gjithë fëmijët, prindërit janë shumë të rëndësishëm, pasi janë ata që na drejtojnë në çdo hap që ne bëjmë. Ata gjithmonë janë aty për ne. Për çdo problem që ne kemi, ata na japin zgjidhjen. Prindërit gjithmonë janë munduar që ne të kemi një jetë dhe një të ardhme të mirë. Edhe pse të dy ata janë të rëndësishëm, unë doja që në këtë shkrim, t'i kushtoj më shumë vëmendje heroit tim, babit tim. Babi gjithmonë ka qenë një hero për mua. Gjithmonë baballarët janë shumë të rëndësishëm për vajzat. Kështu edhe babai im, gjithmonë ka qenë një mbështetje shumë e madhe për mua. Ai gjithmonë është munduar të m'i plotësojë dëshirat. Babi im është shumë kërkues ndaj meje, dhe ndonjëherë mund të kemi dhe debate. Gjithmonë babi im më thotë që asnjëherë mos të dorëzohem dhe se gjithmonë të them që unë jam më e mira dhe asnjëri tjetër nuk duhet të më mposhtë me fjalë negative. Babi është gjithmonë njeriu që më jep kurajë dhe shpresë. Shumë herë ne i kushtojmë këngë, poezi e festa nënave, pasi ato janë krijesat që na kanë sjellë në jetë, por edhe baballarët janë krijesa shumë të shtrenjta për ne. Për djemtë baballarët janë shembulli i parë, ndërsa për vajzat janë dashuria e parë.

Ana Këndella 7G



Unë kam gjithmonë pranë dikë, të cilin e pyes, i marr mendime, i kërkoj ndihmë për situata të vështira. Tek ai gjej forcën, guximin, trimërinë dhe urtësinë në situata dhe marrëdhënie të ndryshme. Ai s'e ngre zërin, vetëm më vështroon dhe unë kuptoj çdo gjë. Prekem nga fjalët e tij të menduara mirë dhe dua në çdo rast të jem si ai. Më pëlqen të jem si babi im!

Jurgen Bokçiu 7G



Kur na kërkojnë që të shkruajmë për prindërit, zakonisht duhet të shkruajmë për mamatë ose për gjyshet. Pse? Nuk është vetëm mamaja që rrit fëmijën. Është edhe babai që duhet të vlerësohet dhe ja pse ne po e bëjmë këtë krijim. Kjo është për babin. Sa herë që dëgjojmë fjalën "hero", mendja na shkon tek ata që shikojmë nëpër filma ose lexojmë nëpër libra, njerëz më aftësi të mbinatyrshme dhe të magjishme, por heronjtë e vërtetë janë ata që na rritin, ata që na mësojnë, ata që na mbështetin dhe janë pranë nesh gjatë gjithë jetës sonë. Prindërit janë ata njerëz.

Që kur kam qenë e vogël, kam qenë shumë pranë prindërve të mi, shpeshherë ikja te puna e babit ose e mamit. E mbaj mend se kur isha në klasë të parë deri në të katërt doja të kisha të njëjtën punë me babin tim. Ai ka qenë dhe është një njeri shumë i zgjuar. Disa herë përsëritja mësimi me të ose rrinim dhe zgjidhnim gjëëgjëza.

Ka disa gjëra që dua të shkruaj. Këto janë disa nga ato:

-Babi, faleminderit që më ke ndihmuar për mësim dhe gjëra të tjera, po ashtu faleminderit që më ke mbështetur gjatë gjithë jetës sime!

Sa herë që dëgjoj fjalën "hero", mendoj për babin tim!

Mei Et-hemaj 7G

Çfarë është babai për mua? Babai për mua është një person i cili ka qenë gjithmonë pranë meje. Më ka dëgjuar kur askush nuk ka qenë aty për mua dhe më ka këshilluar. Ai është si një shok i ngushtë për mua. Ai ka qenë krenar kur unë kam triumfuar, por dhe kur gjërat nuk kanë shkuar ashtu siç duhet, ai prapë është munduar që unë t'ia dilja mbanë. Për shkak të përkujdesjes së tij të madhe, nga një person i thjeshtë, për mua ai është kthyer në një hero. Ai më ka mësuar të jem e fortë dhe të përballoj çdo situatë të vështirë. Çdo fjalë që ai thotë, vlen shumë për mua. Fjalët e gjithë botës nuk do të mjaftonin për të shprehur sakrificat e tij për mua. Kudo ku shkoj dhe dëgjoj fjalën "hero" më kujtohet babai im. Ai ka ruajtur qetësinë dhe gjithmonë ka duruar kur unë nuk jam sjell ashtu siç duhet. Përpijekjet e tij për të më çuar deri në majë të suksesit nuk do të mbarojnë kurrë. Në qoftë se unë një ditë bëhem dikushi në jetë, kjo është vetëm prej babait tim. Nga ajo vajza e vogël që nuk dinte asgjë rreth problemeve të jetës, tani jam një vajzë më e rritur dhe çdo këshillë që më ka dhënë babai im e kujtoj dhe me ndihmën e tyre unë vazhdoj të eci ngadalë në rrugën e jetës. Në zemrën time gjithmonë do të ketë një vend për të, dashuria për të asnjëherë nuk do të shterojë. Për çdo vit që kalon, unë jam gjithmonë e më mirënjohëse ndaj babait tim. Do të jepja gjithçka t'i shikoja të paktën vetëm një herë momentet e kaluara bashkë. Në qoftë se çdo gjë që kemi kaluar bashkë me babain tim do të mblidhej në një histori, për mua ajo do të ishte historia më me vlerë dhe më e bukur në botë. E falenderoj babanë tim që ka dhënë gjithçka, vetëm që unë të isha e lumtur. Të dua shumë babai im i dashur, të premtoj që do të të jap dashurinë dhe qetësinë që ti meriton! Faleminderit që je pjesë e jetës sime! Faleminderit!



Rajla Çulli 7G

Prindërit e mi kanë qenë gjithmonë mbështetës ndaj meje dhe vëllait tim. Babi gjithmonë më ka toleruar për gabimet që kam bërë. Ai dhe mami punojnë shumë që të jetojmë një jetë sa më të mirë.

Ne nuk është se kalojmë shumë kohë bashkë, pasi unë jam e zënë me detyrat dhe testet e shkollës kur ai vjen në shtëpi. Gjatë fundjavave ka raste kur i duhet të shkojë në zyrë për të mbaruar punët e javës. Edhe pse puna i zë shumë nga koha e tij, kur është pushim, përpiqet të rrijë sa më gjatë me ne.

Ka raste kur ne shkojmë me pushime që i duhet të ikë më herët dhe në ditët në vazhdim na merr gjithmonë në telefon për të pyetur se si ia kalojmë.

Kur të rritem dhe të kem mbaruar shkollën dua që ti të jesh krenar për mua dhe për punën që kam bërë. Dua të mendosh se ia vlejti për punën që bëre për të më çuar deri aty.

Duke e lidhur me temën e kësaj eseje mund të them se babi im quhet hero pasi përpijekjet e tij, lodhja dhe besimi i tij ndaj nesh, na ndihmon shumë. Mjafton që ai të jetë një prind i mirë ndaj meje, dhe ai është i quajtur nga unë hero!

Nikol Tushaj 7G

Ti je njeriu më i shtrenjtë në botë. Ti nuk je idhulli im, por heroi im! Pa ty nuk e di se ku do të isha tani. Ti je ai që urren të më shikosh mua të mërzitur, ti çfarë nuk bën për buzqeshjen time. Kur të kam afër, marr shumë guxim. Ti je arsyeja pse unë jetoj. Ti bën shumë sakrifkica për lumturinë tonë. Ti je heroi im!

Santino Etien Bushi 7G



I dashur babi,

Ti je një person i shtrenjtë dhe i dashur për mua. Ti je kujdesur për mua dhe familjen tonë çdo sekond të jetës. Je përpjekur vazhdimisht që të na plotësosh çdo dëshirë dhe kërkesë që ne kemi pasur, duke qenë mbështetja më e madhe e jona. Momentet me ty janë të paharrueshme, pasi ne mirëkuptohemi shumë mirë me njëri-tjetrin. Ti vazhdimisht më këshillon për situatat me të cilat unë përballem, si dhe më mbështet kur unë ndodhem në vështirësi. Por mbi të gjitha ti babi përpiqesh që të më largosh çdo mërzi apo stres që mund të kem gjatë periudhës së shkollës, duke më argëtuar nëpërmjet momenteve që kaloj me ty.

Duke ditur sakrificat që ke bërë për të më rritur dhe edukuar mua, unë po përpiqem dhe do përpiqem gjithmonë që ty të të bëj krenar. Do përpiqem në maksimum që unë të bëhem dikush në jetë, dhe ti babi të krenohesh për mua, duke e thënë me plot gojën: "Ky djalë i talentuar është biri im!"

Festa jote po afron dhe kjo ditë do të jetë një vlerësim dhe shpërblim për punën që ti ke bërë gjatë gjithë vitit.

Të dua shumë, je idhulli im, heroi im dhe do të ndjek hapat e tu për të arritur majat më të larta të jetës!

Rustem Brahimaj 7G



Familja është gjëja më e shtrenjtë që njeriu ka dhe babai zë një pjesë shumë të madhe të jetës sonë, pasi ai gjendet aty kur ne i kemi nevojën.

Kur unë isha i vogël babai im më nxirrte shëtitje. Kur fillova të ecja ishte babai që më mbante për dore dhe nuk më linte të rrëzohesha. Ai luante me mua dhe më mësoi shumë lojëra të bukura.

Ishte babai që më përcolli në shkollë ditën e parë kur fillova klasën e parë. Ai me durim më ndihmonte në përgatitjen e mësimëve. Në vitet në vijim ishte babi, ai i cili më orientoj që të aktivizohesha në sporte të ndryshme si: basketboll, ping-pong, not, tenis etj.

Edhe tani që jam në klasë të shtatë ai vazhdon të kujdeset për mua, më ndihmon sa herë i kërkoj ndihmë. Ai vjen në shkollë sa herë ka mbledhje me prindër për të marrë informacion për sjelljen dhe ecurinë time në mësim.

Gjatë pushimeve verore është babai, i cili na plotëson dëshirat tona për të vizituar vende të ndryshme. Për mua ai është heroi im!

Xhoel Përmeti 7G

Gjithë jetës sime më ka mbështjellë një frymë inspirimi dhe krenarie. Një mbështjellje e fortë që asnjëherë nuk më ka lënë të dorëzohem. Personi që jam lidhur emocionalisht që ditën kur lindi. Njeriu që më ka bërë të jem kjo sot, je ti babi! Je ti, ai që më ke ndihmuar të mësoj të eci drejt rrugës së jetës. Ndërsa ditët e jetës marrin trajta të rrumbullakta ditë për ditë, ti ba akoma nuk e ke bërë një nga këto të marrë një gjendje monotone. Çdo kujtim i errësirës është zhdukur me hapat e fortë të erës. Nuk ke lënë që siluetat të mbizotërojnë në jetën time. Ishe ti, ai që më rriti me modesti dhe prandaj, sot falë teje jam një vajzë e thjeshtë, pa komplekse dhe me mendime të pakomplikuara. Ba, të jam mirënjohëse... por mbi të gjitha të jam mirënjohëse që ekziston në botën time, të madhe a të vogël. Faleminderit që më ke bërë të kuptoj se virtyti vjen me mund dhe nëse dua të kem objektiva duhet që vullneti të jetë krahu im i djathtë. Faleminderit që nuk më ke lënë të bie pre e asaj humnere të errësirës ku hapat e kohës fshihen dhe që kujtimet të jenë një hije e së shkuarës. Frymëzimi im më i madh je ti dhe optimizmi yt. Armiku yt më i madh është dorëheqja dhe me këtë ide më ke rritur edhe mua. Është shumë e vështirë të gjesësh fjalë për të shprehur dashurinë time ndaj teje, sa edhe arkivat më të lashta të gjuhës shqipe nuk mundën. Akoma më vijnë ndërmend lajkat dhe përkëdheljet që merrte princesha jote kur ishte e vogël. Për vite me radhë më kanë thënë se i ngjaj babait tim dhe gjithmonë e kam pritur me shumë krenari. Sot eci rrugëve me kokën lart duke thërritur brenda rruzullit tim "babai im", por jehona ime më përplas e më turbullon duke shtuar "heroi im". Një baba është gjithçka që qoftë një i mitur a i rritur do që të ketë përkrah. Ndër dashuritë e gjithsecilit, ka dhe prej tyre që peshojnë aq shumë, sa fillojnë të ndryshojnë gradualisht, duke të kthyer në një shëmbëlltyrë dashurie. Dashuria për ty babi, është një prej tyre, prandaj ti je gjithë bota ime... heroi im dhe e di që do më ndjekësh në çdo hap të jetës sime deri në frymën tënde të fundit, ashtu sikurse edhe unë të pretoj se do të jem krenaria jote pafund!

Suada Xholi 7G

Baba, nuk e besoj dot se si gjithë këto vite nuk kemi shkruar asnjëherë për ty. Do ta bëj këtë ese duke të thënë falenderime dhe fjalë të shkurtra.

Disa fjalë...

Babai, njeriu më paqësor dhe me i respektueshëm që mund të ekzistojë! Je një njeri që më ndihmon, më respekton dhe gjithmonë më mbron. Asnjëherë nuk më qorton dhe nuk më vë në faj.

Disa falenderime...

Të falenderoj që më ke rritur!

Të falenderoj që më ke ndihmuar!

Të falenderoj që më ke ushqyer!

Të falenderoj që ke hedhur djersën e punës për të më bërë mua një njeri më të mirë!

Të falenderoj që më ke shkolluar!

Të falenderoj që më ke plotësuar çdo dëshirë që unë të kam thënë!

Dëshiroj ta mbyll këtë ese me një shprehje të bukur: "Një baba nuk më tregoi si të jetoja, por më la të mësoja nga ai."

Boiken Nallbani 7G



Babi, shoku im më i mirë! Je figura ku unë shoh njeriun e ndershëm e punëtor, të mençur e të dashur. Ti je heroi im. Ti je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Ti je idhulli im. Çdo moment të vështirë që kam kaluar ti ke qenë aty dhe më ke ndihmuar përherë. Je shembulli më i mirë për mua. Ti më jep forcë për të shkuar në shkollë çdo mëngjes. Jam shumë me fat dhe krenar që të kam, babi im i dashur!

Martin Lipe 7G

Klasat e 8-ta

Babi, ai që mund të zëvendësojë këdo, por që nuk mund të zëvendësohet nga askush. Ai i cili flet me vepra dhe jo me fjalë. Ai, që si drita ndriçoi errësirën dhe me dashuri na bëri të përjetojmë parajsën. Nëse një ditë dua t'i ngjasoj dikujt, do të ishte vetëm ai. Një person i cili luan çdo rol në jetë, por cilëson arritje vetëm rolin më të rëndësishëm e kryesor: atë të të qenit baba. Babai, atje ku mirëkuptimi, dashuria, qetësia, edukimi, durimi përplasen e sa vijnë e rriten, shumohen e shumëzohen. Ah, sa pak fjalë e sa shumë ndjenja për të përshkruar atë më madhështorin, figurën kryesore në jetë, të pazëvendësueshmin baba! Babai, që më ndihmoi të krijoja kujtimet më të paharrueshme, që më ngriti kur u rrëzova dhe me qetësi më ndriçoi rrugën e jetës. Për mua emri 'baba' është një tjetër emër për dashurinë e pafundme, një fjalë drithëruese që përshkruan esencën e jetës.

Adea Xibraku 8A



Për më të mirin tim ...Babai im, unë ty të dua më shumë nga të gjithë. E vërteta është që unë kurrë nuk mund të të ngre në pedestalin që ti meriton, unë nuk jam aq i zoti të thur fjalë për të përshkruar imazhin tënd ashtu si dua. E gjithë dëshira ime është që të të ngjaj ty e të eci nën hapat e tu. Dua të të përqafoj fort e të të them 'Faleminderit!'. Jam i sigurt që në këtë botë çdokush mund të më hedhë tutje, çdokush mund të më zhgënjëjë, çdokush mund të më tradhtojë, por ti kurrë. Ti ke treguar që nuk je si gjithë të tjerët, ti je më i veçanti, je ai njeriu besnik që qëndronte çdo natë tek koka ime derisa mua të më zinte gjumi. Prehëri yt është jastëku më i ëmbël e më i sigurt, ku unë mund të fle i qetë. Je vendi ku unë gjej të vërtetën, je babi im. E di që ka ndodhur që edhe s'ta kam dëgjuar fjalën... Por ti gjithmonë më mban afër vetes tënde, pavarësisht gabimeve dhe zhgënjimeve që merr nga unë. Ti kurrë nuk më largon nga vetja, por më shtrëngon fort, si të jem medaljon i artë. Ti lufton pafund në betejat e mia. Ti more përsipër çdo gjë vetëm që unë të mos prekesha nga asgjë e keqe. Ti je babi im dhe unë do të të dua përgjithmonë.

Ali Ekber Bardha 8A



Ti je ai i cili më ndihmon për gjithçka. Ti je krenaria ime. Kur ti je i lumtur, më bën edhe mua të lumtur. Kur të rritem dua të ndjek shembullin dhe vullnetin tënd. Deri më sot më ke edukuar shumë mirë dhe falë teje jam ky që jam sot. Je arsyeja pse jetoj, gjërat që nuk mund t'ua tregoj shokëve unë i flas me ty. Sado që unë të rritem, ti do të jesh gjithmonë në zemrën time. Të dua shumë, baba!

Esli Baçi 8A

Shumë njerëz e mendojnë idhullin si dikë me një karrierë dhe jetë perfekte. Por shembulli që unë ndjek e do të vazhdoj të ndjek është pikërisht ai që e urren të më shikojë të mërzhitur dhe që më bën gjithmonë të buzëqesh. Është ai për të cilin çdo ditë unë ndihem krenare. Babai im... Një aktor që luan të gjitha rolet në jetë, por që rolin e tij nuk e luan dot askush. Ai është pika ime më e fortë dhe ajo më e dobët, autori dhe protagonist i ditarit të jetës sime. Dëshira ime më e madhe është t'i ngjaj atij, të ec në hapat e tij dhe të gaboja aq bukur sa gabon ai. Sado që koha të kalojë e sado që të rritem, ai do të jetë mbreti dhe heroi i botës sime, i pazëvendësueshmi baba...

Alisia Bami 8A



Babai... Njeriu që më dha jetën dhe më fali dashuri. Njeriu më i shtrenjtë për mua dhe shembulli që ndjek në jetë. Ndoshta nuk arrij dot t'i shpreh ndjenjat me fjalë, por e di se babai do të jetë gjithnjë i pazëvendësueshëm për mua. Ai është njeriu që më bën të qesh dhe shpatulla ku mbështetem sa herë qaj, personi që mban në këmbë familjen dhe që është gjithmonë aty për mua në kohët e vështira, me pak fjalë ai është heroi im. Falë babait kam arritur këtu ku jam dhe e di se edhe në të ardhmen do e kem gjithmonë pranë.

Eanda Pajaj 8A



Ja, babi, më në fund një letër u bë dhe për ty. Nejse, babi, më pëlqen shumë shprehja që thotë se çdo vajzë e ka një hero dhe ai hero është babai i tyre. Babai është personi që të dëgjon fjalën e parë, që të shikon e të ndihmon ndërsa hedh hapat e parë, që të ngre kur je në vështirësi dhe të jep kurajë. Kur dëgjoj fjalën 'baba' menjëherë më vjen në mend heroi i fëmijërisë sime dhe heroi i së ardhmes sime. Babai ka bërë shumë për mua dhe për vëllanë. Çdo dëshirë, çdo nevojë që kam pasur ai ma ka plotësuar. Baba, unë do të ta shpërblej ty njësoj. E di që dëshira jote e vetme ndaj meje është që unë të jem shumë mirë me mësimet, por unë, baba, do të jap maksimumin dhe të premtoj që kam për të të bërë krenar. Të premtoj që kur të rritem do të jem një person i suksesshëm, ashtu si ti ke dashur që të jem. Babai im është gjëja më e shtrenjtë për mua. Kur jam në vështirësi ai gjithmonë më ndihmon. Ai është si krahu im i djathtë. Ai ka sakrifikuar shumë për mua. Ai më tregon të drejtën dhe të gabuarën. Ai është oksigjeni dhe unë, njeriu që pa, të nuk jetoj dot. Sado që unë të rritem, baba, do të jem gjithmonë ajo vajza e vogël, princesha flokartë dhe ti, baba, për mua do të ngelesh gjithmonë heroi im, sepse çdo baba është heroi i vajzës së tij.

Elia Kondi 8A

Kur dëgjoj fjalën 'baba', më vjen në mendje heroi im. Babai është ai që më ka dëgjuar fjalën e parë, është ai që më ka mbështetur i pari. Unë nuk e dija domethënien e kësaj fjale sa isha i vogël, por me kalimin e kohës e kuptova atë, fjalën më të rëndësishme në botë. Që kur kam lindur e deri tani ti ke bërë gjithçka për mua. Sado që unë të rritem, ti do të jesh gjithmonë në zemrën time. Je arsyeja që unë jetoj. Nuk po e zgjas kaq shumë sepse dashurinë time ndaj teje nuk e shpreh me fjalë, por e shpreh me ndjenja dhe vepra. Dhe, baba, unë do të jem djali që ti dëshiron që të jem. Të dua shumë, baba!!!



Emiljano Brahimaj 8A

Ti je ai i cili më ndihmoi në gjithçka. Ti më jep lumturi dhe gëzim, më jep dije dhe njohuri. Ti je ai që më plotëson çdo gjë, por, me thënë të vërtetën, atë çfarë ke dëshiruar për mua, dhe unë e kam bërë realitet. Kur të rritem do të ndjek shembullin tënd për shumë gjëra. Ti më edukove që të jem një djalë i mirë dhe shembullor. Sot jam këtu prej teje. Falë teje jam një djalë i lumtur, në një shkollë të mirë, me gjithçka rreth meje siç e kam dashur. Nuk po më vijnë shumë ide tani, por mund të them që ti je prijësi im, drejtuesi im, udhëheqësi im, dielli im, drita ime... Baba, ti je JETA ime në këtë botë!



Endi Leka 8A

Baba... Dikush më ka thënë se princi i çdo vajze është dhe do të jete BABAI. Heroi im do të jesh në çdo hap të jetës sime. Babai është ai i cili më ndihmon në rastet e vështira dhe më zgjat dorën aty ku kam më shumë nevojë. Deri më sot kam shkruar vetëm për nënën, por sot erdhi momenti ku edhe ty të të shprehet dashuria e vajzës tënde. Jo shpesh të kam shprehur ndjenjat, por sot në këtë fletë të bardhë dua të hedh të gjitha mendimet e mia, ku fjala kyç je ti, BABAI IM! Je ai që do të vazhdojë të më ndjekë në çdo hap të rrugëtimit tim. Të kam konsideruar gjithmonë si mik e shok të ngushtë dhe të gjitha vajzat do ta kishin zili këtë gjë. Këtë fletë dua që ta ruash dhe ta lexosh edhe në të ardhmen, si një kujtim të vyer nga unë. Do Të Të Dua Githmonë, Babai Im!

Esli Bano 8A



Me të vërtetë për të tjerët heroi ose idhulli është një futbollist apo dikush i famshëm, por për mua je ti. Ndoshta nuk më beson, por unë gjithmonë kam ndjekur hapat e tu. Ditë për ditë punon për familjen tënde dhe për mua, prandaj unë po them ç'është e drejtë dhe çfarë ti meriton. Ti je më i shtrenjti dhe më i miri. Je shumë i rëndësishëm për mua. Shpresoj që një ditë të të shëtis unë me makinë, siç më shëtiti ti sot mua.

Tedi Jupi 8A

Shoqëria ku jetojmë është bërë shumë sipërfaqësore e i mungojnë idetë e reja e origjinale dhe vetëm një njeri në jetë na ndihmon dhe na këshillon për çdo problem, sado të vogël, dhe për jetën. Unë personalisht ia dedikoj gjithë gjërat që kam arritur deri tani babait tim, sepse në të vërtetë është merita e tij. Kur kam qenë i vogël, ai bënte çdo gjë që të më bënte të lumtur, madje dhe gjëra që nuk duhej. Ashtu si kam dëgjuar nga familjarët e mi, kur kam qenë pesë vjeç, bashkë me familjen kishim shkuar për pushime në Sarandë dhe një natë unë isha shumë sëmurë. Babai im nga meraku doli në dy të natës dhe nga s'kërkoj për të blerë një ilaç. Kur fillova futbollin, unë mendoja se nuk do t'ia dilja dot që të merresha edhe me shkollën, edhe me sportin, por babai më mbështeti.

Babain tim nuk e konsideroj vetëm si baba, por edhe si shok të ngushtë. Unë nuk besoj që heronjtë janë të vërtetë, por di që një hero është i vërtetë dhe ai është heroi im, Babai Im.

Franklin Shehu 8A



Heroi im, modeli im në jetë, udhërrëfytyesi im. Ti je ai që më ndihmoi të ecja, ai që më mësoi të flisja, ai që më ngriti kur rrëzohesha, teksa më mësoje biçikletën. Ti je shembulli që dua të ndjek në çdo hap që bëj në jetën time. Kurrë nuk mund të të falenderoj aq sa meriton ti. Gjithmonë më je gjendur afër kur më është dashur ndihmë dhe kurrë nuk ke refuzuar, sado i lodhur të ishe. Babai është ai njeri që nuk do të vinte interesat e tij vetjake para dëshirave të birit të tij. Ai do të ishte në gjendje që të gjente mënyrën e duhur, që dëshirat e fëmijës së tij të plotësohen dhe ai të kënaqet, por jo me tepri. Por çfarë kuptojmë me fjalën "baba"? Kjo fjalë nënkupton mirësinë, sakrificën, ndihmesën dhe dashurinë që ky person i dashur i transmeton fëmijës së tij, duke i dhënë atij dashurinë e merituar. Si përfundim, dua të them se babai është me të vërtetë heroi im shpëtimar.

Jord Thanasi 8A



Çdo fëmijë e ka të paktën edhe sikur vetëm një hero të parapëlqyer nga filmat vizatimorë, por për mua hero nuk quhet dikush i cili nuk është real, dikush që unë nuk e kam njohur apo takuar ndonjëherë. Hero unë quaj atë, të cilin e dua më shumë nga gjithçka tjetër, ai i cili më ka ndihmuar në çdo moment të jetës sime, që kur kam lindur e deri më tani, dhe ky njeri kaq i shtrenjtë për mua është babai im, në fakt ai është heroi im!

Jugerta Duriçi 8A

Babai është heroi im në çdo aspekt. Ai është shembulli më i mirë që mund të ndiqet nga unë. Ai përbën gjysmën e zemrës sime. Babai është si krahu im i djathtë, i cili më mbështet në çdo moment kur kam nevojë për të. Ai ka marrë përsipër sigurinë time, duke më mbrojtur sa herë që kam dhe do të kem nevojë. Dëshira ime më e madhe është të kem sadopak suksesin që ka ai në jetë. Babai nuk është thjeshtënjëri që më rriti, ai është shoku im më i ngushtë. Është një fat i madh që kam një baba si ai dhe kur të rritem dua të ndjek rrugën që ai ndoqi, për të vazhduar pjesën tjetër të jetës sime.



Leonardo Ndoj 8A

Shembulli im në jetë... Është zgjedhje e vështirë kur mendon shumë njerëz të suksesshëm, por edhe disa që ti i do aq shumë. Shembulli im në jetë nuk është asnjë person i famshëm. Shembulli im është ai që unë e quaj perandor e mbret. Ai është babai im. Një njeri që ke dëshirë ta njohësh, t'i flasësh, t'i qëndrosh pranë, ai njeri që ti e konsideron si baba dhe si shok, dhe që në rastin tim janë të dyja. Është një njeri madhështor dhe ashtu do të mbetet gjithnjë. Unë e dua dhe vazhdoj ta dua pavarësisht gjithçkaje, prandaj them se asnjë familjar apo shok nuk mund ta zëvendësojë kurrë babanë.



Marsegli Gjeçi 8A

I shtrenjti baba, jam unë ai djalë që ka bërë gabime në jetë dhe kam kuptuar shumë. Ai djalë që bën gjithçka për të të bërë ty krenar për djalin që ke rritur. Ai djalë është krenar për ty, për edukatën dhe kulturën që i ke dhënë, si dhe për dashurinë që i ke falur. Gjithë jetën tënde po punon për familjen, pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na u përgjigjur për të gjitha nevojat që kemi, duke na plotësuar të gjitha kushtet. Babi im, kam shumë fjalë për të të thënë. Të dua shumë dhe jam shumë i kënaqur, i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti!



Marvin Bylyku 8A

Një falenderim për ty, Baba...
Njeri i dashur je ti, baba.
Punëtor më je, sa më s'ka!
Njeri që bën çdo gjë për mua,
bën gjithçka që unë dua.
Ti je hero për mua!

Je njeriu më i mirë për mua, prandaj unë kaq shumë të dua.
Ti baba je besnik, andaj të kam si mik.
Faleminderit që më do!
Faleminderit që ekziston!

Mersin Kasemi 8A

Babai im nuk është vetëm heroi im, ai është shembulli më i mirë për mua. Më qëndron pranë kur unë jam në vështirësi, më ndihmon dhe përpiqet që të m'i plotësojë dëshirat. Unë jam shumë i lumtur që kam një baba të tillë, edhe pse ai ndonjëherë më qorton. Ndonjëherë babai im përpiqet t'i bëjë të tjerët të lumtur me aq mundësi sa ka. Jo vetëm babai im, por edhe gjyshi im ka një karakteristikë të tillë. Babai im ka vetinë të komunikojë me të gjithë. Unë dua që të ngjasoj me të në shumë karakterista të tij. Ai ka bërë arritje në jetë. Ai gëzohet kur unë bëj një vepër të mirë, qoftë me futbollin, me shtëpinë apo shkollën. Më vjen shumë keq për ata që nuk kanë baba, një njeri të cilit mund t'i besosh plotësisht, një person i cili kërkon më të mirën për ty. Jam i lumtur që kam një baba si ai. Shpresoj të jem një baba i tillë kur të kem familjen time.

Nicola Çekrezi 8A



Babai im, ç'është ai për mua? Në radhë të parë ai për mua është një shok i ngushtë. Ai është idhulli im dhe kur të rritem, si ai do të bëhem, si babai im. Në çdo moment të jetës sime ai më ka qëndruar pranë dhe kur kam pasur më shumë nevojë për të ai ka qenë aty për mua. Unë jam njeriu që do të ndjekë hapat e tij dhe me gjithë zemër dua të bëhem si ai. Shembulli im është ai. Mbrojtësi im është ai. Edhe gjëja më e shtrenjtë në botë për mua është ai, shoku im i ngushtë, babai im!

Rajan Subashi 8A



Babai im është një njeri si asnjë tjetër. Ai më dha jetë, më ushqeui, më mësoi, më veshi, luftoi për mua, më mbajti në prehër, me bërëtitë, më puthi, por më e rëndësishmja: më dhuroi dashuri pa kushte. Ti je dhe do të vazhdosësh të jesh një ndër njerëzit më të rëndësishëm për mua. Thellësia e dashurisë tënde kuptohet në sytë e mi. Dashuria e përhershme për ty, angazhimet e mbajtura dhe premtimet e paprekura, një emocion që askush dhe asgjë nuk mundet ta fshijë, themelet që ndërtohen në më shumë se vetëm ato që thuhet, këto më bëjnë të kuptoj dhe besoj se ti je njeriu, modeli atëror që çdokush do të donte ta ndiqte. Fjalët për të përshkruar sa i rëndësishëm je, nuk mbarojnë. Ti je influencuesi më i fuqishëm tek unë... Të dua, Babi!

Uarda Xhaferaj 8A

I shtrenjti baba, si ta nis kur as fjalë s'ka për ta përshkruar dashurinë time për ty? Ti je ai që më ka bërë për të qeshur kur kisha lotë në sy, ai që më ka ndenjur afër në çdo çast. Babi, ti je miku im më i mirë. Nuk ka njeri që mund të krahasohet me ty. Ti je arsyeja që jam këtu ku jam sot. Mundohesh për ne pareshtur. Shpresoj që kjo letër të jetë një nga kujtimet më të bukura për ty, Baba! Çdo fëmijë do ndihej i lumtur për një baba si ti, ashtu si ndihem dhe unë. Kam akoma edhe më shumë për të thënë, por më duhet ta mbyll këtë letër. Të dua, babi...

Uena Çaushaj 8A



Babai im është gjëja më e shtrenjtë për mua. Kur jam në vështirësi ai gjithmonë më ndihmon. Ai është si krahu im i djathtë. Ai ka sakrifikuar shumë për mua. Ai më fal shumë dashuri dhe më mbron nga çdo gjë. Nuk mund të përshkruhet me fjalë sa shumë vlerë ka babai im për mua. Ai më fal dashurinë më të madhe në botë. Ai më tregon të drejtën nga gabimi. Ai është si uji dhe unë jam peshku, nuk mund të jetoj dot pa të. Ai bëhet delfini dhe më mbron nga peshkaqeni. Që kur kam lindur, bashkë me mamane, më kanë ndihmuar të bëhem ky që jam tani. Ato kritikant që ai më bën janë vetëm për të mirën time. Ato do të më ndihmojnë që mos bie sërish në të njëjtat gabime dhe të shkoj drejt një të ardhmeje më të suksesshme.

Albri Kasmi 8B



Dedikuar babait... Unë nuk jam aq e zonja sa t'i shpreh ndjenjat në këtë letër. Dua të të them faleminderit për çdo gjë që ke bërë dhe çdo gjë që vazhdon të bësh. Në këtë botë të zymtë çdo gjë është e rrezikshme, por jam e bindur që ti do të më mbrosh gjithmonë, sepse ti je heroi im. Po rritem në mes të mirash dhe kjo meritë të takon vetëm ty. Asgjë nuk mund ta mohojë që unë jam fotokopja jote. Jam si ty, jo vetëm në pamje, por edhe në shprehjet e fytyrës. Mënyra se si sillemi, në të vërtetë është e çuditshme. Ti babi e di se dy pole shtyhen, prandaj unë dhe ti konfliktohemi shpesh, por ti e di sa të dua dhe kjo nuk mund të vendoset asnjëherë në dyshim. Kur të rritem babi dua të jem si ty, po aq punëtore, po aq këmbëngulëse, po aq e përlulur sa je ti. Krenaria nuk ka vend te ti dhe për këtë unë ty të adhuroj. Të kujtohet, o ba, që kur isha e vogël gjithmonë më thërrisje biri im dhe jo bija ime? Ti më konsideroje si djalin tënd, si një djalë kokëfortë që të ngjante vetëm ty, e njëjta gjë edhe sot. Unë jam "djali yt" dhe do të jem "djali yt" në përjetësi. Koha që kaloj me ty, o ba, më pëlqen shumë dhe e çmoj shumë. Dua që këto kohë të mos përfundojnë kurrë...

Ana Dumani 8B

Babi im, shoku im më i mirë, të dua shumë. Ti bashkë me mamin më keni ndenjur pranë në çdo moment të jetës sime. Më kujtohet kur unë bëja gabime apo rrëmuje, kur mami më bërtiste dhe ti më qeshje apo kur bëje video dhe unë nuk mërzhitesha. Po kur vija dhe të zgjoja në mes të natës sepse kisha frikë të flija vetëm? Ose kur ti nuk vije dhe unë filloja të qaja dhe ti detyroheshe të vije, sepse s'kishte rrugë tjetër. Mbaj mend kur ti shkove në Gjermani një herë dhe unë isha akoma e vogël, më mori shumë malli atëherë dhe nuk më zinte gjumi pa një bluzë tënden. Natën e përqafoja dhe më dukej sikur ishe aty. Babi... një nga fjalët që kam thënë për herë të parë dhe që nuk do ndaloj së thëni asnjëherë. Ti ishe dhe do të jesh gjithmonë aty për mua dhe dua të të falenderoj... Faleminderit që më ke ndihmuar gjithmonë e për çdo gjë; kur rrëzohesha më ndihmoje të ngrihesha, kur mërzhitesha më gëzoje dhe më thoje që të mos mërzhitem për asgjë, kur qaja më bëje të qeshja me shakatë e tua ose thjesht duke bërë fytyra të çuditshme, kur nuk krihja dot flokët dhe bëhesha me nerva, ti me qetësi merrje krehërin, qeshje dhe filloje të më krihje flokët. Më ke mbrojtur gjithmonë dhe e di që do të vazhdosh ta bësh gjithmonë, pasi ti je heroi im, shoku im më i mirë dhe gjithmonë do të jesh i tillë, sepse askush nuk e zëvendëson dot vendin që ti zë në zemrën time. Çdo baba është mbret për vajzën e tij dhe e njëta gjë për vajzat të cilat janë princeshat e tyre... Të dua dhe do të të dua gjithmonë...

Anejda Llazari 8B



Gjithandej shikojmë vlerësime për disa gjëra që ne i konsiderojmë mjaft të shtrenjta në jetë, që nga atdheu, liria e deri tek nënat. Nuk them që këto gjëra nuk kanë vlerë, por ne të gjithë duhet të dimë të vlerësojmë bekimet e tjera në jetët tona, pa të cilat nuk do të ishim asgjë. Një prej këtyre është pa asnjë dyshim babai, figura atërore e cila është e domosdoshme për një jetë të bukur e një formim të mirë. Harrojmë se sa me vlerë është ai, i cili përpiqet me mish e me shpirt për mbarëvajtjen e familjes. Harrojmë që është personi më i durueshëm, e që na e do të mirën me një sinqeritet totalisht të pastër. Shpeshherë është një person nga më të rreptit, por ne nuk arrijmë t'i kuptojmë veprimet e tij. Harrojmë që çdo veprim i tij, sado i padrejtë që të na duket, nuk është asgjë tjetër përveçse një synim për të mirën tonë. Ai është heroi ynë i vërtetë, por që kurrë nuk pret vlerësime nga ne. Është ai që përherë qëndron në prapaskenë e nuk pret asnjë shpërblim për gjithë sakrificat e tij. Është arsyeja pse çdokush ka arritur aty ku është tani, dhe ne duhet të dimë ta vlerësojmë këtë element vital në jetët tona. Mjafton t'i falim pak dashuri e ai na fal botën.

Evjol Goga 8B

Këtë shkrim ta dedikoj ty, i shtrenjti babi im. Ti ke qenë gjithmonë hero për mua dhe do të mbetesh i tillë. Mund të përmend këtu, që ke filluar punë që i vogël për të ndihmuar familjen tënde apo sakrificat që ke bërë gjatë rrugëtimit të jetës tënde. Dua të flas për këto momente, sepse tani s' të kam më. Momentet e bukura dhe sakrificat që ke bërë për ne janë ngulitur në mendjen dhe zemrën time. Më mungon jashtë mase, më mungon buzëqeshja jote, puthjet e tua, zëri yt, zënkat tona, më mungon ti... Më kujtohen momentet e fundit, ku si gjithmonë na flisje e na mësoje të bëheshim të ndershëm, të zotët e vetes etj. Babi, ti ke punuar e je munduar aq shumë për ne, sa edhe tani që nuk je, ne jetojmë me të ardhura të mira. E ke arritur me mund e dërsë gjithçka e për këtë të admiroj. Dua të të ngjaj ty, heroi im. E gjithë dëshira ime është të të ngjaj ty, të eci në hapat e tu, të gaboja aq bukur sa gaboje ti. Do të doja të të përqafoja fort tani, shpresoj të jesh duke më parë teksa shkruaj këtë letër për ty. Babi, ti për mua vlen më shumë se çdo gjë. Të dua shumë, heroi im.

Bianca Burimi 8B



Shpesh momenti më i gëzueshëm për mamatë është dita kur dëgjojnë fëmijën e tyre të thërrasin "mama", por në familjen time ndodhi ndryshe, ishte babai ai që e fitoi këtë gëzim.

Shpeshherë njerëzit kanë idhuj aktorë ose lojtarë futbollit, por idhulli im që në fëmijëri ka qenë babai im. Sa herë që kam pasur ndonjë problem ose gëzim ke qenë personi i parë që më ke dalluar. Ke qenë gjithmonë pika ime e fortë, por ndonjëherë dhe ajo e dobët. Je një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Gjithmonë ke qenë udhëheqësi im në rrugën e drejtë, por gjithashtu ke qenë dhe shoku im më i ngushtë. Më ke ndihmuar gjithmonë, pa kërkuar ndonjë gjë në shkëmbim. S'kanë fund kujtimet dhe momentet që kemi kaluar bashkë. Ke qenë gjithmonë aty për mua kur kam pasur nevojë. Më ke qëndruar gjithmonë pranë për të më lavdëruar dhe kritikuar.



Hygen Amoniku 8B

Babi, je njeriu që unë dua të marr për shembull kur të rritem. Je frymëzimi im. Kur të rritem dua të bëhem si ti. E di që këto fletë nuk mjaftojnë për të shprehur dashurinë që ndiej për ty, por një gjë e them me siguri: Faleminderit që je babai im! Kur kujtoj fëmijërinë time, i pari që më vjen ndërmend është babai im.

Babai im, ti je i gatshëm të më dëgjosh çdo herë e për çdo problem që mund të kem dhe për të më plotësuar çdo dëshirë që kam. Ti mundohesh që të më mësosh cilësitë më të mira që një njeri mund të ketë, kështu që faleminderit që më ke sjellë këtu ku jam.

Ledio Lala 8B

Babai, figura e parë që më shfaqet para syve kur mendoj një person trim, të dashur, të kujdesshëm, hero, që do të jepte gjithçka e do të luftonte çdo vështirësi për lumturinë e njerëzve të tij të dashur, e kurrë nuk do t'i linte ata në baltë.

Babai gjithmonë më është gjendur pranë: në çdo gëzim e çdo hidhërim, në çdo fitore e çdo humbje, në çdo rënie e ngritje të jetës sime. Është gjendur aty për buzëqeshjen e parë, për të dëgjuar fjalën e parë, për të qenë një mbështetje në hapat e parë dhe një mbështetje për gjithë jetën.

Babi, më fal për çdo gabim që kam bërë, më fal për çdo fjalë a vepër që pa dashur të ka lënduar, më fal që ndonjëherë nuk e kam kuptuar që pas çdo qortimi ka qenë e fshehur dashuria dhe përkujdesja e madhe që ti ke për mua. Jam penduar për të gjitha këto kur kam parë vështrimin në sytë e tu. Një vështrim, të cilin nuk kam fjalë për ta përshkruar, vështrimin më të veçantë që më kanë zënë sytë. Si vështrimi yt nuk ka të dytë në botë.

Të falenderoj nga thellësia e zemrës që më udhëheq gjithmonë drejt rrugës së drejtë, që kujdesesh për mua pa menduar për lodhjet dhe shqetësimet e tua! Të falenderoj që më do pa kushte e kufij!

Jam krenare që jam vajza jote, babi, vajza e një hero!

Iljona Hysenaj 8B



Familja për mua është gjithçka, por babai është hero i im. Babai nuk më lë asnjëherë në baltë dhe më mëson gjithmonë, por mbi të gjitha më përgatit për jetën.

Lukas Heidorn 8B



Ku ka gjë më të shtrenjtë sesa babai im, i cili më lumturon me praninë e tij, më ndihmon në rastet kur kam më shumë nevojë dhe gjithmonë është i gatshëm të më ndihmojë, pa më kërkuar diçka në këmbim dhe duke më dhënë atë buzëqeshjen aq të ëmbël, që unë gjithmonë e kërkoj. Ai është njeriu që më do shumë dhe gjithmonë kërkon maksimumin nga unë. Babai im është ai që do bënte gjithçka që unë të isha më i sigurt dhe të arrija objektivat e mia, duke shkuar gjithmonë e më lart.

A ka njeri tjetër në botë që të do më shumë se prindërit e tu? Epo, përgjigjja është një "Jo" e madhe, pasi prindërit, në këtë rast babai, të do më shumë nga gjithë të tjerët dhe do të ishte i gatshëm të bënte gjithçka për mua, në mënyrë që të arrij objektivat që të jem "dikushi" në jetë dhe të lë një gjurmë të madhe në të.

Babai është ai njeri që nuk do të vinte interesat e tij vetjake para dëshirave të birit të tij. Ai do të ishte në gjendje të gjente mënyrën e duhur, që dëshirat e fëmijës së tij të plotësohen dhe ai të kënaqet, por jo me tepri. Fjala "baba"... Kjo fjalë nënkupton mirësinë, sakrificën, ndihmesën dhe dashurinë që ky person i dashur i kumbon fëmijës së tij, duke i dhënë atij dashurinë e merituar. Si përfundim, dua të them se, babai është me të vërtetë hero i im shpëtimtar.

Mario Topulli 8B

I dashur Babi, shpresoj që kjo letër të jetë një nga kujtimet më të bukura për ty. E bëj këtë gjest edhe pse çdo ditë të shoh, por më pëlqen të shprehem nëpërmjet fletës.

Prandaj doja të të thoja që të dua shumë e je njeriu i parë ku mund të mbështetem dhe krenaria e shpresa ime. Nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty.

I dashur babi, unë të kam treguar në çdo moment që të dua pafund, por sot do doja të të thoja diçka të veçantë e të mbushur plot dashuri. Çdo fëmijë do të ndihej i lumtur nëse do të kishte një baba si ti, ashtu siç ndihem dhe unë. Çdo ditë e jetës sime ka qenë e lumtur dhe vazhdon të jetë e tillë. Energjitë e tua janë të pashtershme, nuk më ke thënë kurrë jo, ose që ndiheshe i lodhur dhe të falenderoj për këtë gjë. Unë tani jam e rritur dhe e kam kuptuar që jeta jote ka qenë e mbushur me sakrifica, por falë besimit, punës dhe aftësisë tënde ke arritur këtu ku je sot. Uroj që të jetosh sa më gjatë dhe i lumtur në këtë botë. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, për mbështetjen, buzëqeshjet, faleminderit që më bën të kaloj çdo ditë me lumturi e buzëqeshje. Faleminderit që ekziston! Mos harro se sa fort të dua Babi!

Mejla Hoxha 8B



I shtrenjti baba, me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti. Je heroj im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si një busull drejtuese për mua. Je kritiku që më ka frenuar pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë e që më bën të mos gaboj kurrë në jetë. Gjithmonë do të ndihem krenare për ty. Je babai ideal për mua. Jam unë vajza jote e parë. Ajo vajzë që kur ka bërë gabime në jetë ka kuptuar shumë. Ajo që bën gjithçka që të ndihesh krenar për vajzën që ke dhe që rrit. Të falenderoj për edukatën, kulturën dhe dashurinë që më ke dhënë. Gjithë jetën tënde po punon për familjen, duke punuar pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na plotësuar të gjitha nevojat që kemi, duke na dhënë të gjitha kushtet. Babi, kur unë të dal të punoj, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh dy fëmijë, çdo të thotë të japësh dhe të marrësh nga jeta dhe çfarë do të thotë familje. Babi im, ka shumë fjalë për të të thënë... Të dua shumë dhe jam shumë e kënaqur, e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti. I shtrejtji baba, ti je gjithçka për mua.

Nicole Guri 8B

I dashur babi im, po ta dërgoj këtë letër, sepse kam dëshirë të të falenderoj për gjithçka ke bërë për mua. Dëshiroj të të falenderoj për sakrificat që ke bërë për mua. Dua të të falenderoj që më je gjendur pranë gjithmonë, sa herë ta kam pasur nevojën. Faleminderit që m'i ke plotësuar tekat e mia. Dua të të them se je gjëja më e shtrenjtë për mua. Je forca ime, çdo gjë mund të më ndodhë, por derisa do të të kem ty pranë, çdo gjë do e kaloj. Sepse me ty jam më e fortë, më e mirë, më e dashur, ti je frymëzimi im! Çdo gjë në botë të më jepnin ty nuk do të të ndërroja kurrë. Në çdo situatë që kam kaluar, gjithmonë ma ke mbështetur mendimin. Ti je një nga njerëzit që e di që do më përkrahin, çfarëdolloj gjëje të bëj, sepse e di që ti më beson dhe asnjëherë nuk do të largohesh. Je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën time të jetës. Të dua shumë.

Paula Xho Vilajeti 8B



I dashur baba,

Ti je gjithçka për mua, ti je udhërrëfyesi im. Ti më jep vetëbesim që të ec përpara në jetë. Ti je shoku im më i mirë dhe jam shumë me fat që pata mundësinë të të takoja, pasi në këtë botë ka njerëz të cilët nuk kanë fatin që ta takojnë babanë e tyre. Edhe kur ndodhin keqkuptime mes meje dhe të tjerëve, ti je ai që më qëndron afër, në mënyrë që të sqarohemi sa më shpejt. Kur janë ditët e pushimit, ne të dy dalim gjithmonë jashtë qytetit dhe kalojmë kohë shumë të bukura së bashku. Shpresoj që marrëdhënia mes nesh të jetë e pafundme.

Zhan Toptani 8B



I dashur babi, ti je njeriu i parë që më ke mbajtur në krahë dhe besoj se kjo është arsyeja që lidhja jonë është kaq e veçantë. Që kur kam qenë e vogël, ne rrinim gjithmonë bashkë. Kam dashur gjithmonë të qëndroja me ty, sepse gjërat që bënim bashkë më gëzonin shumë. Ti ke kaluar gëzime dhe vështirësi të ndryshme, por asnjëherë humori yt nuk ka ndryshuar. Sado që mund të kesh pasur ndonjë problem, me mua nuk e ke ndryshuar asnjëherë sjelljen tënde, sepse kur rrije me mua dukej se gjithçka ishte në rregull, sado që nuk ishte e tillë. Ti je frymëzimi im, je njeriu që kam dëshirë të jem në të ardhmen. Mami është shumë me fat që ka gjetur një njeri si ty. Ti mbështet çdo njeri dhe mundohesh të na mësosh edhe ne që një njeri i mirë është ai që ndihmon të tjerët dhe nuk është asnjëherë egoist. Cilësitë e tua janë ato cilësi që unë dua të kem në të ardhmen. Je shumë punëtor dhe jep maksimumin që unë, motra dhe mami të jetojmë një jetë të lumtur dhe pa vështirësi. Gjithmonë më ke trajtuar si shoqen tënde e ke dashur që ti të ishe shoku im më i mirë dhe të siguroj që ti je ai!

Sara Shahini 8B

Babai im...

Një njeri i vështirë për t'u përshkruar me pak fjalë, sepse ai është si një pazëll ku çdo pjesë formon një qenie magjike. Frymëzohem nga ai, nga mënyra se si flet, se si sillet, se si përballet me vështirësitë e jetës. Admiroj mënyrën se si i zgjidh problemet në mënyrë aq praktike, admiroj ambicien e tij, ajo e cila i buron thellë nga zemra dhe që e bën të mendojë gjithmonë perspektivën, të mendojë për ne, për familjen tonë. Ai ka një pamje, e cila të thotë se nuk i përjeton ngjarjet, por ai është një tip aq emocional, i cili preket dhe përjeton çdo gjë, por mundohet që ta mbajë brenda vetvetes. Është një njeri i dashur dhe kjo dallohet që nga sytë, sytë që i shkëlqejnë shumë kur na sheh. Gjithmonë mendon për ne, mundohet të na plotësojë të gjitha kërkesat, dëshirat dhe të na sjellë sa më shumë dhurata. Është një person gazmor, i cili krijon situata komike dhe ajo që më bën përshtypje është se është tërë kohën në mendime, duke u munduar që gjithmonë gjithçka të jetë në perfeksion. Është i apasionuar pas dokumentarëve dhe le të themi se ai më ka krijuar edhe pasionin për historinë. Është një njeri, i cili punon fort për atë që do dhe është shumë këmbëngulës. Përveçse ka krijuar pozicionin e prindit, babi mundohet edhe të jetë një shok i mirë, me të cilin mund të bisedoj çdo gjë dhe t'i marr shumë mendime. Ndonjëherë pyes veten si do t'ia bëja pa të, si do ishte bota pa të dhe aty kuptoj se ai është heroji im, sepse bota në të cilën jetoj është krijuar nga ai deri në detajin më të vogël, që unë të kem jetesën më të mirë. Jeta ime pa të nuk funksionon, sepse ai më drejton gjatë rrugës. Kemi një karakter identik dhe ndonjëherë debatojmë për ndonjë gjë të vogël, sepse jemi shumë kokëfortë, por prapë babin e dua shumë dhe sa herë që e përqafoj mendoj me vete se sa me fat jam që kam babin dhe që kam prindërit e mi. Është ai që gjen gjithmonë një rrugëzgjidhje për problemet dhe që më mbështet shumë, por edhe që pret shumë nga unë. Babi im është si një libër historik shumë frymëzuese, të cilat gjithmonë më shtojnë dëshirën për të ecur para. Ai është një person shumë i apasionuar pas udhëtimeve dhe gjëja më e bukur është se nuk udhëton dot pa ne dhe mua kjo më bën të ndihem e veçantë. Babai im është një person, i cili e vlerëson shumë veten dhe të duash veten është gjëja më e mirë tek një person, sepse si rrjedhojë e kësaj vjen përkushtimi për familjen edhe për punën. Babai im formon një barrierë mbrojtëse, e cila do vazhdojë tërë jetën të mbrojë familjen tonë dhe nuk e di se si, por unë thjesht e ndiej atë përkujdesje dhe atë mbrojtje. Mendoj se kjo është veçori e veçantë e baballarëve, të formosh një barrierë e cila na mbron, na mban lumturinë dhe na përcjell përkushtim. Babai im është heroji im, sepse ai ka krijuar themelet e jetës sime dhe do t'i mbajë ato fort me dashurinë që më jep, me përkujdesjen dhe me mënyrën se si e ka zbukuruar, po e zbukuron dhe e di se do të ma zbukurojë jetën time. Të dua, babi im!

Xhoia Mekollari 8B

Babai im, e di që këto fletë nuk mjaftojnë për të shprehur dashurinë që ndiej për ty, por një gjë e them me siguri: Faleminderit që je babai im! Kur sjell ndërmend fëmijërinë time, i pari që më vjen ndërmend është babai im. Babai im është i gatshëm të më dëgjojë gjithmonë, për çdo problem që mund të kem. Babai im ka sy që i ndryshojnë sipas kohës. Ai ecën ngadalë e me trupin drejt dhe nuk e ndryshon ritmin e hapit. Tani më vijnë ndërmend duart e tij që mund të bëjnë çdo lloj pune. Asnjëherë në shtëpinë time nuk shikon një gjë të prishur. Vendi ku ai mban veglat është një dhomë e vogël prapa shtëpisë, por ajo rri gjithmonë e pastër dhe e rregullt. Çdo gjë është vendin e vet. Raftet janë me kuti të sistemuara, që nga kaçavidat e deri te trapanet. Ai ka një sens të mirë humori. E shikon gjithmonë duke qeshur e duke bërë shaka. Çdo fëmijë për prindërit e tij thotë fjalët më të mira, si dhe anasjelltas. Në përgjithësi djemtë mendojnë më shumë për babanë. Thjesht fare, fjala 'baba' për mua ka një kuptim tepër të gjerë. Atë nuk do ta harroj kurrë, pasi është ai që më ka qëndruar dhe më qëndron pranë, në ditë të këqija e të mira.



Alteo Malaj 8C

Heroi im është babai im, pasi unë atë e ndjek në çdo hap, sepse kam dashur gjithmonë të bëhem si ai. Ai ka qenë gjithmonë aty kur kam pasur nevojë për të. Ai ka qenë gjithmonë aty për të më korrigjuar e për të më treguar rrugën e drejtë, kur unë bëja një gabim. Ai nuk ka përtuar kurrë t'i përgjigjet pyetjeve të mia kur unë isha kurioz a nuk kuptoja diçka. Ai për mua ka qenë gjithmonë figura më e drejtë dhe e ndershme, prandaj ai është hero i im. Ai më do shumë dhe do të sakrifikonte shumë për mua. Prandaj unë dua t'i kushtoj atij këtë tekst të shkurtër, për t'i treguar se sa e vlerësoj dhe e dua, për t'i thënë se ai është i pazëvendësueshëm për mua.

Albi Malko 8C



Babi, të dua shumë dhe duhet ta dish këtë. Je gjëja më e shtrenjtë në jetën e fëmijës tënd. Që kur u linda, ti ishe aty me lot gëzimi në sy, sepse ishte hera e parë në jetën tënde që u bërë baba. Dua të të falënderoj që më ke rritur në mënyrën e duhur, duke më bërë personin që jam sot. Sa herë kam nevojë për ty, ti je atje për të më mbrojtur. Faleminderit që më ke mbrojtur nga të tjerët dhe faleminderit që më ke qëndruar pranë gjatë gjithë këtyre viteve, duke bërë të mundur edukimin tim. Me gjithë këtë mund, ke rritur një djalë që është si imitimi yt, por në versionin 13-vjeçar. Sot është dita jote dhe e gjithë baballarëve të tjerë anembanë globit dhe unë dua ta shijosh këtë ditë sepse ke bërë një punë të mrekullueshme 13 vite me radhë, duke rritur kështu një djalë të mrekullueshëm. Të falënderoj që e ke bërë jetën time të ketë kuptim.

Arkel Nervaj 8C

Është çuditërisht e zakonshme që përgjigjja e pyetjes "Kë admiron ti?" apo "Hapat e kujt do të ndiqje?" të ishte babai. Fëmija nuk e percepton të atin si një person me fuqi të mbinatyrshme, por si një person të veçantë, në sajë të vlerave dhe influencës që ai jep tek ne. Kjo gjë e bën babain heroin e fëmijës së tij dhe ngjall një potencial ngjashmërie tek fëmija. Aspekti që marrim ne nga babai ynë është disiplina e punës, dashuria dhe ngrohtësia që ai jep në çdo fjalë që thotë dhe si shigjeta ato fjalë përshkojnë ndjenjat tona. Babai për fëmijën është si një libër gjigant, që nuk mund të klasifikohet me zhanër, është fragmenti kryesor i jetës sonë, udhërrëfyesi i parë dhe më i rëndësishëm. Ai është dora që shtrihet për të ndihmuar, sakrifica e bërë për ne, shpatulla e gjerë e mbushur me të qarat dhe të qeshurat tona, është ajo që ne shikojmë në të ardhmen dhe kur ajo ditë të vijë, ne do të kemi një buzëqeshje në fytyrë dhe lot në sy, sepse do të jemi bërë si ai, si Heroi ynë.

Bestjan Mamo 8C



Fjala e parë në jetën e çdo fëmiu,
je ti, baba.
Dashuria e madhe e çdo fëmiu,
je ti, baba.
Heroi i vajzës tënde gjithmonë,
je ti, baba.
Jorgani i çdo gabimi gjithmonë,
je ti, baba...
Ai që mërzitet për çdo lot që rrjedh,
je ti, baba.
Ai që për lumturinë tonë bëhet lumë që rrjedh,
je ti, baba.
Ai që më bën të guximshme në çdo aspekt,
je ti, baba.
Ai mashkull që çdo herë më flet me respekt,
je ti, baba...

Emiljana Kapollari 8C



Babai është ai që më ka edukuar dhe më ka treguar rrugën e drejtë kur unë kam gabuar. Për këtë arsye unë dua të ndjek hapat e tij dhe të bëhem si ai në të ardhmen, të kem besim në vetvete dhe të jem i drejtë me të gjithë e me gjithçka. Ai është heroimi, për shkak se sillet me mua si të jetë shoku, vëllai dhe babai në të njëjtën kohë, pa asnjë dallim. Ai më ka thënë si të sillem kur kam qenë në gabim, më ka lavdëruar kur kam qenë në rrugën e duhur dhe më ka dhënë këshilla se si të jem akoma më i mirë. Nuk e di ç'të shkruaj. Kam shumë për të thënë, por nuk i shpreh dot. Dua thjesht t'i them babait tim që ai është idhulli im dhe është gjithçka për mua.

Elsajd Hyseni 8C

Çdo fëmijë rritet me një idhull, një njeri që është gati ta ndjekë në çdo veprim, në çdo zgjedhje. Ky idhull për mua ka qenë figura atërore, babai im. Kthehem pas në kohë e shoh në kujtimet e mia veten time, duke u munduar të imitoj babanë tim, duke u munduar të kaloj në hapat e babait tim dhe duhet ta pranoj, jam shumë e ngjashme me të. Por ç'është figura atërore në sytë e fëmijës? Figura atërore, babai, në sytë e fëmijës është njeriu i pagabueshëm, i gatshëm për të ndihmuar dhe porti ku mund të shprehesh e sillesh lirshëm, pa frikën e paragjykitimit. Babai duhet të jetë ai modeli që çdo fëmijë mundohet të jetë, ajo dora që të ndihmon kur ke nevojë dhe e kupton kur ke nevojë për mbështetje. Babai është heroi i çdo fëmije. Heroi që më tregon rrugën e drejtë, më këshillon e më kupton. Jeta ime do të ishte bosh pa ty, do të ishte pa ngjyra dhe do të ndihesha e pasigurt. Me ty pranë meje ndihem e sigurt.

Kur isha e vogël nuk e kuptoja se sa shumë lodheshe ti, baba, duke punuar, duke u munduar të më plotësoje dëshirat e mia të pafundme. Vetëm tani e kuptoj se të gjitha sakrificat që ke bërë kanë qenë për mua, prandaj sot të them: Faleminderit, Heroi Im!

Dea Bonjaku 8C



Prallë herë shkruaj për familjen edhe njerëzit e mi më të dashur, ndoshta sepse ata janë përherë aty, e di që nuk ikin, sado të mërzhiten me mua, ose sado t'i lodh, e di që do jenë mbështetja ime më e madhe.

Ndoshta u zgjata në këtë hyrje përshkrimi ndjenjash për më të dashurit e mi. Më ndjeni, por këto fjalë më dolën nga shpirti që në momentin e parë që m'u kërkua të bëj një shkrim, amator them, për idealin tim, babain tim.

Jo më kot e quaj kështu, ai ka peshën më të madhe në formimin tim si një individ me vlera, ëndrra, qëllime, në një botë ku këto tri gjëra kurrësi s'mund të qëndrojnë bashkë. Edhe ideal për mua, dua të ndjek shembullin e tij, dua të kem suksesin e tij, por më tepër nga të gjitha dua të jem me zemër të bardhë e të bukur si ai.

Nuk e di se sa fjalë mund të përdor për ta përshkruar, por asnjë fjalë nuk mund ta përshkruajë atë ashtu si është, ashtu si e dua unë, ashtu si e ndiej unë veten me të. Fjalët janë shumë pak për këtë përshkrim, po ashtu edhe veprat. Asnjë përshkrim nuk mund ta tregojë atë siç është.

Për çdo fëmijë prindi i vet është më i miri, ashtu siç është më i miri për çdo prind fëmija i tij. Por për mua babai im është më tepër se i mirë, është heroi im...

Emel Ergun 8C



Ti që më ndihmove në ditët më të vështira,
 Ti që më mësove se ç'është e drejta,
 Ti që bërë ç'ishte e nevojshme për mua, për ne,
 Ty të kam idhull, si ty dua të bëhem!
 Eh, me kaq do e mbyll këtë poezi të shkurtër,
 Edhe pse e di që nuk është mjaftueshëm,
 Për të shprehur dashurinë që kam për ty...

Matthew Cano 8C

BABI, Unë kurrë nuk mund të të ngre ty në piedestalin që ti meriton, nuk jam aq e zonja të thur fjalë për ty. Ti punon ditë e natë vetëm e vetëm që të na sigurosh një jetë sa më të mirë. Ndiem shumë krenare kur më pyesin se bija e kujt jam. Ka shumë gjëra për të cilat dua të të falenderoj. Faleminderit që ishe aty që nga dita kur erdha në këtë botë! Faleminderit që je treguar i duruar për çdo gjë! Faleminderit që më fal kur bëj ndonjë gabim! Faleminderit që më këshillon gjithmonë që të bëhem një vajzë sa më e mirë! E di që do jesh gjithmonë aty për mua, sepse ti bashkë me kohën keni treguar që nuk jeni si gjithë të tjerët. Je personi më i veçantë dhe më perfekt që ekziston e kjo gjë nuk do ndryshojë asnjëherë. Ti je mbreti dhe heroi i botës sime, të dua pafund jeta ime!

Fatjola Kërkhaliu 8C



Ka kaq shumë gjëra për të thënë për ty, ama fjalët nuk janë të vlefshme e nuk mjaftojnë për të shprehur ato që ndiej në shpirtin tim. Ti je heroi im. Je hero, sepse ti më jep këshillën e vlefshme për të ardhmen time, më edukon ashtu siç duhet dhe mbi të gjitha më dhuron dashuri pafund. Babi, ti je shembulli më i mirë, shembulli që do të ndjek gjatë gjithë jetës. Në çdo moment të lumtur dhe në çdo vështirësi ti ndodhesh aty për të më dhënë mbështetje, duke qenë busulla ime drejtuese.

Nga ti kam mësuar shumë gjëra, më ke dhënë shumë mësim, më ke mësuar si të vazhdoj të eci përpara, pavarësisht çdo gjëje.

BABI më i mirë në botë, ti je thesar për mua! Në të ardhmen uroj të ndihesh krenar për mua, ashtu siç ndihem unë krenare që jam vajza jote.

Jona Hurdha 8C



Babai im është një person shumë i rëndësishëm për mua. Ai nuk është vetëm një baba. Është gjithashtu dhe një shok shumë i mirë për mua. I jam shumë mirënjohës për gjithçka që ka bërë për mua. Për çdo sakrificë të tijën, për të më mundësuar të gjitha të mirat e mundshme. Përveçse një shok i mirë, është një baba shumë i përkushtuar ndaj familjes. Na është gjendur gjithmonë pranë, sa herë që kemi pasur vështirësi dhe kjo është një cilësi që jo çdo baba e ka. Është një person shumë i përkushtuar ndaj punës, për të cilën ka dhënë gjithmonë maksimumin, pavarësisht se jeta e ka përballur me shumë vështirësi. Ai nuk është dorëzuar kurrë dhe sot ai është një politikan shumë i suksesshëm dhe gëzon respektin e shumë njerëzve, duke u treguar gjithmonë i drejtë dhe duke mos bërë asnjëherë dallime. Prandaj këto janë cilësi që jo të gjithë i kanë. Nuk do të njoh kurrë një person më të mirë se ai.

Kristian Ndreu 8C

Për ty, Baba...
O Baba, heroi im...
Sa herë kam nevojë, ti më mbron.
Ti je fantastik,
Për të qenë si ti e kam ëndërr nën jastëk!

Ti je mbështetje për çdo gjë,
Pa ty nuk bëj dot asgjë,
Je aty gjithmonë kur kam nevojë,
Pa ty dot nuk rroj.

Gjithmonë nga ty kam dalë i fituar,
Pa ty nuk kam fuqi as për t'u zgjuar,
Sa herë rrëzohem, ti më ngre prapë,
Ti je me mua në çdo hap!

O baba, o heroi im...
Ti më ke mësuar se çdo humbje e ka një fitim.
Je i veçantë dhe i pazëvendësueshëm,
Nuk kam parë në botë njeri më të besueshëm!

Kristian Nela 8C



Babai im është shumë bujar, njeri me zemër dhe heroi im. Ai dëshiron të më bëjë një njeri të mirë në jetë dhe një person të suksesshëm. Ai është personi që gjithmonë ndihmon njerëzit në nevojë, në shoqëri ose kudo në rrugë. Babi im nuk nguron të ndihmojë të tjerët, kur sheh që kanë nevojë për ndihmë. Më mëson se si të fitoj, të jem e drejtë, si të jem person paqësor gjatë gjithë jetës. Ai është krahu im i djathtë. Babi më gjendet pranë gjithmonë kur jam në vështirësi. Prindërit e mi, kryesisht babi, më tregojnë gjithmonë që unë duhet të kërkoj te njerëzit të bukurën dhe jo të keqen.

Ai është këshilltar i mirë në familjen time. Unë me vëllanë marrim këshilla nga ai sa herë që kemi probleme. Babi im është person shumë i dashur dhe i përkushtuar. Ai mbështet vendimet e mia dhe më këshillon kur duhet të bëj diçka dhe nuk jam e sigurt. Babi më ndihmon në përgatitjen për shkollën në kohën e duhur. Mua dhe babit na pëlqejnë shumë librat, ndaj kur kthehet nga puna, shpeshherë ai më blen libra të ndryshëm për t'i lexuar e më pas i diskutojmë. Babi im është njeriu më i shtrenjtë për mua dhe unë e dua shumë.

Megan Xhaxhi 8C

Për personin të cilin e dua dhe e vlerësoj shumë!

Ti je ai që më ke mbështetur për çdo vendim që unë kam marrë.

Ti për mua je si një burim dashurie dhe mirësie, i cili ka aq shumë dashuri për të dhënë dhe mirësi për të shpërndarë. Ti më ke mësuar që unë të jem e ndershme dhe e drejtë, por më shumë të jem një njeri shpirtmirë dhe i dashur. Ti je dhe do të jesh gjithmonë krahu im i djathtë, ti je ai që sado të çmendura të jenë idetë ose dëshirat e mia, gjithmonë do t'i plotësosh, vetëm për të më parë mua të qeshur e të lumtur. Mbi të gjitha, unë dua të të shoh ty të lumtur dhe krenar për mua, në çdo hap që marr në jetë. Në çdo problem ose vështirësi që kam pasur, ti ke qenë aty për të më dhënë një nga këshillat e tua të veçanta dhe të menduara mira, por edhe për të më treguar rrugën më të drejtë. Ti gjithmonë ke për të qenë gjëja më e çmuar që unë kam dhe personi i vetëm tek i cili mund të gjej një përqafim të ngrohë plot dashuri!

Megi Çeta 8C



Babi im është një njeri shumë i veçantë për mua. Ai më ka mësuar që të jem e fortë në jetë dhe të luftoj për t'ia dalë mbanë. Më ka ndenjur pranë gjithmonë dhe më ka ndihmuar në çdo hap që kam hedhur. Kemi biseduar dhe kam mësuar shumë gjëra nga ai. Është i gatshëm gjithmonë për të më bërë të lumtur, i dashur, i dhembshur dhe i palodhur. Ai bën gjithçka që familjes mos t'i mungojë asgjë. Më ka mësuar që në jetë duhet të bëj gjithmonë mirë, t'i dua njerëzit, të jem e drejtë dhe e singertë. Ai më befason gjithmonë me surpriza të bukura dhe ma mbush jetën me gëzim. E di që ai do jetë personi që do më ndodhet gjithmonë pranë, pavarësisht çdo gjëje. Dhe unë do mundohem që gjithmonë ta bëj të lumtur e të ndihet krenar për mua.

Raela Cani 8C



I shtrenjti babai im. Jam unë, vajza jote. Ajo vajzë që bën gabime në jetë dhe mundohet që të nxjerrë mësim nga ato. Jam ajo vajza që bën çdo gjë që të bëhesh ti krenar për të. Ajo vajzë që është gjithmonë krenare për ty, për edukatën që më ke dhënë. Ti gjithë jetën tënde punove për ne, për familjen tënde, që të na rritësh me një arsimim të mirë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na dhënë të gjitha gjërat që na nevojiten. Ti je modeli im në rrugën e jetës, për respektin që merr dhe u jep njerëzve. Për ty ka aq shumë fjalë për të thënë, që nuk mbarojnë dhe jam shumë e lumtur që kam një baba si ty. Ti, mami dhe motra jeni pasuria ime e vetme. Ju dua shumë!

Reyhan Tokcelik 8C

Me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti! E di që nuk mjaftojnë për të shprehur dashurinë që ndiej për ty, por një gjë e them me siguri: Faleminderit që je babai im! Për vite me radhë më kanë thënë se i ngjaj tim eti dhe gjithmonë e kam pritur shumë krenarisht.

Kur isha e vogël, kisha çdo gjë që më duhej, dashuri, përkëdheli, deri në plotësim të tekave të mia. Kujtoj dhe këngët që ti më këndoje sa futeshe në shtëpi, më kërkoje me sy derisa më gjeje dhe të dy përqafoheshim, luanim..... Ti ke ditur të përçosh tek unë një fymë të ngrohtë prindërore. Çdo ditë e jetës sime ka qenë e lumtur dhe vazhdon të jetë e tillë. Dhe a e di pse? Sepse në rrugëtimin e jetës sime, përkrah meje, njeriu që më ka shoqëruar gjithmonë është nëna ime dhe ti, i dashur baba. Je kritikuar që më ka frenuar që pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë e që më ke bërë të mos gaboj. Babai im ka një sens të mirë humori, e shikon gjithmonë duke qeshur e duke bërë shaka. Prandaj të dua shumë, je krenaria dhe shpresa ime. Kur të shoh aq të lumtur dhe që në çdo kohë rrezaton mirësi dhe dashuri, më bën të ndihem dhe unë e lumtur dhe krenare që jam vajza jote.

Kur isha e vogël dhe nuk të shihja në shtëpi pyesja gjithmonë mamin: "Ku është babi?" Dhe kam marrë të njëjtën përgjigje: "Në punë". Tani e kuptoj rëndësinë e këtyre fjalëve, ti je ai që mban më shumë peshën e familjes. Energjitë e tua janë të pashtershme. Unë tani nuk jam më e vogël dhe e kuptoj që jeta jote ka qenë e mbushur me sakrificë, por falë besimit, punës dhe aftësisë tënde ke arritur këtu ku je sot dhe Zoti të ka shpërblyer, dhe a e di me çfarë? Me thesarin më të çmuar në botë, të ka bekuar duke të dhënë një familje të mrekullueshme, plot jetë. Uroj që të jetosh sa më gjatë dhe të shohësh frytet e punës tënde të palodhur. Babi, të premtoj se një ditë do të të bëj të ndihesh krenar për mua, për vajzën tënde, që të do sa e gjithë bota. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, mbështetjen, buzëqeshjet që pa kursim m'i dhuron.

Vivjan Kokeri 8C



Dua të flas për ty, o baba, por fjalë nuk po di të nxjerr nga goja. Dua të shkruaj për ty, por gishtat më shikojnë me përçmim. E dinë që s'jam dhe s'do jem i aftë kurrë të të ngre në fronin që meriton dhe e dinë që s'jam i zoti të thur fjalë për të përqaftuar imazhin tënd ashtu si dua. Sa dua të të ngjaj, o babai im! Sa dua të eci në hapat e tu. Sa krenar jam kur më pyesin njerëzit se biri i kujt jam. Ti punon nga mëngjesi deri në darkë. Si luan përpiqesh të çash në këtë botë të egër, vetëm e vetëm që në folenë tënde të ketë mirëqenie. Dua të të uth në ballë, or bab, dua të të shtrëngoj fort në kraharor dhe të të them me zemër "Faleminderit!".

Rubin Kërxfhalu 8C

Nuk ka rëndësi se ku jam apo se me çfarë merrem, e rëndësishme është që kudo unë ndiej praninë tënde dhe jam njeriu më i lumtur që të kam. Çdo hap që hedh mundohem ta hedh të sigurt, ashtu siç të pëlqen ty, ashtu si më ke mësuar ti. Edhe kur gaboj kam pranë dorën tënde që më ngre dhe fytyrën tënde që më bën të buzëqesh, më jep forcë për të vazhduar dhe për të përballuar çdo sfidë të jetës. Ja pse ti je heroi im, heroi që më frymëzon dhe më mbush me forcë dhe kurajë në çdo rast të jetës sime, heroi me të cilin unë hodha hapat e parë dhe mësova fjalët e para, heroi i cili do të bënte çdo gjë të mundur vetëm që unë të jem e qetë dhe e lumtur.

Babai im i shtrenjtë, të dua aq shumë, sa asnjë fjalë nuk do të shprehte kuptimin e asaj që unë ndiej për ty dhe do të mundohem me gjithë shpirt të bëhem ajo që ti do.



Tea Meraj 8C

I shtrenjti babai im, jam unë, djali yt i parë, ai djalë që bën gjithçka që të ndihesh krenar që e ke dhe që e rrit, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë, për dhembshurinë. Gjithë jetën tënde ke punuar për familjen dhe për të arritur suksesin, pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na përmbushur të gjitha nevojat që kemi, duke na dhënë të gjitha kushtet. Babi, kur unë të dal të punoj, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh tre fëmijë dhe çfarë do të thotë familje. Babi im, ka shumë fjalë për të thënë e që nuk mbarojnë, të dua shumë dhe jam shumë i kënaqur, i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti. I shtrenjti baba, ti dhe mami jeni pasuria ime, për ju të dy fal dhe jetën, ju dua shumë...

Visar Sinaj 8C



Babai. Një person që e dua dhe do e dua me gjithë qenien time. Një figurë heroike që të udhëheq në çdo hap që hedh. Babai. Nuk e imagjinoj dot jetën pa të. Sa herë që rrëzohesha, kur mësoja të ecja, ai më ndihmonte të çohesha përsëri. Sepse për këtë janë baballarët. Sa herë që të rrëzohemi në jetë, ata do jenë aty, duke pritur të na ngrenë nga toka. Gjëja më mizore që jeta mund t'i bëjë një njeriu është t'i marrë babanë. Dhe nuk flas vetëm për fëmijët. Edhe të rriturit kanë nevojë për një udhërrëfyes në jetë. Edhe ata kanë nevojë për dashuri atërore.

Zemra e një babai është kryevepër e natyrës. Ka aq mirësi dhe bardhësi në të. Ai është i gatshëm të bëjë gjithçka për mua. Dhe ka bërë. Është siguruar që të mos më mungojë asgjë. Është siguruar që unë jam e lumtur. Nuk ka asgjë që të lëvizë shpirtin e një babai të dashur siç është thirrja e fëmijës së tij. Unë e di se sa herë të kem nevojë për të, ai do më ndihmojë. Por, i dashuri baba, dua të të them diçka: Edhe pse nuk ta them shpesh, unë të dua. Të dua shumë. Dhe dua të dish se dhe unë jam e gatshme të bëj gjithçka për ty. Jam gati të lëviz male për të qenë pranë teje. Prandaj, mos e harro kurrë që të dua dhe do të dua përjetësisht, heroi im!

Armela Shahini 8D

Heroi im, nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty. Çdo fëmijë do të ndihej i lumtur që ka një baba si ty, ashtu siç ndihem dhe unë. Ti ke ditur të përçosh tek ne një fymë të ngrohtë prindërore. Jam mirënjohës që kam dy prindër të mrekullueshëm. Jo se dua të veçoj mamamë, por po vë në dukje sakrificat dhe punën e palodhur të babait tim. Dhe gjithë kjo punë për t'i nxjerrë në jetë fëmijët e tu. Shpresoj të jetosh aq gjatë sa të shohësh frytet e fëmijëve të tu. Do të përpiqem mos të të zhgënjej dhe të të bëj krenar. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, mbështetjen, buzëqeshjet! Faleminderit që më bën ta kaloj çdo ditë me buzëqeshje! Ti je protagonisti në jetën time. Ti je i vetmi që e kupton kur kam nevojë për ndihmë!

Arnis Rroji 8D



Babi im... Sa shumë fjalë më vijnë në mendje kur dëgjoj emrin e tij. Babin tim me plot gojën mund ta thërras inspirimi dhe motivimi im. E shoh babin si një mik, një shok që më ndihmon dhe më këshillon. Mësimet më të çmueshme nga ai i kam marrë. Vlerat më të mëdha në jetë ai m'i ka treguar. Me ndihmën e tij kam gjetur veten, identitetin tim. Kam formuar karakterin tim dhe kam trashëguar virtyte. Babi më ka mësuar se edhe pse do përballem me vështirësi në jetë, jam e fortë për t'i mposhtur. Kam mësuar ta shoh botën nga një kënd më pozitiv dhe gjithmonë të shoh anën e mirë të ndodhive dhe njerëzve. Babi më ka ndihmuar të mësoj të shpreh veten. Më ka inspiruar gjatë krijimeve të mia. Më ka treguar se arti dhe krijimtaria janë çelësa drejt një dere të mbushur me dritë, ngjyra dhe kreativitet. Me prezencën e babit tim ngjyrat e errëta më janë dukur më të çelura, degët e thara të pemëve më janë dukur plot me lule shumëngjyrëshe, errësira më është zbehur e më është bërë dritë. Më përpara nuk kisha shumë pretendime për veten dhe të ardhmen time. Babi më ndihmoi t'i jepja një drejtim jetës sime dhe të kisha besim në vete. E falenderoj babin tim me gjithë shpirt dhe uroj që në të ardhmen të ecim bashkë, dorë për dorë, me dashuri dhe harmoni. Shumë krijime ia kam kushtuar nënës, por këtë herë shkruajta për ty, pasi edhe ti e meriton, o ba!

Engjëllushe Basha 8D



Këtë shkrim ia dedikoj të shtrenjtit tim, babait tim. Ai është një idhull për mua. Gjithmonë ka gjetur kohë që të më bëjë të lumtur, edhe kur ka qenë i zënë me punë. Jam rritur mes të mirave dhe me ndihmën e tij arrita t'i ndaj gjërat nga njëra - tjetra. Gjithmonë do t'i mbaj mend përrallat që më ka treguar dhe kohët e bukura që kemi kaluar bashkë. Edhe pse ndonjëherë mund ta mërzis, kjo nuk do të thotë që unë nuk e dua atë, sepse ai do të jetë gjithmonë babi im dhe unë vajza e tij. Nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty.

Estel Reci 8D

Babi, ti nuk e di se sa herë jam përpjekur të shkruaj për ty, por nuk kam mundur. Gjithmonë kam shkruar për mamën dhe ti asnjëherë nuk je bërë xheloz. Ti e di që ajo është pika ime e dobët dhe në asnjë sekondë nuk më ke bërë të ndihem në faj për këtë gjë. E çuditshme! Talenti ynë i përbashkët na ka larguar dhe afruar njëkohësisht. Dashuria ime për ty ka qenë e heshtur dhe nuk e kisha besuar që dashuritë e heshtura e pa shumë fjalë janë kaq të fuqishme. Ndonjëherë është e vështirë ta shprehësh atë që ndien vetëm me vepra, prandaj sot vendosa të shkruaj për ty. Ndoshta nuk do ta lexosh kurrë këtë letër, apo ndoshta unë nuk do të mund të vazhdoj të shkruaj më gjatë, por... Këtu në shkollë u kam treguar të gjithëve që talentin tim të të shkruarit e kam trashëguar nga ti. Nuk kemi biseduar asnjëherë bashkë rreth artit e megjithatë e kemi kuptuar njëri-tjetrin qoftë me shikime. Për shkak të asaj që ke kaluar e ke të vështirë të flasësh për botën e letërsisë dhe unë të kuptoj shumë mirë, prandaj hesht... Hesht sepse më mjafton t'i shoh sytë e tu të mbushur me lot nga gëzimi, për të kuptuar se ndihesh krenar. Ndiheh krenar që djali yt arriti të realizonte ëndrrën tënde të vyshkur në një sirtar të vogël, të ftohtë e të vjetër. Në atë sirtar të cilin sa herë e ke hapur, të ka goditur në plagën e pashëruar. Por tani jo më! Jam i lumtur që arrita të të fal paqen e nevojshme për shpirtin tënd prej artisti, që askush përveç meje nuk mundi ta kuptonte. Babi, më fal që e adhuroj mamën, ndërsa ty të dua me gjithë fuqinë e shpirtit tim!

Ilario Broci 8D



Babi është forca dhe burimi i karakterit të çdo fëmije. Sikur gjithë shkronjat e botës t'i bëja fjalë e fjalët shprehje, prapë nuk do të mjaftonin për të shprehur atë që zemra ime ndien për ty. Kur kam qenë e vogël, çuditërisht, sa herë largoheshe për punë unë qaja, sepse ti më mungoje.

Edhe kur vajta në klasë të parë, ti prapë ishe aty dhe më fshije lotët. Kaluan vitet, ti kujdeseshe që mua asgjë të mos më mungonte, kujdeseshe pafund që fëmijëria ime të ngelte kujtim. Rrallë herë shpreh dashurinë që kam për ty, por ti e di shumë mirë se sa të dua. Je inspirimi im i vetëm e që më ndihmon në çdo hap të jetës. Ti më ke mësuar se çfarë do të thotë të duash e të respektosh. Je njeriu më i shtrenjtë për mua e shpresoj që të të bëj edhe unë krenar një ditë, ashtu si më ke bërë ti mua, krenaria ime. Babi im, ti je ai për të cilin unë ndihem krenare çdo ditë e më shumë. Ke ditur dhe di si të kujdesesh për mua e të më bësh të lumtur. Fjalët s'mjaftojnë për të të përshkruar. Faleminderit që ma ke bërë fëmijërinë më të bukurën në botë dhe faleminderit që ekziston, o BA!

Ina Kollçinaku 8D

E di që këto fjalë nuk janë të mjaftueshme për të shprehur dashurinë që ndiej për ty, por një gjë e them me siguri: Faleminderit! Kur sjell ndërmend fëmijërinë time, i pari që më kujtohet është babai im. Babai im është i gatshëm të më dëgjojë çdo herë, për çdo problem që mund të kem. Babai im nuk është shumë i gjatë, ai ka sy që i ndryshojnë sipas kohës, ecën ngadalë e me trupin drejt dhe nuk e ndryshon ritmin e hapit. Tani më vijnë ndërmend duart e tij që mund të bënin çdo lloj pune. Asnjëherë në shtëpinë time nuk shikon një gjë të prishur. Vendi ku ai mban veglat është një dhomë e vogël prapa shtëpisë, por ajo rri gjithmonë e pastër dhe e rregullt, ku çdo gjë është në vendin e saj. Raftet janë me kuti të mbushura, që nga kaçavidat deri te trapanët. Ai ka një sens të mirë humori, e shikon gjithmonë duke qeshur e duke bërë shaka. Çdo fëmijë për prindërit e tij thotë fjalët më të mira si dhe anasjelltas. Thjesht fare, fjala 'baba' për mua ka një kuptim tepër të gjerë.

Irdi Zeneli 8D



Babai... Ky emër, i cili me jep vetëm kënaqësi dhe lumturi. Babai im, i cili ma mbush jetën plot kënaqësi dhe plot me jetë, ky person i cili më ka mësuar të gjitha gjërat bazë dhe të cilat do të më ndihmojnë në jetë, është ai që do të ma lehtësojë jetën dhe do të ma bëjë fushë me lule. Ky është babai im, kjo është pasuria ime dhe jeta ime, është njeriu më me vlerë bashkë me mamin, motrën dhe vëllanë. Këta janë personat, të cilët më lumturojnë edhe në ditët më të vështira e më të mërztishme. Kjo është vlera e një familje: të mbështesim njëri-tjetrin, që të jemi të gjithë të lumtur e të gëzuar. Babai im është një nga personat më të rëndësishëm në këtë botë, është personi që më bën krenar në çdo këndvështrim. Dashuria për babain tim s'ka përfundim. Çdo gjë që do të bëj në të ardhmen time, do ta bëj për të të nderuar ty dhe mamin, sepse ai do të jetë fryt i mundit që keni bërë për mua. Të dua shumë, babi im!

John George Gordani 8D



Babai im është njeriu më i mirë në të gjithë botën, është i adhureshëm. Ka qenë aty gjithmonë, edhe pse në të shkuarën ka udhëtuar shumë, ai ka qenë me mua në çdo çast të bukur, të lumtur, të trishtuar, të shëmtuar të jetës sime. Babi im është mrekulli, madje është dhurata më e bukur që mund të më bëhej. Është perfekt, i pabesueshëm. Unë dhe vëllai im jemi me fat që e kemi. Ka qenë aty për çdo gjë, kur thashë fjalën e parë, kur kam bërë lëvizjen e parë, në ditën e parë të shkollës, në festën e abetares, sa herë që jam sëmure etj. Babit duhet t'i them faleminderit për çdo gjë, për çdo dëshirë të plotësuar, për shkollën që po më jep, për faktin që është një baba i tillë, dhe mbi të gjitha për jetën që më ka ndërtuar, një jetë me të gjitha të mirat e mundshme. Duhet t'i kërkoj falje jo vetëm babait, por dhe mamit dhe për shumë gabime. Por mund t'ju premtoj që do t'jua shpërblej sa më parë çdo mundim tuajin dhe çdo shqetësim që ju kam shkaktuar.

Kris Breshani 8D

Babait im në moshë shumë të vogël iu desh të punonte e të mbante nënën, babanë dhe motrat e tij, sepse ishte fëmija më i madh në familje. Bëhet fjalë për 35-39 vjet më parë, kur edhe mundësitë ekonomike ishin shumë të ulëta. Im atë ka pasur një fëmijëri të thjeshtë, ose më saktë nuk ka pasur fëmijëri, sepse pavarësisht moshës duhet të punonte dhe të mbante familjen. Iu desh të linte edhe shkollën, herë shkonte e herë jo, derisa e ndërpreu, sepse nuk kishte çfarë të vishte, madje edhe në ato herë që shkonte, më shumë ishte zbathur. Punonte ku të mundte për të mbajtur familjen, por të ardhurat nuk mjaftonin me gjithë ndihmën që jepnin edhe prindërit e tim eti. Më vonë iu desh të merrte rrugët e Italisë krejt i vetëm dhe të bënte edhe atje ç'punë të gjente. Gjendja në shtëpi në atë kohë ishte e vështirë, ndaj iu desh të bënte çdo lloj sakrifice. Babi im është një njeri tepër i fortë, me shumë guxim dhe me ambicie të madhe. Si ia doli i vetëm pas gjithë këtyre sakrificave? Kur dikush është i vuajtur, e sheh familjen e tij pa të ardhura, në varfëri, gjen guxim për gjithçka, ia del mbanë dhe atëherë kur nuk mundesh më, i jep më shumë forcë vetes, sepse bëhet fjalë për familjen. Dhe kur dikush është i drejtë, siç është ai, ka gjithmonë mirësi në vete. Unë me babanë tim kemi një marrëdhënie shumë të mirë. Ne dalim fundajvë për fundjavë bashkë nga shtëpia dhe ecim në tërë Tiranën. Edhe kur isha i vogël ai më rrinte pranë.

Keanu Senka 8D



Lidhja midis meje dhe babait tim është ndryshe nga të tjerat. E veçanta e saj qëndron se ne e trajtojmë njëri - tjetrin si shok e shoqe. Që e vogël babi më ka mësuar që të flas lirshëm me të dhe kjo besoj se ka ndikuar shumë në lidhjen tonë, e cila mund të konsiderohet tepër e fortë. Gjatë bisedave me tim atë, ai gjithmonë mundohet të kuptojë moshën time dhe kohën në të cilën jetojmë. Këshillat e marra nga babi do të më shoqërojnë gjatë gjithë jetës dhe do të mundohem t'i vë në zbatim. Mënyra se si këto këshilla jepen nga ai nuk janë në formën e moralit, por janë më se të thjeshta dhe goditëse. Im atë asnjëherë nuk mban qëndrim autoritar ndaj meje ose ndaj pjesëtarëve të tjerë të familjes e për këtë virtyt më bën që ta adhuroj edhe më shumë. Një nga këshillat që ai më thekson gjithmonë është: "Nëse do vërtetë të arrish diçka në jetë, puno me vullnet të plotë, por me ndershmëri." Me sa kam kuptuar nga karakteri i tim eti, është se ai vlerëson sinqeritetin dhe urren gënjeshtër në punë e kudo tjetër. Sa herë që unë diskutoj me të, ai nuk e shikon çështjen vetëm nga njëra anë e medaljes, por në këndvështrime të ndryshme, për të dhënë opinionin e tij tepër korrekt dhe të pjekur. Gjithashtu, një cilësi e tij që më bën ta dua edhe më shumë është mënyra se si e shfrytëzon kohën e lirë. Babai gjithmonë zgjedh mënyra prej të cilave ai mund të mësojë informacione nga fusha të ndryshme, duke filluar që nga librat historikë deri tek ata filozofikë. Im atë do të mbetet për mua figura e një miku dhe e një njeriu të shtrenjtë e të pazëvendësueshëm, që gjithmonë më ka mbështetur, pavarësisht situatës. Faleminderit babi!

Lea Vakiari 8D

Tani që mora të shkruaj diçka për babanë tim, më kaloi para syve e gjithë fëmijëria ime, nga përrallat që më tregonte kur isha e vogël, përkëdheljet, shëtitjet dhe pushimet e deri tek bisedat e gjata, kur ai më tregonte kuriozitete dhe pjesë nga jeta e tij. Babai im, megjithëse ka qënë i zënë me punë, ka gjetur gjithmonë kohë për mua. Ai për mua është idhulli im, është heroi im dhe besoj se do të jetë gjithmonë miku dhe shoku im më i mirë dhe unë do të ngelem gjithmonë princesha e tij e vogël.

Megan Karapici 8D



Nëse duhet t'i vë një emër heroit tim, ai është babi im. Ai nuk është vetëm heroi im, por edhe udhërrëfyesi i udhës sime drejt suksesit. Kur të shoh ty, shoh një baba të përkushtuar dhe me ambicie për jetën. Të adhuroj për këtë gjë dhe shpresoj t'i arrij dhe unë një ditë. Ti je një nga njerëzit më të drejtë që kam njohur dhe uroj ta ruash këtë drejtësi deri në fund. Gjithë jetën tënde ke punuar për të arritur rezultatet e tanishme. Ke luftuar që të bëhesh dikushi dhe ia ke arritur. Shpesh më tregon sa e vështirë është jeta po nuk i arrite gjërat me forcat e tua dhe e di që për këtë ke të drejtë, sepse të gjitha i thua nga eksperiencat e kaluara. Më shumë se një baba unë do të të shikoja si një shok dashamirës që kërkon më të mirën për mua. Babi, ti për mua je njeriu më i rëndësishëm në këtë botë. Të dua shumë dhe do të të dua Përgjithmonë!

Jona Malaj 8D



Babai im i shtrenjtë. Më kujtohet, si të kishte ndodhur dje, kur ti dhe xhaxhai na tregonit sakrificat e tua për të sjellë disa të ardhura në shtëpi. Ti ishe larguar nga shtëpia që në rini, pa lënë gjurmë në shtëpi. Shkove në Greqi, e qëndrove andej për katër vite, dhe asnjëri në familje nuk e dinte se ku a si ishe. Të gjithë ishin të shqetësuar e po të kërkonin. I vetmi person i njohur që të kishte takuar në ato vite, ishte shoku yt më i mirë i fëmijërisë. Disa muaj më vonë ai takoi xhaxhin, dhe i tha vendin ku ti punoje. Xhaxhai erdhi të të merrte e të të kthente në shtëpi, dhe ju u kthyet të dy në shtëpi. Qëllimi i këtij tregimi ishte t'iu tregoj të gjithëve sakrificat që prindërit tanë kanë bërë kur kanë qenë të rinj, që në të ardhmen të kishin të ardhura për të rritur fëmijë të shëndetshëm, me shtëpi e me një familje që i do shumë. Ne i mërzisim ata ndonjëherë, por dashuria e tyre për ne mbetet gjithnjë e njëjtë. Duajini prindërit tuaj dhe shprehjani atyre dashurinë që keni për ta, para se të jetë vonë.

Mikaela Goxha 8D



I dashur baba, fjalët nuk mjaftojnë për të shprehur dashurinë që kam për ty. Unë jam shumë krenare që kam një baba si ti, një baba që kujdeset për familjen e tij, që i bën të lumtur fëmijët e tij, edhe pse është shumë i lodhur. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe të premtoj se një ditë do të të bëj të ndihesh krenar për mua!

Rana Söğütü 8D

Sa shumë gjëra na vijnë në mendje, kur dëgjojmë fjalën 'BABA'. Babai është i vetmi njeri që të do po aq sa nëna, ai që të mban gjallë, ai që të siguron gjithçka. Me pak fjalë, pa të nuk ka kuptim jeta. Babai është mjaft trim, pasi ai siguron jetesën e familjes dhe është drejtuesi në edukimin e fëmijëve të tij. Ai gjithashtu na jep dashurinë e duhur. Ajo që më pëlqen tek ai është se punon fort për të na plotësuar nevojat e duhura dhe për të pasur një jetë sa më të mirë. Ai na ndihmon për çdo problem që kemi. Babai na nxjerr nga situatat e vështira. Me pak fjalë, ai me nënën na sigurojnë gjithçka. Sa shumë mund të shkruaj për të. Fjalët për të janë të pafundme. Faleminderit që ekziston, baba! Nga ty kam mësuar shumë gjëra dhe do vazhdoj të mësoj. Të dua, baba! Besoj se e di këtë gjë.



Mikel Seferi 8D

Baba, jam përpjekur shumë herë të të shkruaj një letër, po nuk kam mundur. Kam shkruar me mijëra herë për mamin dhe ti asnjëherë nuk je bërë xheloz. Dashuria ime për ty ka qenë e heshtur dhe nuk e dija që dashuritë e heshtura janë kaq të fuqishme. Sot vendosa të të shkruaj këtë letër, sepse nuk di se si mund ta shpreh dashurinë time për ty në një mënyrë tjetër. Ke punuar pa ndaluar asnjëherë, për të mirën tonë, dhe unë do të përpiqem të ta shpërblej.



Noel Dengu 8D

Unë nuk e dija domethënien e fjalës 'baba', por në një kohë e kuptova. Mund të them se kam një baba shumë të mirë dhe mallëngjyes. E di se nuk mund të t'i kthej ato që ke bërë për mua dhe kam një parandjenjë që je krenar me mua. Askush nuk mundet të thotë që ka një baba të keq, secili thotë se babi i tij është më i miri në botë. Kam shumë kujtime me babanë tim. Kur isha i vogël, kisha shumë pyetje: Pse babi dhe mami kujdesen shumë për mua? Pse më këshillojnë për çdo gjë? Përgjigjet e tyre i kuptova, nxora kuptimin e tyre, po ku do të jem nesër në qoftë se nuk të kam ty pranë? Shumë herë dedikime i kushtova nënës, por kësaj here ta kushtova ty, sepse edhe ti ke një vend të çmuar në zemrën time. Të dua, Babi!



Ruent Muhameti 8D

I shtrenjti babi im, sa shumë gjëra më vijnë në mendje kur filloj të shkruaj për ty. Je një baba i mrekullueshëm, ndryshe nga të tjerët, për mua je edhe një nënë. Ti më ke rritur, më ke edukuar dhe më ke dhënë dashuri pafund. Gjithë jetën tënde ke punuar pa pushuar asnjëherë, për të na plotësuar çdo dëshirë tonën dhe për të pasur një jetë me kushte sa më të mira. Ndiem shumë krenare për ty, që ke bërë të pamundurën për mua dhe vëllanë tim, më ke qëndruar gjithmonë pranë, që unë të ndihesha sa më e sigurt në krahët e tu. Gjithmonë do të mundohem të ta shpërblej, duke të të bërë krenar dhe të lumtur dhe gjithashtu do të mundohem që lotët e tu të mos jenë kurrë lot trishtimi, por lot gëzimi. Ti je udhërrëfyesi im, heroi im, gjithçka që kam. Gjithmonë do të mbështetem tek ti dhe ti tek unë.

Sara Kollçaku 8D

E di se kujt i ngjaj?! ...Edhe poetit më të madh nuk do t'i shkruante pena që të gdhendte në roman fjalët e duhura. Karakteri i tij është po aq i fortë sa dallgët që përplasen tek shkëmbinjtë, por njëkohësisht butësia, dhembshuria e tij janë si valët që të përkëdhelin këmbët në rërë. Pozitiviteti i tij të ndjek kudo, përcjell vetëm mirësi. Ka buzëqeshjen më të bukur në botë, me të cilën jep vetëm siguri. Është ai që më ngre kur bie. Përqafimi i tij është më i ngrohti në botë. Ai është thjesht çelësi i problemeve të mia. Për të unë jam akoma e vogla e tij, princesha e babit që kurrë nuk do të rritet. Kam shumë fjalë që më burojnë nga shpirti, por, kur bëhet fjalë për të vlerësuar tim atë fjalët thjesht shterojnë përpara madhësisë së tij. Jam krenare dhe e lumtur që e kam në krah dhe në jetë këtë njeri të veçantë. E falenderoj që më solli në këtë jetë dhe më bëri ta kem shembullin më të bukur. Hero është pak. Mbret është pak. E përmbledhur me dy fjalë të vetme: Ai është Gjithësia Ime. Faleminderit që ekziston! Do jem shëmbëlltyra jote.

Sanije Nuredini 8D



Babai im është heroi im. Ai më është gjendur gjithmonë pranë kur kam pasur nevojë për të. Ai ka qenë me mua që nga fillimi i jetës sime. Në hapat e parë, fjalët e para, ai ka qenë gjithmonë pranë meje, për të më këshilluar dhe drejtuar në jetë. Ka qëndruar krahas meje edhe kur të gjithë ishin kundër. Më ka mbështetur dhe ka besuar tek unë edhe kur nuk më besonte njeri. Ai është motivimi im për jetën, të jem si ai, të ndjek hapat e tij dhe të jem e suksesshme. Influenca më e rëndësishme në jetën time ishte babai im. Babai më ka mësuar të jem e mirë me njerëzit, të jem e sinqertë dhe e drejtpërdrejtë. Më ka mësuar të punoj shumë për diçka që dua dhe të mos të dorëzohem kurrë, të jap maksimumin dhe të jem e duruar. Ai më mësoi që ta vlerësoj veten për atë që jam dhe të mos e ndryshoj veten për atë që të tjerët duan të jem.

Selma Vorpsi 8D



Babai im është babai më i mirë në botë. Ai m'i plotëson dëshirat pothuajse gjithmonë. Është njeriu që më ka rritur dhe është kujdesur për mua dhe për motrën time. Unë kam një lidhje shumë të fortë me të. Kur doja të dorëzohesha para vështirësive, ai më ka motivuar që të vazhdoja dhe kam realizuar shumë gjëra të mëdha, vetëm me ndihmën e tij. Marrëdhënia ime me babain tim është shumë e fortë, sepse unë atij i them çdo gjë, sidomos problemet e përditshme, sepse ai është njeriu që më kupton më mirë nga të gjithë. Pa të nuk e di si do të jetoja. Ai është organizuesi i familjes sonë për çdo mendim.

Stiven Braho 8D

Babai im është frymëzimi më i madh për mua. Që në vegjëli kam dashur të bëhem si ai, të jem aq e zgjuar, punëtore dhe e matur. Dua që edhe kur të rritem të ndjek shembullin e tij, të jem e zonja e vetes, siç më ka mësuar im atë. Babai im është një njeri i drejtë dhe zemërmirë, jo vetëm me familjen, por me çdokënd. Ai është një burrë shumë i përkushtuar kundrejt punës së tij, gjithnjë i palodhur dhe i motivuar për të ecur përpara. Ky përkushtim nganjëherë sjell mbingarkesë, por edhe pas mundimeve të stërmëdha ai gjithmonë vendos një buzëqeshje në fytyrë kur kthehet në shtëpi. Aspekti që vlerësoj më shumë është devotshmëria e tij kundrejt gjërave që bën. Im atë është gjithmonë i gatshëm për familjen tonë. Ndonjëherë e pyes veten se si është e mundur, që ai kalon përtej dëshirave të tij individuale dhe shikon gjithnjë së pari mirëqenien e familjes mbi të tijën. Nuk ka moment kur prezenca e tij nuk sjell lumturi në familje. Edhe pse shpesh i zënë me punë, momentet me babanë tim janë më të çmuarat. Duke filluar nga më të thjeshtat, një darkë e ngrohtë me të në familje është nganjëherë pjesa më e bukur e ditës. Babai im është mësuesi më i mirë që kam pasur ndonjëherë. Që kur isha e vogël ishte ai që më ndihmoi të përballesha me frikërat e mia më të mëdha. Edhe pse të kota, ai kurrë nuk i ka parë si të tilla. Ndihmesa e tij më ka bërë që t'i kapërcej ato dhe të eci përpara. Im atë më ka mësuar gjëra të vogla dhe të thjeshta në dukje, por që në të vërtetë kanë formuar karakterin tim dhe më kanë bërë ajo që jam sot. Nëpërmjet bisedave me të dhe këshillave të tij, unë kam kuptuar botën që më rrethon. Disa herë mund të tregohet tejet i kujdesshëm dhe si një baba i devotshëm, vendos kufij dhe rregulla të caktuara, por asnjëherë në jetën time nuk jam ndier e cënuar nga to. Sa herë kam pasur nevojë ose kam qenë e shqetësuar, babai im më ka orientuar drejt rrugës së duhur. Ai gjithnjë është kujdesur për mua, pavarësisht situatës në të cilën është ndodhur. Ai asnjëherë nuk më ka demotivuar dhe kurrë nuk i ka penguar ëndrrat e mia, vetëm më ka shtyrë përpara në jetë. Thuhet se njeriu që të do më shumë, është ai që të mbështet edhe në momentet e tua më të vështira. Im atë është pikërisht ky njeri. Ai është gjithnjë pranë meje, edhe kur është kilometra larg, pasi fjalët dhe mësimet e tij do të mbeten gjithnjë me mua.

Rei Korkuti 8E



Babai im është një person shumë i veçantë për mua. Ai më ka dhënë dashuri që në fëmijërinë time. Lidhja midis ne të dyve është shumë e ngushtë. Të dy kemi të njëjtin sens humori dhe më ndihmon për gjithçka, edhe pse është gjithmonë i zënë. Edhe pse unë kam bërë shumë gabime, nuk ta kam dëgjuar fjalën, nuk të jam bindur, ti gjithmonë më ke falur e më ke toleruar.

Arbi Vaqari 8E

Babai im, dielli i jetës sime. Babai im është një ndër personat më të veçantë për mua. Ai është personi ku unë mund të gjej një strehëzë të ngrohtë, një dorë ku mund të mbahem fort, një dorë e cila më fshin lotët në ditët më të vështira. Tek ai unë gjej një pastërti të veçantë në zemër, të cilën askush tjetër nuk mund të ma falë.

Babai është i vetmi person në botë i cili të fal një dashuri pa kushte, pa interesa, një dashuri, e cila pranon gabimet e tua më të rënda e nuk heq dorë kurrë prej teje. Baba quhet ai person që sakrifikon për ty, që punon ditë të tëra për të ndriçuar rrugën tënde e nuk rresht kurrë së bëri gjënë e duhur për fëmijët e tij. Për të nuk ka rëndësi asgjë tjetër përveç jetës tënde. Ai përpiqet pafundësisht për të të dhënë dashuri e përkushtim, gjëra të cilat çdo fëmijë i duhen. Baba quhet personi që i përmbush detyrat e tij deri në fund, edhe nëse i duhet t'i paguajë me jetë.

Babai im është gjithçka për mua. Ai është thesari të cilin nuk ka çmim në botë që ta zëvendësojë. Baba për mua do të thotë shpresë, një fije dritë në errësirën e jetës, një zë i ngrohtë që të shkrin zemrën në ditët më të acarta e Dielli që nuk shuhet kurrë, edhe në ditët me re!



Assia Malkja 8E

Në fjalë unë nuk mundem të them ose të shkruaj dashurinë dhe respektin që kam për babanë tim. Kur kujtoj fëmijërinë, unë mbaj mend që babai im ishte "i buti" në familje, me shumë mundësi sepse vetë ai ka pasur një familje strikte. Por që atëherë e deri më sot im atë më ka trajtuar me respekt dhe dashuri. Edhe në këto ditë, që adoleshenca bën që të kem disa probleme me inatin, prapë jo me dhunë, por me fjalë, babi im më flet dhe diskuton me mua dhe kur më duhet ndihmë ai gjithmonë më ndihmon. Babait tim i pëlqen të shikojë filma komedi dhe aksion, por kur jemi bashkë shikojmë dhe filmat më të rinj dhe ato klasikë. Edhe pse babai im është shumë i zënë, ai prapë gjen kohë për ta kaluar me mua. Kur unë kam nevojë për një bisedë, shkoj gjithmonë te ai për ndihmë, sepse jo vetëm që më dëgjon, por dhe më kupton, sepse këto eksperiencia i ka kaluar edhe ai. Unë të dua shumë dhe nuk arrij ta imagjinoj një ditë pa ty.

Bjorn Vila 8E



Babai është një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Ai është shoku im më i ngushtë. Me të kam shumë kujtime. Lidhja ime me të është e veçantë. Ai lodhet për mua që unë të kem një të ardhme të mbarë. Ai më ka çuar për herë të parë në stadium bashkë me vëllanë tim. Pa babanë tim, jeta do të ishte e zymtë dhe pa lumturi për mua. Ai më tregon shumë kuriozitete të ndryshme. Ne kalojmë shumë kohë të bukura së bashku, por kemi dhe ato zënkat tona kur nuk biem dakord për diçka. Por gjithsesi, ai m'i plotëson të gjitha dëshirat. Kohën e lirë e kaloj me të dhe vëllanë.

Brendon Haloçi 8E

Babai im është njeriu më i mirë dhe shoku më i ngushtë për mua. Ai është një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Çdo ditë ai më ndihmon me mësimet dhe lodhet gjithë ditën në punë, që unë të shkollohem mirë dhe të bëhem dikushi në jetë.

Ai është i vetmi me të cilin unë kaloj kohën e lirë në familje. Ai m'ï plotëson të gjitha dëshirat që kam. Pa babanë tim jeta do të ishte pa lumturi dhe e mërzitshme. Si në çdo familje, edhe unë me babin tim kemi zënka, por zënkat nuk zgjasin shumë, sepse ne i kërkojmë falje njëri - tjetrit. Unë dua që gjithë lodhja e tij të mos shkojë kot, por t'ia shpërblej duke u bërë dikushi në jetë, prandaj kam kuptuar se babai për mua është njeriu më i rëndësishëm në jetë.

Bredi Alla 8E



Që e vogël, të doja më shumë se të gjithë, më shumë se jetën time, më shumë se gjithçka. Je kujdesur për mua edhe kur ti vetë ke pasur nevojë për kujdes. Më ke dhuruar dashuri e ngrohtësi gjithmonë e më ke qëndruar afër në momentet më të vështira. Ke qenë, je dhe do të mbetesh gjithmonë i shtrenjti im. Gjithmonë kam besuar se heronjtë nuk ekzistojnë, por ti më bërë të besoj të kundërtën. Të jesh hero, nuk do të thotë të jesh një person me superfuqi. Ti ma mësove këtë duke u bërë vetë hero në sytë e mi e të familjarëve të tjerë. Të gjithë kanë qenë prezent kur më ke shpëtuar jetën mua dhe vëllait tim gjithashtu. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë për të mirën time! Të falenderoj për të gjitha këshillat që më ke dhënë! Të falenderoj për mbështetjen tënde në këtë botë të pamëshirshme! Të falenderoj në pafundësi që ke qenë një baba i mrekullueshëm për mua. Unë jam më se e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti, një hero si ti, të zgjuar e të palodhur!

Era Hoxha 8E



Unë nuk e shpreh dot se sa e dua babanë tim. Ai jep gjithçka për mua, por unë nuk dua që ai të mundohet kaq shumë për mua. Kur të rritem, do e kujtoj këtë kohë dhe do më marrë malli për të. Siç më jep ai mua gjithçka, edhe unë dua t'ï jap atij gjithçka, por e di që nuk mundem.

Babi im punon në një kompani cigaresh, ku ai menaxhon përmbajtjet e kompanisë. Ai porosit dhe kontakton shitësit. Ai shkon shumë jashtë shteti dhe gjithmonë gjen kohë të flasë në skype. Atij i pëlqen të shohë sport dhe di të gatujë shumë mirë. Edhe pse është i zënë, ai gjen kohë të dalë me mua. Babai im më ka gjënë më të shtrenjtë në botë.

Erion Vathi 8E

Këtë letër ia drejtoj babait tim, heroit tim të vërtetë, atij që më mundësoi një jetë të qetë e të lumtur, që u përpoq për familjen e tij dhe në mënyrë të veçantë për ne, fëmijët e tij, që të mos na mungonte asgjë, që di të dhurojë dashuri, ngrohtësi, përkujdesje pafund, babait tim që edhe pse i lodhur nga puna na përshëndet me buzëqeshje në buzë. Sa shumë kam për të thënë për ty babai im! Ti je heroi im, që më shpëton nga çdo vështirësi ku unë gjendem, në krahun tënd mbështetem e sigurt dhe nuk kam frikë nga asgjë. Gjithmonë i gatshëm për të qenë pranë meje kudo, për të më shoqëruar në çdo hap që unë hedh. Ti je edukatori im, mësuesi im, udhërrëfyesi im. Ti je shoku dhe mik im. Sa shumë dëshirë kam të ulem e të bisedoj me ty! Tani që u rrita ne mund të flasim për çdo gjë bashkë. Tek ti unë gjej përgjigjet e të gjitha pyetjeve të mia. Ndonjëherë çuditëm dhe mendoj me vete se si është e mundur që di gjithçka. Më ngjan me enciklopedinë që kam në sirtar, por ndryshe nga ajo, fletët e tua janë të pafundme. Fjalët nuk mbarojnë për ty, babai im i shtrenjtë. Me gjakftohtësinë tënde, me durimin e madh që të karakterizon, me pjekurinë dhe maturinë tënde, ti mund t'i bësh ballë çdo furtune në jetë, ashtu siç ke bërë deri më tani. Dhe ne fëmijët e tu nuk ndiejmë as erën më të vogël nga gjithë këto furtuna, pasi je ti ai që i vë gjoksin dhe çan përpara në jetë. Çfarë ka më shumë se ti një hero? Jo, asgjë më shumë. Ti, ti je heroi im, që lufton për mua, që më ruan e më mbron nga çdo e keqe, që më shpëton sa herë jam në rrezik. Përherë më thua se mund t'ia dal vetë, por në fakt ti je gjithmonë aty, si krahu im mbështetës. Je aty me këshillat, mendimet dhe sugjerimet e tua. Pa ty, unë nuk do të isha kjo që jam. Je ti ai që më jep kurajo në çdo gjë që unë bëj, më nxit për të ecur përpara, për të kërkuar më shumë nga vetja, më inkurajon në zgjedhjet e mia. Je ti ai që më jep besim dhe nuk më lë kurrë të gaboj. Edhe sikur të shkruaja pafund, nuk do të mundja kurrë të shprehja mirënjohjen dhe dashurinë që kam për ty. Në fakt, kjo dashuri është e hershme, është që atëherë kur isha foshnjë në krahët e tu, që atëherë kur ndieja ngrohtësinë e përkedheljet e tua.

A e mban mend kur më merrje në krahët e tu e më fluturoje lart në ajër? Unë dëshiroja të fluturoja e të kapja retë dhe kaq mjaftonte që ti të më ngrije peshë mbi supet e tu, dhe të më rrotulloje duke imituar aeroplanin. Më thërrisje "zemra e babit" ose "princesha e babit" dhe më pas më ulje në tokë duke më përqaftuar. Po kur shkonim tek parku dhe luanim me top? Ti gjithmonë bëje sikur humbje, që unë të ndihesha e gëzuar për fitoren. Dhe në fakt unë vrapoja e gëzuar nëpër lëndinë. Pastaj luanim kukafshehtas dhe unë gjithmonë të gjeja se ku ishte fshehur, ndërsa ti asnjëherë nuk më gjeje dot. Tani dua të të kujtohet se sa shumë më pëlqenin akulloret... E mban mend atë ditë kur unë isha e sëmurë me bajame dhe kisha goxha temperaturë? Ne sapo po ktheheshim nga mjeku, kur përpara na del karroca me akullore. Mjaftoi që unë të ktheja kokën nga ty dhe pastaj të dy bashkë morëm rrugën drejt karrocës me akullore. Sa shumë çaste të bukura kemi kaluar së bashku, babai im i shtrenjtë! Çaste të

paharruara që do të mbeten në kujtesën time përgjithmonë. Nuk di a është e mundur që një fëmijë të gjejë fjalët e duhura për të shprehur dashurinë e mirënjohjen për prindërit e tij. Unë, në këtë letër jam munduar të shpreh sadopak mirënjohjen time për ty, babai im, dhe njëkohësisht të të falënderoj për gjithçka që ke bërë, për gjithçka më ke mësuar, për gjithçka më ke dhënë mua, vajzës tënde. Babai im i dashur, ti je shembulli që unë kam zgjedhur të ndjek. Dëshiroj shumë që një ditë edhe unë, duke ecur në hapat e tu, të bëhem si ty.

Gjithmonë do të të dua dhe do të të përulem me dashurinë më të madhe. Vajza jote, Ejona.

Ejona Domi 8E



Për heroin tim! E gjithë dëshira ime është që të të ngjaj ty e të eci në hapat e tu. Dua të të përqafoj fort e të të them 'Faleminderit!' Ti, bashkë me kohën më keni treguar që nuk jeni si gjithë të tjerët, ti je më i veçanti, je ai njeriu besnik që më ndihmonte gjithmonë. Prehri yt është jastëku më i ëmbël, më i sigurtë, ku unë mund të fle e qetë. Je vendi ku unë gjej të vërtetën, je babai im! E di që ka ndodhur që edhe s'ta kam dëgjuar fjalën. Ti kurrë nuk më largon nga vetja, por më shtrëngon si të jem një medaljon i artë. Ti lufton gjithmonë në betejat e mia, ti more përsipër çdo gjë vetëm që unë mos të prekesh nga asgjë e keqe. U rrita mes të mirave dhe me ty në krah mësova t'i ndaj gjërat nga njëra-tjetra. Ti di çdo detaj timin, ti di çdo shprehje të mimikës së fytyrës sime, je pasqyra ime. Do të të përulem gjithmonë, me dashurinë dhe respektin suprem për ty. Mos më lër asnjëherë vetëm pa ty në këtë botë!

Ester Alla 8E



E di që këto pak fjali nuk mjaftojnë për të shprehur dashurinë që ndiej për ty. Me gjithë zemër të them: Faleminderit që je babai im! Ti baba je i gatshëm të më dëgjosh për çdo shqetësim që mund të kem. Ti për mua nuk je vetëm një baba, por edhe një shok, i cili kurrë nuk mërzitet duke dëgjuar mendimet e mia, qofshin ato edhe të gabuara. Baba, ti kurrë nuk lodhesh me mua. E di që ndonjëherë edhe të kam mërzitur, edhe pse asnjëherë nuk kam dashur të të lëndoj. Ti më ke dashur shumë përherë. Kurrë nuk ke hequr dorë prej meje e gjithmonë ke pasur besim tek unë. Të dua shumë, baba!

Egli Babasi 8E

Nuk mund ta gjej dot mënyrën se si ta tregoj dashurinë për babanë tim. Fjalët ngatërrohen dhe nuk ka fjalë për ta përshkruar të shtrenjtin tim. Kur dëgjoj fjalën "Baba", imazhi i të adhureshmit tim më shfaqet. Ai është babai pa të meta, pa gabime, është shembull i babait ideal, është shoku im, vëllai i madh pa limit. Është ai që më bën të qaj dhe të qesh kur e shikoj dhe e mendoj. Është forca që nuk më le të ndalem para asnjë pengese. Ai është kujdesur për mua që kur kam lindur. Është njeriu me më pak vese në botë. Shpesh kthehet i lodhur nga puna. Më kujtohet kur dora ime e vogël vendosej sipër tëndes dhe të thoja: "Babush, ele unë e dua dorën kaq të mave sa e jotja!". "Bukoroshe, do e kesh", më thojë. E mban mend kur qaja për diçka që e doja dhe mami nuk e kishte? Ti më merrje në krahë dhe fytyra ime e vogël vendosej pranë teje. Mësimi më i vlefshëm që kam marrë nga ti është që duhet të kem respekt për veten dhe në këtë mënyrë do e kem për të gjithë. Dashuria e babait është horizont i pafund për vajzën e tij.

Fatma Kafellari 8E



Babai im është shoku im më i mirë. Çdo gjë që kam bërë që kur kam qenë i vogël, e kemi bërë bashkë. Babanë e pyes edhe për gjënë më të vogël. Ai më ka mësuar me virtyte dhe më ka përgatitur për jetën jashtë mureve të shtëpisë. Ka punuar shumë për të më dhënë një arsim të mirë dhe një jetë të mirë. Më ka plotësuar çdo dëshirë që të më bëjë të lumtur. Është përkushtuar për mua me gjithë qenien e tij. Më ka ndihmuar në kohë të vështira. Shpërblimi im për ty do të jetë sjellja ime, formimi im si një qenie njerëzore dhe respekti im për ty. Prandaj, kur të rritem, dua të bëhem si ty. Do të mbetesh mbështetja, ngrohtësia dhe dashuria ime përgjithmonë.

Gersi Hajdari 8E



Babai im është njeriu më i shtrenjtë për mua. Është njeriu që ka sakrifikuar shumë për të mos më munguar asgjë. Ai më fal shumë dashuri dhe më mbron nga çdo gjë. Nuk mund ta përshkruaj me fjalë se sa shumë vlerë ka babai im për mua. Ai nuk është thjesht babai im, por është edhe shoku im i ngushtë, krahu më i fuqishëm ku unë mund të mëshetem dhe të përballoj çdo sfidë që mund të has në jetë. Që kur kam lindur e deri më tani, ai çfarë s'ka bërë për mua, për të më dhënë vlera sa më të mira dhe për t'u bërë ky që jam. E kam kuptuar që kritikata e tij nuk janë thjesht sa për të më kritikuar mua, por për të më ndihmuar për t'u përmirësuar në vetvete. Tani përgjegjësia është e imja, për të bërë më të mirën time, që të përpiqem të eci drejt suksesit, drejt një të ardhmeje të ndritur.

Sidrit Hoxha 8E

Babai im, jo sepse është im atë, por ai me të vërtetë është një njeri i zgjuar e shumë bujar. Ai gjithmonë më është gjendur pranë, edhe në momentet më të vështira. Më ka mbrojtur, por edhe më ka qortuar. Më ka mësuar se si të dalloj të mirën nga e keqja. Tani unë e konsideroj atë si shokun tim më të mirë. Ai më ka plotësuar çdo dëshirë. Jemi tifozë të së njëjtës skuadër. E ndjekim atë skuadër në çdo ndeshje. Bashkë kemi vizituar vende nga më të ndryshmet. Jam i bindur se këtë radhë do të shkojmë në një vend të largët. Babai im është më i miri për mua. Ai do të jetë gjithmonë heroi im.

Greis Nuri 8E



Babai im është heroi im i vërtetë, kampioni im, sepse ai është personi më i veçantë në jetën time. Ai është atlet shumë i mirë dhe artist. Ai është inxhinier civil me profesion. Në fundjavë atij i pëlqen të luajë me mua gjatë tërë ditës. Gjatë ditëve të javës ne punojmë shumë dhe harxhojmë kohën maksimale duke punuar në zyrën e tij. Ai është ndër punonjësit më të lartë të kompanisë së tij dhe ka fituar shumë çmime. Babi përpiket më së miri për ta mbajtur familjen tonë të lumtur. Punon shumë për familjen tonë. Ai më do shumë dhe gjithmonë përpiket të më mbushë me gëzim, sa herë që jam në një humor të trishtuar. Gjithmonë më ka mësuar vlerat e mira dhe nuk ma ka prishur, duke më blerë të gjitha gjërat që dëshiroja. Por në të njëjtën kohë ai më ka dhuruar shumë gjëra që unë gjithmonë dëshiroj t'i kem. Babai im gjithmonë ka sakrifikuar në jetë për të më bërë mua një qenie të mirë njerëzore. Unë jam djali i tij i vetëm. Ai është shumë i kujdesshëm edhe në lidhje me mënyrën e të ushqyerit tim. Ai gjithmonë insiston që të ha gjëra të shëndetshme si frutat dhe perimet, që janë të pasura me vitamina dhe minerale. Ai është një baba jashtëzakonisht i dashur. Gjithmonë më pëlqen të kaloj kohë me të dhe të mësoj gjëra të reja me të. Ai më ka mësuar të notoj. Deri tani kam fituar shumë kampionate noti. Babai im më ndihmon edhe në studimet e mia. Ai nuk më lejon të marr mësim nga të tjerët, por ai personalisht ulet me mua për të zgjidhur problemet e mia. Ai është një baba i dashur dhe personi më ideal në jetën time. Ai dëshiron që unë të bëhem njeri i mirë në jetë. Kjo është arsyeja pse ai gjithmonë më mëson të dalloj midis së gabuarës dhe së mirës. Çdo ditë ai merr nga koha e tij që ma kushton mua dhe aktiviteteve të mia të përditshme. Është shoku im i ngushtë. Unë mund të diskutoj gjithçka me të pa asnjë hezitim. Gjërat që nuk ua zbuloj miqve të mi të ngushtë, mund t'i diskutoj lehtë me babanë tim. Të dua shumë, baba!

Kevin Dragoshi 8E

I dashur babi! Jam unë, princesha jote. Ti më ke ndihmuar të krijoj kujtimet më të mrekullueshme të jetës sime. Nuk di nga t'ia filloj, sepse janë kaq shumë gjëra për të cilat dua të të falenderoj. Faleminderit që ishe aty që nga dita kur erdha në këtë botë! Faleminderit që më ndihmove të ngrihesha sa herë rrëzohesha, ndërsa përpiquesha të ecja mbi këmbët e mia. Dikur mendoja se e bëje thjesht që të mos vritesha. Sot kam kuptuar që po më mësoje të ecja drejt rrugës së jetës. Kam kuptuar që në heshtje thoje: "Unë do jem gjithmonë pranë teje, duke të të zgjatur dorën sa herë të biesh, e vogla ime." Faleminderit që më ke plotësuar çdo kapriço! Faleminderit që u tregove i duruar për to! Faleminderit që u tregove i duruar për çdo prapësi që kam bërë! Faleminderit që më dhe mundësinë të jetoj në një familje ku mbizotëron dashuria dhe respekti! Faleminderit që me këshillat e tua, sot më ke përgatitur për problemet e vështira që më presin! Faleminderit për të gjitha netët pa gjumë që ke kaluar pranë meje, kur qaja apo kur isha e sëmurë. Sot kam kuptuar që ishin provat e dashurisë tënde të pafundme që ke për mua. Kam kuptuar që janë provat e përkujdesjes tënde, që vazhdon dhe sot që nuk jam më fëmijë. Faleminderit që më mësoje gjithmonë të dalloja të mirën nga e keqja! Sot kam kupuar që po më mësoje vlerat që me të vërtetë kanë rëndësi në jetë dhe njëra prej tyre ishte të bëhesha njeri i drejtë e me një zemër të madhe si TY. Të admiroj, babush! Je mashkulli më perfekt që ekziston. Je ti ai që më kupton gjithmonë. Je ti ai që më mbështet. Je ti ai që më këshillon për çdo gjë. Nuk kam fjalë tjetër përveçse "Faleminderit, Babi!" Është e pamundur ta përshkruaj dashurinë që kam për ty, sepse kalon çdo limit. Ti je heroi im, frymëzimi im! Të dua, babi im!

Klarisa Pengu 8E



E çfarë mund të na shkojë tjetër në mendje kur mendojmë për babin përveç fjalës hero? Të jetë një hero nuk do të thotë të shpëtojë botën, por t'i gjendet afër fëmijës së tij. Çdo problem e ndan në copëza dhe e zgjith atë në mënyrën më të mirë të mundshme. Është aty për të dëgjuar çdo mendim tëndin dhe nëse ti je gabim jep një shpjegim që të bën të mendosh se ai di gjithçka. Pavarësisht problemeve që mund të ketë, të cilat ti nuk do t'i dish kurrë, ai do të jetë gjithmonë aty për ty, edhe kur të jesh larg, gjithmonë do të jetë aty me ty. T'i dhurosh një përqaftim, një puthje dhe pak dashuri për ne mund të duket shumë pak, por për të është momenti i shumëpritur gjatë gjithë ditës. Kurrë nuk mund të thuash se dikush është perfekt, por për sytë e mi familja është vendi më perfekt për të mësuar dhe për të ndarë jetën.

Tea Zeqo 8E

Shpresoj që kjo letër të jetë një nga kujtimet më të bukura për ty, baba. Edhe pse çdo ditë të shoh, po e bëj këtë gjest sepse më pëlqen të shprehem nëpërmjet fletës. Prandaj doja të të thoja që të dua shumë dhe se je krenaria dhe shpresa ime. Kur të shoh aq të lumtur dhe që në çdo kohë rrezaton mirësi dhe dashuri, më bën të ndihem dhe unë i lumtur e krenar që jam djali yt. Nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty. I dashur baba, unë të kam treguar në çdo moment që të dua pafund. Por sot do të doja diçka të veçantë të mbushur plot dashuri. Çdo fëmijë do të ndihej i lumtur që ka një baba si ti, ashtu siç ndihem dhe unë. Ti ke ditur të përçosh tek ne një fymë të ngrohtë prindërore. Çdo ditë e jetës sime ka qenë e lumtur dhe vazhdon të jetë e tillë dhe a e di pse? Sepse në rrugëtimin e jetës sime, përkrah meje, njeriu që më ka shoqëruar gjithmonë je ti, i dashur baba. Jo se mamin nuk e dua, natyrisht që dhe ajo zë një vend të rëndësishëm në zemrën dhe jetën time, po për ty është një dashuri e pazëvendësueshme. Je i pakrahasueshëm dhe energjik, plot jetë dhe në çdo moment rrezaton respekt, dashuri, mirësi, vlera. Energjitë e tua janë të pashtershme. Nuk ke thënë kurrë u lodha dhe nuk ke thënë kurrë jo. Unë tani jam i rritur dhe e kam kuptuar që jeta jote ka qenë e mbushur me sakrifica, por falë besimit, punës dhe aftësisë tënde ke arritur këtu ku je sot, dhe kjo të është shpërblyer me ne, tre fëmijët e tu dhe një grua të mrekullueshme. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, mbështetjen, buzëqeshjet. Faleminderit që më bën ta kaloj çdo ditë me buzëqeshje! Faleminderit që ekziston! Mos harro se sa fort të dua, babi!

Leart Qefalia 8E



E dini se cili është idhulli im? Nuk është as një aktor, as një këngëtar, as një sportist.... Është ai që e urren të më shikojë të mërzhitur dhe që bën gjithcka të më bëjë të buzëqesh. Është ai që më kupton që në sy...E kupton jo vetëm nëse jam e mërzhitur, por kupton edhe arsyen pse. Është ai që sa herë e shikoj më fal një energji pozitive me ata sytë dhe buzëqeshjen e tij...Është ai njeriu që shumë shoqe të mia e kanë zili. Është ai që ka zemrën më të madhe, është ai për të cilin unë çdo ditë e më shumë ndihem krenare. Është Babi im!! Është ai për të cilin unë rrallë e shpreh rëndësinë që ka në jetën time, por që frika ime më e madhe është ta humbas, pikërisht atë, atë që deri tani është protagonistin në ditarin e jetës sime. Ai është pika ime e fortë dhe e dobët. Është ai që më bën ta dua çdo ditë e më shumë. I shtrenjti baba, jam unë vajza jote e parë, ajo vajzë që ka bërë gabime në jetë dhe ka kuptuar shumë, ajo vajzë që bën gjithçka që të ndihesh krenar për fëmijën që ke rritur, atë vajzë që është krenare për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë. Gjithë jetën tënde ke punuar për familjen, pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na përmbushur të gjitha nevojat që kemi, duke na mundësuar të gjitha kushtet. Babi, kur

unë të dal në punë, kur të bëhem me familje do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh katër fëmijë, çdo të thotë të japësh dhe të marrësh nga jeta dhe çfarë do të thotë familje. Babi im, kam shumë fjalë për të thënë që nuk mbarojnë. Të dua shumë dhe jam shumë e kënaqur e lumtur dhe krenare që kam një baba si ti. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë. Je kritiku që më ka frenuar për të hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë e që më ke bërë të mos gaboj kurrë në jetë. Të dua shumë shumë, sepse kam gjakun tënd, sepse jam bija jote, që nuk të zhgënjeu kurrë. Gjithmonë do të ndihem krenare për ty. Ke qenë babai ideal për mua. I tillë do mbetesh deri në fund ... I shtrenjti baba! Ti dhe mami jeni pasuria ime. Ju dua shumë... Faleminderit që ekziston...! Mos harro se sa fort të dua, BABI!



Nekieda Tahiraj 8E

Engjëlli im mbrojtës është Babai im... Çfarë i vjen në mendje një personi sapo dëgjon emrin baba? I guximshëm, i pamposhtur, heroi i çdo vajze. Ai është njeriu më pozitiv që njoh. Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtimit tim, babit tim. Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë, me shumë virtyte, njeri me shpirt të pastër e të bukur, që në jetë ka hasur shumë vështirësi, që në fëmijëri. Në moshë shumë të vogël iu desh të punonte e të mbante nënën, babanë, motrat e vëllezërit e tij, sepse ishte fëmija i madh në atë familje prej 11 personash. Njerëzit kanë idhuj të ndryshëm, dikush ka një këngëtar, dikush një aktor e dikush tjetër një shkrimtar, por tek unë nuk ka ndodhur kështu, sepse idhullin tim kam pasur fatin ta kem në çdo hap timin. Admiroj autoritetin e tij, admiroj mënyrën se si sillet me të tjerët, admiroj zgjuarsinë, pozitivitetin, por për më tepër admiroj vullnetin që ka për të ecur përpara. Po shkruaj për atë person që nuk më tha asnjëherë "jo", për një baba që nuk e kam dëgjuar asnjëherë të ankohet. Ka qenë aty për mua në çdo moment dhe do të mbetet aty.



Rea Pali 8E

Babai është më tepër se thjesht një anëtar në familje, është një shpatull ku të mbështetesh, një mburojë ndaj shigjetave të fatit, një vesh për të dëgjuar, një gojë për të këshilluar, një dorë për të të ngritur, si dhe një mik. Sidoqoftë, marrëdhëniet me një person që të do të mirën nuk janë gjithmonë perfekte, ato janë si valët e detit, me ulje - ngritje. Dhe si gjithmonë, shumicën e kohëve deti është i qetë, por ka raste kur dallgëzohet. Ndodh që ndonjëherë erërat që vijnë janë të lehta dhe mund të jenë dhe pa një prejardhje konkrete, por përsëri deti qetësohet sërish. Por dhe ne të dy, si dy guacka deti, që çfarëdo të bëjmë kthehemi përsëri në breg, sado të na marrin dallgët, na nxjerrin përsëri, që sado të ndryshojmë, jemi të njëjtë, dhe sado të mundohemi s'bëhemi dot si të tjerë, jemi të veçantë dhe perfektë në mënyrën tonë të të qenurit të tillë. Ashtu si fytyrat tona mund të ngjasojnë, si dhe dora mund të duket e njëjtë, ashtu ka edhe mendime që s'na puthiten, por prapë është zemra që na bashkon.

Selma Isufi 8E

Kjo ese është për njeriun më të shtrenjtë, më të dashur, më të mirë, për atë që gjithmonë më lumturon dhe me gjërat më të vogla, për babanë tim. Dua të të them që të dua shumë e je krenaria dhe shpresa ime. Kur të shoh aq të lumtur dhe që në çdo kohë rrezaton mirësi dhe dashuri, më bën të ndihem dhe unë i lumtur dhe krenar që jam djali yt. Nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty. I dashur baba! Unë të kam treguar në çdo moment që të dua në pafundësi dhe me këtë ese do të përpiqem të të lumturoj dhe ty sadopak. Çdo fëmijë do të ndihet i lumtur po të kishte një baba si ti, ashtu siç ndihem dhe unë. Ti ke ditur të përçosh tek ne një fymë të ngrohtë prindërore. Çdo ditë e jetës sime ka qenë e lumtur dhe vazhdon të jetë e tillë, sepse në rrugëtimin e jetës sime je ti, i dashur Baba. Je i pakrahasueshëm dhe energjik, plot jetë dhe në çdo moment rrezaton respekt, dashuri, mirësi, vlera. Energjitë e tua janë të pashterueshme, nuk ke thënë kurrë "u lodha" dhe nuk ke thënë kurrë "jo". Unë tani jam i rritur dhe e kam kuptuar që jeta jote ka qenë e mbushur me sakrificë. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, mbështetjen, buzëqeshjet dhe kurrë mos harro se sa fort të dua, babi!

Amaris Vreshta 8F



I shtrenjti baba, me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti! Je si idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë dua të zgjedh. Je shoku më i denjë që kam, je mbështetja më e madhe për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar gjithmonë ke qenë pranë meje për të më drejtuar. Je kritikuar më i mirë për gabimet e mia, mbetesh këshilluesi më i saktë. Të dua shumë, sepse kam gjakun tënd, sepse jam djali yt. Gjithmonë do të ndihem krenar për ty. Je babai ideal për mua. I tillë do të mbetesh edhe në të ardhmen. Të dua pafundësisht!



Arion Tarka 8F

Babai është ai që e urren të më shikojë të mërzhitur dhe që bën gjithçka që të më bëjë të buzëqesh. Është ai që më kupton që në sy. E kupton jo vetëm nëse jam mërzhitur, por kupton edhe arsyen. Është ai që sa herë e shikoj më fal një energji pozitive me ata sytë dhe buzëqeshjen e tij. Është ai që ka zemër të madhe, që pavarësisht gjithçkaje, pavarësisht vuajtjes që një njeri mund t'i shkaktojë, ai gjen gjithmonë një anë të mirë tek çdo njeri. Është ai për të cilin unë çdo ditë e më shumë ndihem krenar. Është babai im, për të cilin unë rrallë e shpreh rëndësinë që ka në jetën time. Ai është pika ime e fortë dhe e dobët. Është ai që më bën ta dua çdo ditë e më shumë. Dëshiroj që e gjithë mirësia që ai ka bërë në këtë jetë t'i shpërblehet si ai e meriton dhe që ai një ditë të ndihet po aq krenar sa unë për të.

Endri Qato 8F

Ne fëmijët jetojmë në një botë, e cila është e rrethuar me ngohtësi, siguri dhe dashuri. Kjo botë janë prindërit tanë. Të dy kanë përgjegjësi për ne, për të na bërë dikushi në jetë. Përveç nënave, që gjithmonë na ruajnë dhe përkujdesen për ne, gjithashtu kujdes për jetën tonë kanë edhe baballarët. Kujdesen për ne, na ndihmojnë që të kapërcejmë problemet e përditshme. Mundohen dhe sigurohen që të jetojmë një jetë të bukur, të lumtur e të sigurt. Me të vërtetë që për secilin prej nesh ai është i veçantë. Ai për mua nuk është vetëm një baba, por edhe një shok shumë i mirë, që gjithmonë i gjen zgjidhje problemeve të mia. Asnjëherë nuk përton të dëgjojë, por e bën me kënaqësi. Edhe pse i lodhur, prapë nuk e tregon, por përpiket të më kënaqë. Dhe unë mundohem ta bëj krenar. Mërzitem kur e zhgënjëj, edhe pse ai nuk e tregon që është i zhgënjyer. Babai është një hero. Është i aftë të na mbrojë kudo dhe çdo herë. Për mua ai është dhe do të mbetet shembulli më i mirë ku unë mund të mësoj dhe të marr këshilla, prandaj dhe jam mirënjohëse ndaj tij. Dhe do të vazhdoj të mundohem sadopak t'ia shpërblej me punën time dhe përpjekjet e mia. Dhe tani, dhe kur të rritem nuk do i harroj mësimet që më ka dhënë dhe sakrificat që ai bëri për mua. Babai për mua është një nga personat më të rëndësishëm dhe të çmuar. Ndaj dashuria ime për të është e pafundme dhe do të vazhdojë të jetë kështu deri në fund. Ndaj këtë ta dedikoj ty, baba.

Anja Gjini 8F



Fjalët kurrë nuk do të mjaftojnë për të shprehur dashurinë që kam për ty babi, por unë dua ta nis këtë dedikim duke të thënë "Faleminderit!" Faleminderit për gjithçka që ke bërë për mua! Faleminderit që je pjesë e jetës sime! Faleminderit që më je gjendur pranë në çdo moment! Ti je frymëzimi im! Arritjet, puna jote e palodhur, zemërbardhësia dhe zgjuarsia jote më bëjnë të krenohem me ty. Ti je heroi im, je shpresa ime. Kur të shoh ty të lumtur dhe që në çdo kohë fal dashuri dhe mirësi te të tjerët, më bën të ndihem edhe më e lumtur dhe krenare që jam vajza jote. Shpesh jam mërzitur nga qortimet e tua, por tani e kuptoj shumë mirë se pa ato qortime dhe ato këshilla unë nuk do të arrija këtu ku jam sot. Në jetë do të përballem me shumë sfida, vështirësi dhe padrejtësi, por ti më ke mësuar të jem e fortë dhe të mos lejoj asgjë të më mposhtë. Kam kuptuar se çdokush në këtë jetë mund të më lëndojë dhe të më zhgënjëj, por ti nuk do ta bësh kurrë. Ti je personi ku gjej kurajo. Je personi që më frymëzon dhe më bën të eci përpara e të mos dorëzohem kurrë për të arritur synimet e mia. Dua të dish se pa ty jeta ime nuk do të kishte kuptim. Pa ty nuk do të kisha një krah ku të mbështetesha, pa ty do të ndihesha e pasigurt. Gjithçka dua, është të ndjek hapat e tu, të arrij të krijoj një jetë të mirë dhe të lumtur, ashtu si ti ke bërë. Meriton më shumë se mund të të jap, por dije se çdo gjë që do të bëj në jetë do të jetë si shpërblim i gjithçkaje që ke bërë për mua. Dashuria për ty kurrë nuk do të shterojë. Të dua shumë, babi im!

Egi Lika 8F

Unë kurrë nuk do të arrij të gjej fjalët për të përshkruar se sa shumë të dua ty. Ndaj dua ta nis këtë dedikim duke të të falenderuar. Faleminderit për të gjitha sakrificat që ke bërë deri më sot për mua! Faleminderit për dashurinë pa fund që më ofron çdo ditë dhe faleminderit që je gjithmonë aty për të më mbështetur! Puna jote e palodhur, dashuria jote pa kufi dhe arritjet e tua më janë bërë tashmë frymëzim për gjithçka që unë bëj. Ti je frymëzimi im, ti je shembulli im! Në këtë botë shumë herë mund të më zhgënjëjnë, të më tradhëtojnë dhe të më lëndojnë, por ti... kurrë. Ti je mbrojtësi im kryesor, njeriu te i cili do të mbështetem gjithmonë, pa pasur asnjë lloj frike, shoku, të cilit mund t'i them çdo gjë dhe njeriu që do të më zgjasë duart për të më ndihmuar, ashtu siç bëri ditën e parë që unë erdha në këtë botë. Ti je njeriu më i veçantë për mua. Ti më ke mësuar se asnjëherë nuk duhet t'i lë të tjerët të më zhgënjëjnë e se s' duhet të pres shumë nga ata. Të gjithë e shohin marrëdhënien tonë si thjesht babë e bijë, por ata nuk e dinë se për njëri-tjetrin ne jemi shokët më të mirë. Ti më thua se tashmë kam arritur t'i jap drejtim disa nga problemeve të mia, por kjo aftësi e imja ka ardhur si pasojë e mësimave dhe këshillave që ti më ke dhënë dhe akoma vazhdon të më japësh. Dije se unë gjithmonë do të kem nevojë për supin tënd të ngrohtë e për ato këshillat e tua. Ne i tregojmë njëri-tjetrit çdo sekret, çdo gabim, çdo ves e çdo aftësi. Së bashku ne mundohemi që t'i zhdukim këto vese me forcat e njëri-tjetrit, mundohemi dhe luftojmë të kuptojmë gabimet tona, e më pas t'i heqim. E gjithë dëshira ime është të të bëj krenar ty, në të njëjtën mënyrë si dhe ti më ke bërë mua. Gjithçka dua në këtë jetë është të kem një jetë të lumtur dhe të qetë, siç ti e ke tashmë, duke ecur në hapat e tu. Ti je i shtrenjti im, drita e syve të mi. Ti je heroi i çdo sfide të jetës sime. Je në krye të saj. Do të të përulëm gjithmonë me dashurinë e respektin suprem që unë kam për ty. Kur të shoh aq të lumtur dhe të gëzuar e që në çdo kohë dhe vend pasqyron dhe rrezaton mirësi, respekt, shpresë dhe dashuri më bën të ndihem akoma dhe më e lumtur e krenare që jam vajza jote. Të dua pafund!

Eva Kasmi 8F



I shtrenjti babai im! Jam unë, djali yt i parë, ai djalë që ka bërë gabime në jetë dhe ka kuptuar shumë, ai djalë që bën gjithçka që të ndihesh krenar për djalin që ke dhe ke rritur, ai djalë që është krenar për ty, për edukatën dhe kulturën që i ke dhënë, për dashurinë....Gjithë jetën tënde po punon për familjen, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na plotësuar të gjitha nevojat që kemi, duke na dhënë të gjitha kushtet. Babi, kur unë të dal të punoj, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh fëmijë. Babi im, kam shumë fjalë për të të thënë e që nuk mbarojnë...Të dua shumë dhe jam shumë i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti....

Erlis Nazarko 8F

I shkruaj engjëllit tim, personit që më ka zgjatur dorën i pari kur erdha në këtë botë të egër, atij që më ka ndenjur gjithmonë pranë, i shkruaj babait tim të shtrenjtë. Nuk gjej dot mënyrën për të treguar dashurinë e madhe që kam për ty, se sa shumë vlen ti për mua. Fjalët ngatërrohen dhe nuk do të mjaftonin kurrë për të shprehur dashurinë time për ty. Ti për mua je njeriu më unik në këtë botë, je babai pa të meta, pa gabime, shembulli im, shoku im, vëllai pa kushte e pa limite, je ai që nuk lodhet nga gabimet e mia, ai që më bën të qaj dhe të qesh kur e shoh dhe e mendoj, forca që s'më lë të ndalem para asnjë pengese. Ai që çdo ditë nuk lodhem duke i thënë se sa e dua e duke e falenderuar për gjithçka, për çdo sakrificë që ka bërë për mua. Ajo që dëshiroj më shumë është të të ngaj ty, të ndjek hapat e tu. Në këtë botë jam e sigurt se çdokush mund të më hedhë tutje, të më zhgënjëjë, tek çdokush mund ta humb besimin, por tek ti kurrë. Jam rritur mes të mirash, me ty në krah kam mësuar t'i ndaj gjërat nga njëra - tjetra, të ndaj të mirën nga e keqja. Më ke dhënë gjithmonë këshilla të vlefshme. Ke qenë aty kur kam pasur më shumë nevojë për ty, për mbështetjen tënde. Je drita e syve të mi, je heroi i çdo lufte e çdo beteje që kam kaluar, ti je në krye të të gjithë botës sime, je gjysma ime më e plotë dhe më e saktë. Do të të bindem gjithmonë me dashuri dhe respekt, sepse prej teje kam arritur deri këtu ku jam. Do të isha askushi pa ty, babi, dua që ta dish se pavarësisht çdo gjëje dashuria ime për ty nuk do të zbehet asnjëherë. Do përpiqem të jap maksimumin tim për të të bërë ty krenar, për të shpërblyer sadopak lodhjen tënde, çdo sakrificë dhe mund që ti ke bërë për mua. Babi, je heroi im dhe pika ime më e dobët.

Greta Merlika 8F



I dashur baba, me mirënjohje të madhe më dalin këto fjalë nga zemra. Je heroi im, je shembulli më i mirë në jetë! Je shoku më i denjë që kam! Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë afër meje. Je kritiku që më ka frenuar që pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë e që më bërë të mos gaboj kurrë në jetë. Të dua shumë shumë, sepse jam biri yt, që nuk të zhgënjeu kurrë. Gjithmonë do ndihem krenar për ty. Ke qenë babai ideal për mua dhe i tillë do të mbetesh...

Harald Gjuzi 8F



Unë po rritem një fëmijë i lumtur pranë prindërve të mi. Babai, mami, nëna dhe vëllai formojnë familjen time. Prindërit s'i ndaj dot, por duhet ta pranoj se babai është heroi im. Është ai që më qëndron gjithmonë pranë. Falë tij, punës së tij, përkushtimit të tij ne jetojmë të lumtur. Jam shumë krenar për ty, babi. Je ti ai që na qëndron gjithmonë pranë, si mua, ashtu edhe vëllait. Je shoku më i mirë për ne dhe ne të duam shumë. Ti meriton më shumë dashuri e mirënjohje sesa unë mund të të jap. Babai im, të dua shumë, ti je gjithçka për mua. Dua të jem si ty dhe jam shumë krenar që jam djali yt!

Henri Tozaj 8F

Shpesh esetë dhe poezitë e ndryshme i kushtohen nënave, sepse tek e fundit ato na kanë sjellë në jetë. Por ne harrojmë se dhe babi luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Kur isha e vogël të gjitha shoqet e mia kishin dëshirë të bëheshin këngëtare apo balerina, por e vetmja dëshirë për mua ka qenë, është dhe do të jetë që të ndjek hapat e babit. Ai është heroi im dhe jam me të vërtetë me fat që e kam. Babi është një nga njerëzit më optimistë, më punëtorë dhe më të dashur që kam takuar dhe me të vërtetë ka arritur aty ku është me forcat e veta. Është babi ai që do të bënte çdo gjë që neve mos të na mungojë asgjë. Edhe pse ai është shumicën e kohës i zënë me punë, gjithmonë arrin të gjejë kohë që ta shpenzojë me ne. Babi më ka mësuar të jem e dashur, e duruar dhe kurrë mos të lejoj të tjerët të më nënvlerësojnë. Ai ka qenë gjithmonë aty për mua, në çdo hap të jetës sime, qoftë i lumtur, kur ka gëzuar më shumë se unë vetë, e qoftë i trishtuar, kur më ka dhënë këshilla e kam qarë në shpatullën e tij. Sado të rritem, unë do të kem gjithmonë nevojë për mbështetjen e babit. Kur jam me babin ndihem e sigurt dhe s'kam frikë nga asgjë. Ne kemi shumë të përbashkëta dhe e them me krenari se i ngaj më shumë atij. Dashurinë e babit nuk e zëvendëson dot asnjëri dhe do ta dua përgjithmonë heroin tim.

Jona Nallbani 8F



Këtë shkrim ia dedikoj babait tim të dashur. E di që këto fjalë nuk mjaftojnë për të të shprehur dashurinë time për ty. Ç'mund të kërkoj më shumë nga një baba, i cili të përkrahë, që është i dashur dhe që sakrifikon çdo gjë për ty. Unë ty të konsideroj si heroin tim, si shokun tim më të mirë. Me ty ndaj çdo gjë, edhe sekretet më të thella. Unë e di që çdo qortim që më ke bërë, çdo vërejtje e ke bërë që unë kur të rritem të jem një njeri më i mirë. Do të të jem gjithmonë mirënjohës për çdo gjë që ke bërë për mua. Ndoshta ti nuk je më i miri, por unë baba më të mirë nuk kam parë. Të dua shumë, babai im!

Kleivi Saraçini 8F



Këto fjalë zemre ia dedikoj tim eti. Babait tim të dashur, i cili mundohet që mua dhe familjes të na plotësohen të gjitha dëshirat dhe të jemi të lumtur. E di që këto fjalë nuk janë të mjaftueshme për të gjitha gjërat që ti ke bërë për ne, për familjen tonë të dashur. Baba, ti je më shumë se një dashuri për mua, ti je kurajoja ime, je babai që kurrë nuk ka nguruar për përmbushjen e dëshirave të mia të shumta. Nuk e kam akoma idenë se si mund të të bëj të lumtur ose të shpreh dashurinë që kam për ty, por e di që dëshira jote më e madhe është që familja jonë të jetë e lumtur përgjithmonë, dhe që ty të të plotësohet dëshira. Të premtoj që do të sillem mirë me të gjithë dhe do të arrij rezultate më të mira në mësim. Të dua shumë, babai im.

Ledio Mara 8F

Hero për mua nuk është as superheroi i filmave, as ndonjë aktor tjetër i famshëm. Hero për mua është babai im. Ai më rri gjithmonë pranë kur unë jam i mërzhitur, për të më bërë të ndihem mirë. Është personi që do të jepte çdo gjë dhe do të bënte çdo sakrificë për të më parë mua të buzëqeshur. Babai im gjen gjithmonë mënyrën më të mirë për të më bërë të qesh me lot. Është ai që m'i plotëson gjithmonë dëshirat dhe ëndrrat. Ai bashkë me mamanë më kanë mësuar çdo gjë, si të flas, si të eci, si të lexoj dhe shumë e shumë gjëra të tjera. Është ai që më jep gjithmonë këshilla kur kam nevojë, më tregon rrugën e drejtë kur jam në udhëkryq. Edhe kur më kritikon ose më vështron ashpër kur gaboj, unë e di që ai e bën për të mirën time. Unë e di që ai do të jetë gjithmonë aty për mua, edhe kur unë të jem rritur, jo për të më mbajtur për dore, por për të qenë pranë meje në gëzime dhe në vështirësi.

Kleon Oshafi 8F



E di që kjo fletë nuk mjafton për të shprehur dashurinë që ndiej për ty, por një gjë e them me siguri: "Faleminderit që je babai im!" Kur kujtoj fëmijërinë time, i pari që më vjen ndërmend është babai im. Babai im është i gatshëm të më dëgjojë çdo herë, për çdo problem që mund të kem. Babai im ka sy jeshil. Ai ka një sens të mirë humorit, e shikon gjithmonë duke qeshur e duke bërë shaka. Fjala 'baba' për mua ka një kuptim tepër të gjerë. Atë mirësi që më ka dhuruar nuk do ta harroj kurrë, pasi është ai që më ka qëndruar dhe më qëndron pranë në ditë të këqija e të mira.

Klevi Bitraj 8F



I dashur babi! Jam unë, biri yt, që të drejtohem me fjalë zemre. Je krijuesi i qenies sime mendore e shpirtërore. Ti më ke ndihmuar të krijoj kujtimet më të rëndësishme të jetës sime. Nuk di nga t'ia filloj sepse janë kaq shumë gjëra për të cilat dua të të falenderoj. Faleminderit që ishe aty, që nga dita kur unë erdha në këtë jetë! Faleminderit që ke duruar çdo gabim timin! Faleminderit për këshillat që më ke dhënë, duke më përgatitur për problemet në jetë, qofshin ato edhe të vogla! Faleminderit që më ke mësuar të dalloj të mirën nga e keqja dhe të jem një njeri i drejtë si ti! Faleminderit që më ke ngritur sa herë që jam rrëzuar! Faleminderit për netët pa gjumë, kur unë isha sëmurë ose kisha ndonjë problem! Faleminderit për sakrificën që po bën për të na shkolluar dhe arsimuar! Je ti ai që më ke mbështetur dhe nxitur për të ecur përpara. Dashuria që kam për ty është e papërshkrueshme. Kam dëshirë që dhe unë të të ndjek ty si shembull. Nga djali yt, Luisi.

Luis Mjollli 8F

Babai im është një nga njerëzit që dua më shumë. Si të gjithë baballarët edhe ai përpiqet të më plotësojë çdo dëshirë. Edhe pse ndonjëherë e teproj, ai prapë nuk mërëzitet asnjëherë. Për të, ne fëmijët jemi gjëja më e shtrenjtë dhe këtë ai na i tregon çdo ditë, duke na falur dashuri pafund. Ai është model që ne duhet ta ndjekim. Babai më ka mësuar se njeriu ka forcë brenda vetes, të cilën duhet ta përdorë kur i vjen momenti i duhur dhe për gjërat e duhura, por kjo do vullnet dhe durim. Ai na tregon çdo ditë e më shumë se ne duhet të jemi njerëz të mirë në radhë të parë, pastaj nxënës të mirë, sepse vetëm kështu mund të realizojmë ëndrrat tona në jetë. Por gjëja kryesore, që ai ma thotë shpesh si këshillë, është se duhet të duash veten, pastaj të tjerët. Një gjë tjetër që më pëlqen te babi është dëshira e madhe për të bërë punën e tij në mënyrë perfekte. Ai më këshillon se kur të rritem duhet të zgjedh si profesion një punë që duhet ta dua dhe ta kem pasion, sepse vetëm atëherë mund të arrij të bëj atë që dua në mënyrë perfekte, dhe kur puna bëhet me dashuri, del më e mirë. Babai im ka dëshirë t'i ndihmojë njerëzit në nevojë dhe sa herë i jepet mundësia ai i ndihmon edhe nga ana financiare. Ky është një virtut që ai dëshiron të na e trashëgojë dhe ne, fëmijëve të tij. Këto janë disa cilësi që babai im i ka dhe që unë dua t'i kem dhe vetë. Pra, ai është një mësues shumë i mirë për mua dhe motrat e mia. Ndiem me fat që kam një baba si ai dhe çdo ditë do t'ia vërtetoj se sa shumë e dua.

Uesla Subashi 8F



Babi im është njeriu i tretë që dua më shumë në të gjithë botën. Më përpara vijnë mami dhe gjyshja. Babi im, e di që nuk je perfekt, sepse asnjëri nuk është perfekt, por ti je i përkryeri për mua dhe unë nuk do të të ndërroja me asgjë, as me diamantin më të çmuar në botë. Ti je shumë i çmuar për mua. Edhe pse sillesh disa herë i rreptë me mua për arsye të caktuara, në krahasim me bashkëmoshatarët e mi ti më ke lënë dhjetë herë më shumë liri. Ti, gjithashtu, dalëngadalë po më mëson të dal vetë në jetë dhe të jem i zoti i vetes. Fjala 'Baba' është një fjalë dhe një pozicion aq i fuqishëm, aq vendimmarrës dhe aq i rëndësishëm në të gjithë familjen. Unë e di se sa shumë je lodhur duke punuar që në fëmijëri. E di se ti thua se jam dembel dhe duhet të punoj më shumë, por unë të premtoj se nuk do të bëhem ai njeri që ti do që unë të mos jem. Gjithashtu të premtoj se do të kem një rol të rëndësishëm në jetë. Unë dua që gjithçka që ju keni bërë ose më keni dhënë, t'ju shpërblej dhjetëfish ose dhe më shumë. Ty, babi im i dashur, të dua në përjetësi!

Rigel Hashimi 8F

Marsi ka qenë gjithmonë një muaj i veçantë për mua. Jo se tregon fillimin e pranverës apo emrin tim, por sepse është shumë më shumë se aq. Është muaji kur babai im më ngre në pedestal, duke më thënë gjithmonë që: "Është muaj i bekuar, sepse ke lindur ti!" Nga sa mbaj mend, që nga fëmijëria e hershme e deri tani, babai im ka bërë që çdo gjë për mua të jetë një mrekulli. Nuk jam aq e zonja për të thurur fjalë apo për të përshkruar, sepse s'ka fjalë që mjaftojnë për ta bërë një përshkrim për babanë tim. Mund të shkruaja me ditë të tëra dhe prapë s'do të kisha thënë as çerekun e asaj që dua apo ndiej. Kam një imazh të fiksuar në mendjen time që s'e harroj kurrë. Isha e vogël, diku tek katër apo pesë vjeç, dhe ishim në plazh. Babai po tentonte të më mësonte notin. Kur e shikoja më dukej si ato perënditë e deteve që kisha parë nëpër filma, i madh, i fortë, që nuk trembej para asgjëje. Kisha frikë nga uji dhe ai rrinte aty e më mbante duke më thënë: "Mos ki frikë, Marsi, Bushi është këtu me ty, s'të lëshon!" Ai zëri i tij aq i ëmbël dhe i fuqishëm më jepte një ndjesi paqeje e sigurie që mund të bëja çdo gjë. Është ai, zëri i tij, që më ka shoqëruar edhe sot e kësaj dite në gjithë sfidat e mia. Mbaj mend kur fillova të notoja dhe brohorimat e tij "Bravo, Marsi!" Rrija e ktheja kokën dhe nuk i shqisja sytë nga sytë e tij që ndriçonin nga lotët e gëzimit dhe krenarisë që ndiente që unë po notoja vetë. Nuk ishte puna te noti sa ishte tek pavarësia që po merrja, që nuk kisha më frikë dhe që ishte ai që po më ndihmonte të largoja frikën, për t'i lënë vend sigurisë. Që atëherë më mbante gjithmonë për dore për të më shoqëruar në garat e notit. Më dukej aq i madh kur mbante dorën time. Në sytë e mi ishte një gjigant që nuk trembej dhe me fjalët, shikimet, gjestet e tij mendohej të ndikonte tek unë. Tani jam rritur dhe më vjen turp të eci për dore me babanë. E di, gabo, por babi im e di këtë gjë dhe gjithmonë bën shaka duke më thënë: "Shiko, je bërë sa unë, s'ke nevojë më të të mbaj për dore". Dhe unë buzëqesh, por thellë mallëngjehem, sepse unë do të kem gjithmonë nevojë që ai të më mbajë për dore dhe të më këshillojë. Të më flasë, të më shpjegojë çdo gjë që e pyes, siç bënte kur isha e vogël, kur pyesja për çdo gjë "Pse?" Nuk lodhej kurrë nga pse-të e mia, bënte një buzëqeshje, kënaqej e krenohej që unë, vajza e tij, doja të dija kaq shumë rreth botës dhe doja t'i dija të gjitha nga babai im, sepse vetëm tek ai kisha besim. Jam kjo që jam sot veç falë tij. Uroj që të bëhem sa gjysma e atij burri të mrekullueshëm që ka dhënë çdo gjë për mua. Dua ta përqafoj fort dhe t'i them "Faleminderit!" Sikur vetëm të dinte sa shumë e dua dhe e admiroj. Babi im është heroi im dhe shpresoj që ai të krenohet gjithmonë me mua.

Marsi Vigani 8F

Në shkollë neve na kanë dhënë shumë projekte dhe tema për mamin, vëllanë dhe motrën, por rrallë herë për babanë. Edhe babai ka një rol të rëndësishëm në jetën tonë. Babi im nuk është vetëm një "baba" për mua, por edhe një hero, sepse ditë pas dite ai lodhet aq shumë, vetëm që unë të kem një të ardhme të bukur dhe një jetë "perfekte". Edhe pse ai lodhet super shumë, ai përsëri nuk e tregon. Kur ndihem keq, edhe pse ai është shumë i lodhur, përsëri kujdeset për mua. Gjithashtu ai është edhe shoku im i ngushtë, pasi çdo problem që kam ia tregoj dhe ai gjithmonë e gjen një zgjidhje. Unë jam gati të bëj çdo gjë që t'ia shpërblej. Unë gjithmonë kam qenë, jam dhe do të jem krenare për të dhe asnjëherë dhe asgjë s'do ta ndryshojë këtë. Mbështetja dhe dashuria e tij asnjëherë nuk më kanë munguar. Po unë a po ia shpërblej sadopak? Nuk e di, por unë po mundohem. Edhe tani, dhe kur të rritem, asnjëherë nuk do t'i harroj këto mësimë dhe sakrificat që ai bën për mua. Ai për mua është bota ime dhe një person shumë i rëndësishëm. Të dua, babi ...

Tania Kalaci 8F



I shtrenjti babai im! Kam kuptuar shumë nga qortimet e tua. Jam ai, djali yt që bën gjithçka që të ndihesh krenar, ai që ke dhe ke rritur. Ai që është krenar për ty, për edukatën dhe kulturën që i ke dhënë, për dashurinë. Gjithë jetën tënde ke punuar dhe po punon për familjen, duke derdhur djersë dhe mund, pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na plotësuar të gjitha nevojat, duke na mundësuar të gjitha kushtet. Kur unë të rritem dhe të dal në jetë, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh fëmijë, të krijosh familje. Babi im, ka shumë fjalë që do të doja të të thoja. Të dua shumë dhe jam shumë i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti.

Albis Spahiu 8G



Bota ka njohur shumë heronj, shumicën e të cilëve nuk i njohim me emër. Ajo që ne dimë është se ata kanë dhënë më të mirën e tyre dhe në fund kanë marrë një çmim si formë shpërblimi. Ka një hero në jetën time dhe ai është pa dyshim babai im. Ky hero nuk mund të fluturojë, nuk shndërrohet dhe as nuk mban një shpatë në dorë. Por ky hero është shumë special, sepse si këmbim nuk ka kërkuar kurrë një çmim. Ai është personi i cili më ndihmon të ngrihem sa herë që rrëzohem. Është ai që drejton binarët me ne fëmijët e tij dhe arrin të ndajë drejtësinë me paanshmëri. Edukimi i tij mbështetet në pesë shtyllat e jetës dhe thjeshtësia e tij rrjedh si burimi i lumit. Prezenca e tij rrezaton fuqi dhe dashuri. Pas çdo humori të tij dihet se fshihet një mesazh. Dhurata më e madhe që ai më ka dhënë është besimi që ka tek unë. Reflektimi i dashurisë dhe kujdesit të babait është përcjellë pa kurrfarë dyshimi tek ne, fëmijët e tij. E ndiej veten njeri aq me fat, sa nuk mund ta përshkruaj dot. Dhe, e dini përse? Sepse babai më i mirë në botë më përket mua. Për mua rrezaton fuqi dhe dashuri...

Vera Biba 8F

I Shtrenjti Babai Im, në këtë letër që të kushtoj ty, dua të them se sa të dua. Ti je kujdesur për mua dhe më ke rritur. Më je gjendur pranë sa herë që unë të kërkoja. Do të doja të të komplimentoja për përkushtimin tënd ndaj meje, por tani unë nuk i perceptoj dot vështirësitë e të qenit prind. Prandaj po të falenderoj për vendosmërinë tënde, sa për të gjithë jetën time. Sepse në të vërtetë ajo është më shumë merita jote sesa e imja. Ti je babai më i mirë sepse je i rreptë, por në të njëjtën kohë shumë i dashur dhe zemërgjerë. Ti më qorton kur unë bëj gabime, sepse vërtet e meritoj dhe përsëri nuk më pëlqen, sa të konfliktuar që jemi! Dhe gjithsesi ti vazhdon e bën punën tënde, sado që ndonjëherë unë nuk e bëj timen, prandaj të falenderoj që ke qenë babai im.

Albi Muça 8G



"Baba", ndoshta nuk është fjala e parë që themi, por pa diskutim një nga personat që do ta kemi gjithë jetën pranë. Ashtu si dhe nëna, ai do të na udhëheqë dhe do të na mbështesë në rrugën e jetës. Ai do të na mësojë ndryshimin mes së mirës dhe së keqes, do jetë gjithmonë aty për ne, si një hero që do të na ndihmojë t'i bëjmë ballë problemeve dhe do të luftojë për ne. Ai do të bëhet shoku ynë më i mirë, ku do të mbështetemi pa frikën se do të largohet apo se s' do të na falë dashurinë që na duhet. Babai do të jetë shembulli që do të ndjekim me besimin e plotë se do na mësojë gjithmonë gjënë e duhur. Fakti që kemi një baba, tek i cili mbështetemi, të kërkojmë ndihmë, të ndajmë çastet e lumtura dhe ato të trishta, duhet të na bëjë të ndihemi si njerëzit më me fat në botë. Ndiem shumë fatlume për faktin që babai im është gjithmonë aty për mua. Dua ta falenderoj dhe t'i them se do ta dua gjithmonë dhe do të jetë gjithmonë hero në sytë e mi.

Ergita Zenelhasani 8G



I shtrenjti baba, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën e jetës dhe shoku më i denjë që kam. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë aty për mua. Je këshilluesi më i mirë e që më bërë të mos gaboj kurrë në jetë. Të dua shumë sepse kam gjakun tënd, sepse jam djali që nuk të zhgënjeu kurrë. Gjithmonë do të ndihem krenar për ty. Ke qenë babai ideal për mua. I tillë do mbetesh përgjithmonë...

Erik Tomini 8G

Babai im, e vërteta është se unë kurrë nuk do të të ngre dot në piedestalin që meriton. Nuk do të mund të jem kurrë aq e zonja për të thurur fjalë që ta shpjegojnë krejt dashurinë dhe respektin që kam për ty. Gjithçka dëshiroj për të ardhmen është te eci në hapat e tu, të gaboj aq bukur sa gabon ti. Prehri yt ka qenë jastëku më i mirë, aty ku kam derdhur qindra lot dhe kam gjetur mbështetjen më të mirë të mundshme. Nuk ka fjalë që mund ta shpjegoj sa mirënjohëse të jam dhe do të të jem.

Erma Zeneli 8G



Baba i dashur, sa fjalë të bukura dua të të them sot, por e kam të vështirë, sepse sado shumë të jenë, prapë nuk mjaftojnë ... Ti je njeriu që më mbështet në çdo hap që hedh, je heroi im, je shembulli më i mirë në jetën time. Çdo ditë e kaluar me ty është e veçantë sepse ti je i tillë. Kemi kujtime të bukura së bashku, që janë skalitur thellë në kujtesat tona dhe që koha s'i fshin dot. Dua të të them se do të përpiqem të të bëj krenar, por për ta arritur këtë, kam nevojë për siguri e mbështetje dhe e di se këto do t'i marr gjithnjë prej teje...

Alvi Resulaj 8G



Heroi im...

Ai kurrë nuk kërkon lëvdata.
 Ai kurrë nuk është dikush që mburret.
 Ai thjesht vazhdon të punojë në heshtje.
 Ëndrrat e tij fliten rrallë,
 Dëshirat e tij janë të pakta.
 Dhe shumicën e kohës shqetësimet e tij,
 Do të vazhdojnë të pashprehura.
 Ai është atje ... një themel i fortë.
 Nëpërmjet të gjitha stuhive tona të jetës,
 Një dorë e fortë për t'u mbajtur,
 Në kohë stresi dhe grindjesh.
 Një mik i vërtetë ku mund të kthehem,
 Kur kohët janë të mira apo të këqija.
 Një nga bekimet tona më të mëdha,
 Njeriu që ne e quajmë Baba.

Gezjon Muça 8G

Thonë që fëmijët janë shëmbëlltyra e prindërve të tyre. Krenohen ata prindër që sjellin në jetë fëmijë të shëndetshëm e të mbarë. Familja është oazi i dashurisë dhe qetësisë. Ajo është si një varkë e vogël që lundron pa frikë, kur ka timonier të zot. Timonieri i kësaj varkë është babai. Babai që unë e kam idhull. Unë dua të jem si babai im. T'i ngaj atij në shikim, në të folur, të qesh si ai, të dua si ai. Qenia e tij rrëzëllen. Mbushet shtëpia e ndriçon plot dritë kur ai vjen. Fjala baba të burrëron, të bën më të sigurtë në familje. Nga ai marrim gjithçka. Mbushet goja plot kur thërret fjalën 'baba'. Ai është njeriu më i palodhur për ne. Prandaj unë dua t'i ngaj atij. Zgjuarsia dhe praktikiteti i tij më integron, më bën të jem si ai, se mbase luftoj edhe më shumë që punët të shkojnë përpara. Vërtet unë them se i ngaj edhe në trup. Ashtu si dhe babai im, jam shtatlartë. Qenia ime është shëmbëlltyrë e tij, ndaj ai është shembulli im më i mirë.

Ivjon Subashi 8G



Babushi im, kështu të kam thirrur gjithmonë, por tani e tutje do të të thërras HEROI IM! Ti je me të vërtetë heroi im, sepse ti je ai që më ke bërë krenare për ty, për edukatën, për kulturën dhe dashurinë që më ke falur e për shpresën që më ke mësuar mos ta humbas kurrë. Gjithë jetën tënde po punon për familjen pa pushuar, duke na plotësuar shumë nga ato dëshirat e tepërta, duke na plotësuar të gjitha kushtet, duke na dhënë gjërat për të cilat kemi nevojë. Ti ke ditur të përçosh tek ne një frymë të ngrohtë prindërore. Çdo ditë e jetës sime ka qenë e lumtur dhe vazhdon të jetë e tillë, sepse në jetën time, përkrah meje ka qenë gjithmonë një hero që më ka shoqëruar dhe ke qenë pikërisht ti, heroi im! Energjitë e tua janë të pashtershme, nuk ke thënë asnjëherë jo, nuk ke thënë se je lodhur, por ke vazhduar të ecësh përpara. Uroj që të jetosh sa më gjatë dhe të shohësh frytet e punës tënde të palodhur. Të premtoj se një ditë do të të bëj krenar për mua, për vogëlushen tënde që të do sa e gjithë bota.....E ç'botë them unë, me dashurinë që kam për ty bota duket shumë e vogël. Nuk do të mjaftojnë kurrë fjalët për të shprehur dashurinë që kam për ty! Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, për mbështetjen, për buzëqeshjen.....Kam shumë fjalë për të të thënë, por më e rëndësishmja është se ti je lumturia, krenaria, shpresa dhe HEROI IM, që shpresoj të më shoqërojnë gjatë gjithë jetës sime.

Jesna Demushi 8G

Çdo njeri ka dikë në jetë, i cili ka ndikuar shumë në krijimin e personalitetit të tij, për të gjitha gjërat, nga ato më të voglat e deri te më të mëdhatë. Në përgjithësi, këtë forcë e mbartin ata individë që kanë lënë gjurmë apo kanë bërë ndryshime thelbësore në jetët e tyre apo kanë ndikuar te të tjerët. Ndryshe këta njerëz quhen "Heronj". Kur përdorim fjalën 'hero' gjithmonë mendja të shkon te një "supermen" apo dikush që ka cilësi mbitokësore apo te dikush që ka bërë gjëra të jashtëzakonshme. Për mua, hero është edhe ai që në përditshmërinë e tij nuk bën gjëra të jashtëzakonshme, por që të bën të ndihesh e veçantë çdo ditë. Ai që të qëndron pranë, të përgëzon, të udhëzon, të dëgjon, të korrigjon, që nuk harron të të puthë çdo mëngjes dhe çdo darkë të përkëdhel, të përqafon. Për mua ky është heroi im dhe ai është Babai im. Njeri i thjeshtë, i dashur, bashkëpunues, punëtor dhe shumë bujar. Për sytë e çdo vajze, babai është heroi i tyre, pasi lidhja midis vajzës dhe babait është e vjetër sa edhe toka. Por disa kanë një lidhje më speciale dhe këtu bëj pjesë dhe unë. Që më e vogël unë isha gjithmonë pranë tij, këtë ma tregojnë të gjithë të afërmit dhe familjarët e mi, por edhe fotot familjare. Ai është njeriu me ndikimin më të madh tek unë. Besoj se ai ka ndikuar shumë në formimin e personalitetit tim, dhe besoj se ky ndikim do të vazhdojë gjithmonë. Pa dyshim që ai është dhe do të mbetet heroi im.

Kejsi Nuriu 8G



Krahët e tu janë mbrojtja ime,
që më sigurojnë se çdo gjë do të bëhet më mirë.
Dora jote, mbështetja ime,
më ngre lart kur vështirësitë e jetës mundohen të më ulin poshtë.
Zëri yt më bën të fortë,
më tregon çfarë është e saktë e çfarë nuk shkon.
Buzëqeshja jote i tregon të gjitha,
BABA, të dua më shumë se çdo gjë në botë!

Klaudia Plevneshi 8G



I shtrenjti baba, e di të kam lënduar, por ti prapë më do dhe unë të dua shumë, edhe pse asnjëherë s'ta kam thënë. Shpresoj që kjo letër të jetë një nga kujtimet më të bukura për ty, baba. E bëj këtë gjest edhe pse çdo ditë të kam në shtëpi e të shoh, por duke më njohur ti e di se më së miri se ato që ndiej i them nëpërmjet fletës. Prandaj doja të thoja që të dua shumë e je krenaria dhe shpresa ime. Ke qenë heroi im dhe akoma je i tillë, të dua pafund, të dua sa ti nuk e imagjinon dot. E di se të kam zhgënjyer pafund dhe je mërëzitur shumë prej meje. Unë thjesht doja të të thoja më fal dhe se të dua pafundësisht, babai im.

Klisilda Tahiri 8G

I shtrenjti babai im, gjithë jetën tënde po punon për familjen, duke punuar pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na dhënë të gjitha ato që kemi nevojë. Babi, kur unë të ndërtoj familjen time, do ta kuptoj sa e vështirë është të jesh prind...Ju më keni shpëtuar në çdo situatë të vështirë në jetë, si për shembull në shkollë, kur më bullonin shokët. I shtrenjti baba, ti dhe mami jeni pasuria ime, ju dua shumë. Por në veçanti ty, babi, dua të të them se je babai më i mirë në botë.

Luan Levendi 8G



Baba, ti je ajër pa të cilin nuk mund të jetoj.
Ti je Idhulli im, pa të cilin nuk mund të vazhdoj.
Dielli që më jep ngrohtësi,
Oqeani që më jep freski.
Unë të shikoj ty,
Dhe guximi më ripërtërihet.
Dora jote është mbështetje për mua,
Zemra jote, ëndrra ime,
Bota jote, mbretëria ime.
Njeriu më i dashur në botë,
Forca më e madhe në Tokë.
Nëse të gjithë kanë një hero,
Heroi im je ti.

Tenola Kurti 8G



Baba është ai person, që gjatë gjithë jetës sonë do të na ndihmojë që ne të zgjedhim rrugën e duhur. Është ai, i cili në momente të vështira na vjen në ndihmë me këshilla të shumta për jetën, dhe që na këshillon se ne duhet të jemi gjithmonë të fortë, në çfarëdo situatë. Babai është një nga personat e vetëm që pranon të të dojë pa kushte. Ai person që, pavarësisht pamjes, personalitetit, zgjedhjeve të tua, të do. Ky është personi që asnjëherë s'të kundërshton, pasi kurrë s'e ka për qëllim të të lëndojë. Vetëm do të të plotësojë dëshirat e tua, për të parë buzëqeshjen tënde çdo ditë, ta dëgjojë të qeshurën tënde çdo ditë. Heroi i çdo vajze është babai i saj, siç është edhe për mua babai im. Ai gjithmonë është i dashur, punëtor, dhe, edhe sikur të lodhet, asnjëherë nuk e shfaq atë. E meriton pa kundërshtime titullin "Hero". Edhe pse ai nuk ka superfuqi, ai është personi më i jashtëzakonshëm që kam njohur në tërë jetën time, pasi është ai që ma dha atë. Pra, pa diskutim, Babai është hero i im.

Nikol Dalipi 8G

Mund të shkruaj për orë e orë të tëra për babanë tim, por asgjë nga ato që mund të shkruaj nuk mund të jetë e mjaftueshme për të përshkruar dashurinë që kam për të. Në shumë momente të ditës, babai ndodhet në mendimet e mia dhe mes mendimeve më kujtohen këshillat që ai më jep për çdo gjë që unë diskutoj me të. Dua ta falenderoj babanë tim për familjen time të bukur, për dashurinë që më ka falur, për besimin që ka pasur dhe ka tek unë, për mbështetjen që më ka dhënë dhe për gjithçka bën për ne. Babai është ai që më mëson se çfarë do të thotë të ndjekësh ëndrrat, dhe më frymëzon të jem vetvetja. Unë jam shumë krenare për babanë tim dhe mundohem që çdo ditë e në vazhdim ta bëj atë të ndihet krenar për mua.

Babai im është me mua çdo herë që marr frymë, në çdo hap që hedh, në çdo vendim dhe zgjedhje që bëj. Ai është i skalitur në ndërgjegjen time si një figurë perfekte, është i gdhendur në ambiciet e mia si shembulli që duhet të ndjek. E adhuroj angazhimin e tij në çdo gjë që bën dhe dëshirën e tij të madhe që unë dhe vëllai im të mësojmë sa më shumë dhe të bëhemi njerëz me vlera. Dua të falenderoj babanë tim për gjithçka që kam dhe gjithçka që jam.

Stelakea Mërtiri 8G



Të shkruash për babin nuk është aq e lehtë. Janë me qindra fjalë që vërshojnë në mendje dhe me mijëra ndenja që më pushtojnë. Të shkruash për atë, që për vite me radhë ka qëndruar afër meje, duke më dhënë lumturinë më të madhe, imazhin e çmuar atëror dhe dashurinë më të pakufishme. Është krejt e natyrshme ta mendoj si hero, sepse i tillë është. Këtë e dëshmon sakrifica e madhe që ai bën për familjen tonë. E adhuroj kur hap derën dhe shtëpia merr një pamje tjetër, e adhuroj akoma më shumë kur motra shkon me vrap drejt tij dhe e them me bindje se ajo është pamja më e bukur në botë. Për vite me radhë më kanë thënë që i ngjaj atij dhe ndihem krenare për këtë. Sepse gjithmonë e kam adhuruar mirësinë që ai përcjell, qetësinë që krijon prania e tij, zërin, hapat e tij, përpjekjet që bën për të bërë jetën tonë të lumtur. Në këtë shkrim do të doja të përcillja një mesazh jo vetëm për heroin tim, por për çdo baba tjetër në këtë botë. Pa ata bota do të ishte bosh, nuk do kishte dashuri, madje as paqe në familje. Çdo fëmijë ka një idhull, imi është babi im, hero i im.

Xhenifer Xhaferi 8G

E ku ka si ty o babi im, ti mua më mëson gjëra të rëndësishme për jetën, si të sillem, si të veproj në raste të vështira. Edhe pse ndoshta jo gjithmonë i di përgjigjet e pyetjeve të mia, ti përpiqesh të m'i shpjegosh sa më qartë të gjitha. Ku do të isha unë pa ty, pa ndihmën tënde, pa mbështetjen tënde çdo ditë jeta ime s'do të kishte kuptim. Jo vetëm që punon pa pushim, që unë të kem gjërat që dua e të shkoj në shkollë, por ti gjithashtu përpiqesh të kalosh sa më shumë kohë me mua. Ti lodhesh çdo ditë në punë dhe unë e kuptoj se sa e vështirë është për ty të kalosh kohë me mua, duke pretenduar sikur lodhja nuk të mundon, por unë të kuptoj dhe nuk ke pse përmbahesh para meje, babi. Ti je shembulli që unë ndjek çdo ditë. Lodhjen që kalon për të më bërë të lumtur unë s'do ta harroj kurrë. Më fal nëse ndonjëherë të mërzis, kurrë nuk e kam pasur për qëllim të të shoh të trishtuar, mbi të gjitha prej meje. Të uroj buzëqeshje në fytyrë gjithmonë. Të premtoj se çdo ditë do të përpiqem të arrij të bëhem vajza që ti do të doje të isha dhe do të të bëj krenar për mua, por në jetën time asgjë s'do të ishte e mundur pa ty dhe mbështetjen tënde. Uroj ta dish se sa i rëndësishëm je për mua dhe se sa shumë të dua.

Tea Çerenishti 8G



I shtenjtë im,
 Përballesh me sfida e nuk përkulesh...,
 Sfida është adrenalina për ty.
 Dashuron me shpirt të drejtën e të vërtetën,
 Kompromisi nuk ka vend te ty.
 Dhuron energji, forcë dhuron,
 Me një pasion që kurrë s'të shteron.
 Më udhëheq në jetë me virtytin tënd,
 Me intuitën tënde që kurrë s'gabon.
 Je I dashur, je mendjendritur,
 I palodhur për mua je gjithmonë.
 Me sjelljen tënde më edukon,
 Me forcën tënde më frymëzon,
 Me një energji që vetëm buron,
 Je fisnik, je madhështor,
 Të kam idhull, si një perëndi.
 Në qoftë se bota ka një perandor,
 Për mua ai je ti!

Meri Berisha 8G

I dashur babai im, jam përpjekur shumë të shkruaj këto fjalë të ngrohta për ty dhe përsëri nuk e di çfarë është ngatërruar aty. Ne kemi pasur ditë të lumtura dhe të trishtuara. Edhe kur kam qenë i nevrikosur me ty, ti përsëri me mbaje pranë vetes dhe më jepje këshilla për të vazhduar përpara. Ti asnjëherë nuk më ke vënë në rrugë të gabuar dhe asnjëherë nuk do të më vësh. Unë jam ky që jam vetëm prej teje. As nuk do e imagjonoja dot si do të jetoja pa ty. Ti je ai që më ka frymëzuar të eci përpara dhe asnjëherë të mos ndaloj. Të lutem, mos ndalo së bëri këtë gjë!

Ani Bitri 8H



Për mua babai im është si një hero, i cili më vjen në ndihmë sa herë që unë kam nevojë për të. Për mua ai është shembulli më i mirë dhe sa herë që e shoh më lind pyetja: "A mund të bëhem ndonjëherë si ai ose më i mirë?" Babai im është i sjellshëm dhe shumë i kujdesshëm në veprimet e tij. Ai silltet mirë me të tërë dhe kur kanë nevojë, ai i ndihmon. Ndonjëherë më qorton, por e di që gjithmonë është për të mirën time, sepse besoj se çdo baba do që fëmija e tij të bëhet më i mirë se vetja. Kur bisedoj me të unë ndihem i qetë. Për mua ai është dhe një vëlla i madh, i cili më këshillon për të arritur më të mirën. Ai po ashtu më ndihmon t'i përballoj frikërat e mia. Por në familje nuk jam vetëm unë, sigurisht ai është suportues i mirë edhe për motrën time dhe një bashkëshort i mahnitshëm për mamanë time.

Antonio Dimo 8H



Babai im është një nga personat më të shtrenjtë në jetën time. Ai më ndihmon shumë, duke më dhënë këshilla të rëndësishme, që asnjëherë nuk do t'i harroj. Dashuria ime për të është shumë e madhe dhe e pakrahasueshme. Gjithashtu edhe e atij për mua. Gjithmonë, kur kam qenë në probleme të ndryshme, babai më ka bërë që të besoj në vetvete dhe që të mos dështoj. Edhe pse unë kam bërë shumë gabime këto kohë, ai m'i ka falur ato dhe i ka lënë të kalojnë. Babai im është shumë i punës. Ai çdo ditë dhe natë lodhet për të na siguruar të mira si shkollimi, ushqimi dhe argëtimi. Është një njeri i veçantë, që më inspiron mua çdo ditë, për të dhënë gjithmonë më të mirën. Kur unë doja që të më plotësoheshin dëshirat, ai me sa mundësi të kishte, por edhe kur nuk mundej, ma plotësonte atë, duke më bërë shumë të gëzuar. Jam rritur me dashuri nga të dy prindërit dhe për këtë jam shumë i lumtur. Jam shumë krenar që kam një baba kaq të mirë, saqë as edhe në ëndrra nuk mund të imagjinohet. Shpresoj që të gjithë kështu të mendojnë për baballarët e tyre. Edhe në qoftë se ne kemi ndonjë problem me babanë, edhe gjithashtu me mamanë tonë, ne duhet t'i lëmë pas dore zënkat me to, sepse prindërit janë gjëja më e shtrenjtë që ne kemi. Është një shprehje që thotë se "Prindërit janë gjëja më e shtrenjtë dhe asnjë tjetër nuk na do aq shumë sa ata..."

Besim Pashaj 8H

Babai im është idhulli im, është njeriu që çdo herë më ka ndihmuar të eci përpara dhe që gjithmonë më gjendej pranë, që në moshë të vogël. Unë me të kam formuar disa lidhje sikur të ishim shokë me njëri-tjetrin, ku unë flas me të për çdo gjë dhe më duket sikur e kam një vëlla më të madh që më këshillon. Kam shume respekt për të, sepse ai më pranon kështu siç jam dhe nuk më krahason me asnjëri tjetër, por më ndihmon të bëhem një njeri sa më i mirë. Gjithashtu, ai ka shumë besim tek unë për çdo gjë që unë bëj, dhe prandaj mundohem t'i bëj sa më mirë, sepse nuk dua ta zhgënjej as atë dhe as veten time.



Bjorni Hoxha 8H

Babai është një person i shtrenjtë për mua. Jam rritur pranë tij, me ngrohtësinë, fjalën e përkëdhelinë e tij. Një shembull i shkëlqyer që Zoti më ka skalitur... Është i vetmi njeri, i cili është i gatshëm çdo herë të dëgjojë problemet e mia. Këshillat e tij më kanë ndihmuar dhe do të më shërbejnë në të ardhmen. Gjithmonë më ka ndenjur pranë, në ditë të mira dhe të këqija. Dua të ndjek hapat e tij, që të bëhem një njeri i suksesshëm. I jam shumë mirënjohës babait tim që më ka dhënë edukatën dhe sidomos dashurinë. Të falenderoj për çdo dëshirë që më ke plotësuar, sadopak e vogël që të ketë qenë! Për të folur rreth teje ka edhe shumë fjalë të tjera, të cilat nuk mund të shprehen. Gjithmonë do të mbetesh "Heroi im".



Blin Curaj 8H

Personi më me ndikim në jetën time ndoshta nuk është as i vetëdijshëm për gjërat që më ka mësuar, apo se sa peshë ka në ekzistencën time. Ky person ka qenë pranë meje në çdo çast, që në momentin kur kam hapur sytë për herë të parë e deri tani. Ai është një mësues, një udhëheqës, një burim force, një suport, por më e rëndësishmja: ai është BABAI IM. Babai im është ai që më mundëson gjithçka që kam nevojë në jetë. Është ai që do të sakrifikonte çdo gjë për mua. Baba quhet ai që beson tek ti, kur çdokush të ka kthyer shpinën. Ai ndoshta nuk ka shpëtuar njerëz nga një ndërtesë në flakë apo nuk ka sakrifikuar veten për të tjerët, por ai është hero i im! Ai që gjendet pranë familjes së tij në lumturi e trishtim. Kur unë jam e mërzhitur, është ai që dëgjon ankesat e mia. Ai nuk është vetëm një baba biologjik, por është një nga pjesët më të mëdha në zemrën time. Babi është idhulli im. Dua që në jetë t'i arrij qëllimet e mia, ashtu si ai i ka arritur të tija. Të bëhem dikush, që ai të krenohet me zemër e të jetë babai më i lumtur në botë. E falenderoj për çdo gjë që bën për ne. Ai do jetë babai im e mbështetja ime në çdo moment. Në çdo çast, ai do të jetë pranë meje, duke buzëqeshur e duke më thënë: "Bravo, ia dole!" E di që ndoshta nuk të falenderoj shpesh, por dije që je gjithçka për mua. Të dua dhe do të të dua më thellë se çdo oqean!

Elsina Buzi 8H

Babai im është heroi im dhe personi ideal i jetës sime. Ai është shumë i sjellshëm, i singërtë dhe i përkushtuar, inteligjent dhe i dashur. Ai gjithmonë ndihmon të tjerët në problemet e tyre. Babai im ka shumë durim. Ai gjithmonë i kupton ndjenjat dhe pikëllimin tim. Ai më përkrah në të gjitha problemet e mia dhe më udhëzon. Ai më ka mësuar gjithmonë vlera të mira. Ai kalon kohë me mua çdo ditë dhe më pyet për aktivitetet e mia në shkollë. Ai është person shumë i veçantë në jetën time. E dua shumë babain tim. Ai është babai më i mirë në botë.

Denis Gjoka 8H



Shumë fëmijë zgjedhin që për idhuj të kenë njerëz të famshëm si këngëtarë apo aktorë, por unë zgjedh babanë tim. Zgjedh atë, sepse mënyra se si përpiket, pa u lodhur, për të mbajtur familjen tonë të lumtur është ajo çka, për mendimin tim, e bën atë unik. Babai im rrallëherë më ka thënë 'Jo', por edhe për ato herë që më ka thënë e falenderoj, sepse ajo 'Jo' më ka mbajtur larg gabimeve, për të cilat sot mund të pendohesha. Nuk do të mjaftonte ajri që unë do të merrja për t'i thënë 'Faleminderit!' babit tim, por në këmbim të fjalëve përpikem ta bëj krenar në çdo moment dhe t'i tregoj se është merita e tij për personin që unë jam sot. Sigurisht që do jetë merita e tij dhe e mamit për personin që unë do të jem. Jam e sigurt se në bazë të këshillave dhe mësimave që ata më kanë dhënë do të jem personi i duhur që do t'i përfaqësojë ata në të ardhmen. Në marrëdhëniet baba - vajzë dashuria është një çështje subjektive, sepse shumë vajza, mes tyre edhe unë, zgjedhin që mos ta nxjerrin në pah të gjithë dashurinë që ato kanë për babanë e tyre, por edhe baballarët duhet të jenë të sigurt se vajzat e tyre i duan ata pafund. Në vajzat duhet të jemi të ndërgjegjshme se pas një ditë pune të lodhshme, një përqafim apo një puthje do ishte shumë më mirë se një sy gjumë apo pak televizor, për të. Babit i them vetëm diçka: "Mos harro se bashkë do të mbrojmë dhuratën më të çmuar nga Zoti, familjen tonë. Uroj që të jetosh sa më gjatë dhe të shohësh frytet e punës tënde të palodhur, të më shikosh mua dhe vëllanë në një të ardhme të sigurt dhe me një jetë e familje të lumtur, siç është ajo e jotja sot. Babi, të premtoj se në çdo moment do të të bëj të ndihesh krenar për mua, për vajzën tënde të vogël, që të do sa e gjithë bota, edhe pse bota është e vogël krahasuar me dashurinë time ndaj teje. Të falenderoj për gjithçka që ke bërë dhe vazhdon të bësh për mua, për këshillat, mbështetjen e buzëqeshjet. Mos harro se sa fort të dua! Ti do të mbetesh unik për mua..."

Estel Fype 8H

Për vite me radhë më kanë thënë se i ngaj tim eti dhe gjithmonë e kam pritur shumë krenarisht. E kuptoj që çdo fëmijë shprehet me krenari për prindërit e tij. Ndiej nga brenda që kjo krenari tek unë është shumë e madhe. Shfaqesh para syve të mi i përkulur mbi libra, me orë të tëra mbi ta dhe gjithmonë duke i shkruar ato. Më rrite dhe më ushqeve me idenë që libri është shoku im më i mirë. Më edukove me ndjenjën që duhet të punoj fort jo vetëm për vete, por dhe për brezat që vijnë. Nuk mund ta harroj gazin e syve të tu kur promovimin e librave që ke botuar e ndjekin dhe mbështetin qindra studentë që ke formuar, shumë personalitete të shkencës. Janë mbresëlënëse rrëfimet që sjell nga përvojat e ndryshme prej konferencave shkencore e ndërkombëtare. Heroi im i shtrenjtë, përveçse je një mjek i aftë, pedagog i nderuar, koleg bashkëpunues, njeri shumë human, familjar i devotshëm, je dhe Ai i dashuri, i kujdesshmi, i buzëqeshuri ynë. Është e vërtetë se më do si asgjë në botë dhe madje me rrëqeth kur më thua se: "Unë lë kokën për ty", por për mua je më i shtrenjti në botë. Të dua, baba!

Enio Boçi 8H



Babai im është një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Ai më ka ndihmuar për çdo gjë. Më ka bërë që unë të reflektoj për jetën dhe të ardhmen time. Me ndihmën e tij kam kuptuar dhe kam mësuar shumë gjëra, të cilat jam e sigurt që do të më nevojiten në jetën time. Për mua ai është një idhull i denjë, një hero. Është shoku im më i mirë. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar ai më është gjendur pranë, si një busull, duke më orientuar në drejtimin e duhur. Çdo fjalë e tij ka qenë një mësim për mua dhe asnjëherë nuk ka shkuar kot. E di që këto lloje letrash u dedikohen zakonisht nënave, por duhet ta dimë se harrojmë ndonjëherë pa përmendur një njeri po aq të rëndësishëm e me po aq shumë vlera në jetët tona. Ky njeri për mua je ti, Babai Im.

Keltjona Shpata 8H



Janë të panumërueshme sakrificat që babai im ka bërë për mua dhe vëllanë tim. Është e papërshkrueshme dashuria që buron vetëm nga një zemër, zemra e tij. Shpresoj shumë fort që ai ta dijë se është idhull për fëmijët e tij. Që fare e vogël kam qenë e mahnitur nga personaliteti i tij. Asnjëherë nuk ka reshtur së kënaquri dëshirat e fëmijëve të tij. Jo vetëm baba, por dhe shoku im më i mirë, mbështetja dhe forca në një moment të vështirë. E di që ke bërë shumë për mua, por edhe unë do të të bëj të ndihesh njeriu më krenar në botë. E di, ka shumë njerëz që thonë se vajzat e kanë më të vështirë të shprehen te babai, sesa te nëna. Por ta dish që për mua kjo nuk vlen, sepse tek ti unë gjej mbështetjen e duhur. Ka raste kur vetëm ti më kupton, ndërkohë që të tjerët jo. Je ti, babi im, forca e pashteruar, fuqi për shpirtin tim.

Silva Qëndro 8H

Babi im është shoku im i ri. Deri tani ishte vetëm babi, por gjërat kanë filluar të ndryshojnë që kur kemi filluar të bëjmë bashkë aktivitete të ndryshme. Kur bleva kompjuterin mendova që do të mundesha ta ndërtoja të gjithin vetë. Duke punuar ngecja dhe u mërzita, por kur erdhi babi të më ndihmojë, gjërat u rregulluan. Munda që më në fund të gjeja disa tela ose të shtrëngoja disa vida. Kur kompjuteri u ndez të dy u gëzuam shumë që punonte. Babi im gjithashtu më ndihmon që të rregulloj probleme. Më thotë se çfarë të fshij e çfarë jo. Ne edhe punojmë bashkë në kompjuter.

Babi im di edhe të bëjë fotografi shumë të bukura. Sa herë që shkojmë diku, shkrep disa foto për ti mbajtur kujtim. Ai më ka mësuar edhe mua që të bëj foto shumë të bukura, më ka dhënë edhe një aparat fotografik shumë të mirë. Ne gjithashtu punojmë që ti rregullojmë fotot në kompjuter. Pasi i rregullojmë, ato dalin të mahnitshme.

Ne kemi edhe shumë qejf që të dalim me biçikleta. Babi im bën disa rrugë shumë të gjata, por kur del me mua shkojmë tek liqeni, disa herë edhe jashtë rruge. Për vit të ri më bleu një biçikletë me goma të mëdha, që të kemi mundësi të ecim kudo, edhe në rrëzë. Babi më ka ndihmuar edhe që të mësoj disa numra në biçikletë, si për shembull të ngre rrotën e përparme.

Unë kam ngelur pa telefon që kur më ka rënë në det, dhe babi më ndihmoi që të gjeja një të ri. Po kërkoja për një telefon të ri jo shumë të shtrenjtë sepse nuk më nevojitej shumë i avancuar, por të gjithë që shikoja e kishin çmimin shumë të lartë. Thirra babin për ndihmë dhe gjetëm një telefon shumë të shpejtë dhe të ri për një çmim shumë të ulët. U gëzoja shumë kur e pashë.

Me babin unë bëj edhe windsurf. Që kur kam qënë i vogël ma ka mësuar këtë sport dhe që atëherë më ka pëlqyer. Ne akoma dalim gjatë verës me windsurf për të parë zona të plazhit që nuk i kisha parë kurrë. Por ky nuk është i vetmi sport që bëj me të. Ai më ka mësuar edhe për SUP (Stand Up Paddling). Ky është një sport i ri, në të cilin merr një bord sërri dhe i jep me lopatë. Është një mënyrë e lezetshme për të lundruar në det.

Babi sigurisht më mëson që t'i bëj gjërat mirë duke më dhënë shembullin e tij dhe pikërisht për këtë, ai është heroi im.

Erlis Ciko 8H



I shtrejtji babai im! Dua të të them se të jam shumë mirënjohës për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë pa kushte që më dhuron çdo ditë. I vlerësoj pafund të gjitha sakrificat që ke bërë për mua. Gjithnjë ke punuar dhe ke sakrifikuar për fëmijët e tu. Edhe pse mund të kem gabuar ndonjëherë, ke qënë ti që më ke bërë t'i shoh e t'i rregulloj gabimet e mia. Jam shumë i lumtur dhe krenar që je babai im dhe do të përpiqem që edhe ty të të bëj krenar për djalin që po rrit.

Itilio Broci 8H

Kur mendoj për një baba, në mendje më vjen një figurë burrërore, e rreptë. Por babai im është krejt ndryshe. Figura e tij më sjell në mendje dashurinë, respektin dhe dhembshurinë. Marrëdhënia ime me babain është nga ato marrëdhëniet herë si shoku me shoqen e herë si mesuesi me nxënësin. Ai suporton çdo vendim timin, dhe plotëson çdo dëshirë timen, me aq mundësi sa ka. Babai im është idhulli im, personi që çdo ditë më inspiron të bëhem një njeri po aq i përsosur sa ai vetë. Këshillat më të bukura dhe më kuptimplota për jetën i kam marrë nga babai im. Këshilla më e mirë që kam marrë prej tij është: "Jetën tënde mund ta ndryshosh vetëm ti dhe askush tjetër s'mund të ketë kontroll mbi atë." Por kjo këshillë është një nga të shumtat që ai më ka thënë. Përveç ndikimit që ai ka tek unë në anën shpirtërore, ai ka një ndikim të veçantë në familjen tonë. Edhe pse lodhet shumë në punë, gjen gjithmonë kohë të shpenzojë me familjen. Por virtytet kryesore që ka babai im janë dhembshuria dhe arsyetimi. Për çdo gabim që bëj unë ose vëllai im, ai gjithmonë fal dhe e kupton se jemi të vegjël dhe se çdo njeri gabon. Unë do t'i jem gjithnjë mirënjohëse për kohën që më ka kushtuar, për dhembshurinë që ka treguar, për këshillat që më ka dhënë, për jetën që më ka dhuruar dhe që ka qenë aty edhe kur askush nuk kishte besim tek unë, edhe kur nuk kam dhënë maksimumin dhe e kam zhgënjyer. Babai Im, Je Heroi Im.

Klea Çela 8H



Babai është një figurë prindërore shumë e dashur nga ne fëmijët. Ai gjithmonë ka qenë simboli i forcës, argëtimit, të lojës në natyrë, të punës pa pushim. Babai im është një person shumë i rëndësishëm në jetën time. Tek ai mund të gjej mbështetje si kurrkund tjetër. Më inkurajon të punoj sa më tepër, të mësoj sa më shumë, të argëtohem, të ndjek pasionin tim. Më thotë se kur të rritem do të bëhem njeri me vlera e i rëndësishëm. Kur kam nevojë më ndihmon për çdo lloj problemi. Do që të rritem sa më e lumtur e të kem një jetë sociale të mirë, por ama, mos ta teproj me miqtë, kohën që kaloj në telefon, rrjetet sociale. Për këtë, më heq telefonin gjatë ditëve të javës dhe ma kthen në fundjavë, që mos të harxhoj kohë kot me të e të fokusohem te detyrat dhe mësimet, ndonjëherë dhe te arti. Më pëlqen fakti që ka besim tek unë, ndryshe nga mami im, duke qenë se e di që jam pak ndryshe nga fëmijët e tjerë, të cilët i ka kapur faza e adoleshencës. Mundohet që unë të jem sa më e shëndetshme, duke më thënë se si të ushqehem shëndetshëm, të stërvitem, edhe pse unë ndonjëherë nuk i ndjek instruksionet e tij. Shpresoj që një ditë, në të ardhmen, t'ia shlyej të gjitha ato që ka bërë e do të bëjë për mua e familjen tonë, edhe pse kjo është e pamundur. Mundem vetëm të premtoj se do ta bëj krenar, e do punoj fort që të bëhem dikush në jetë. Për të, për heroin tim.

Mirea Levendi 8H

Sa herë vjen mëngjesi dëgjohet një zile pas një qetësie të gjatë, dielli është ende i fshehur, dita akoma nuk ka zbardhur. Babai im ngrihet pa zhurmë, puth fëmijët e tij në ballë dhe del vetëtimthi për të filluar një ditë të gjatë, të lodhshme që duket si një përjetësi.

Është i pari që del nga shtëpia dhe i fundit që hyn brenda për të lënë pas lodhjen e për të gjetur çlodhjen pranë familjes së tij.

Ditët shkojnë e vijnë, vijnë e shkojnë, babai im vazhdon ende programin e pandryshueshëm, programin që e bën ti duken muajt ditë, ditët orë e orët sekonda. Më bën të ndihem krenare për babanë tim për sakrificën, vetmohimin dhe këmbënguljen për të më nxjerrë në një jetë të plotësuar, të kompletuar dhe të aftë për tu përballur me çdo sfidë.

Martina Shkoza 8H



Babai im është personi tek i cili unë gjej mbështetje dhe mirëkuptim. Pa Të jeta ime nuk do të kishte kuptim. Ai për mua është një njeri shumë i rëndësishëm, sepse kur kam probleme ai më ndihmon të gjej gjithmonë rrugën e drejtë. Babai është si dielli për shtëpinë tonë, sepse ai çdo ditë mundohet që të na mundësojë kushte sa më të mira për të jetuar dhe mbi të gjitha për shkollimin tim. Me babin ne jemi si dy shokë të ngushtë që nuk ndahen dot nga njëri - tjetri. Për mua, babai im është gjithçka që kam në këtë botë, për të vetmen arsye sepse ai më kupton më mirë se kushdo tjetër dhe tek i cili kam besim të plotë. Me pak fjalë, babai im është idhulli im.

Noel Arkaxhiu 8H



Mbrojtësi im, babai im

Babai im... personi më i shtrenjtë në jetën time. Ai që do të jepte jetën për mua dhe po ashtu edhe unë për të. Babai... një mbrojtës i imi, me një forcë të pashtershme dhe me një zemër të pagabueshme e të veçantë. Personi që unë e dua më shumë se veten time dhe se gjithçka në botë. I vetmi njeri me të cilin mund të pranoj gabimet dhe me të cilin mund të dëfrehem. I vetmi njeri që më bën tepër të lumtur, edhe kur jam në gjendjen time më të keqe. Ai person që mund të ma shërojë zemrën vetëm me një fjalë të vetme dhe ai person që më bën të ëndërroj pafund, duke harruar realitetin e hidhur dhe të gjithë mërzinë time. Babai im... një hero pa mburojë... pa shpatë, një hero që lufton me zemër. Një ëndërr e paharrueshme dhe një ëndërr e ruajtur në zemrën time. Ai mund të jetë shumë larg... tepër larg... por prapë, dashuria ime për të nuk mund të shuhet dot as nga era më e fortë që ekziston. Kujtimet na mbajnë afër edhe kur nuk jemi bashkë. Kjo dashuri nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër, sepse kjo dashuri është më shumë se e veçantë. Babai im... një mbrojtës në zemrën time të vogël, por që ndien më shumë seç e imagjinoj vetë unë. Babi im... e vetjma shpresë e imja, e cila më mban këtu ku jam tani!

Livia Mandro 8H

Këtu unë dua të flas për babanë tim, i cili është idhulli im dhe ndreqësi i gabimeve të mia në jetë. Mund të ankojem për çdo gjë, por për babanë tim nuk mundem. Babai më ka ndihmuar pothuajse në çdo aspekt dhe në çdo vështirësi që unë kam pasur. Është një njeri i mrekullueshëm dhe unë jam me fat që kam një baba të tillë. Edhe pse i ngarkuar me punë, ai e gjen kohën për të ndenjur pranë meje dhe për të më shoqëruar mua. Im atë hyn te shokët e mi më të ngushtë. Më plotëson çdo lloj dëshire që unë kam, por me kushtin që unë të dal shumë mirë në shkollë, të cilën ai e ka parësore në jetë. Gjëja e vetme që kërkon babai im është arsimimi në shkollë, pastaj të tjerat janë dytësore. Unë mundohem mos ta mërzis tim atë, por edhe kur ndodh në ndonjë rast, përsëri e gjej duke më puthur ballin natën, kur ai vjen i lodhur nga puna. Më frymëzon babi, sepse kur e gjej që është duke u marrë me dosje me kushedi sa e sa faqe, ai përsëri nuk ka një fytyrë të mërzitur, përkundrazi, atij i pëlqen puna, pra, e urren përtësën. Sipas mendimit tim, këtë virtyt që ka babi im duhet ta zotërojnë të gjithë, pasi përtesa është shumë e gabuar. Babi im është kujdesur dhe vazhdon të kujdeset edhe te e ngrëna, pasi ai kërkon që unë të marr vitaminat e duhura dhe ushqimet të jenë sa më të shëndetshme dhe të freskëta. Unë kam aq shumë për të shtuar për babin tim, sa besoj që nuk ka vend të mjaftueshëm. Dua të shtoj që me aq sa di unë nuk ekziston një fjalë e cila shpreh dashurinë time për babanë. Ai ka qenë, është, dhe do të jetë gjithmonë heroi dhe idhulli im më i madh. E dua babin tim dhe nuk do e ndërroja me asnjë në këtë botë.

Rubin Musta 8H



Babai im është i vetmi idhull dhe i vetmi person si i cili dua të bëhem, kur të rritem. Është paqësor dhe i dashur, sa ndonjëherë ndihem sikur mund t'i tregoj çdo gjë. Vlerat dhe virtytet e tij nuk kanë fund. Shpeshherë, kur jam e stresuar për ndonjë provim, më mjafton një përqafim dhe një "Sukseste, shpirti i babit!" prej tij dhe e di se gjithçka do të shkojë mirë. Kur jam e mërzitur, më mjafton një përqafim i tij dhe në fytyrën time vendoset një e buzëqeshur. Me pak fjalë, mund të them që nuk do të isha e njëjta pa të. Gjithmonë, më hap sytë tek një rrugë më e drejtë dhe gjithmonë jam ndier e sigurt pranë tij. Kënaqësi tjetër që nuk mund të largohet kurrë është ajo kur dëgjoj të trokiturën e derës. Fjalët nuk mund të shprehin dashurinë dhe respektin që kam për të dhe e di që jam me fat.

Nensi Meçalla 8H

Meqenëse tema e kësaj eseje është "Heroi im", jam e sigurt që shumë persona do të vendosnin të shkruanin për një hero kombëtar, idhullin e tyre letrar ose ndoshta dhe aktorin e preferuar. Po unë nuk kam pse shkruaj për një epitete, sepse në të vërtetë hero i ndodhet çdo ditë pranë meje, gjithmonë me mua. Dhe ai nuk është askush tjetër përveç më të shtrenjtit, babit tim. E di se shumë fëmijë e mendojnë si më të afërt figurën amësore, më të ngrohtë, më të gjindshme, pasi në çdo hap të jetës, në çdo skutë të kujtesës, ajo gjendet aty, qoftë duke të marrë për dore tek parku i lodrave, qoftë duke të përqaftuar kur je lënduar në vrapim e sipër. Por ajo që nuk shikojnë është se aty, te parku i lodrave ose në momentin kur je vlarë gjendet edhe dikush i cili të ndihmon të zbresësh nga rrëshqitësja, ose të mjekon plagën pasi je rrëzuar... E kur ky dikush ndodhet pranë teje frika zbehet, largohet dhe me praninë e tij ndien se nuk mund të të ndodhë asgjë e keqe. Për ty është i gatshëm t'i dalë përballë gjithçkaje, sado kolosale të duket. Pikërisht këtë ndjenjë më dhuron baba im. Sa herë kam pyetje që nuk mund t'i përgjigjem, probleme të vockla, por edhe të mëdha, raste kur ndihem e frikësuar dhe e vetmuar, e di se mund t'i drejtohem atij për një këshillë të mençur, por edhe për një fjalë të ngrohtë. Ndonjëherë edhe vetëm prania e tij ose dhe trokitja e veçantë e derës më qetëson, sidomos në kohën e natës, kur nuk më zë gjumi. Mjafton që të kthehem në anën tjetër të krevatit dhe të shikoj dritën që vjen nga dhoma e ndenjes, ose dhe të dëgjoj një tingull nga kolona zanore e filmit të tij të parapëlqyer dhe e di që s'jam vetëm, aty në errësirë. Babai im në pamje mund të duket si një njeri normal, i cili bën gjëra normale e të përditshme; ngrihet herët në mëngjes, largohet për në punë, dhe kthehet prapë në shtëpi. Por gjithmonë në mendjen time, projektimi i tij ka qenë shumë i zmadhuar, qindra herë i shumëfishuar, sa mua shpeshherë më është dukur si një gjigant, i cili është gjithmonë i pathyeshëm, kurdoherë i gatshëm për t'u bërë "mburoja" ime. Edhe ato ritualet e vockla që ai kryen çdo mëngjes janë pjesë e rutinës sime, të jetës sime, që shpesh mund të mos i vë re, por luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Asnjë alarm nuk më zgjon dot në mëngjes, si zëri i babit nga dhoma tjetër, në fund të fundit. Edhe pse e di shumë mirë që vitet ecin, vrapojnë dhe pluhuri që ngrenë pas rëndohet mbi ne, për diçka jam e sigurtë, që marrëdhëniet e veçantë që kemi krijuar unë dhe baba im nuk do të ndryshojë kurrë, as dashuria midis nesh dhe as vizioni që unë kam pasur për të që kur isha fëmijë i parritur, sepse lidhja që ekziston midis prindit e fëmijës nuk mund të thyhet as me peshën e njëmijë vjetëve.

Vivien Shkodra 8H

Klasat e 9-ta

Je një idhull, hero për mua

Babi im, nuk di nga t'ia nis për një baba si ty. Më mirë shok do thoja, për atë që më rriti me shumë mund, ai që më plotësonte dhe vazhdon ta bëjë, çdo dëshirë apo tekë timen, ai që sakrifikon veten çdo ditë që të mos na mungojë asgjë. Ndonjëherë ndihem pesimiste, por çdo herë që ndodh kjo, është babai ai që vjen dhe më jep zemër, duke më thënë që njeriu duhet të tregohet i fortë dhe më rikthen humorin. E di që brenda tij ka shumë emocione, por veprimet e tij gjithmonë më sjellin buzëqeshjen. Ai është shembulli më i mirë për t'u ndjekur. Do të dëshiroja shumë që kur të bëhem dhe unë me një familje, të jem aq e përkushtuar dhe e dedikuar ndaj saj, sa është babi im ndaj nesh. Je një idhull, hero për mua.

Adela Xhiani 9A



Babai im është idhulli im. Unë dua të bëhem si ai kur të rritem. Ai gjithmonë më ka ndihmuar në çaste të vështira. Kur ndihesha vetëm ai më qëndronte pranë. Kur vritesha duke luajtur ai më mjekonte plagën. Ai gjithmonë sigurohej që unë të mos qëndroja i mërzitur. Kur isha i mërzitur, ai vinte dhe më çonte për akulllore. Akullorja më sillte prapë buzëqeshjen në fytyrë. Ai sigurohej që unë mos të shkoja në shkollë me ndonjë send mangët. Kur bëja ndonjë prapësi ai nuk më qortonte, por më thoshte se nuk duhet ta përsëritja atë gjë, sepse mund të vritesha. Unë ndihem shumë krenar që kam një baba të tillë dhe shpresoj që edhe unë të jem kështu një ditë, po kaq i përkushtuar ndaj familjes sa ai.

Afrim Hima 9A



Babi, do të të them disa fjalë të vogla. Edhe pse nuk e shpreh shpesh, unë të dua ty. Zakonisht fjala e parë e çdo fëmije është "mama" ama fjala ime e parë ishte "baba". Unë gjithmonë kam qenë me e afërt me ty, ndoshta sepse të ngaj ty në çdo aspekt. Kur të rritem shpresoj të ndjek rrugën më të mirë, ashtu siç më ke mësuar ti. Faleminderit që ke qenë gjithmonë pranë meje në momentet e mia më të vështira. Faleminderit që më ke dhënë çdo gjë në jetë. Jo vetëm kur kam qenë e vogël, por dhe tani, ti je përherë aty pranë meje që të më ngresh sa herë rrëzohem. Kurdoherë më ke bërë të mësoj nga gabimet e mia, duke më dhënë kurajo. Më mësove të eci në hapat e tu, më mësove të ndjek rrugën e drejtë, pavarësisht çdo gjëje, më mësove rregullat themelore të jetës, pra më ke mësuar gati çdo gjë që unë di dhe unë jam kjo që jam sot, falë teje. Shpresoj të jesh krenar për mua. Faleminderit që gjendesh përherë për mua dhe mbi të gjitha faleminderit që më dhe jetën.

Arjola Nuredini 9A

Babai im është heroi im, ai është personi më i veçantë në jetën time. Ai është më i miri në profesionin e tij. Ne dalim çdo fundjavë me biçikleta për t'u qetësuar. Gjatë ditëve të javës ne punojmë në garazh, duke punuar në projekte të reja. Ai është ndër punonjësit më të mirë dhe ka fituar shumë respekt te të tjerët. Ai përpiket më së miri për ta mbajtur familjen tonë të lumtur. Ai më do shumë dhe gjithmonë përpiket të më mbushë me gëzim sa herë që jam i trishtuar. Ai më ka mësuar me vlera dhe nuk më ka llastuar me tepri, por në të njëjtën kohë ai më ka dhënë shumë gjëra që unë gjithmonë kam dëshiruar t'i kem. Babai im është gjithmonë duke u munduar për të më bërë një njeri model. Unë nuk jam djali i tij i vetëm. Kam edhe dy motra më të mëdha dhe ka qenë gjithmonë e vështirë që të kujdeset për mua dhe motrat e mia. Babai im është dhurata më e çmuar për mua. Ai është një baba i dashur dhe personi më i hirshëm që kam parë ndonjëherë në jetën time. Ai dëshiron që unë të bëhem një qenie e mirë njerëzore si ai. Kjo është arsyeja pse ai gjithmonë më mëson të dalloj midis të gabuarës dhe të mirës. Gjithmonë më pëlqen të kaloj kohë me të dhe të mësoj gjëra të reja me të. Ai më ka ndihmuar që të praktikoj sportin tim të preferuar, MMA, duke më blerë doreza boksi, fasho, kostume sportive dhe mbrojtëse dhëmbësh. Çdo natë merr pak kohë, për mua për të më pyetur për aktivitetet e mia të përditshme dhe problemet, nëse kam. Ai është shoku im i ngushtë. Unë mund të diskutoj gjithçka me të pa asnjë hezitim. Gjërat që nuk mund t'i flas edhe me shokët e ngushtë, mund t'i diskutoj lehtë me babin tim. Sipas tij, përvoja e ka ndihmuar atë për të zgjeruar horizontet e tij. Kjo është arsyeja pse më ka shtyrë mjaft herët që unë të mësoj anglishten. Ai dëshiron që unë të udhëtoj e të njoh botën, sepse ai beson se udhëtimi është një edukim në vetvete. Kur isha në moshën 12 vjeç, mora fluturimin tim të parë në Turqi. Kam mësuar shumë gjëra nën drejtimin e babait tim, të cilat arsime nuk arrin të m'i mësojë. Mësimi kryesor që babai im më ka mësuar është disiplina dhe edukata e punës. Këto dy gjëra janë përbërësit kyç për arritjen e suksesit në jetë.

Enrik Hamzallari 9A

Për ty s'ka mëngjes,
 për ty dita s'ka mbarim,
 për ty s'ka lodhje,
 për ty s'ka rënkim.
 Duart e regjura,
 ti kurrë s'i shikon,
 por vazhdon punën
 dhe në mbrëmje pushon.
 Po pse s'të dëgjova
 një herë, o babi im,
 të thuash që jam lodhur,
 që nuk kam më fuqi?
 Po pse s'të dëgjova
 të thuash që jam sëmurë?
 Por ngrihesh dhe punon
 dhe me temperaturë.
 Në botën tënde
 përtimi s'ekziston,
 guximin dhe forcën
 gjithmonë e kërkon.
 Portreti yt, vuajtjen e mbulon,
 para syve tanë, heroin tregon.
 Nëse dikush do më pyeste,
 nëse idhull a kam,
 Unë do t'u thoja
 që idhullin e kam pranë.
 Nëse sërish do më pyesnin;
 se kush është ai?
 Me plot krenari do t'u thoja,
 që idhulli im BABI je Ti!

Erik Peshkëpia 9A

Babai, idhulli im!!!

Babi, ti s'je thjesht një fjalë ose njeri, ti je një poeziE dini cili është idhulli im?! Nuk është një aktor, as një këngëtar, as një sportist... Është ai që urren të m'i shikojë sytë me lot. Ai që jep jetën për një buzëqeshje timen. Është ai që në netët e gjata mbi kokë më rri, ai më kupton qoftë dhe me një shikim. Ai është babai im. I shtrenjti baba... Jam unë, vajza jote e parë dhe e vetme. Jam ajo që gjithnjë bën gabime, por ti e ndihmon të ngrihet, të çajë rrugën e saj. Unë, si vajza jote, jam shumë krenare për ty, për edukatën që ti më ke dhënë gjithë këto vite. Je një idhull për mua, je një hero, je shembulli më i mirë i një njeriu, i një babai. Gjithë jetën tënde ke punuar dhe vazhdon të punosh. Kjo gjë vetëm për ne, për të na plotësuar dëshirat dhe nevojat tona. Gjithë jetën s'më ka munguar asgjë. Dhe kjo gjë vetëm falë teje. Babi, ti je njeriu që gjithnjë më çon në rrugën e drejtë. Ai që më frenon kur jam gabim dhe thotë "Vazhdo" kur kam të drejtë. Në çdo çast më ke ndihmuar. Në momente të vështira gjithnjë ke qenë si një busull nga ku më ke drejtuar. Je njeriu më i saktë e që nuk gabon kurrë. Ky je ti. Kësaj radhe iu drejtova babit, se për nënën flasim gjithmonë. Po të mos ishe ti unë s'do të isha këtu sot. Babi, ti s'je thjesht një fjalë ose njeri, ti je një poezi, një engjell që ke ardhur për të më drejtuar.

Enea Palamani 9A



Fjalët për ty nuk di as ku t'i filloj më parë,
se kam harruar edhe fillimin nga një fund i paarrirë.
Ece krah meje dhe më mbajte dorën time të vogël e të brishtë,
në këmbë më ngrite plot me kujdesi.
Fjalë të vogla për ty nuk kam,
por as të mëdha zemra s'më mban.
ndjeva aromën tënde për herë të parë,
që në vogëli mend e mbaj.
Në folezën tënde më mbajte ngrohtë,
më fale buzëqeshje, të fala edhe lot,
ndonjëherë të kam mërzhitur e padashje të kam lënduar,
shpirti yt mëri s'njeh, dashuri e pakufizuar.
Fjalët e mia shkrihen në flakë, kur bëhet puna për ty, zemra ime e vogël ndjeu
ngrohtësinë e tëndes, në momentin e parë që u takuam ne të dy.
Të shoqërova me dhimbje e jetën nuk të ndihmova ta jetoje dot,
dije që kanë qenë dhimbje dashurie, me notat më të ëmbla mbi piano i luajta ato.
Me penel, mbi një telajo, një buzëqeshje vizatova në jetën tënde,
të bëra të lumtur besoj, gëzim solla aty, në shtëpinë tonë.
Mbi shpatulla mbaj unë këtë emër me fat,
me krenari e them: "Të kam baba!"

Erina Shano 9A

Ti më ofrove gjithçka në jetë,
 më ofrove diçka me vlerë,
 dashurinë e një prindi,
 atë dashurinë e vërtetë.
 Ti je arsyeja
 pse tek unë ka buzëqeshje.
 E për mua gjithmonë,
 Ti do të mbetesh kuptim jete.
 Prezenca jote,
 jetën ma bën të çmuar,
 Babi, ti je personi
 më i veçantë për mua.
 Jeta ime pa ty,
 nuk do kishte kuptim,
 ngaqë ti je,
 pjesë e shpirtit tim.

Ervin Hima 9A



Heroi im është babi im

Një mashkull me një fizik të fortë, sytë jeshil, i besës, me një zemërgjerësi të jashtëzakonshme. Është ai heroi im, që dhe jetën do jepte për mua. Eh, sa të vështirë e kam të shkruaj për ty! Nuk e di nga t'ia nis për një baba të tillë. Jam unë babi, vajza jote e vogël, princesha jote. Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtut tim, babait tim. Ai ka qenë dhe është një person shumë i denjë, njeri me shpirt të pastër e të bukur, që në jetë ka hasur shumë vështirësi, që në fëmijëri. U bënë plot 44 vite që ti po punon, po mban familjen tonë bashkë me mamën. Ti na rrite sipas edukatës familjare, na rrite me aq sa mundësitë ekonomike ishin. Fëmijëria jote nuk ka qenë një fëmijëri si të gjithë të tjerët. Mundësitë ekonomike, koha, njerëzit ishin ndryshe. Që në moshën 15-vjeçare ti mbaje familjen tënde, kujdeseshe për veten dhe për prindërit. E ja ku je tani, çdo sakrificë që ti ke bërë nuk shkoj dëm. Jam tepër krenare që jam vajza jote. Të falenderoj shumë për çdo sakrificë, për çdo mundim që ke bërë për mua. Je heroi i çdo lufte e beteje dhe në çdo vështirësi që unë kam kaluar ti ke qenë gjithmonë aty për të më mbështetur. Je bota ime, je arsyeja që unë jam sot këtu. Do të ta shpërblej çdo pikë djerse që ke derdhur për mua, çdo sakrificë. Do të të përulëm gjithmonë me dashuri dhe respekt. Ashtu siç ti ke dhënë dhe shpirtin për ne, ashtu siç unë jam krenare dhe eci me kokën lart që kam një baba si ty, tani është radha ime të ta kthej me të njëjtën vlerë.

Isli Zeneli 9A

Kjo letër i dedikohet idhullit tim. Nuk është as një aktor, as një këngëtar, as një sportist. E kupton jo vetëm nëse jam mërziur, por kupton edhe arsyen. Është ai, që sa herë e shikoj, më fal një energji pozitive. Është ai që ka shpirtin më të madh, që pavarësisht gjithçkaje, pavarësisht vuajtjes që një njeri mund t'i shkaktojë, ai gjen gjithmonë një anë të mirë tek çdo njeri. Është ai, për të cilin unë çdo ditë e më shumë krenohem. Është Babai im! Është ai, që unë rrallë e shpreh rëndësinë që ka në jetën time, por që frika ime më e madhe është ta humbas, pikërisht atë, atë që deri tani është protagonist i jetës sime. Ai është pika ime e fortë dhe e dobët. Është ai, që më bën ta dua çdo ditë e më shumë. Lutem që ai një ditë të ndihet për mua po aq krenar sa ndihem unë për të!

Keith Mici 9A



Babai, idhulli im

Të them të drejtën nuk më ka rastisur të flas për të me anë të shkrimit. Për të flas me anë të ndjenjave, për të flas me zë të lartë, që ta kuptojë e gjithë bota se ai është njeriu më i veçantë i jetës sime, ai është babi im. Më thanë të merrja një laps e një letër e aty të flisja për të, por s'kam çfarë të them, pasi ai ka çdo gjë që një prind duhet të kishte, ai ka atë mirësinë e tij që i dallohet me kilometra largësi, ai ka atë dhembshurinë e një personi të pafajshëm, lotët që rrjedhin nga sytë e tij në momente trishtimi dhe gëzimi janë si kristalet e dëborës, të pastra e plot dashuri. Babai për vajzën është gjithçka, është mashkulli i parë në jetën e saj, është mbështetja më e madhe e kësaj jete, është dhurata më e çmueshme, është heroi i përrallës sime, është ai që më bën të kuptoj që jeta do të jetë e vështirë, por me të në krah, më bën të kuptoj se do ta kaloj çdo stuhi brenda shpirtit tim, çdo lot të pavlefshëm për një person, sepse ai sërish më sheh si një vajzë të vogël që rrëzohet, teksa hedh hapat e parë të jetës. Babi, idhulli im, arsyeja e vetme pse kam arritur deri këtu, je ti, je ti që të zezën e bërë të bardhë dhe shiun e bërë diell. Faleminderit për gjithçka! Faleminderit që je pjesë e jetës sime, idhulli im!

Klara Morinaj 9A



Faleminderit Babi, heroi im!

Këtë letër ia dedikoj babait tim të dashur, personit që më ka ndihmuar dhe më ka udhëzuar në çdo moment të jetës, si të lehtë ashtu edhe të vështirë. Nuk di nga të filloj me falenderimet për të. Faleminderit që më ke plotësuar çdo dëshirë dhe që më ke ndihmuar të ngrihesha sa herë që rrëzohesha. Faleminderit që ke punuar pa pushim për të më dhënë mua shkollimin më të mirë të mundshëm dhe një jetë luksoze. Faleminderit për çdo rrugë që ke bërë, për të më çuar mua në kurset e nevojshme. Falenderimet e mia nuk kanë të sosur dhe prandaj po e mbyll këtu këtë letër me një falenderim të fundit: Faleminderit për gjithçka! Ti je heroi, idhulli, motivimi im dhe nuk mund të të falenderoj mjaftueshëm. Të dua baba!

Klevis Hoxha 9A

Unë po rritem një fëmijë i lumtur pranë prindërve të mi. Familja ime përbëhet nga mami, babi, nëna, unë dhe vëllai. Prindërit nuk i ndaj dot për nga dashuria, por babin e kam idhullin tim. Gjithmonë them me vete se dua të bëhem si babi im. Ai është gjithçka për mua. Ai më ka mësuar hapat e parë në jetë. Babi ma ka bërë jetën time edhe më të bukur. Gjithmonë është kujdesur për mua dhe vazhdon të kujdeset. Ai do më të mirën për mua dhe kështu kujdeset që të kem një shkollim sa më të mirë. Falë tij, punës së tij të përkushtuar, ne jetojmë si një familje e lumtur. Unë dua të bëhem si babi im, pasi ai është një njeri shumë punëtor dhe gjithmonë e ka një ide për çfarëdo të jetë ajo. I pëlqejnë aventurat dhe i pëlqen të udhëtojë ,po ashtu si unë. Ai më merr me vete kudo që shkon, që unë të mësoj sa më shumë gjëra e të bëhem i zoti në jetë. Ai është gjëja më e shtrenjtë për mua.

Babi, ti je gjithçka për mua! Je jeta dhe drita që ndriçon rrugën time në shkollë e në jetë. Dua të jem si ti, se je idhulli im, je krenaria ime. Babi të dua shumë! Jam krenar për ty!

Klaudio Tozaj 9A



Babai, idhulli im!!!

Nuk gjej dot fjalë për të përshkruar dashurinë ndaj babait tim. Fjalët duken të varfëra dhe të paaftha ta mbushin këtë shkrim. Për nënën flasim çdo herë dhe harrojmë të përmendim të shtrenjtin baba, i cili edhe nëqoftëse nuk ndodhet aty, influenza e tij na shtyn të ecim përpara. Ata gjenden gjithmonë aty, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na ndihmuar. Na kanë mësuar se ndjeshmëria, zemërgjerësia dhe humanizmi janë ato të cilat të përcaktojnë vlerën "Njeri". Edhe pse prindërit e mi nuk jetojnë bashkë, ai është gjithmonë aty, i gatshëm dhe në vendosmëri për mua dhe për motrën time. Por kjo botë i mban të gjitha llojet e njerëzve; ka dhe nga ata të cilët babain nuk e kanë më fizikisht pranë, por shpirti dhe energjia e tyre ndodhet aty për t'i ngushëlluar sadopak. Vjen një ditë që njerëzit largohen prej kësaj bote dhe mbyllin sytë, fryma iu ndalet dhe nuk janë më, ose nga ata të cilët nuk arritën ta njihnin kurrë. A ka njeri pa vuajtje? Edhe ai më i lumturi brenda vetes fsheh diçka. Dhe në fund të ditës, babai im është aty, në anën tjetër të qytetit duke më marrë në telefon çdo ditë e duke u siguruar që unë jam mirë, pa harruar edhe motrën time të vogël. E vërtetë, idhujt e mi mund të jenë njerëz të famshëm, nga anë të ndryshme të botës, por ai më i rëndësishmi është babi im. Nëqoftëse njerëzit do të karakterizoheshin nga një ngjyrë, babai im do të ishte ngjyra jeshile, sepse ajo ngjyrë është ngjyra e shpresës dhe besoj se babai im jep shpresë çdo ditë, duke arritur të shpëtojë jetët e mijëra njerëzve ndërsa bën punën e tij. Faleminderit babi!

Livia Mezini 9A

Shkrimin e sotëm ia dedikoj personit më të dashur në botë, babait tim.

Je personi që më ke ndenjur afër gjithmonë. Mbaj mend gjërat që kemi kaluar bashkë deri më sot. Ato janë të panumërta. Ishe ti ai që më çoje kudo që të doja, ai që më ndihmonte me gjërat, më rrije afër gjithmonë. Çdo gjë që kam kaluar në jetë, i kam kaluar me ndihmën e këshillave të tua. Gjithmonë pas shkolle unë vija te vendi ku ti punoje dhe kaloja kohën duke luajtur te kompjuteri. Nuk mbahet mend sa herë e kam prishur, por përsëri ti kurrë nuk mërziteshe me mua. Momenti më i paharrueshëm me ty, ishte momenti kur më mësove makinën. Herën e parë kisha pak frikë, por ti ishe aty për mua. Atëherë kisha frikë, ndërsa tani zihemi se kush e drejton i pari. Kur ti je me mua, unë mund të bëj gjithçka që dua. Kur ne ziheshim, ne gjithmonë flisnim gjatë, deri sa problemi të zgjidhej. Gjithmonë kishte një rrugëzgjdhje. Babi, ti më mbush me gëzim sa herë jemi bashkë, kudo që të jemi. Ti je heroi im dhe gjithmonë do të jesh një i tillë për mua.

Klevis Mera 9A



Këtë shkrim sot dua t'ia dedikoj të shtrenjtit tim, babait tim.

Mbaj mend kur na e ka treguar historinë e jetës së tij në një natë nëntori me shi. Ishim pa drita në shtëpi. Ai tregonte dhe i shkisinin lotët nëpër fytyrën e tij të dërrmuar. Isha vetëm 10 vjeç dhe kanë kaluar 5 vjet që e kujtoj si sot atë natë: "Po ta tregoj të gjithë historinë time me detaje, që kur unë lindi e deri më sot", thoshte ai. Nuk e shihja dot babin tim teksa tregonte historinë e tij të gjatë e të dhimbshme dhe rrugët e vetmuara që ka kaluar për t'u bërë njeriu që është sot. Babai im gjithmonë i mbante lotët nëpër trupin e tij të vetmuar, dhe pse donte t'i zbraste aq shumë ato, por nuk donte të na mërziste ne dhe të gjithë familjen e tij. Ai qëndroi i fortë deri në fund dhe sot e kësaj dite është më i lumtur se kurrë, por gjëja që e lumturon atë më shumë nuk është paraja dhe fama e madhe, por familja e tij, e cila do ta mbështesë gjithmonë kudo që të shkojë dhe kudo që të jetë, sepse ishte ai që më ndihmonte mua sa herë që rrëzohesha, ishte ai që më ndihmonte sa herë që qaja, ishte ai që më ndihmonte sa herë që kisha problemet e mia, ishte ai që më ndihmonte të më jepte udhëzime në çdo gjë që kisha gabuar. Ndaj jini të kënaqur gjithmonë, jini të drejtë, jini zemërpastër dhe për çfarëdolloj gjëje do doni, do ia arrini. Vetëm me drejtësi. Pra këto janë mësimet që më ka mësuar babai im gjatë gjithë jetës së tij.

Marin Baloshi 9A

Babush!

Sot, vajza jote po shkruan për ty, pasi ajo kurrë nuk të ka thënë sesa e lumtur dhe me fat është që ka një baba si ty. Si fillim dua të të falenderoj, për gjithçka që ke bërë për mua. Faleminderit që ishe aty, që nga dita kur erdha në këtë botë! Faleminderit që më ndihmove të ngrihesha sa herë që rrëzohesha, ndërsa përpiqesha të ecja mbi këmbët e mia. Të falenderoj për netët që nuk vure gjumë në sy nga të qarat e mia! Të falenderoj që nuk u lodhe asnjëherë nga kërkesat e mia të shumta! Të falenderoj që çdo dëshirë timen, e plotësove dhe asnjëherë nuk më the "Jo"! Të falenderoj që u tregove i duruar, me një vajzë mistrece si puna ime. Të falenderoj që më dhe mundësinë të jetoj në një familje ku mbizotëron dashuria dhe respekti. Sot kam kuptuar që ishin provat e dashurisë tënde të pafundme që ke për mua. Ndoshta nuk të them shpesh sa shumë të dua. Ndoshta nuk ta kam thënë asnjëherë sesa shumë të admiroj. Të admiroj për faktin që edhe pse në moshë të vogël humbe babanë dhe nuk e jetove tamam ndjenjën e të pasurit një baba. Kjo besoj të bëri ky që je tani, një baba të përkushtuar ndaj fëmijëve të tu, u bërë ai baba që dëshiroje të kishe. Të admiroj për faktin që nise nga zero gjithçka dhe që në moshën 18-vjeçare, kur shokët e tu dilnin e pinin, ti punoje deri vonë për fëmijët e tu, që ne të kishim një të ardhme më të mirë, dhe të gjitha këto vite lodhjet t'u shpërblyen. Mbi të gjitha të admiroj që je i pavarur dhe gjithmonë ke bërë atë që të është dukur ty më e drejtë, dhe besoj se të qenët një vajzë e fortë dhe e pavarur, e kam marrë nga ty. Për mua, o babush je shoku im i ngushtë, dhe ti e di që në momentet e vështira kam ardhur tek ti. Ke qenë ti i pari që më ke parë të hedh hapat e parë, kur kam thënë fjalët e para, kur kam qeshur e qarë. Të kam treguar çdo problem që kisha, qoftë ai i vogël apo i madh. Ke qenë ti i pari, kur të kam thënë për ndonjë djalë që mund të kem pëlqyer, por si çdo baba nuk të ka ardhur mirë teksa flisja për atë "djalin", nuk doje që unë të lëndohesha dhë më thojë gjithmonë që "Djemtë janë egërsira" dhe "Asnjë nuk të meriton ty". Dhe sa më shumë koha kalonte, sa më shumë hapesha me ty, kuptoja se ti je i vetmi person nga i cili unë e marr forcën. Babush, je i vetmi që kurrë nuk u mërzite me mua, kurrë nuk më gjykoje dhe në njëfarë mënyre më mësove shumë gjëra nga jeta. Pa ty o ba, do isha si një piktor i verbër që nuk sheh ngjyrat. Të Dua Ba! Me dashuri, vogëlushja jote!

Megi Gjyli 9A

Heroi ynë

Babai është personi më i mirë në botë për mua. E di që duket si diçka që një fëmijë i vogël do të thoshte, por unë kjo jam, e vogla e babit. Çdo ditë ai ngrihet i pari dhe fillon ditën, për të punuar që të arrijë të na plotësojë çdo dëshirë që unë, motra dhe vëllai kemi. Çdo gjë që kërkoj plotësohet pa asnjë ankesë. Ai përveçse punon shumë, kalon edhe shumë kohë me ne. Darkat kalohen së bashku, po ashtu dhe dita e diel është vetëm për ne. Mbaj mend që gjithnjë më thoshte dhe më thotë këshilla që i kam shumë të nevojshme. Madje më inkurajonte të merrja pjesë në aktivitete ku unë kisha turp të shkoja, por asnjëherë nuk më detyronte. Kjo gjë më pëlqen shumë tek ai, sepse është i duruar dhe i qetë dhe asnjëherë nuk më shtyn drejt asaj që nuk dua. Babai ka shumë pritshmëri tek unë. Kërkon që unë të arrij shumë në jetë dhe unë këtë mundohem të bëj çdo ditë, që nga momenti që ngrihem e deri kur bie të fle. Nga babi kam mësuar shumë gjëra të pabesueshme dhe në të ardhmen dua të bëhem si ai. Një vajzë e zgjuar, punëtore, e dashur dhe e afërt me familjen, që nuk lodhet e nuk ankohet kurrë. Një person i qetë dhe që i mendon gjërat para se t'i bëjë. Tani jam adoleshente dhe ndonjëherë i bëj gjërat pa menduar, por shpresoj që kjo të ndyshojë në të ardhmen. Dua ta bëj krenar atë e të eci në hapat e tij, dhe të arrij diçka në jetë, ashtu si ai.

Pamela Mera 9A



Baba i dashur ,

E di që në shumë raste kam qenë e llastuar dhe jam kthyer kundër fjalëve të tua, por asnjëherë nuk kam pasur qëllim të keq. Më fal për çdo sjellje timen, je një nga njerëzit që vlerësoj me shumë, je një njeri i përkushtuar si në familje dhe në punë. Ndonjëherë mendoj se si ia del për gjithçka dhe se si ti asnjëherë gjërat nuk i lë në gjysmë. Jam e lumtur që më ke qëndruar gjithmonë pranë, në çdo çast të jetës sime dhe të faleminderit që ke bërë gjithë gjërat e mundshme që unë të jem e lumtur. Marrëdhëniet e mia me ty kanë qenë gjithmonë të mira dhe jam krenare të them që kam një baba si ty. Ka pasur raste që ke punuar gjithë ditën në shtëpi dhe nuk ke dalë nga dhoma. Kam dashur të të ndihmoj, por nuk dija se si. Nuk ka fjalë të përshkruaj se sa shumë të vlerësoj dhe se sa shumë të dua. Gjithmonë më ke ndihmuar për detyrat e shtëpisë, për esetë sidomos, po jam shumë e lumtur që po e shkruaj vetë këtë letër. Dëshira ime më e madhe ka qenë që ti, mami dhe vëllai të ishit të lumtur. Kam dashur gjithmonë që të jesh krenar për mua. Mund të them me plot gojë që ti je idhulli im, edhe pse kemi debatuar, marrëdhënia jonë e mirë i ka lënë të gjitha pas. Ti edhe mami keni qenë prindërit idealë për mua dhe shpresoj që familja jonë të jetë e mbushur vetëm me gëzim, siç ka qenë deri tani.

Amelia Pashaj 9B

I dashur babi,

Është e vërtetë që shumicën e kohës unë kam qenë një fëmijë i llastuar dhe shpeshherë kam kërkuar më shumë se sa duhet, por ti nuk ke hezituar kurrë që të m'i plotësosh kërkesat e mia, sado të panevojshme që ishin. Ti je një nga të vetmit persona që më ka suportuar në zgjedhjet e mia. Në kohët kur unë kam kërkuar ndihmë ose kam pasur nevojë për dikë, ti më ke ndihmuar dhe kurrë nuk ke dyshuar tek unë. Nuk mund të them që më je ndodhur pranë gjithmonë, por më ke ndihmuar që të kaloj çdo etapë të jetës sime me sportivitet. E di që ti punon gjatë gjithë ditës pa pushim dhe nuk ke gjithmonë mundësi për të ardhur në drekat familjare a pushimet që ne bëjmë, por prapëseprapë nuk do të thotë se ti nuk ke dëshirë të kalosh kohën tënde të lirë me ne. Nëse do të shkruaja një histori, do ta shkruaja për heroin e botës sime dhe ai je ti. Kur të shoh ty duke punuar pa pushim, unë përpiqem të të bëj sa më krenar dhe të mos ta lë gjithë atë punë të shkojë dëm. Të falenderoj për gjithçka që ti ke bërë për mua, për edukimin që më ke dhënë dhe për të gjitha kujtimet e bukura që kemi kaluar bashkë. Të falenderoj për kushtet e mira të jetesës që ti më ke siguruar. Shpresoj që në të ardhmen të bëhem si ty, një person zemërgjerë, një person i cili shpeshherë mundohet për të mirën e të tjerëve. Je një person shumë i rëndësishëm për mua dhe kështu do të jesh gjithmonë.



Fiona Rramilli 9B

Babai, Idhulli im

Vitet kalojnë e akoma ti je personi që më mbështet më shumë. Akoma prezenca jote ka një influencë shumë të madhe te unë. Gjithmonë fjalët e tua janë inkurajuese për mua dhe pikërisht këto fjalë më shtyjnë për më shumë. Ti që nga dita e parë më ke qëndruar nga pas, duke më mbështetur në çdo fushë të jetës. Kur isha i vogël dhe ankohesha për çdo gjë, ti ke qenë i vetmi që nuk lodheshe me mua, por ke qenë gjithmonë i duruar. Ti gjithmonë ke thënë se ka kohë për mua që t'i kuptoj gjërat. Gjithmonë thoshin se kam qenë më i lidhur pas mamit, por në të vërtetë unë nuk mund t'i ndaj dot prindërit se kë dua më shumë. Secili prind ka ndikuar ndryshe te unë. Mami është ajo që tregohet më e dashur me mua dhe motrën, por babi është më i tërhequr dhe vetëm me praninë e tij unë ndiej një siguri shpirtërore. Që i vogël ti ke qenë një nga shtysat e mia që të filloja futbollin dhe deri sot e kësaj dite ti akoma vazhdon të jesh një stimul që unë të vazhdoj të bëj gjënë që kam më shumë me dëshirë e për zemër. Edhe kur nuk jam në formë a në gjendjen më të mirë, ti je ai që më thua që të mos dorëzohem kurrë, por të vazhdoj të jap maksimumin tim. Futbolli nuk ka qenë vetëm pasioni im, por në radhë të parë edhe i yti. Pavarësisht gjithçkaje, unë të falenderoj pafund që je pjesë e jetës sime dhe që ke ndikuar pozitivisht te unë. Të falenderoj që besove te unë dhe vazhdon akoma të besosh!

Frenki Koduzi 9B

Babi im, këtë letër dua të ta dedikoj ty, një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Ti për mua je dielli që shndrin, busulla që më udhëzon, je frymëzimi im, je këshilluesi im. Te ti shikoj dinjitet, paqe dhe e di që ti je idhulli im. Je çfarë dua të arrij kur unë të rritem, çfarë dua të bëhem në të ardhmen. Më ke mësuar gjithmonë se fillimisht duhet të kesh respekt për veten, e në këtë mënyrë do të kesh për të gjithë. Më ke dhënë vlerat parësore dhe themelore të njeriut. Optimizmi që ti përçon, është ç'ka më jep forcë çdo ditë për të vazhduar përpara dhe për t'u bërë versioni më i mirë i vetes sime. Ke krijuar një botë ku je siguruar që asnjëherë asgjë të mos më mungojë. Më ke përkrahur dhe më ke ndihmuar gjithmonë. Ti je babai im i dashur dhe dua që të të falenderoj për kontributin që ke dhënë në atë që unë jam sot. Jam krenarë për ty dhe do të jem deri në pafundësi, sepse ti do të mbetesh burimi i dritës dhe frymëzimit tim që kurrë nuk do të shterojë.

Ester Albrahimi 9B



Baba, ti që ke qenë pranë meje që në ditën e parë që hapa sytë. Më ty kam disa nga kujtimet më të bukura të jetës sime, kujtime që nuk kam për t'i harruar kurrë. Shpeshherë mendoja se ishe shumë i ashpër dhe se nuk arrije të më kuptoje, por tani e shoh se ti doje vetëm më të mirën për mua. Gjithmonë më ke shtyrë të punoj më shumë e të bëhem një person më i mirë. Ndonjëherë vjen i lodhur nga puna dhe nuk kemi shumë kohë për të folur bashkë, por çdo moment që kemi kaluar, sado pak që të jenë, kanë mbetur në kujtesën time. Gjithmonë gjen një mënyrë për të më ngritur humorin dhe më plotëson dëshirat, edhe kur janë të pakuptimta. Ndoshta nuk ta shpreh gjithmonë se sa shumë të vlerësoj, se sa i shtrenjtë je për mua. Prandaj sot po ta them se je një nga personat më të rëndësishëm në jetën time, dikush që dua gjithmonë ta bëj krenar. Baba, ti je heroi im!

Gledis Kondi 9B



I dashur baba...

Të dy prindërit e mi janë gjëja më e shtrenjtë për mua, ata më mbështesin mua gjithmonë, por kjo ditë është vetëm për babin. Do të doja të të falënderoja. Do të doja të them "faleminderit" për gjithçka që kam dhe gjithçka që jam! Do të doja të të falënderoja që më dhe jetën! Falë teje, jam ky që jam! Gjithnjë e kam adhuruar imazhin tënd në jetën time, angazhimin tënd në çdo gjë që bën, dëshira jote për t'u angazhuar në aktivitete të reja dhe dëshira për t'ia dalë mbanë. Të kam heroin tim!

Grenti Rajta 9B

Babi... kur të vështroj thellë, në delikatesën e krenarisë tënde mashkullore, me kujtimin që më sjell ndërmend të kaluarën e largët dhe të tashmen që jetojmë çdo ditë, me vështrimin e një fëmije ende të vogël, që kërkon ndihmën dhe përkujdesjen delikate që vetëm babai mund ta dhurojë, përjetoj përsëri çdo moment tonin. Çdo moment përkujdesjeje dhe çdo pikë të dashurisë prindërore e ruaj në kutinë e zemrës sime. I shtrenjti ba! Me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti. Të dua shumë, kam gjakun tënd. Gjithmonë do të ndihem krenare për ty. Je babai ideal për mua! I tillë do mbetesh deri në fund ... edhe në kujtimet e mia.

Iris Mato 9B



I dashur babi,

Kanë kaluar plot 15 vjet që kur kam ardhur në jetë dhe mund të them me siguri të plotë se ti më je gjendur gjithmonë pranë, si në çastet e mira, por dhe në ato të vështira. Ke qenë model për mua që në fillim të jetës sime dhe do të jesh deri në fund. Fjalët e tua janë ato që më inspirojnë gjithnjë dhe çdo moment që kaloj me ty është unik e i veçantë. Falenderoj Zotin që kam pasur një fat të tillë dhe që je ti babai im.

Shumë njerëz thonë se duan më shumë mamanë, sepse mendojnë se është më e butë dhe e dashur dhe e cilësojnë babain si të sertë dhe të ashpër. Realiteti është që babai është po aq i dashur dhe i sjellshëm, por është karakteri i një burri që i nxjerr në pah më rrallë këto cilësi. Çdo baba në botë është entuziast kur fëmija i tij është i suksesshëm në jetë dhe shpenzon sa më shumë të mundet në shkollimin e fëmijës dhe në formimin e tij të përgjithshëm. Në fund, sigurisht pret që këto sakrifica t'i shpërblehen, duke ditur se fëmija është në rrugë të mbarë. Personalisht, ti ke qenë shumë mbështetës babi im i dashur dhe më ke ndihmuar gjithnjë. Kur udhëtojmë bashkë jashtë shtetit jam shumë i emocionuar, pasi e di që do të kalojmë një kohë shumë të mirë bashkë. Marrëdhënia jonë është aq e afërt, sa që të konsideroj si një mik të ngushtë dhe të tregoj gjithçka, pa pasur drojë. Së bashku me mamin, keni kontribuar që unë të jem ky që jam sot, dhe për këtë ju falenderoj shumë. Ju të dy keni qenë shembulli më i mirë për të zgjedhur se cili dua të jem në jetë. Duke qenë se jam djalë, më shumë jam munduar të të ngjaj ty, por patjetër që kam marrë edhe cilësitë më të mira të mamin. Këtë letër ta dedikoj ty për të të falenderuar që ke qenë përkrah meje nga dita e parë dhe që më ke ndihmuar të bëhem njeriu më i mirë që mund të jem. Të dua shumë dhe do vazhdoj të mundohem të jem si ti, pasi je i mbushur vetëm me cilësi pozitive! Ti je frymëzim për mua, prandaj nga zemra ime të them se je heroi im! Me dashuri, Kevin.

Kevin Hoxha 9B

Baba! Të falenderoj për gjithçka. Më ke qenë pranë që ditën kur linda, kur hodha hapin e kur thashë fjalën e parë. Më ke qenë pranë, kur unë kam qenë sëmure. Je kujdesur për mua. Më kujtohen ditët kur unë nuk flija dot vetëm dhe vija të flija gjithmonë afër teje, në krahët e tu. Babi, ti gjithmonë më ke ndihmuar sa herë kam pasur nevojë. Më ke ngritur në këmbë, sa herë rrëzohesha dhe më thoje të isha e fortë, më ke ndihmuar në gjuhët e huaja, më ke ndihmuar gjithashtu dhe në sporte të ndryshme si: noti, ping-pongu, volejboli etj. Gjithashtu, faleminderit për kujtimet e bukura që në çastin e lindjes, tani, e më vonë. Ba, ti jo vetëm je babai im, por gjithashtu shoku im më i mirë. Të dua e do të dua përjetë!

Iva Mane 9B

Babai im është boshti ku unë mbështetem, është shembulli më i mirë që çdo fëmijë do donte ta kishte. Duke ndenjur gjithmonë pranë njëri - tjetrit, jemi bërë si dy shokë dhe ndajmë çdo mendim bashkë. Ai më kupton mua për çdo gjë, është këshilluesi më i mirë dhe më ndjek ngado që shkoj në eventet sportive. Babai im është njeriu më korrekt që kam njohur dhe gjëja që urren më shumë, është gënjeshtria. Të gjithë miqtë e vlerësojnë për karakterin dhe korrektësinë. Në të ardhmen dua të bëhem si ai, njeri me vlera, familjar dhe mbi të gjitha njeri i besës. Për mua është babai më i mirë në botë, shoku im më i mirë dhe tifozi im më i çmendur.

Kevin Koka 9B

Babi im, ti më ke ndihmuar të krijoj kujtimet më të rëndësishme dhe më të bukura të jetës sime. Janë kaq shumë gjëra për të cilat dua të të falenderoj. Ti më ndihmoje të ngrihesha edhe pse gjithmonë rrëzohesha. Asnjëherë nuk u lodhe kur unë bëja gabime, edhe pse ishin të shpeshta. Edhe pse gjithmonë qaja kur më qortoje dhe mendoja se nuk më doje, sot kam kuptuar që po më mësoje si të ecja drejt rrugës së jetës. Më ke ndihmuar, këshilluar edhe për problemet më të vogla. Më ndihmoje të dalloja të mirën nga e keqja. Prandaj sot dua të të falenderoj për gjithçka që ke bër për mua. Je ti ai që më kupton gjithmonë! Je ti ai që më mbështet! Është e pamundur të përshkruaj dashurinë që kam për ty, pasi dashuria ime për ty i kalon limitet. Ti je heroi im!

Klea Dingu 9B

Babai im është një nga personat që më ka mbështetur më shumë në jetën time. Ai ka qenë aty që nga momenti që unë kam lindur e deri në ditët e sotme. Babai im më ka mësuar si t'i përballoj vështirësitë e shumta të jetës sime. Ai më ka mbrojtur, këshilluar dhe më ka treguar rrugën më të saktë e më të mirë për mua. Përveç përkujdesjes, ai është gjithashtu edhe shumë gazmor, i gëzueshëm dhe shumë njeri i mirë me zemër të madhe dhe bujare. Kur jam afër babait tim unë ndihem i sigurt dhe konfident se gjithçka do të shkojë mirë. Babai im është dhe do të jetë heroi im përgjithmonë!

Patrick Kola 9B

I dashur babi...

I shtrenjti babai im. Jam unë djali yt, ai djali që ka bërë gabime në jetë dhe ka kuptuar shumë, ai djali që bën gjithçka që të ndihesh krenar për djalin që ke rritur, ai djali që është krenar për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë, për dashurinë. Gjithë jetën tënde po punon për familjen, duke punuar pa pushuar asnjë ditë, duke na plotësuar çdo dëshirë, duke na plotësuar të gjitha nevojat që kemi. Babi, kur unë të dal të punoj, kur unë të bëhem me familje, do ta kuptoj çdo të thotë të jesh prind, çdo të thotë të rritësh dy fëmijë, çdo të thotë të japësh dhe të marrësh nga jeta dhe çfarë do të thotë familje. Babi im, kam shumë fjalë për të thënë, fjalë që nuk mbarojnë. Të dua shumë dhe jam shumë i kënaqur, i lumtur dhe krenar që kam një baba si ti. I shtrenjti baba! Të dua shumë, o babi!

Stivi Balla 9B



Baba...Ndonëse dikujt mund t'i tingëllojë një fjalë e zakonshme, për mua është fjala më kuptimplotë në jetën time. Pas kësaj fjale qëndron një burrë i matur, i fortë dhe i mirëkuptueshëm. Ai është dikush që di të përmbushë çdo kriter të një figure prindërore të përsosur. Për mua babi ka qenë dhe do të mbetet një model për t'u ndjekur. Të dua shumë dhe të falenderoj pafund për gjithçka që ke bërë për mua. Me plotë gojën mund të them me krenari "Babi, ti je heroi im!"

Ajkana Hima 9C



Në vogëli prindërit e mi kanë qenë si shokë për mua. Në veçanti babi. Nuk vinte asnjëherë duarbosh në shtëpi. Çdo ditë më blinte çokollata dhe dhurata. Babain e konsideroj shokun më të ngushtë në jetë. Më ka mësuar gjëra të rëndësishme për jetën. Është treguar gjithmonë i kujdesshëm në marrëdhënien tonë si babë e bir. Ai kalon shumë kohë duke më plotësuar dëshirat. Me babain tim flas shumë lirshëm, sikur po flas me një moshatar. Megjithatë nuk harron të më këshillojë dhe të më rikujtojë që është babai im. E admiroj për cilësitë që ka. Nuk ka turp nga puna, njeri me humor, i zgjuar, i shkathët, i fortë fizikisht dhe mendërisht. Babai im e ka fituar respektin tim dhe të gjithë të tjerëve. Çdo i afërm është krenar për babin tim.

Drini Kajtazi 9C

Ai është heroi ynë i vërtetë, por që kurrë nuk pret vlerësim nga ne. Është ai, që përherë qëndron në prapaskenë e nuk pret asnjë shpërblim për gjithë sakrificat e tij. Është arsyeja pse çdokush ka arritur aty ku është tani dhe ne duhet të dimë të vlerësojmë këtë element të rëndësishëm në jetët tona. Mjafton t'i falim pak dashuri e ai na fal botën.

Ergi Bushati 9C



Babi, një fjalë që mbart shumë kujtime brenda saj, përkujdesje, përkushtim... Çdo moment që kemi kaluar bashkë është i paharrueshëm për mua. Ke qenë idhulli që kam ndjekur gjithmonë në jetë dhe do të mbetesh figura që do i referohem gjithmonë. Të premtoj që një ditë do të ta kthej gjithë lodhjen e mundin që ke bërë për mua. Je një baba ideal. Një baba që çdo fëmijë do ta ëndërronte. Mijëra e mijëra kujtime të bukura kemi kaluar bashkë, të cilat do të ngelen një shenjë e bukur në zemrat tona. Do të të dua gjithmonë!!!

Aurora Elezaj 9C



Babai im
Fjala e parë në jetën e çdo fëmije,
Je ti baba.
Dashuria e madhe e çdo fëmije,
Je ti baba.
Heroi i djalit tënd, gjithmonë
Je ti baba.

Ai që mërzhitet për çdo lot që rrjedh,
Je ti baba.
Ai që për lumturinë tonë bëhet lumë që rrjedh,
Je ti baba.
Ai që më bën te guximshëm në çdo aspekt,
Je ti baba.
Ai mashkull që çdo herë më flet me respekt, Je ti baba.

Je ti baba, je ti gjithçka!

Firdeus Demiraj 9C

E kuptoj emrin e babait hero,
 i devotshëm dhe i denjë ngado.
 I mbaj si krenari këto fjalë,
 e ti do të jesh përherë i rrallë.
 Zemërgjerë e i duruar,
 psikolog i papërtuar.
 Fjalët e këshillat s'të kanë munguar,
 shembullin tënd kam fituar.
 Në vargje, fjalët më emocionojnë,
 vallë për ty asnjëherë s'shterjonë?
 Eh, sa shumë të dua baba!
 Ti për mua je prind,
 udhëtar i shpresës,
 udhëtar i së vërtetës...

Fjona Muça 9C



E dini se cili është idhulli im?! Është ai që e urren të më shikojë të mërzhitur dhe që bën gjithçka të më bëjë të buzëqesh... Është ai që më kupton që në sy, e kupton jo vetëm nëse jam mërzhitur, por kupton edhe arsyen... Është ai, që sa herë e shikoj, më fal një energji pozitive me ato sytë dhe buzëqeshjen e tij... Është ai, njeriu që shumë nga shokët e mi e kanë zili... Është ai, që ka zemrën më të madhe, që pavarësisht gjithçkaje, pavarësisht vuajtjes që një njeri mund t'i shkaktojë, ai gjen gjithmonë një anë të mirë tek çdo njeri... Është ai, për të cilin unë çdo ditë e më shumë ndihem krenar... Është ai, që unë rrallë e shpreh rëndësinë që ka në jetën time, por që frika ime më e madhe është ta humbas, pikërisht atë, atë që deri tani është protagonistin në ditarin e jetës sime... Ai është pika ime e fortë dhe e dobët... Është ai që më bën ta dua çdo ditë e më shumë...

Flavio Vila 9C



Dua të të tregoj, se sa shumë më ke dhënë.
 Dua të të kërkoj falje, për çdo debat që kemi bërë.
 Dua të shfrytëzoj kohën, për të përtërirë gjithçka.
 Gjithmonë dhe përherë, do të të shikoj si baba.
 Faleminderit për gjithçka!
 Për kohën e lirë, që e shfrytëzoje për mua.
 Për dashurinë e pafund, duke më thënë "Vajza ime, je gjëja më e shtrenjtë për mua!"

Gledia Ferko 9C

Njeriu më i rëndësishëm i jetës sime. Shoku im më i mirë. Personi që më ka ndihmuar më shumë nga të gjithë dhe më ka mbështetur në të gjitha momentet, si të këqija edhe të mira. Ai më tregoi rrugën e jetës sime...

Gerard Marku 9C



Është e vërtetë që e kam hapur këtë temë shpesh dhe në të qindtat e sekondit e kam mbyllur. E dija që duke lexuar fjalët tuaja aq të bukura e të singerta lotët do të më rridhnin pa dashur dhe do të ndieja dhe unë një therje në shpirt për babin tim...

I dashur Babi!!!

Jetoj në mendje kujtime të mrekullueshme nga ty. Pranë krevatit kam në kornizë fotografinë tënde, që e shoh çdo natë përpara se të fle... dhe fle me ëndrra...!!!! Ëndërroj për të ardhmen time, ashtu siç e dua dhe e ëndërron dhe ti. Të falenderoj me shpirt të mbushur nga dashuria pa kufij që kam për ty. Të falenderoj që më ke qenë pranë në çdo gjë.. aleat dhe shok, baba dhe mik. Të falenderoj që ke qenë vendi ku unë mund të mbështetesha dhe të qaja në momentet më të vështira që unë kam pasur. Të falenderoj për këshillat e tua dhe fjalët e tua të palodhura që më ke thënë gjatë gjithë jetës sime. Të falenderoj që më ke plotësuar çdo dëshirë dhe tekë timen sado e çmendur të ketë qenë. Të falenderoj për dashurinë që më ke dhënë gjatë këtyre viteve. Të falenderoj që më ke dhënë mundësi të rritem në një familje plot paqe dhe dashuri. Të falenderoj që çdo ditë të jetës sime, e ke bërë më unike duke qenë ti pjesë me surprizat e tua të pafundme. Sa më shumë kalon koha, aq më shumë rritet dëshira për të pasur cilësitë që ti ke. Të dua shumë dhe akoma më shumë dua të dish që jam krenare për ty, për energjitë e tua dhe vullnetin tënd. Po përpiqem me shpirt të arrij gjithçka, por sërish dua të dish, se asgjë nuk do të kish qenë e mundur pa suportin, me të cilin më ke mbështetur. Mbase nuk mësova kurrë që të sillesha si ty. Por ama sa herë që pretendoj të të ngjaj më vjen në mendje gjithmonë ti. Më vijnë në mendje ato kohë kur isha fare e vogël dhe shtrihesha sipër teje sa herë që shikonim ndonjë film. Të quaja "Jastëku im i butë". Si gjithmonë të kam thënë... Ti je hero i parë... Je personi i parë që kam dashur në jetë. Unë besoj në dashuri të parë, sepse sapo të pashë ty babi, që në momentin e parë të doja dhe do të të dua gjithmonë. Një vajzë mund të ketë një hero në jetë, por hero i parë do të jetë gjithmonë babai i saj, ashtu siç është dhe babai im për mua. Të jam dhe do të të jem gjithmonë mirënjohëse për gjithçka që ke bërë për mua, vëllanë, mamin dhe për familjen tonë, që të jetë gjithmonë një familje lumtur. Të dua shumë babi. Heroi im...

Megi Elezi 9C

Babi. Është kjo fjala që ndonëse ka katër shkronja, mbart ndër vete një pafundësi vlerash, që në mënyrë të pavetëdijshe rrënjosen në jetën e çdo fëmije. Të jesh prind është përgjegjësi, por mbi të gjitha një dashuri e pakufishme e sublime, që të bën të përjetosh një dimension tjetër. Mirëpo, si përjetohet kjo në sytë e një fëmije dhe sidomos të një vajze...

Sapo hapa sytë e mi të vegjël, ato u përballën me vështrimin tënd që ndonëse ishte mashkullor, sërish lotimi i një gëzimi të hareshëm, i falte atij një brishtësi unike. Që prej asaj dite, unë jam rritur në krahët e tu të ngrohtë, që më falnin lumturi. Ti më trajtoje mua si princeshë dhe unë ty si mbret, kur ne tregonim përralla. Ti më trajtoje si fortesën tënde, kur ne dilnim shëtitje, pasi për sa kohë që do më kishe pranë, asgjë nuk do të ndodhte. Ndërkohë, të qeshurat vazhdonin pandërprerë...

Mirëpo, ndonëse unë isha princesha jote, jeta jonë nuk ishte ajo përralla që ne ëndërronim. Pasi, ishte puna ajo, që dukej si një hajdut i pamëshirshëm, që ma rrëmbente babin çdo natë para se unë të mbyllja sytë, çdo natë para se të tregonim përrallën, çdo natë para se të të thoja fjalët: "Babi, të dua!" Megjithatë, ndonëse fëmijëria ime nuk ishte një kështjellë, ajo ishte shkolla më e vlefshme në jetën time. Pasi, në këtë periudhë të jetës time, mësova si të kujdesesha për veten, mësova si të formuloja përrallat mbi imagjinatën time dhe jo mbi tekste të shkruara, por mbi të gjitha mësova se është malli, ai që të bën të duash më shumë diçka. Dhe pikërisht ishte malli ai, që më bëri të kuptoja më mirë figurën prindërore, ai që më bëri ta dua më shumë babin tim... Çdo gjë, ashtu siç ka një fillim, ka edhe një mbarim. Fëmijëria ime ishte një erë kalimtare, që mori me vete mijëra kujtime, mijëra copëza jete të kaluara me vështirësi, mirëpo nuk arriti të merrte me vete dashurinë prindërore, e cila tashmë i kishte hedhur rrënjët në zemrën dhe jetën time. Çdo ditë kuptoj se pas çdo gabimi që unë bëj, ti je i gatshëm të më ndihmosh me një këshillë të papërfillshme në dukje, ama që ngulitet thellë në memorien time. Pas çdo trishtimi që më mban pezull në vetmi, ti je i gatshëm të më qëndrosh krahëhapur dhe të më ngushëllosh me fjalë që më përkëdhelin lehtësisht, duke i shndërruar lotët e hidhur në lot gëzimi. Pas çdo sukcesi që unë arrij, ti je i gatshëm të më mbështetësh, duke më inkurajuar pafundësisht. Por, mbi të gjitha, unë e di që në çdo hap që unë do të hedh, ti do të jesh aty bashkë me mua, duke më trajtuar si vogëlushen tënde, dhe unë ty si Heroin Tim.

Megi Murati 9C

Babi, nuk gjej dot fjalë për ta përshkruar dashurinë që kam për ty. Je ti ai, që nuk lodhesh nga gabimet e mia, je ti ai, që më bën të qaj e të qesh në çdo moment të vështirë e të gëzueshëm. Do të doja që të ktheja kohën pas dhe të përjetonim çdo moment të lumtur që kemi kaluar bashkë. Nuk dua të zgjatem shumë dhe të flas për babanë tim, se fundja çdo baba është hero për fëmijët e tij. Do të doja të të falenderoja pafundësisht për çdo mundim rreth meje, ama fjalët nuk kanë fund për ty!

Korab Kupa 9C



Babush, të dua shumë!

Nuk e them çdo ditë, por dua që ta dish. Gjithmonë përpiqesh të jesh me ne edhe pse puna bëhet pengesë ndonjëherë. Sado i lodhur dhe i mërzitur të jesh, ti gjen diçka që mua dhe mamit na bën të qeshim. Përpiqesh të jesh me mua në çdo moment të rëndësishëm. Dëshirat dhe kapriçot e mia mund të të kenë mërzitur dhe dua të të falenderoj për durimin që ke treguar. Gjendesh për mua kurdoherë dhe më bën që të qesh gjithmonë. E adhuroj faktin që në çdo situatë, edhe pse të vështirë, ti ke për të gjetur diçka që të më bëjë të ndihem më mirë. Nuk do të të ndërroja me asnjë njeri tjetër, pasi e di që ti je i veçantë dhe nuk ka njeri tjetër si ty në botë. Sado të rritem, e di që do ngelem përsëri vajza jote e vogël dhe tek ti do të gjej gjithmonë dashurinë e kërkuar. Je shoku më i mirë që kam dhe e di që do të jesh pranë meje gjithmonë.

Odri Bregu 9C



Kur dëgjoj fjalën hero, i pari person që më vjen në mendje është babai im. Një metrazh i shkurtër filmik me kujtimet më të bukura që kemi ndarë bashkë, më shfaqet. Dua të të falenderoj për çdo gjë që ke bërë për mua deri më sot. Ke qenë aty, që në momentin e parë, që kjo botë më lejoi të bëhesha pjesë e saj. Ti ke qenë dhe do të jesh një mbështetje e madhe në jetën time. Je ajo lloj mbështetjeje, e cila s'më ka lënë kurrë në baltë. E adhuroj faktin që përpiqesh të jesh gjithmonë pranë familjes dhe të mos humbasësh asnjë moment, edhe pse pjesën më të madhe të kohës e kalon në punë. Të falenderoj që më ke plotësuar çdo dëshirë, sado e çmendur të ketë qenë dhe ke duruar çdo tekë timen. Sa më shumë kalon koha, aq më shumë rritet dëshira ime që të kem të njëjtat cilësi si ty dhe të të ngjaj sadopak. Dua që ta dish se të jam mirënjohëse për gjithçka.

Sara Kondi 9C

Punon pa u lodhur
 çdo ditë babi im.
 Shpesh kur unë zgjothem,
 Ti je në udhëtim.

Librin nga dora
 s'e lëshoj kurrë.
 Sa shpejt kalon ora
 kur pranë të kam unë!

Sa herë mendothem:
 A do mund të të ngjaj?
 Librin mundohem
 nga dora mos ta ndaj.

Sibora Haxhia 9C



I shtrenjti baba! Me mirënjohje të thellë më dalin këto fjalë nga shpirti. Je një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar gjithmonë ke qenë si një busull drejtuese për mua. Je kritiku që më ka frenuar që pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë.

Gjithmonë do ndihem krenare për ty. Ke qenë babai ideal për mua. I tillë do mbetesh deri në fund ... edhe në kujtimet e mia.
 Të dua shumë babai im.

Lainus Hyska 9C



Babi, s'mund ta përshkruaj kaq thjeshtë dashurinë time për ty. Më je gjendur në rastet më të vështira dhe ato më të lumtura. Ke qenë i duruar për çdo gjë. I shtrenjti ba, me mirënjohje dhe dashuri po shkruaj këto fjalë tani. Gjithmonë do jesh personi tek i cili unë do mund të mbështetem. Babai na mëson për gjithçka. Na përgatit për jetën dhe nuk na lë kurrë në baltë. Këtë tekst ta dedikoj ty, babai im i shtrenjtë. Ky tekst është një mënyrë tjetër për të të thënë se "Të dua BABI!"

Sidora Tyli 9C

Sa shumë vargje thuhen për të ëmblën mama dhe sa lihet në harresë trimi baba. Vijnë në jetë nga një femër dhe gjithë jetën i përkushtohemi nënës, se dhe vetë një ditë, do bëhemi nëna. Mund të më thoni, a e keni menduar ndonjëherë që pas një nëne ideale fshihet një mashkull, i cili prioritet të jetës së vet ka vendosur jetën e fëmijë së tij? Rrallëherë, apo jo... ose mbase se kemi menduar fare. Këtë gjë arrita ta mendoja sot, kur ai më pa të mërzhitur. Ngulmonte derisa të gjente përgjigjen, se thellë-thellë vajza e vet, do të mbetet gjithmonë e vogla e babit, princesha e tij dhe nuk e çon ndërmend që një ditë ajo do të jetë mbretëresha e dikujt tjetër, e tek e fundit kush do ta çojë nëpër mend këtë? Ba... dy gërma ka kjo fjalë, por për të është statusi më i bukur që kjo jetë i ka falur. Nëse kaloj tërë kohën me nënën dhe babit i kushtoj qoftë vetëm një orë, jam e sigurt që orët të cilat nuk jam e pranishme me të, imazhi im ka qenë gjithë kohës para syve të tij, sa herë që ai përplas qepallat për të mbyllur sytë. Ngulmoj të them se vajza është e dhembshura e babit, se ai jep shpirtin pas saj, se ai të gjitha do t'i jepte për ta parë atë të qeshur, se ai sa herë kthehet nga puna për në shtëpi pret me padurim që ta përqafojë të parën vogëlushen e tij, që i fal buzëqeshjen më të bukur në botë. Nëse nëna për të bijën do të jepte jetën, padyshim që babi do e shkatërronte botën.

Suila Zela 9C



I shtrenjti baba! Je si një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek.

Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar, gjithmonë ke qenë si një busull drejtues për mua. Je kritiku që më ka frenuar që pa hedhur hapin e gabuar, je këshilluesi më i saktë e që më bëre të mos gaboj kurrë në jetë. Gjithmonë do ndjehem krenare për ty. Ke qenë babai ideal për mua.

Xhisilda Cami 9C



Babi im, sa shumë të dua,
Ti je gjithçka për mua,
Ti idhulli im je,
Dhe dashuri pafund ti më jep.

Xhosela Rraboshta 9C

Lindim dhe rritemi me legjenda heronjsh, njerëzish të mëdhenj që kanë luftuar përgjatë historisë për lirinë e tyre. Sot kam një ndjesi për një hero të veçantë, një hero që më përket vetëm mua. Ky është babi im, modeli im, frymëzimi im. Në çdo moment, në çdo hap që kam hedhur në jetë ke qenë aty për mua. Kur kam rënë më ke ngritur, më ke mësuar të dalloj të saktën nga e gabuara. Ai është personi më i rëndësishëm për mua, personi ku unë mbështetem dhe që ma bën çdo gjë më të lehtë. Dhe jam e sigurt që sado vite të kalojnë, sado që të rritem, gjithmonë do të kem nevojë për ty. Para babit tim më duken të vegjël gjithë heronjtë e mëdhenj.

Adile Su Girengir 9D



Babai im është boshti ku unë mbështetem, është shembulli më i mirë që çdo fëmijë do donte ta kishte. Duke ndenjur gjithmonë pranë njëri tjetrit jemi bërë si dy shokë dhe ndajmë çdo mendim bashkë. Ai më kupton mua për çdo gjë, është këshilluesi më i mirë dhe më ndjek ngado që shkoj në eventet sportive. Babai im është njeriu më korrekt që kam njohur dhe gjëja që urren më shumë është gënjeshtria. Në të ardhmen dua të bëhem si ai, njeri me vlera. Për mua është babai më i mirë në botë, shoku im më i mirë dhe tifozi im më i çmëndur.

Aldi Gjumsii 9D



Faleminderit Babi!

Babi im është njeriu më i mirë në të gjithë botën, është i adhurueshëm. Ai ka qenë me mua në çdo çast të bukur, të lumtur, të trishtuar dhe të shëmtuar të jetës sime. Ai është perfekt, është prindi më i mirë që ekziston. Unë dhe vëllai im i vogël jemi me fat që e kemi atë. Ka qenë aty për çdo gjë, kur thamë fjalën e parë, kur kemi bërë lëvizjen e parë, në ditën e parë të shkollës, në festën e abetares, sa herë që jemi sëmëmurur dhe sa herë që kemi festuar. Babit duhet t'i them faleminderit për çdo gjë, për çdo dëshirë të plotësuar, për shkollën që po më jep, për faktin që është një baba i tillë, dhe mbi të gjitha për jetën që më ka ndërtuar, një jetë me të gjitha të mirat e mundshme. Duhet t'i kërkoj falje jo vetëm babit, por dhe mamit për shumë gabime, por mund t'ju premtoj që do t'ju shpërblej sa më parë çdo mundim tuajin dhe çdo shqetësim që ju kam shkaktuar. Babi im është dhe një shok shumë i mirë, me të mund të bisedoj dhe të këshillohem për shumë probleme dhe çështje të ndryshme. Jam thjesht me FAT!

Aron Alushani 9D

Babi im kam shumë fjalë për të të thënë, të cilat nuk mbarojnë kurrë. E vërteta është që unë kurrë nuk mund të të ngre në pozicionin që ti meriton. Unë nuk jam aq e zonja të thur fjalë për të përshkruar imazhin tënd në sytë e mi aq sa dua. Fjalët ngatërrohen dhe duket sikur humbin. Je një idhull për mua, je heroi im, je shembulli më i mirë. Mësimet që më ke mësuar janë të pafundme. Nuk mundem të vlerësoj njërin më shumë se tjetrin, pasi të gjithë kanë ndikuar në krijimin e një karakteri me plot vetëbesim tek unë. Nga të gjitha gjërat në këtë botë, më e rëndësishmja është familja dhe çdokush duhet t'ia dijë vlerat. Ka shumë gjëra, për të cilat duhet të të falenderoj, por më e rëndësishmja është besimi i pakufizuar që ti ke për mua. Ekzistenca jote e ka bërë jetën time në një farë mënyre shumë herë më të bukur dhe më të lehtë.

I shtrenjti babai im, ti, mami dhe motra jeni pasuria ime dhe për ju të gjithë fal edhe jetën. Një gjë dua t'ju them dhe s'kam për ta harruar kurrë: JU DUA SHUMË!!!!!!



Deborah Hasanago 9D

Babai im, personi më i shtrenjtë në botë për mua. Nuk e di a do t'ia kisha dalë pa ty. Me ty kam kaluar shumë vështirësi të jetës. Vetëm në çastet e vështira e kam mësuar se ç'do të thotë fjala "baba". Babai është i vetmi burrë në botë, ku mund të hapesh dhe të rrëfesh pa frikë dhe pa turp. Babai im është shumë gazmor dhe inteligjent, edhe pse ndonjëherë acarohet shpejt, por unë e dua atë ashtu siç është. E di se nuk mund t'ia kthej ato që ai ka bërë për mua dhe kam një ndjenjë që ai është krenar për djalin që ka. Askush në këtë botë nuk mundet të thotë se ka një baba të keq, secili thotë se babai im është më i miri në botë. Shpeshherë në gjestet e mia më kujtohesht ti! E dua shumë veten kur më thonë që i ngjaj babait dhe jam shumë i lumtur që kam një baba si ti! Ti je më i miri për mua! Shumë herë i kam kushtuar nënës vargje, po kësaj here ta kushtova ty, sepse edhe ti ke një vend në zemrën time Të dua shumë babi!



Ergi Spahiu 9D

Baba, një fjalë e cila më sjell ndërmend heroin tim, më sjell ndërmend njeriun, i cili ka sakrifikuar çdo gjë për mua. Ai është një nga personat më të çmuar në jetën time, ai është një person, i cili më ka ndihmuar dhe më ka ndenjur pranë, kur askush nuk ka qenë aty. Kur unë kam pasur mendimin që nuk mundem të bëj diçka, ai më ka ardhur dhe ka thënë që po, mundesh, sepse do të më kesh dhe mua aty pranë teje, duke të të ndihmuar që të pamundurën ta bësh të mundur. Ai është i vetmi person me të cilin nuk mund të rri pa folur dhe kurrë nuk mund të mërzitem me të. Ai është personi që rri duke më pritur çdo ditë pas shkolle dhe sa herë hapet dera, më pret me krahë hapur dhe vjen të më përqafojë dhe të më puthë sikur të kishte muaj pa më parë. Babi, të dua shumë dhe gjithmonë do të jesh personi që dua më shumë në këtë botë dhe kurrë s'do të ndryshojë!

Erjana Çejku 9D

I dashur babi,

Shpeshherë më ke thënë se si ishte jeta juaj para se të lindja unë. Më ke thënë se si bashkë me mamën luteshit që mbi të gjitha, të isha një fëmijë i shëndetshëm dhe i mbarë. Se si thurnit imazhe në mendjen tuaj se kujt do t'i ngjaja më shumë. Babai ka një rol më të madh se vetëm prind. Babai është një shok që të mirëkupton dhe do më të mirën për ty. Ai është gjithmonë aty për një këshillë. Të kupton edhe kur ti nuk flet. Ti baba, je aty pranë meje në çdo hap. Dhe kur rrëzohesha, ishe i pari që më ndihmoje të ngrihesha. Ndonjëherë harrojmë se pa babain, nuk do të ishim këta që jemi. Të falenderoj për gjithçka. Të falenderoj për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë. Të falenderoj që më ke plotësuar çdo kërkesë e dëshirë. Të falenderoj, që bashkë me mamën më mundësove një jetë dhe arsim më të mirë. Ne fëmijët gëzohemi më shumë me arritjet tona, kur mendojmë sa krenarë do të ndihen prindërit. Besoj se edhe për një prind, gjëja më e bukur është të shohë fëmijën e vet të arrijë gjërat për të cilat punon. I mbaj mend të tëra momentet bashkë. Kur shkova për herë të parë në shkollë, gëzimi në fytyrën tënde ishte i pamatë. Kur sapo filova klasën e 6-të, dhe akoma nuk isha përshtatur, ti më siguroje se çdo gjë do të shkonte mirë. Dhe këto ditë, kur unë rri tërë mbasditen mbyllur në dhomën time duke mësuar, ti sigurohesh që unë të mos lodhem shumë, që të mos më bezdisë njeri. Edhe pse shpeshherë zihemi, marrëdhënia që kemi me njëri-tjetrin na bën të lëmë pas krahëve gjithçka jo të pëlqyeshme që ndodh. Je një nga personat më të rëndësishëm në jetën time. Askush nuk mund të zërë vendin tënd!

Erta Hoxha 9D



Babi im,

Ti je personi që më ka mbështetur gjithmonë. Çfarëdo lloj gjëje që kam bërë, të keqe ose të mirë, ti ke pasur mendime pozitive për të. Je preokupuar shumë që unë të bëhem dikushi dhe vazhdon ta bësh këtë gjë. Edhe pse shpeshherë nuk të kam dëgjuar, por kam vepruar sipas mendjes sime, e kam ditur që e ke pasur për të mirën time. Fjalët janë të pamjaftueshme për të të përshkruar. Je një nga gjërat më të rëndësishme që kam në këtë jetë!

Even Qarri 9D

I dashur babi,

Kanë kaluar plot 15 vite dhe ti baba i dashur më je gjithmonë pranë. Sa herë që mendoj për të gjitha gjërat e mira që Zoti më ka dhënë ti, mami dhe motra jeni të parët që më kujtohen. Dashuria, mirësia, përkujdesja dhe urtësia jote, më rrjedhin gjithmonë nëpër mendime. Kur isha e vogël, kisha shumë dëshirë të shikoja filma me superheronj, me shpresën që edhe unë do të takoja një të tillë një ditë. Por u gabova rëndë. Heroi më i madh i jetës sime je ti, babi! Ti gjithmonë më ke qëndruar pranë, pavarësisht gabimeve të mia. Më ke mësuar që pas çdo të keqeje ka gjithmonë një të mirë. Mbaj mend që më ke treguar se si dëshiroje të kishe një djalë pas lindjes së fëmijës së parë, por kur zbulove që ti dhe mami do të prisnit një vajzë, kjo dëshirë nisi të venitej. Lindi një dëshirë e re më e madhe: të na shikoje mua dhe time motër të rriteshim, të edukoheshim dhe të respektonim vetveten, pasi po të mos ishim ne të parët që do ta bënim një gjë të tillë, atëherë askush tjetër nuk do të ishte. Ti gjithmonë ke shpresuar për një jetë sa më të mirë për ne dhe kjo shpresë vazhdon edhe sot. Muajt kaluan dhe më në fund erdhi dita e shumëpritur, lindja ime. Personi i parë që më mbajti në krahë ishte ti. Më kujtohet sesi që kur më mbajte në duar për herë të parë, unë u qetësova dhe nisa të mos qaja më. Hapa sytë, të pashë dhe buzëqesha, sikur ta dija që përpara kisha një njeri, i cili në një të ardhme do të thoshte shumë. Vitet kaluan dhe unë u rrita. Edhe pse tani mund të jem 15 vjeç, ti gjithmonë do të më trajtosh si vogëlushen tënde të pafajshme. Babi, fjalët që unë dua të të them janë të pafundme dhe do të duheshin ditë të tëra për t'i shprehur dhe për t'i shkruar në një copë letër, por dije që unë do të vazhdoj të të falenderoj për dhuratën më të madhe dhe më të bukur që askush nuk mund të ma jepte dot ... Babi, ti BESOVE TE UNË! Pavarësisht gjithçkaje, çdo zhgënjimi që unë të kam sjellë, ti vazhdove të besosh. Ti për mua do të mbetesh gjithmonë si shoku im më i ngushtë, si dhe thesari më i çmuar që unë kam. I dashur babi, unë arrita të besoj në dashurinë me shikim të parë, pasi kur të pashë ty e dija që ti do të më rrije pranë, në çdo hap që unë do të hedh në jetë. Babi të dua pafund! Me dashuri, princesha jote e vogël Evi!

Evi Tafaj 9D

I dashur babi,

A e mban mend ditën kur unë erdha në jetë? Sa i emocionuar dhe njëkohësisht nervoz që ishe? Do të bëheshe baba për herë të parë! Thurje ëndrra për atë foshnje të porsalindur, do të bëje të pamundurën që ajo vajzë e vogël të jetonte jetën më të mirë. Nuk do ta lije kurrë të qante, do ta mbroje nga çdo e keqe e kësaj bote dhe kurrë nuk do ta lije të lëndohej. Një vajzë e vogël, që gjithmonë do të ta ndiente nevojën, që kurrë nuk do të mund të jetonte dot pa ty. Do të bëheshe një baba, që gjithmonë do të ishte mbështetësi numër Një, i princeshës tënde të vogël, gjithmonë do ta mbështetje dhe do të ishe pranë saj në momentet më të vështira. Do të bëheshe ai, që do t'i dinte zgjidhjet e të gjitha problemeve. Do ta ngrije sa herë të rrëzohej dhe gjithmonë do të kujdeseshe për të. Në ditën kur ajo lindi, ti i premtove vetes se gjithmonë do t'i gjendeshe pranë dhe kurrë nuk do ta lëshoje dorën e saj të vogël. Ti e shoqërove gjatë gjithë fëmijërisë së saj, e ndihmove të hidhte hapat e saj të parë, e dëgjove kur tha fjalën e parë, luajte më të, duke u kthyer edhe vetë në një fëmijë ,vetëm që ta bëje të qeshte. E qeshura e saj ishte një muzikë për veshët e tu. Ishe i pari që kërcëve me të, i pari që e paralajmërove për të gjithë rreziqet që jeta do t'i hidhte përpara. Ishe personi i parë, me të cilin ajo ra në dashuri. U bëre një hero që e udhëheq atë në të mirat dhe në gëzimet e jetës. Ajo vajzë e vogël, tashmë është rritur dhe tani po shkruan disa rreshta për ty. Të qeshurat, puthjet e përqaftimet, me ardhjen e adoleshencës, u kthyen në zënka e qortime, por pavarësisht të gjithave, ajo do të mbetet gjithmonë vajza jote e vogël, asgjë nuk do ta ndryshojë këtë gjë. Pavarësisht të gjithave ajo do të jetë gjithmonë krenare për ty, sepse ti je personi më i shtrenjtë, që ajo do ta mbajë në zemër përgjithmonë. Ndihet kaq me fat që ka një baba si ty! Me dashuri, vogëlushja jote, Gea.

Gea Ivanaj 9D

Babai im

Babi! Nuk di çfarë të them për ty. Nuk di si të të falenderoj për gjithë lodhjen dhe përkushtimin e këtyre viteve, që unë dhe motra ime të kemi një jetë sa më të mirë. Asnjëherë nuk pushon së punuari për ne. Që i vogël jam rritur me praninë tënde, dhe s'do ta harroj kurrë ndihmën që më ke dhënë gjatë këtyre viteve. Prania jote, gjithmonë më ka bërë të ndihem më i sigurtë dhe të mos kem frikë, pasi në çdo vështirësi timen, unë e di që ti do të jesh aty duke më mbeshtetur. Gjatë kohës që jam rritur, gjithmonë të kam pasur shembull ty, sepse ti për mua ishe babai ideal dhe shpresoj që kur të rritem të paktën të bëhem si ty. Ti ishe gjithmonë aty për ne, dhe ne do të jemi aty për ty.

Henri Hoxha 9D



Për ty, Babi!

19 Marsi. Kjo ditë e shënuar, kushtuar të gjithë baballarëve në mbarë botën. Nëna dhe babai janë gjëja më e shtrenjtë për të gjithë ne. Por, ashtu siç thotë një fjalë e urtë "Gocat janë të baballarëve", mund të them se është e vërtetë. Ajo ç'ka është mes nesh është e veçantë. Jemi të afërt me njëri-tjetrin dhe çdo shqetësim timin e ndaj me ty dhe të dy mundohemi të gjejmë zgjidhjen e duhur. Ndonjëherë debatojmë, por kjo nuk ndryshon asgjë. Jemi dy miq të ngushtë dhe kam shumë fjalë për ty. Nuk di nga t'ia filloj me falenderimet. Ajo për të cilën dua të të falenderoj më shumë është se ti bërë të mundur ardhjen time në këtë botë dhe që ishe gati për çdo gjë që të priste më tej. Të falenderoj që je pranë meje në çdo çast të vështirë dhe i bën ato më të lehta. Pa harruar dashurinë dhe mirëkuptimin që nuk munguan kurrë. Duke i shtuar falenderimet, për plotësimin e dëshirave që nuk kanë kurrë fund. Ishin të shumta netët pa gjumë së bashku me mamin, kur unë isha sëmurë. Nuk do t'i harroj kurrë shëtitjet e vona në rrugët e qytetit, ku bisedonim e bisedonim për shumë gjëra. Ajo që më kujtohet, kur unë isha e vogël, është se uleshim të dy para televizorit dhe shikonim filma të ndryshëm vizatimorë. Janë të pafundta falenderimet për ty. Një fletë, as dy, as tre nuk mjaftojnë për t'i shkruar të gjitha. Do të mbetem gjithmonë princesha jote dhe ti mbreti im. Je njeriu më perfekt që kam njohur. Për ty...

Esti Dautaj 9D

Babi im

Babi im, të falenderoj shumë për gjithçka që ke bërë për mua. Ke qenë dhe je gjithmonë pranë meje, në momente të bukura, të gëzueshme dhe të vështira. Për ty jam unë në plan të parë, dhe këtë nuk lodhesh kurrë së ma treguari dhe shprehuri, me gjëra të vogla dhe të mëdha, me dashurinë dhe vëmendjen që më kushton, me fjalët që më thua dhe këshillat që më jep. Ti gjithmonë ke plotësuar dëshirat e mia. Kur pasiguria më pushton, e di që aty do të jesh ti për të më inkurajuar. Jemi si shokë me njëri-tjetrin dhe nuk mbajmë sekrete. Çdo të mirë dhe të keqe, ne i kalojmë me një buzëqeshje. Më ke mësuar të dua sportin, t'i jap biçikletës, të luaj ping-pong, të di të tregoj bukur histori, ashtu sikurse ti i tregon bukur ato për mua. Të dua shumë babi im!

Henri Vishka 9D



Një hero pa pelerinë

Babai, një fjalë aq e bukur dhe me një peshë aq të madhe. Për mua, babai është një nga njerëzit më të rëndësishëm. Ka qenë gjithmonë shpatulla ku unë mund të mbështetesha. Më ka mbrojtur dhe më ka plotësuar çdo dëshirë që unë kisha, pavarësisht çdo gjëje. Sa herë unë gaboja, ai më mbështeste dhe më thoshte të mos shqetësohesha, duke më përkëdhelur lehtë flokët me një buzëqeshje të ngrohtë. Sa netë të gjata ka kaluar pranë meje, kur unë isha sëmurë. Ulur mbi karrigen ngjitur meje, duke fjetur i mbuluar nga djersa, me një pamje aq të mjerueshme që vetëm unë mund t'ia jepja. Për mua, ai ka qenë gjithmonë idhulli im. Që kur kam qenë e vogël, e shihja nga poshtë me një admirim që m'i bënte sytë të shkëlqenin si yjet në natën e errët. Ai ka qenë personi që më ka mësuar gjithçka. Personi i parë që më përgëzonte kur unë bëja diçka mirë. Mund të bëja çdo gjë për atë "Të lumtë!" - ën e tij. Babai im, është personi që më motivon më shumë se të gjithë. Është ai person që do të jetë gjithmonë pranë meje, duke më pritur me krahë të hapur dhe me një buzëqeshje të ëmbël. Ai do të më mbështetë gjithmonë, edhe kur të mos jetë më bashkë me mua. Jam e sigurt se do të me shikojë nga lart, duke më thënë mos të dorëzohem kurrë. Babanë tim do ta dua gjithë jetën time, pavarësisht çdo gjëje. Së fundmi, do të doja të thoja "Faleminderit". Faleminderit që më mbështet, faleminderit që je gjithmonë aty për mua, faleminderit që më jep një shpatull për të qarë! Faleminderit për gjithçka! Do të të kem gjithmonë në zemër! Të dua pa masë hero i im!

Kestin Skura 9D

Babi Im

Ai vetëm më llaston,
ndonjëherë e tepron,
dhe nëse diçka ti kërkon,
ai kurrë s'të kundërshton.

Është trim e shumë i mirë,
i pëlqen torta për ëmbëlsirë,
gjithmonë mekanikun thërret,
por si përfundim, punët i bën vetë.

Ka raste, që shumë të ngacmon,
e kjo shumë më acaroon,
por përgjithësisht është i mirë,
të të bëjë të qeshësh, ka shumë dëshirë.

Askush s'është perfekt,
të gjithë e kanë nga një të metë,
por për mua, ai hero do të jetë,
e kjo s'do të ndryshojë përjetë!

Klea Nela 9D



Babi im

Babai, shtylla e çdo familjeje dhe burri më i fortë në botë për mua. Babai është ai që të mbron dhe punon ditë e natë për familjen dhe merakoset për ty në çdo moment. Babai për mua, është ai që më sjell gjithmonë lumturi dhe nuk më lejon të jem i mërzitur. Ai sakrifikoi gjithë jetën e tij për mua. Me të flas çdo gjë, e kam si një shok të ngushtë, që nuk më lë kurrë në baltë, pavarësisht gabimeve që mund të bëj. Ai më flet me orë të tëra, më këshillon për çdo gjë. Edhe pse gjithmonë kemi zënkata tona, në fund e kuptoj që ai i ka për të mirën time dhe nuk do të ma donte asnjëherë të keqen. Shpresoj që kur të rritem, e të bëhem sa gjysma jote, të përpiqem të të kthej dashurinë dhe kujdesin që ke treguar për mua. Kur të plakësh, do të të mbaj gjithmonë në zemrën time. Faleminderit që më rri çdo moment pranë, idhulli im!

Luis Hysi 9D

Babai, shoku im më i ngushtë

Babi, je një person i çmuar që mbart vlera të jashtëzakonshme. Je prind, shok dhe gjithashtu njeriu më i dashur për mua. Kur më vjen në mendje, nuk di çfarë të shkruaj më parë, sepse ke aq shumë cilësi të mira, sa është e vështirë t'i përshkruash me fjalë. Ndonjëherë konkluzionet më nxjerrin në mendimin se ti je perfekt e më duket sikur je një dhuratë që Zoti më ka dhënë për të më motivuar të eci përpara dhe të mos dorëzohem kurrë. Je gjithmonë i singertë dhe i drejtë dhe të falenderoj për këtë, sepse në këtë mënyrë unë do të jem një pasqyrë ideale e jotja. Për më tepër ti e meriton këtë, pasi ke qenë shembulli më i mirë. Për mua, çdo ditë je burimi i forcës dhe i sinjeritetit, një burim energjish pozitive të pashtershme. Do të mundohem të të bëj krenar. Do të bëj të mundur që buzëqeshja të mbizotërojë në fytyrën tënde. Faleminderit babi, heroi im, për të gjitha sakrificat që ke bërë për mua dhe do të të jem përjetësisht mirënjohëse për dashurinë që më dhuron!

Megisa Muça 9D



Babi, shembulli më i mirë i forcës dhe dashurisë për mua! Jam unë... Vajza jote e parë, Sara, vajza që të bën të ndihesh krenar, vajza që është krenare për ty dhe për çdo gjë që ti ke dhënë për të. Çdo ditë të jetës tënde ti punon fort, për të na siguruar dhe plotësuar çdo kërkesë dhe nevojë që kemi. Ti je ai, që na mëson të ecim drejt rrugës së jetës. Je si një busull drejtuese për mua dhe orientimi i shigjetave të tua është gjithmonë drejt destinacionit të duhur. Ti je gjithmonë aty për mua dhe s'më ke lënë asnjëherë vetëm, që të zhytem në errësirën e vetmisë. Je ti ai që më mëson shumë rreth fatalitetit njerëzor. Më ke treguar që njerëzit nuk janë gjithmonë ashtu siç mendojmë ne, por do të ndeshemi gjithmonë me tipa të ndryshëm dhe duhet të dimë si të sillemi kundrejt tyre. Sekret i suksesit tënd është puna, urtësia dhe sinjeriteti, frymë me të cilën jam rritur dhe unë duke marrë shembull nga ty. Jam krenare të ngre kokën dhe të thërras me të madhe emrin tënd, sepse ndihem gjithmonë e mbrojtur dhe e përkrahur sa herë ti gjendesh pranë meje. Vetmia shpeshherë na pushton dhe pyesim veten nëse ka mbetur dikush në këtë botë që na do. Befas dëgjoj në kokën time një zë që vjen pas zërit tim, por nuk është gjë tjetër, veç se jehona e zërit tim, e cila shkoi diku, u përplas dhe u kthye. Të duket gjithçka e zymtë dhe e gjen veten duke qëndruar në një cep toke të quajtur "Vetmi". Por gjithmonë aty je ti, për të ndriçuar këtë zymtësi dhe për të më dhënë forca që të vazhdoj përpara. Je ti, ai që na rrit me shumë përkujdesje dhe modesti, prandaj unë jam këtu sot. Me gjithë zemër të them se ti je gjëja ime më e shtrenjtë, sepse ti je babai im. Jo! Jo! Ti je heroi im dhe do të të ndjek në çdo hap që do të hedh dhe do të të bëj të ndihesh shumë krenar!

Sara Xholi 9D

Babi im është një nga personat më të shtrenjtë në botë për mua. Ai nuk është vetëm prindi im, por shembulli dhe shoku im i ngushtë. Babi është shpatulla ku unë mbështetem. Babai është shtysë për mua që të arrij sa më shumë gjëra në jetë. Ai është njeriu më korrekt që kam njohur. Ai është njeri i fjalës dhe gjithmonë e mban fjalën e dhënë. Jam krenar për babanë që kam. Ai është shembulli më i mirë që mund të ekzistojë. Ai ka punuar dhe ka sakrifikuar për mua dhe ka punuar që të kemi një jetë më të mirë dhe ia ka dalë. Babai im është njeriu më i mirë në botë dhe njeriu më i dashur për mua. Nuk do ta ndërroja me asgjë në botë.

Rei Tabaku 9D



Data 19 mars. Kjo ditë i kushtohet të gjithë baballarëve. Të dy prindërit janë gjëja më e shtrenjtë, por vajzat llastohen më shumë nga babi. Edhe pse vajzat moshatare me mua në shumicën e rasteve janë më të afërta me mamin, unë jam me babin. Ai gjithmonë ka qenë aty për mua dhe më ka ndihmuar për çdo problem që mund të kem pasur. Në çdo hap ka qenë ngjitur me mua. Unë jam pikë e dobët e tij dhe ai pikë e dobët e imja. Debatet dhe mosmarrëveshjet nuk kanë munguar, por në fund të ditës pajtohem. Edhe pse ndonjëherë e kam zhgënjyer, kjo gjë nuk e ka prishur lidhjen tonë si babë e bijë. Sa herë kam probleme në shtëpi, fjala e parë që them është "O BUSHSH!" dhe ai vjen brenda pak sekondave të më ndihmojë apo të më plotësojë ndonjë dëshirë timen. Dua ta falenderoj për çdo gjë që ka bërë për mua. Sidomos për sakrificat e tij për një të ardhme më të mirë për mua dhe vëllezërit e mi. Gjithmonë ka qenë shembull dhe është munduar të fshehtë të gjitha defektet që ka, edhe pse mua më duket një njeri perfekt. Është babai dhe ndërkohë kryefamiljari ideal. Të 365 ditët e vitit mundohet të përcjellë dashuri dhe pozitivitet në shtëpinë tonë. Çdo dëshirë që kam pasur ma ka plotësuar dhe ndihem shumë mirënjohëse për këtë. Falenderoj Zotin që kam pasur mundësinë të kem një baba të mrekullueshëm. Ai është mashkulli i parë që kam dashur dhe që më ka mësuar për jetën. Edhe kur vitet të kalojnë, unë gjithmonë do të mbetem e vogla e tij dhe kudo që të shkoj do ta kërkoj dashurinë dhe mbështetjen e tij. Babi, është heroi im!

Uendi Tuda 9D

Të nis të flas për ty do më duhej shumë kohë dhe përsëri jam në dilemë nëse i kam thënë të gjitha. Të eci nëpër hapat e tu dhe të jem si ti është fat. Pa dyshim që çdo njeri në këtë botë të hedh poshtë, në çdo kohë mund të të zhgënjë në një mënyrë ose tjetrën, por ti, ti kurrë nuk do e bëje diçka të tillë. Më plotëson çdo dëshirë dhe asnjëherë nuk më ka munguar asgjë dhe kjo vjen nga ty, vjen nga puna jote e palodhshme ditë e natë. Je njeri i mrekullueshëm... Sa më ndihmojnë ato këshillat e tua! Je një baba, një shok, një mik, i cili duhet të merret shembull. Jam krenare për ty, për edukatën që më ke dhënë. Pika ime më e dobët je ti. Këshillat e tua më kanë bërë një njeri më të mirë, më kanë bërë që të jem e zonja për çdo gjë në jetë. Dua t'i dëgjoj përditë ato këshilla dhe kurrë nuk do mërzhitem. Koha kalon dhe ne bëhemi çdo moment më të afërt me njëri tjetrin. Ke një zemër kaq të madhe, e cila është e mbushur me mirësi. Më frymëzon çdo ditë edhe më shumë me vullnetin tënd të pashterueshëm. Do të jesh gjithmonë drita në fund të tunelit, e cila nuk do të fiket kurrë. Nëse nuk e mbyll tani këtë, mendoj që do të jem këtu duke shkruar këtë letër dhe mbas shumë viteve... Të Dua Pafund Babi, Je Krenaria Ime!



Xhiko Llanaj 9D

Babi, falemindeit që ke qenë gjithmonë aty për mua, pranë meje. Ti ke qenë me mua që prej fillimit, kur unë linda e më vonë, kur hodha hapin e parë dhe thashë fjalën e parë. Sa herë shrihesha në darkë në krevatin tim, nuk flija pa dëgjuar një histori të Herkulit, Tarzanit, Spiderman-it apo të Batman-it prej teje. Por ti asnjëherë nuk i mbaroje historitë e tua, sepse mua më zinte gjumi që pa arritur gjysma e historisë. Ti më ke ndihmuar sa herë kam pasur nevojë. Më ke ngritur në këmbë, sa herë jam rrëzuar. Gjithashtu më ke mësuar shumë gjëra, veçanërisht në sporte të ndryshme. Ti më mësove si t'i jap biçikletës, më mësove të notoj, të luaj futboll, ping-pong etj. Kam shkuar të gjuaj peshk bashkë me ty dhe kam rrëshqitur prej rrësqitëseve gjigante në pishinë bashkë me ty. Nuk je vetëm babai më i mirë që mund të kisha, por edhe shoku im më i mirë. Do të të dua gjithmonë babi im!



Sidrit Demiraj 9D

I dashur baba,

Nuk kam fjalë të të përshkruaj ty. Ti më ke qëndruar pranë çdo moment dhe më ke ndihmuar të kapërcej të gjitha vështirësitë me të cilat jam përballur. Asnjëherë nuk ke hezituuar të plotësosh dëshirat e mia. Prej teje kam mësuar se çfarë është respekti, çfarë është edukata, çfarë është dashamirësia dhe shumë e shumë të tjera. Përveç se një baba i mrekullueshëm, ti je edhe një bashkëshort, vëlla dhe djalë shembullor. Nuk e di se si të të falenderoj për gjithçka që ke bërë për mua, por di të them se jam njeriu më fatlum në botë që të kam.

Alvi Kalia 9E

Prindërit janë njerëzit më të shtrenjtë për ne. Kanë qenë ata mbështetja jonë e parë. Janë ata që na kanë zgjatur dorën të parët për të na ndihmuar. Janë ata njerëz, nga të cilët merr dashuri të pafundme dhe që të duan me çdo të mirë dhe defekt që ke. Babai është një hero për mua, në plot kuptimin e fjalës. Edhe pse nuk ka imazhin e një heroi, në mendjen time kam atë përfytyrim, nga ajo që shpreh ai. Ka qenë, është dhe do të mbetet njeriu më i rëndësishëm i jetës sime. Me atë gjithmonë ndiej mbështetje dhe sigurinë që tek askush tjetër nuk gjendet. Është personi që më ka dhënë kurajo e forcë në rastet më të vështira që kam hasur. Më ka mbështetur në çdo aspekt. Vajzat dhe baballarët e tyre janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Jo vetëm që ka qenë një baba shumë i mirë, por edhe një shok i mirë gjithashtu. Ai gjithmonë më jep këshilla shumë të vlefshme. Ai është heroi që e kam në krah gjithmonë dhe kurdoherë. Është miku im më i mirë. Është personi që më llaston më shumë, duke më plotësuar çdo dëshirë. Unë mundohem që t'ia shpërblej atij, edhe pse nuk ka shpërblim aq të madh për çdo gjë që ka bërë për mua. Do mundohem shumë edhe në të ardhmen që ta bëj krenar.

Amela Agastra 9E



Babai, personi ku do të mbështetem gjithmonë

Babai, personi që të do pa interes, i vetmi që është gati të sakrifikojë çdo gjë, që ti të kesh një të ardhme sa më të mirë dhe të mbushur me dashuri dhe suksese nga më të ndryshmet. Figura e tij, nuk do të ndryshojë asnjëherë për mua, pavarësisht viteve që do të kalojnë, ai do të mbetet njeriu më i dashur, më i përkushtuar, i gatshëm të bëjë çdo gjë për mua dhe familjen tonë. Dëshira e tij më e madhe është lumturia e familjes, ndaj ai është heroi im, personi ku do të mbështetem gjithmonë. Mbase nuk kam qenë gjithmonë ashtu siç ke dashur ti, por asnjëherë nuk kam dashur të të mërzit ose të të bëj të ndihesh keq për mua. Nuk mund të gjej dot fjalët e duhura për të shprehur sa mirënjohëse jam për çdo gjë që ke bërë për mua, prandaj po të them që të dua shumë dhe do të të dua përjetë, sepse je një nga personat më të shtrenjtë në jetën time që më do vetëm të mirën dhe nuk më shikon dot të mërzitur, sikurse edhe unë nuk të shoh dot të mërzitur prej gabimeve të mia, prandaj do përpiqem të bëhem vajza ideale për një person ideal si ti.

Anxhela Reçi 9E



Babai është ai person, i cili më mbështet në çdo moment, më qorton atëherë kur duhet, ai që më ndihmon në çdo situatë. Në këtë botë jam i sigurt që çdokush mund të më hedhë tutje, çdokush mund të më zhgënjëjë, çdokush mund të më tradhëtojë, por ti, ti kurrë. Ti bashkë me kohën, keni treguar se ti nuk jeni si gjithë të tjerët. Je më i veçanti, je ai njeriu besnik që gjithmonë më ndihmon.

Ergi Kupi 9E

Shpeshherë kam shkruar për mamin, kam krijuar ese e poezi me fjalë nga më të bukurat, por kurrë nuk kam krijuar diçka për babin. Shumicën e kohës unë zihem me të, ndoshta për fajin tim apo ndoshta, sepse ai nuk më kupton, por dhe për këtë të fundit, nuk i vë shumë faj, pasi ai është rritur në një kohë komplet ndryshe nga kjo që po rritem unë. Pavarësisht kësaj, babi im është një njeri tepër i fortë, me shumë guxim dhe ambicie. Ai ka bërë shumë për mua dhe familjen tonë, për çdo gjë ka qenë i gatshëm dhe nuk është ankuar asnjëherë për asgjë. Edhe pse zihemi shumë për gjëra koti, edhe për faktin se kemi të njëjtin karakter e të njëjtat vese, sepse siç më thonë jam "kopja e tij", unë e dua shumë babin dhe për mua gjithmonë do të jetë mashkulli më i rëndësishëm e më i pazëvendësueshëm në jetën time.



Çeljeta Hodo 9E

Me këtë poezi, dua të të jap pak gëzim.
Sa do të doja të isha trim, njësoj si babi im!
Njeri i dashur dhe me shumë durim,
një shpirt luftëtari dhe një zemër prej ari.

Gjithmonë në shkollë doje të isha i pari,
por shpresoj që këtë poezi kur ta kesh në duar,
sadopak ty të të kem gëzuar.

Virtyte dhe të mira gjithmonë më mësove,
për të më këshilluar mua, asnjëherë nuk përtove,
dhe shumë sakrifica për mua durove.



Edor Shehu 9E

Vetëm për ty babi

Babai, ai person, i cili gjithmonë të do të mirën, që na mbështet, na jep siguri, që na frenon ende pa hedhur hapin e gabuar. Edhe pse mund të të kem mërzitur ndonjëherë, ti ke qenë i gatshëm të më falësh, gjithashtu ka pasur edhe raste kur unë jam mërzitur me ty dhe ti përsëri je munduar të më kuptosh dhe të më bësh të lumtur. Kërkon që gjithmonë të jem e saktë në atë që bëj dhe gjithmonë më mban afër, pavarësisht gabimeve të mia. Je shoku im më i mirë, personi që më kupton dhe më drejton drejt të mirave të kësaj bote, je i vetmi të cilit mund t'i besoj për çdo gjë. Ti gjithmonë më ke treguar historitë e tua të fëmijërisë, dhe sa herë flasim për to, kuptoj sesa shumë ne ngajmë. Nuk kam fjalë të përshkruaj sa të dua dhe sa mirënjohëse jam për çdo gjë që ke bërë për mua, prandaj dije se të dua, shumë madje. Je hero, idhull, shpëtimtar, shoku im më i ngushtë, por mbi të gjitha je babai im. Të dua shumë babi!

Emanuel Goga 9E

Babi, je një nga njerëzit më të veçantë që njoh. Je i vetmi person, që më njeh dhe më kupton, qoftë edhe me një vështrim që unë hedh në cilindo cep të dhomës. Gjithmonë e ndiej praninë tënde, edhe kur ti nuk je aty. Gjithmonë e ndiej dashurinë tënde edhe kur ti je i zemëruar me mua. Je ai që më ngre humorin kur jam e mërëzitur. E di që mua më ke përkëdhelur më shumë se vëllanë edhe e di që shpeshherë ti edhe zihesh me mamin për këtë gjë. Mbaj mend që dhoma ime ishte gjithmonë e mbushur me lodrat që unë kërkoja, se ti gjithmonë i plotësoje tekat e mia. Kur isha e vogël, ti ishe gjatë gjithë kohës në punë dhe mua më merrte malli pafund. Pastaj bëhesha xhelozë kur lindi vëllai dhe ti e kishe gjithmonë në krahët e tu. Por tani e kuptoj, e kuptoj që edhe pse ti shpenzoje më shumë kohë me vëllanë, dashuria për mua nuk të iku asnjëherë. Je dhe do të jesh gjithmonë personi më i afërt për mua, personi që gjithmonë më ka qëndruar dhe e di që do vazhdos të më qëndrosh pranë, pavarësisht gjithçkaje. Je jo si një hero, por një hero i vërtetë për mua. Asnjëherë nuk do të më duhen fjalë për të përshkruar atë që ti simbolizon për mua. Edhe tani që jam rritur pak, pavarësisht të gjithave, je personi me të cilin mund të flas pa mbajtur doreza. Ndodh që shumë herë kam dëshirë të shoh fotografitë kur isha e vogël dhe e shoh mënyrën se si të shkëlqejnë sytë kur më ke në krahë. Shoh edhe krenarinë që përcjell kur je me mua. Më ke thënë shumë herë se unë jam shpresa jote, drita e syve të tu. Je një nga personat e vetëm, të cilët dua që të mos i zhgënjej asnjëherë, as për gjërat më të vogla. Të dua, të dua pafund dhe fjalët nuk kanë për të mjaftuar kurrë për të të thënë atë që ndiej.

Enisa Dalipi 9E



Babai im
 Babai im, je idhull për mua,
 Je hero, je shembull në rrugën që ndjek.
 Ti ke qenë gjithmonë atje për mua në çastet më të vështira.
 Kritika jote më ka ndaluar të bëj gabime, je këshilluesi më i saktë.
 Të dua shumë, sepse jam djali yt dhe kam gjakun tënd.
 Më kujtohen ato momente, kur më mësove të ngas biçikletën,
 të notoja dhe gjithashtu më ke mësuar të mposhtja frikën nga çdo gjë.
 Ti ishe ai që më mësoi të shikoja botën ndryshe dhe të përballoja sfidat e jetës.
 Gjithmonë do jem krenar që të kam baba, sepse je babai më ideal.
 I tillë do mbetesh edhe në kujtesën time.

Gerti Tarka 9E

Babai, Dielli im

Baba.... Ti ishe ai, i cili çdo ditë përkujdeseshe për mua dhe më këshilloje si të veproja në çdo situatë, më merrje në prehër pa u lodhur dhe më thoshe se nuk duhet të hidhja mbeturina në vende jo të përshtatshme apo se nuk duhet të ngisja makinën kur isha 5 vjeç. Ti je busulla, dielli im në çdo skutë ku humbas, dhe më nxjerr menjëherë nga rruga e padrejtë. Unë trashëgoj mbiemrin tënd, i cili më bën fisnik dhe krenar. Je përpjekur për vite me radhë jashtë Shqipërisë, vetëm që të na sillje në jetë. Ndoshta afërsia ime me ty, nuk është aq e afërt sa me mamin, sepse me mamane i diskutoj më shumë problemet tona të përditshme, por këto gjëra që po të them tani po burojnë nga zemra ime, e cila nuk duron dot të më braktisë në këtë rrugë që sapo kam filluar. Baba, ti më ndihmon që këtë odise ta kapërcej gjithmonë, këtë rrugë të gjatë e të dhimbshme, e cila më shqetëson sa herë ti nuk ndodhesh pranë meje. Unë e di se pavarësisht sa më bërtet, ndoshta për gjithçka, nga ana tjetër je një shembull i jetës sime. Unë jam pasqyra jote. Kur kridhem në ujin e kulluar të liqenit, fytyra jote më pasqyrohet pa e ditur as vetë. Nëse ti nuk do të ekzistojë, as unë nuk do të isha ky që jam sot. Sa e mangët është ajo fëmijëri, e cila jetohet pa ba-ba! E kush mund të jetë i lumtur pa baba? Asnjë! Sepse gjendja financiare sigurohet më shumë nga babai, ai na ngre çatinë sipër shtëpisë sonë, e cila fillon të mos pikojë me, përpos të mirave materiale, burimi i gjendjes sime shpirtërore je TI. Prijësi im, drejtuesi im, udhëheqësi im, dielli im, drita ime Baba, ti je JETA ime në këtë botë!

Fatjon Hodo 9E



Për çdo vajzë babai është mbreti i saj, personi të cilin e quajmë hero, ai që na llaston, na sheh si princeshën e tij. Babi im gjithmonë ka qenë pjesë e rëndësishme e jetës sime dhe do të jetë. Që kur kam qenë e vogël nuk më ka munguar kurrë gjë, ai ia hiqte vetes dhe mendohej të më siguronte mua dhe vëllait tim një të ardhme sa më të mirë. Babanë tim e shoh si një idhull, si një person nga i cili duhet të merret shembull në çdo aspekt. Në moshën 15-vjeçare, ai më ka mësuar shumë gjëra, njëra nga ato është të mos heq dorë kurrë nga ajo që dua të arrij. Ai është shoku im i ngushtë, me të mund të flas për çdo gjë.

S'do të isha këtu pa të, pa ndihmën që më ka dhënë. Për mua ai do jetë gjithmonë njeriu më i rëndësishëm. Faleminderit babi që ke qenë gjithmonë pranë meje kur kam pasur nevojë!

Greis Alla 9E

I dashur babi, je njeriu me i rëndësishëm në botë. Më ke ndihmuar për çdo gjë që kur kam qenë i vogël. Je një nga njerëzit më të rëndësishëm në jetën time. Sa herë kam qenë i mërzhitur ti ke qenë atje për të më ndihmuar. I dashur babi, për mua je një nga gjërat më të rëndësishme në jetë. Vitet kalojnë, ne rritemi dhe kuptojmë më shumë. Më ke ndihmuar shumë që kur kam qenë i vogël. Ndihej i lumtur që je babai im!

Erik Kadhe 9E



I Dashur Baba,

Je njeriu më i mirë dhe më i dashur në botë. Nuk ta them se je babi im, jo, por ta them nga thellë brenda zemrës sime. Ti ke qenë pranë në çdo moment kur mua më duhej ndihma jote, në çdo moment kur ti e ndieje që unë isha i mërzhitur, ti ishe aty pranë meje. Sot po ta shkruaj këtë letër, sepse ti je heroi im, çdo problem që unë kam hasur e kemi diskutuar bashkë. Tani ti je duke u plakur dhe ajo më trishton shumë, por diçka ta dish, që unë gjithmonë do të ndihem i lumtur kur ti të jesh pranë meje. Ndihej mirë kur të shoh, ndihem mirë kur më flet, ndihem "unë", kur më shikon, ndihem mirë kur më përqafoj, ndihem mirë në çdo hap që hedh.

Klevis Meçaj 9E



Babai im

Shumë njerëz i japin rëndësi vetëm nënës dhe harrojnë që çdo person, çdo fëmijë ka dy prindër. Përveç nënës kemi edhe babanë, kemi atë person që njëloj si mami silitet për ne. Për shumë fëmijë, ai ndoshta nuk mund të jetë prezent kudo dhe kurdoherë që e duam ne, po kjo nuk do të thotë se ai mungon. Për mua babi has të njëjtin nivel vështirësie si mamaja, në rritjen e një fëmije. Ndoshta edhe më të vështirë. Pse? Sepse babi zakonisht mbulon pjesën financiare në familje. Përveç kësaj, ai zë dhe rolin më të rëndësishëm në familje, atë të kryetarit të saj. Këtë rol e ka pasur që në fillim të historisë. Ku shkon nëse do të të blejnë një dhuratë ose të shkosh diku me pushime? Te babai sigurisht. Pastaj të gjithë ne, ose unë të paktën po, krenohemi më shumë kur na thotë babi "Të lumtë!" ose "Bravo!" sesa kur na e thotë mami. Kjo nuk ndodh sepse nuk na pëlqejnë përgëzimet nga mami, por ndodh sepse na vijnë më bukur, më kënaqshëm, kur na i thotë babi. Arsyeja se pse ndodh kjo gjë, është tepër e dhimbshme. Pse? Sepse babi nuk na gjendet afër shumicën e kohës, sepse ndryshe nga mami ai nuk na vjen nëpër festa ose nëpër ndeshje ose gjëra të tjera si këto. Kjo sepse ai përpiqet për të na dhënë mundësinë për të qenë vetë ne aty. Jam e sigurt se atij nuk i pëlqen fakti se nuk mund të gjendet fizikisht me ne të tërë kohën, po të paktën, nëse e lejojmë ne, ai mund të gjendet me ne mendërisht, në zemrën tonë, por vetëm nëse ne i japim çelësin për të hapur drynin e asaj dërrase. Ai do të jetë gjithnjë i gatshëm për të na ndihmuar ne, me çdo gjë në mundësitë e tij. Të dua Ba!

Livia Bezati 9E

Babi, Personi Që Ishte Pranë Meje Kur Mora Frymën E Parë. Personi Që Më Mësoi Ndryshimin Mes Së Mirës Dhe Së Keqes. Personi Që Më Mbështet Gjithmonë. Ai Është Shoku I Parë Që Unë Kisha, Me Të Cilin Isha Gjithmonë E Sigurt Dhe E Patrembur. E Quaj Hero, Pasi Ai Më Mbron Dhe Më Qetëson Sa Herë Që Unë Kam Nevojë. Është Një Nga Personat Më Të Rëndësishëm Për Mua Dhe Ai Do Jetë Gjithmonë Heroi Im, Sado Që Unë Të Rritem, Unë Përsëri Do Mbetem Vajza E Tij E Vogël.

Livia Vokshi 9E



Babi Im

Ndonjëherë është e vështirë për mua t'i hedh dhe t'i shpreh ndjenjat e mia në një copë letre. Trembem se nuk do të mund të përshkruaj me fjalë atë që qëndron me të vërtetë në mendjen dhe zemrën time. Thjesht mund të them se pa babin tim, nuk do të isha ky person që jam sot, nuk do të mendoja në këtë mënyrë dhe nuk do t'i shikoja gjërat nga kjo pikëpamje. Babi për mua është një hero dhe mësues, që më ka treguar si të përballem me vështirësitë e jetës, si të përpiqem për të qenë version më i mirë i vetes dhe se si të kuptoj gjërat që kanë me të vërtetë rëndësi. Jam shumë krenare për babin tim! Sa herë që dëgjoj të lavdërohet për punën, karakterin dhe arritjet e tij, mbushem me një lumturi të paimagjinueshme, por diku thellë në zemrën time ekziston një lloj mërzie ose më saktë një lloj zhgëjimi se kurrë nuk do të arrij në nivelin e babit tim, kurrë nuk do të bëhem aq e zonja sa ai dhe kurrë nuk do të mund të imagjinoj gjithë vështirësitë dhe aventurat që ka kaluar ai në jetë. Për mua babi është personi që respektoj më shumë në të gjithë botën. Jam e bindur se mund të rri me orë të tëra duke dëgjuar historitë e tij për kohën kur jetonte në fshat. Ai më ka folur me aq krenari dhe nostalgji për lojërat e tyre në natyrë, si edhe për ngjarjet e pabesueshme që ndodhnin çdo ditë në fshat, si të marra drejt nga libri i "Tom Sojerit"-it. Mendoj se nga ai kam marrë një dashuri të veçantë për natyrën, për kafshët si edhe për artin.

Babi, nëse e lexon këtë shkrim dua të të them diçka:

Faleminderit që më ke rritur, faleminderit që më mësove si të dua natyrën dhe jetën me anë të historive të tua, që do t'i mbaj mend përgjithmonë! Faleminderit që e ke plotësuar çdo dëshirë timen dhe gjithmonë ke menduar për të mirën time, të mamit dhe të Onit! Thjesht faleminderit për punën dhe përkushtimin tënd çdo ditë! Të dua shumë!

Megan Duraj 9E

Për babanë tim

Je babai më i mirë për mua, më i miri që mund të përzgjedhja. Ke qenë gjithmonë pranë meje dhe më ndihmon gjithmonë në detyra dhe në sporte. Këshillat që ti më jep për jetën dhe të ardhmen, janë nga më të vlefshmet që një fëmijë mund të marrë nga prindi i vet. Bashkë ia ka-ojmë shumë mirë dhe momentet më të bukura e më gallatë janë gjithmonë ato që kaloj me ty. Ti je gjithmonë aty, si në çastet e bukura dhe në ato më të këqijat. Të kujtohet kur më mësove skitë? Ato mbeten momentet dhe kujtimet nga më të bukurat e të paharruarat për mua. Jam shumë i lumtur dhe krenar që të kam baba!

Kristi Civici 9E



I dashur babi!

Sot dua të flas për ty. Mund të them që kjo është hera e parë që unë shkruaj për ty, për babin tim të shtrenjtë, për një ndër njerëzit më të rëndësishëm të jetës sime. A e mban mend babi kur unë isha e vogël dhe ti luaje me mua? Luanim orë të tëra, këndonim, më lexoje përralla, dilnim shëtitje bashkë. Gjithmonë i mburresha shoqeve për babin tim dhe i thoja që ti ishe babai perfekt dhe se sa i dashur ishe me mua. Nuk je lodhur asnjëherë, ke bërë gjithçka që unë të isha e lumtur. Mbase edhe je lodhur, por ti e fshihje atë me buzëqeshjen tënde të ngrohtë, që më bënte mua të ndihesha e lumtur. Ti je personi që ven-dos lumturinë në shtëpinë tonë. Ti je shumë gazmor, na bën të qeshim në çdo moment. Ndonjëherë më ngjallin kuriozitet gjërat që thua ti, ato janë aq interesante, sa mund të të dëgjoj orë të tëra pa u lodhur. Dhe ëndrra ime është që unë të bëhem një njeri si ti, sepse ti babi im je idhulli im, je shembulli që unë dua të ndjek. Ndoshta tani që jam rritur, nuk kalojmë shumë kohë bashkë. Ti punon më shumë, dhe unë kam më shumë mësim. Por mos harro babi, se dashuria ime për ty, nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë kurrë. Mund të them fjalë pa e kuptuar se të mërzit ty, mund të bëj gabime që ti nuk do të ndiheshe krenar, por mbaje mend që ti je njeriu më i shtrenjtë i zemrës sime dhe unë nuk do të doja kurrë të të lëndoja ty. Ti babi nuk je vetëm një baba i mirë, por ti je dhe një bashkëshort i mirë. Ti e bën mamane time të lumtur dhe unë të jam shumë mirënjohëse për këtë. Ju të dy jeni njerëzit që më doni pa kushte dhe që mërziteni edhe për gjënë më të vogël që më ndodh mua. Edhe unë nuk dua t'ju shoh të mërzitur. Dua t'ju bëj krenarë. Por të premtoj babi, se unë do të bëhem dikush në jetë, dhe se do të vazhdoj rrugën tuaj, atë rrugë të drejtë, që më keni vendosur përpara. Do të ndjek shembullin tënd babi. Ti babi, je heroi im!

Me shumë dashuri Vajza jote e dashur, Megi.

Megi Lamçe 9E

Baba, ti je personi më i mirë që njoh. Ti je ai që më merr me vete kudo, ti je shoku im më i mirë. Ti je ai që më mbështet në çdo moment. Me ty ndaj çdo sekret. Ti je personi më i dashur për mua, me ty bëj çdo gjë të bukur. Ti je ai që më kupton vetëm me një vështrim, më kupton direkt kur gënjej, kur them të vërtetën, gjithçka. Gjithmonë më merr me vete kur del, edhe nëse je me shokët apo jo. Ndonjëherë më vjen shumë keq kur të mërzit, sepse kur kujtoj që çdo ditë punon shumë për ne, lodhesh aq shumë që të na plotësosh dëshirat, të na shkolloshe mua dhe motrën. Të dua aq shumë sa nuk di si të ta them, sepse nuk është me të thënë, por është me ndjenjë. Të dua shumë o ba!

Metjon Agastra 9E



Babi,

Shumë shpesh mbyllem në vete, ulem dhe mendoj përse kam kaq shumë shpesh konflikte me ty. Pyes veten pse asnjëherë nuk kam qenë ajo "vajza e babit", që shumë shoqe të miat thonë se janë. Vras mendjen, çfarë kam unë ndryshe? Kaq e keqe jam? Që kur kam qenë e vogël, që kur im vëlla erdhi në jetë, gjithmonë kam menduar se ti ke dashur më shumë atë. Të kujtoj o ba.... Të kujtoj përse atij i ke qëndruar më shumë në kokë sesa mua. Gjithmonë sa herë vjen nga puna, kam imagjinuar sikur do hapje krahët për të më puthur e përqaftuar, por kjo nuk ndodh. Ke qenë përherë serioz, ashtu siç akoma vazhdon të jesh. Unë e di shumë mirë se ç'vajzë jam dhe ti e di shumë mirë se ç'fëmijë ke. Nuk jam vajza që ti meriton o ba, e di këtë gjë, por dua vetëm që ti ti dish këto rreshta: Për mua si fëmije nuk ka kënaqësi më të madhe, sesa të të shikoj ty të lumtur. Falë teje unë jam një individ në tokë sot. Po aq sa je serioz, po aq të madhe ke dhe zemrën. Aq sa më vlen përqaftimi nga duart e tua të ngrohta, s'më vlen asgjë tjetër. Babi, faleminderit që zgjodhe të jesh prindi im. Në gjithë jetën time, nuk kam njohur njeri më të fortë, më guximtar dhe më të dashur. Unë nuk di të shprehem prandaj ndoshta duket sikur i kam fjalët me kursim. Faleminderit babi! Nga shtatë bilonë njerëz në këtë botë, ti je im atë. Ti je pasuria dhe vetë gjëja më e shenjtë që unë kam. Nuk ka krenari më të madhe në këtë univers sesa ti! Të dua shumë!

Nadia Kola 9E



Je njeriu më i dashur për mua. Ti më ke qëndruar pranë sa herë që kam pasur nevojë. Gjithmonë kur jam hasur me vështirësi ti më ke ndihmuar. Çdo problem e kemi kaluar bashkë. Ti më ke mësuar gjithçka që unë di. Ti më ke mbështetur në çdo vendim që kam marrë. Gjithmonë kur gaboj, ti më kritikon që unë të përmirësohem dhe të bëhem një njeri më i mirë. Ti je njeriu më i rëndësishëm në botë për mua. Të dua shumë.

Ted Likaj 9E

Për ç'arsye çdo familje formohet nga dy të rritur, nga mami dhe babi? Epo ja, unë ju them që jeta ka dy faza. Tek e para kujdeset mami, e cila të tregon ç'është dashuria dhe gëzimi, ajo që të prezanton me botën ku ti do të kalosh pjesën tjetër të jetës tënde. Kjo është faza e parë. Faza e dytë, është ajo më e gjata dhe më e vështira nga të gjitha. Kjo fazë të prezanton ty me vështirësitë dhe rreziqet e jetës dhe personi që të drejton ty gjatë kësaj rruge, nuk ka kush të jetë tjetër, veçse babai. Ai është personi që në raste problemesh të gjendet gjithmonë pranë dhe në raste nevojë është i pari që i përgjigjet thirrjes tënde për ndihmë. Ai ka qenë gjithmonë aty, që në fëmijëri, por ai nuk kërkon para ose ndere për ato që bën. E vetmja gjë që ai kërkon është që ti të jesh i zoti i vetes me ose pa të, fiks si një hero.

Paolo Gurakuqi 9E



Babai, Idhulli Im

Është shumë e vështirë të gjesh fjalë për ta përshkruar babanë. Kur dëgjoj fjalën e ëmbël baba, në mendje më shfaqet një imazh i adhureshëm e i përsosur, pa të meta. është një person shumë i afërt me mua, që nuk lodhet nga gabimet e mia, e më mbështet dhe këshillon në vendimet që marr gjatë jetës. Ai ka qenë gjithmonë atje për mua, në çdo çast të gëzueshëm e të hidhëruar... Unë jam shumë me fat që të kam. Ti ke qenë përherë atje për mua, që në çastin e parë që hapa sytë, që hodha hapin e parë e deri sot. Ai është idhulli im... shembulli që unë dua të ndjek gjatë gjithë jetës. Babai më ka mësuar se si të jem e matur, e kujdesshme dhe shpirtgjerë. Ai mundohet të ma ngrejë gjithmonë humorin e të më bëjë të qesh... Nuk ka fjalë ta përshkruajnë sa shumë e dua babain tim. Mund të mos e shfaq dashurinë time gjatë kohës, por e dua pa masë atë... Baba, të uroj nga zemra gjithë të mirat e botës dhe unë të dua pafund. Je heroi im... idhulli im. Të dua pafundësisht. Vajza jote Anisa.

Anisa Murataj 9F



Një fjalë e vetme, me katër shkronja, nënkupton botën për mua. Ajo është fjala "BABI".

Elvis Morina 9F



Sado të mundohem të përshkruaj babanë tim dhe atë që unë ndiej për të, asnjëherë nuk gjej fjalët e duhura. Prandaj nuk do të zgjatem. Thjesht i kërkoj falje për çdo herë që e kam mërëzitur me gabimet e mia prej mendjelehtësisë, dhe i them se e dua pafundësisht shumë. Do jesh gjithmonë idhulli im dhe shembulli i duhur për t'u ndjekur.

Darlin Muka 9F

Habibi, je personi më i zgjuar, më guximtar dhe më supergallatë që njoh. Gjithmonë kam dashur të të ngjaja nga kjo pjesë. Më fal sa herë të kam mërzhitur, po ti e di si jam. Të falenderoj për çdo gjë. Të dua shumë, o ba!

Dea Gjermani 9F



I shtrenjti baba, me shumë mirënjohje më dalin këto fjalë nga shpirti. Je idhulli im, je heroi im, je shembulli më i mirë në rrugën që unë ndjek. Je shoku më i denjë që kam, je mirëkuptuesi më i mirë për mua. Në çdo çast të vështirë që kam kaluar gjithmonë ke qenë si një busull drejtuese për mua. Je këshilluesi më i saktë! Ti më bën të mos gaboj kurrë në jetë!

Eneo Imeraj 9F



Për Ty Babi

Qenia jote gjithnjë më ka ndjekur,
që i vogël, në hapat e parë,
Rastësisht, edhe vetë pa e ditur,
si idhull ty të kam marrë.
Sado që tani disi jam rritur,
te ti gjeta mbështetjen e parë,
përveç saj dhe gjithçka tjetër,
madje edhe një sup për të qarë.
Në të ardhmen e largët a të afërt,
kur koha që kalon sjell pasojat e saj,
gjithnjë pranë teje do të mbetem,
ba, me ty do qesh, me ty do qaj!

Erik Kaçani 9F



Nuk ka nevojë për shumë fjalë të kota, të tepërta.
Babai është inspirimi im ...

Ervis Allushi 9F



Babi im, më i miri në botë! Të dua fort!

Geri Lufi 9F



Babë, është fjala e parë e thënë nga unë, kur sapo kisha filluar të flisja. Babai është krijesa më e dashur për mua, është ai i cili ka bërë çdo gjë që unë të jem ky që jam sot. Edhe pse unë e kam mërzhitur shumë atë, ai prapë më do mua shumë dhe ai është idhulli im. Të falenderoj për çdo gjë që ke bërë për mua, se falë teje unë po ndryshoj dita ditës. Babi të dua shumë dhe je ti ai që më ke mësuar se si t'ia dal vetë mbanë.

Florjan Çollaku 9F

Çdo njeri e ka një idhull dhe ky idhull për mua është babai im. Në shpatullat e tij, unë gjeta mbështetje, e cila më shoqëron në çdo hap të jetës. Të ndjek një shembull si babi im pa dyshim është një rrugë e cila nuk njeh gabime. Një rrugë e cila ndriçon vetëm të mirën, virtytet e vlerat e një njeriu të formuar në jetë. I rritur në Pogradec, me plot vullnet dhe mund, ai arriti që të bënte një diferencim nga prapambetja dhe të ndërmernte një edukim tejet të mirë. Babi im ndoqi rrugën e arsimit, e cila e përkrah dhe e nderon atë gjatë gjithë jetës. Këtë gjë ai më thotë edhe mua. Përkrahja e tij më e fortë tek unë është arsimi. Ai thotë gjithmonë se arsimi, është një nga investimet më të mëdha që mund të bësh në mendjen e njeriut, pasi mbetet gjithnjë aty. Me shumë vullnet dhe punë ai arriti që të realizonte ëndrrën e tij, të bëhej një kirurg. Babai im gjithnjë ka studiuar për të pasur një arsim më të zhvilluar dhe gjithashtu një vizion tjetër për një jetë me shumë mundësi. Puna e tij shkakton shumë stres, pasi është një punë e cila ka vendime për jetë a vdekje dhe një doktor gjendet gjithmonë në trysinë e një presioni të shkaktuar nga vetë humaniteti i tij i pa masë. Edhe pse gjatë punës ai haset me shumë stres, gjithnjë vjen në shtëpi i lumtur dhe gati për çdo ndihmë që mund të na nevojitet. Ai ka shpenzuar shumë kohë në punë, kur ka qenë në fillimet e punës së tij si mjek, duke menduar për të ardhmen e tij dhe mënyrën se si do ta strukturonte punën e tij, kur ai të krijonte një familje. Çdo gjë e planifikuar nga ai është perfekte, duke nisur që nga mënyra se si ai e organizon kohën e tij të punës për të shpenzuar kohë me ne, deri te kujdesi dhe edukimi që na ofron. Babai im e meriton vërtet fjalën "HERO".

Henri Olldashi 9F



Babai. Për botën mund të jesh vetëm një njeri i thjeshtë,
Po për mua je gjithë bota. Të falenderoj baba...

Samuel Rakipi 9F



Babi, shoku im më i mirë, përkrahësi im më i madh, njeriu më gallatë, më punëtor dhe më i mirë që njoh. Shpesh s'e tregoj, por jam me fat që po rritem nga një njeri me kaq shumë vlera dhe mezi pres të ndjek hapat e tu. Je njeriu më pozitiv që njoh dhe gjithmonë sheh anën e mirë tek gjërat. Në vendin më kot që mund të jemi, ti e kthen në gallatë dhe të gjithë kënaqemi. Në situata të ndryshme, ti i merr me sportivitet dhe je shumë i qetë, kështu, duke përdorur zgjuarsinë tënde, ti zgjidh çdo gjë. Ty të duan dhe të respektojnë të gjithë dhe një ditë shpresoj të bëhem si ti. Edhe pse s'e them shpesh, vërtet të dua më shumë se gjithë bota.

Lora Lika 9F

Babi je idhulli im! Je ai që më je gjendur pranë në çdo moment, të vështirë apo të thjeshtë. Ti je pasqyrimi im dhe jam krenar. Do bëj gjithmonë më të mirën që ti të ndihesh krenar për mua. Je prindi që çdokush do ta dëshironte të kishte dhe unë jam me fat që të kam. Ti je frymëzimi im. Nga ti jam ky që jam sot. Këto mund të duken fjalë të thjeshta, por vijnë nga thellësia e zemrës sime. Babai, idhulli im...

Leonard Kollçaku 9F



Babushi im

I shtrenjti babushi im. Jam unë vajza jote e parë dhe e vetme, ajo vajzë që përpiqet të të bëjë ty krenar. Jam shumë krenare për ty, për edukatën dhe kulturën që më ke dhënë. Gjithë jetën tënde po punon për familjen, duke punuar pa pushuar asnjë ditë, duke më plotësuar çdo dëshirë, duke më dhënë të gjitha kushtet. Babush, kur të dal në jetë dhe kur të bëhem prind, do të të kem gjithmonë në mendje duke më treguar rrugën e drejtë për të ardhmen time. Babushi im, jam shumë krenare dhe e lumtur që kam një njeri si ti në jetën time. Babush, ti dhe mami, jeni pasuria ime. Ju dua pafund. Vajza juaj Lieli.

Liel Dojaka 9F



Babai im më dha dhuratën më të madhe që mund të dhurohet: Besimin e tij tek unë. Besimi i babait me jep forcë dhe kurajo ditë për ditë për të ecur në jetë, duke synuar gjithmonë më të mirën, sepse siç babi më ka mësuar: Unë Mund Të Bëj Gjithçka! Gjithçka...!

Loren Llagami 9F



Babi, dëshiroj që nëpërmjet këtij shkrimi të të falenderoj për çdo gjë. E di që nuk ndodh shpesh të shfaq emocionet e mia dhe mbase këtu gabo, por sot do ta bëj. Je një person i gjendur dhe shumë i dashur për të afërmit dhe gjithë shoqërinë tënde. Je një person që jep ç'mundesh nga vetja shpesh edhe pa pritur diçka në rikthim, por ky fakt nuk të ka shqetësuar ndonjëherë. Je një mentor që të lë pa fjalë me historitë e eksperiencat e tua. Je një baba që nuk ta prish ndonjëherë qejfin. Je ai që ke fituar çdo gjë që jeta të ofron; Prapë se prapë shfaqesh modest e i thjeshtë. Tregohesh i matur e i ditur, por gjithmonë i patrembur. Je arsye për të ecur përpara! Je shembulli im më i mirë!

Marin Shpata 9F

Ba... Nuk di çfarë të shkruaj për ty. Mbase kjo vjen si rezultat i sasisë së panumërt të gjërave që dua të të them. Bishtat e mendimeve ndërpresin pamëshirshëm njëri-tjetrin. Nuk më vjen keq. Ba... Ndoshta e ke vënë re që s'të kam thënë ndonjëherë të dua. S'të kam thënë, se nuk u besoj fjalëve të ëmbla. Nuk besoj se kanë të njëjtën peshë me veprat e prodhuara nga dashuria ime e pagojë për ty. Nuk mund t'i them, por di t'i shkruaj. Kjo më pëlqen te shkrimi, se mund të konkretizoj gjëra që goja ime e akullit nuk i nxë t'i thotë. Nuk më vjen keq. Ba... Ndoshta ti e di që pjesa ime e preferuar e ditës është mëngjesi. Kjo periudhë e hareshme për mua simbolizon gjallëri, ngrohtësi familjare dhe mbi të gjitha, bashkim. Në kontrast, terri paraqitet në sytë e mi si i dërguari i ligësisë, i dërguari i vetmisë. Ti nuk e di sa e vetmuar jam, kur ti nuk je. Do të doja të isha përkrah teje në fushëbetejë, duke u kacafytur me padrejtësitë që na garanton kjo jetë, por s'jam. Nuk më vjen keq. Ba... A e di çfarë shikoj unë kur hedh sytë nga ti? Nuk shikoj një baba perfekt dhe as një qenie të mbinatyrshme. E përmenda dhe më lartë që nuk t'i premtoj dot dashuritë e thëna zhurmshëm. Te ti shikoj njeriun që më bën të lumtur, edhe nëse jam e rrënuar, njeriun që më bën të qesh, edhe nëse lotët janë bërë tashmë pjesë e pandalshme e qenies time. Nuk më vjen keq. Ba... Nuk dua të imagjinoj një ditë të jetës sime pa përqafimin tënd të tejzgjatur. Të më falësh nëse ndonjëherë s'kam qenë e denjë për ty. Do të doja t'i asgjësoja ato momente të nëmura nga kujtesa e njerëzimit. Më vjen tmerrësisht keq...

Rebeka Sharko 9F



Babi, s'ka rëndësi se sa rritem, do të jesh gjithmonë shembull për mua.

Marin Çobo 9F



Babi im i dashur,
unë shumë të dua,
në gjithë botën mbarë,
Një i vetëm je për mua.
Prezenca e tij,
jetën ma bën të çmuar.
Baba, ti je personi
më i veçantë për mua.
Jeta ime pa të,
nuk do kishte kuptim,
ngaqë ai është
pjesë e shpirtit tim.

Samuel Vargu 9F

Nëse do të shkruaja një libër, do të shkruaja për një baba zemërflori dhe vajzën e tij të madhe. Te ky libër do të shprehja çastet e bukura që ata kanë kaluar së bashku, kur shkonin me pushime, lojërat që ata krijuan, përrallat që i ati i tregonte së bijës për çastet e hidhura, të cilat ishin shumë të rralla. Do të shkruaja për përkujdesjen e paharrueshme që babai i dha së bijës, për të gjitha kohërat kur babi motivonte të bijën të ecte përpara, kur e përkrahte në gjërat që ajo donte dhe e mbronte nga gjithçka e keqe. Kjo marrëdhënie kaq e rrallë dhe e bukur është motivuar nga vetë marrëdhënia ime me babain tim, për dashurinë që unë kam për të, për përkushtimin e tij dhe për marrëzirat që bëja unë, të cilat mund ta nevrikosnin atë. Por gjithnjë ishte i duruar me mua. Sot dua të shpreh se e dua pa masë babanë tim.

Ardisa Beqja 9G



Babi, nëse heroi është ai që kryen një akt sublim, atëherë nuk e di se çfarë mund të të quaj ty. Ti je ai që ka bërë gjithçka për të më bërë të lumtur. Ti ke bërë të mundur që unë të jetoja sa më mirë. Kurrë nuk më thua që je i lodhur apo i mërzitur. Më vjen keq që ndonjëherë kur ti më thua të dalim, unë të them se jam e lodhur. Pendohem shumë. Herës tjetër kur të ma thuash këtë, do të pranoj me gjithë kënaqësi. Babi, më vjen keq që të kam mërzitur ose të kam bërë të ndihesh keq, kur nuk e haja supën ose perimet që ti më thoje se më bënin më të bukur. Babi, kujtoj momentet kur ti më gënjeje për të më bërë të qeshja. Epo, tani jam rritur pak për të të kuptuar kur ti më gënjen. Babi dua të të them edhe një gjë të fundit. Unë të dua shumë babi dhe gjithmonë do të dua, sepse ti je jo vetëm babai im, por edhe heroi im!

Diona Shpani 9G



Babi, ylli që më drejton në rrugën e duhur

Babi im është një person i mirë, ai nuk gënjen, ai jeton me plot hare dhe ka shumë shokë. Ai është modeli im. Unë gjithmonë kam dëshiruar të jem si ai, nga mënyra si vishet, deri tek mënyra si jeton. Duke parë atë, shikoj një person, një baba që do të bënte gjithçka që të siguronte një të ardhme të mirë për fëmijët e tij. Shpresoj që të vijë një ditë, kur do të jesh krenar me mua dhe do të më përqafosh sa të kesh fuqi.

Enes Yusuf Bruçaj 9G



I dashur ba,

Unë jam vajza më krenare që kam ty si baba dhe shpresa ime e vetme është që një ditë ti të bëhesh po aq krenar për mua. Të falenderoj shumë për çdo gjë që ke bërë, për mbështetjen dhe dashurinë pa kufi që më ke dhënë!

Hannah Shalsi 9G

Dua të të them shumë gjëra, por kjo do të më merrte shumë kohë dhe nuk do e mbaroja dot, prandaj do të të them me pak fjalë se të dua shumë.

Arbër Sinanaj 9G



Babi,

Faleminderit që ke qenë, je, dhe do te jesh atje për mua! Faleminderit që më jep këshillat më të vlefshme! Do të doja të isha më e mirë me fjalët, por ti e di që je shumë i shtrenjtë për mua!

Hrisa Hyseni 9G



Babai im, heroi im

Kur u ula që të shkruaja këto rreshta, nuk dija çfarë të shkruaja, jo sepse nuk di çfarë të them, por sepse nuk ka fjalë që mund ta shprehin se sa i rëndësishëm je ti për mua. Ti ke qenë gjithnjë aty për mua, pavarësisht se unë jo gjithnjë të kam qenë mirënjohëse. Ti ke qenë personi i parë që unë kam respektuar, madje të kam respektuar pa e ditur se çfarë ishte respekti. Ke qenë dhe je shtylla ku unë mund të mbështetem për çdo lloj problemi që mund të kem. Kur mua më shikon të shqetësuar, më pyet çfarë ka ndodhur dhe dëgjon se çfarë kam për të thënë, pavarësisht sa i lodhur je. Ti gjithnjë vë fëmijët e tu para vetes dhe kjo për mendimin tim të bën një HERO.

Izabela Çupi 9G



"Babi - Ai mund të luajë si një fëmijë, të të këshillojë si një mik dhe të të mbrojë si një trupprojë."

Anonim.

Me këtë shprehje, unë mund të përshkruaj çdo ditë të jetës sime me babin tim. Ai me të vërtetë mund të luajë si fëmijë, jep këshillat më të vlefshme dhe ndonjëherë mund të bëhet miku yt më i ngushtë. Babi im Është Heroi Im. Dashuria që unë kam për babin tim Nuk Njeh Kufi. Babush, të dua ...!

Johara Numanaj 9G



Ti je më i shtrenjti për mua. Je ai që më ke mbështetur në çdo hap që kam bërë. Ti për mua ke një vlerë të veçantë. Edhe pse shpeshherë ti je i rreptë me mua, unë e di që ti e ke për të mirën time. Ti prapë mbetesh babai im, heroi im ... Edhe pse ti ke bërë shumë për mua, shpresoj që një ditë të kujdesem unë për ty dhe jo vetëm ti për mua...

Joni Fjora 9G

Babai, heroi im

Edhe pse ti ke bërë shumë për mua, shpresoj që një ditë të kujdesem unë për ty dhe jo ti për mua.

Klaudio Koka 9G



Babai im është një mësues, por për më tepër ai është një baba i mrekullueshëm. Unë jam djali më krenar që të kam ty si baba dhe shpresa ime e vetme është që, një ditë edhe ti të bëhesh krenar për mua gjithashtu.

Lejdion Hyseni 9G



Babi, heroi im!

Babi im i shtrenjtë, po të shkruaj disa rreshta të të them se sa krenare jam që kam prind ty. Ndonëse jam një vajzë që nuk i shpreh shumë ndjenjat e mia, doja të të thoja se pas çdo gjëje që ka ndodhur të kërkoj falje dhe të mos e humbësh shpresën se një ditë do jem dhe unë një fëmijë normal si gjithë të tjerët. Të falenderoj që ke qenë mbështetja ime! Nuk di se çfarë të them, se siç të thashë nuk jam dhe aq mirë në shprehjen e ndjenjave. Të falenderoj që je një shembull i mirë në jetën time!

Neida Meka 9G



"Unë nuk mund të mendoj për ndonjë nevojë në fëmijëri aq të fortë, sa nevoja për mbrojtjen e babait."

-Sigmund Freud-

Shpeshherë mbrojtja që më nevojitet është mbrojtja e babait tim. Baballarët tanë kanë për detyrë të jenë gjithmonë aty për ne. Çdo fëmijë ka nevojë për një krah ku të mbështetet dhe një person që të jetë aty për ta. Secili mund të jetë i dobët dhe afërsia që krijojnë me babanë e tyre mund t'i bëjë fëmijët më të fortë. Nëse e mendojmë gjatë, asnjëri nga ne nuk mund të kujtojë një situatë, kur babai ynë nuk ka dashur të na mbrojë ose nuk ka sakrifikuar sadopak për interesat dhe dëshirat tona.

Sara Hoxha 9G



Nuk jam shumë i mirë për t'i shprehur ndjenjat në letër për ty baba, por shpresoj t'i shpreh ato me njeriun që do bëhem në të ardhmen.

Rubin Sadushi 9G

Kur në duart e nënës isha,
kur thashë fjalën e parë,
në ato t'para hapa,
ishe ti, baba!

Dita-ditës të shikoja,
me admirim në sy,
dhe aq më shumë kuptoja,
sa doja të t'ngjaja ty!

Si personazh vizatimor,
je i mirë, i fortë e trim,
për çdo gjë që bëj,
Ty të kam frymëzim!

Do kemi mosmarrëveshje,
hidhërime e gëzime,
por ta dish se gjithmonë,
do jesh hero i im!

Noel Çela 9G



Babi. Për mua nuk ka fjalë për ta përshkruar, ai është thjesht unik në mënyrën e tij. Të plotëson çdo dëshirë sa herë që kërkon ti, vetëm për të të bërë të lumtur. Për babin ne jemi jeta e sytë e tij. Gjithmonë më llaston përpara motrës e vëllait, se më do më shumë se gjithçka në botë. E mbaj mend kur për 8 vjetorin më bleve dhuratën që kërkoja dhe nuk kam për ta hequr kurrë nga dhoma. Jo vetëm që më ke plotësuar çdo dëshirë, por edhe më ke mundësuar çdo gjë që një vajzë si unë ka dashur. Ndoshta nuk ke qenë pranë meje në çdo festë apo ditë të rëndësishme që kam pasur, por e di se ti do që unë të jem e përkryer në të gjitha këto gjëra. Ka raste kur je mërzitur me mua dhe mua më është shembur bota, kur mendoja se ndoshta të zhgënjeja dhe nuk do të isha më vajza më të cilën mburreshe. Sa gjëra të tjera mund të shkruaja për ty... Janë të pafundme, ama, kot nuk do të quheshe hero, apo jo? Jam krenare që jam vajza jote dhe të falenderoj për gjithçka.!

Rajna Kamberi 9G

Babai im i shtrenjtë si jeta!
 Babai im i ngrohtë si dielli!
 Babai im i artë si hëna!
 Çdo moment më lumturon.
 Ëndrrat e tij janë të pathëna,
 dëshirat e tij janë të pakta,
 pasi dëshira e tij e madhe,
 është vetëm lumturia jonë!
 Është gjithmonë pranë nesh,
 në çdo stuhi të jetës,
 fjalët janë të pakta,
 dashuria është e shumtë!
 Kur vjen fjala për babanë,
 asgjë nuk ka fund!

Riselda Veliu 9G



Faleminderit që gjithmonë ke qenë dhe je një baba kaq i mirë. Jo të gjithë kanë fatin që të kenë një baba ndërkohë që rriten. Prej teje unë kam një figurë, të cilën e shikoj me admirim. Ti më ke dhënë mjaft liri, edhe pse unë kam gabuar, por prapë ke qenë aty për të më udhëzuar se si të mësoja prej këtyre gabimeve. Unë do të jem gjithmonë mirënjohëse për çdo gjë që më ke ofruar dhe për sakrificat e tua.

Sara Likaj 9G

"Kur një baba i jep diçka të birit, të dy qeshin. Kur biri i jep diçka babait, të dy qajnë." – William Shakespeare.

Kjo është një thënie shumë e bukur, sepse tregon sa të komplikuar janë marrëdhëniet baba - bir. Babi mendohet të jetë një mentor, kështu që kur i biri rritet e i bën një dhuratë babait është një rast i trishtueshëm. Është vërtet një marrëdhënie që përfaqëson kompleksitetin e njerëzve si qenie.

Thelis Stambolliu 9G



Babi, heroi im,
më përkrah në çdo gabim,
Kur unë qesh, kur unë qaj,
Ty në mendje unë të mbaj.

Babi, heroi im,
Ti që mban çdo premtim.
Pavarësisht se ku jam,
Ty gjithmonë pranë të kam.

Babi, heroi im,
Ti më ndihmon në çdo mësim.
Dashuri ti më dhuron,
dhe mbrapsht asgjë s'kërkon.

Vikena Hidri 9G

Si një fëmijë, unë e kam parë gjithmonë babain tim si një hero. Për mua, ai ishte mjaft i fortë për të mbajtur me një dorë një mal, i gjatë mjaftueshëm për të arritur hënën dhe të ma jepte mua, dhe aq i mençur sa të dinte gjithçka për çdo gjë.

Rruga e tij nuk qe gjithmonë e shtruar, madje as në fëmijëri, që ta lejonte atë të ecte drejt pa u kërrusur nga lodhjet e punës, por megjithatë frytet e shpresës dhe mundit të tij, po jepen tani, duke e lejuar që t'i plotësojë sa më mirë ëndrrat që ruajti në zemër.

Pavarësisht çdo problemi e lodhjeje që nuk e lejon të vërë shpesh gjumë në sy, familja është gjithmonë në radhë të parë. Asnjë nga mrekullitë e kësaj bote, nuk do të ishte fitore për të, nëse s'do të ndikonte në lumturinë tonë.

